

Nr. 121

PLENUMI XVII I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 11-12 Korrik 1960

KOMUNIKATË

MBI MBLEDHJEN E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Më datën 11 dhe 12 korrik 1960, nën kryesinë e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të PPSH, shokut Enver Hoxha, u mbledh Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Plenumi dëgjoi raportin e anëtarit të Byrosë Politike dhe sekretarit të Komitetit Qendror, shokut Hysni Kapo, i cili kryesonte delegacionin e Partisë së Punës të Shqipërisë në Kongresin III të Partisë Punëtore Rumune, mbi punimet e mbledhjes së përfaqësuesve të partive komuniste dhe punëtore që asistuan në këtë kongres.

Plenumi aprovoi tërësisht dhe njëzëri qëndrimin e mbajtur nga delegacioni i Partisë së Punës të Shqipërisë në mbledhjen midis përfaqësuesve të partive komuniste dhe punëtore. Gjithashtu plenumi aprovoi komunikatën që doli nga mbledhja e përfaqësuesve të partive komuniste dhe punëtore të kampit socialist, mbajtur në Bukuresht në muajin qershor 1960. Plenumi i Komitetit Qendror shprehu edhe një herë besnikërinë e patundur të Partisë së Punës të Shqipërisë ndaj dokumentave të aprovuara nga Konferenca e Moskës e partive komuniste dhe punëtore të vitit 1957, të cilat si dhe më parë i konsideron një program luftarak në punën e saj për ndërtimin e socializmit, për forcimin e unitetit të kampit të fuqishëm socialist, me Bashkimin Sovjetik në krye, për forcimin e lëvizjes komuniste dhe punëtore ndërkombëtare, për ruajtjen e paqes në botë, për luftën kundër imperializmit dhe armiqve të marksizëm-leninizmit e në mënyrë të veçantë kundër revizionizmit modern, flamurin e të cilit e mbajnë revizionistët jugosllavë.

Besnikëria ndaj ideve fitimtare të marksizëm-leninizmit dhe parimeve të Deklaratës së Moskës e ka udhëhequr dhe do ta udhëheqë edhe në të ardhshmen Partinë e Punës të Shqipërisë në të gjithë veprimtarinë e saj.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Botohet sipas gazetës
«Zëri i Popullit», Nr.
166, datë 13 korrik 1960

Nr. 122

**LETËR E KQ TË PPSH DREJTUAR KOMITETIT QENDROR TË
PARTISË KOMUNISTE TË BASHKIMIT SOVJETIK LIDHUR
ME INCIDENTIN E KRYER NË AMBASADËN E
RP TË SHQIPËRISË NË POLONI**

MOSKË

21 korrik 1960

Muarëm letrën tuaj të datës 13 korrik të vitit 1960, që bën fjalë për incidentin e padëshirueshëm që ka ndodhur në ambasadën tonë në Varshavë, si rezultat i orvatjes së një funksionari të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës Popullore të Polonisë për të vrarë ambasadorin tonë, shokun Musin Kroj.

Ne e kuptojmë shqetësimin tuaj dhe dëshirojmë me këtë rast t'ju falënderojmë për kujdesin shoqëror dhe internacionalist që tregoni për rregullimin e mosmarrëveshjes që ka lindur midis nesh dhe shokëve polonezë në lidhje me incidentin e mësipërm, në mënyrë që marrëdhënjet midis Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Polonisë të mos çenohen, po të forcohen në interes të të dy vendeve tona socialiste dhe të të gjithë kampit socialist në përgjithësi.

Neve na vjen shumë keq që ndodhi një incident i tillë dhe kuptohet se nuk jemi ne fajtorë për këtë incident dhe për konsekuencat që rrjedhin prej tij, por përgjegjësinë e kanë shokët polonezë, të cilët nuk kanë marrë asnjë masë për të mos e lejuar një incident të tillë.

Për të qenë në korrent të çështjes dëshirojmë t'ju themi se kanë ngjarë dy incidente të rënda në ambasadën tonë në Varshavë.

1) Gjatë pritjes së dhënë nga ambasadori ynë në Varshavë në 29 nëntor 1959, me rastin e 15-vjetorit të çlirimit të Shqipërisë nga okupacioni nazi-fashist, një element i rekomanduar për shërbim në këtë pritje nga autoritetet kompetente poloneze tentoi të grabiste dokumentat shtetërore dhe t'i vinte zjarrin Ambasadës Shqiptare, por funksionarët e ambasadës sonë ndërhyjnë menjëherë, e shuan zjarrin, kapën kriminelin dhe ua dorëzuan organeve kompetente poloneze. Këtë akt diversionist, duke marrë parasysh

lidhjet miqësore që ekzistojnë në mes të dy vendeve tona, në frymë shoqërore dhe internacionaliste ja vumë në dukje verbalisht Ministrisë së Punëve të Jashtme të Polonisë, duke kërkuar që të merreshin masa për mospërsëritjen e gjesteve të tilla armiqësore karshi vendit tonë. Pas kësaj ndërhyrjeje në frymë miqësore nga ana jonë, ambasadës sonë në Varshavë ju dhanë «sigurime» formale nga ana e organeve të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës Popullore të Polonisë «se do të merreshin të gjitha masat për të mos lejuar që të përsëriteshin në të ardhshmen të tilla veprime diversioniste». Megjithatë ne konstatuam se autori i krimit të përmendur, i cili kaloi në gjyq, sa për formalitet, u dënua për aktin e tij të shëmtuar me dy muaj kondicional dhe u la i lirë gjoja si «i çmendur» ose «i pirë».

Ambasada jonë në Varshavë i është drejtuar pas këtij incidenti të rëndë tri herë me notë zyrtare Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës Popullore të Polonisë për të vënë një roje të armatosur te porta e ambasadës sonë në Varshavë, sikurse kemi vepruar edhe ne në Tiranë për sigurimin e Ambasadës Poloneze dhe të të gjitha ambasadave të tjera. Por Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës Popullore të Polonisë nuk denjoi të merrte asnjë masë për të vënë roje pranë ambasadës sonë në Varshavë duke ja lënë kujdesin e ambasadës sonë një milici, i cili ruan në të njëjtën kohë edhe shumë ambasada të tjera të huaja. Të gjitha këto tregonin për ne se Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës Popullore të Polonisë e trajtoi këtë çështje në mënyrë shumë të lehtë.

2) Në 29 qershor të këtij viti, një ish-funksionar i Ambasadës Poloneze në Tiranë dhe pikërisht shifrant i saj dhe tani, sikurse deklaroi ai, funksionar në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës Popullore të Polonisë, u paraqit dhe hyri në Ambasadën Shqiptare në Varshavë dhe, duke nxjerrë koburen, tentoi të vriste ambasadorin tonë, shokun Musin Kroj. Funksionarët e ambasadës sonë e kapën kriminelin, e çarmatosën dhe ua dorëzuan organeve të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Polonisë.

Nga këto dy incidente të rënda njëri pas tjetrit kuptohet se Qeveria e Republikës Popullore të Polonisë, sipas pikëpamjes sonë, jo vetëm që nuk e ka marrë seriozisht sigurimin e ambasadës sonë në Varshavë dhe të personelit të saj, po e ka trajtuar këtë çështje me një mungesë konsekuence të rëndë dhe me një përbuzje të palejueshme, që nuk pajtohet jo vetëm me frymën miqësore dhe internacionaliste që lidh të dy vendet tona, po as edhe me normat formale diplomatike. Mund të merret me mend se çfarë skandali ndërkombëtar do të bëhej sikur të vritej ambasadori i Republikës Popullore të Shqipërisë në mes të Varshavës nga një nëpunës i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës Popullore të Polonisë ose të digjej ambasada jonë nga diversionistët... Ne mendojmë

se këto provokacione që ngjanë nuk janë gjëra të rastit dhe janë bërë nga elementë armiq, të cilët përpiqen për të prishur marrëdhënjet vëllazërore midis dy vendeve tona. Përgjegjësia e organeve qeveritare të Republikës Popullore të Polonisë, sipas pikëpamjes sonë, konsiston në atë që nuk kanë marrë deri më sot asnjë masë serioze për të ndaluar akte të tilla provokimi kundër ambasadës sonë dhe personelit të saj.

Nota e qeverisë sonë drejtuar qeverisë poloneze është plotësisht me vend dhe karakterizohet nga një durim i madh në vështrim të zhvillimit të ngjarjeve.

Por, siç duket, shokëve polonezë nuk u pëlqen kur u thuhet e vërteta në sy dhe u kërkohet gjëja më elementare, të marrin masa për ruajtjen e ambasadës sonë dhe të personelit të saj. Ishte e arësyeshme dhe e domosdoshme për çka ngjau që ne të largonim përkohësisht ambasadorin tonë nga Varshava, deri sa qeveria poloneze të kërkonte ndjesë dhe të merrte masat e përshtatshme karshi këtyre incidenteve, që po bëheshin një vijë e rrezikshme dhe plot konsekuenca të rënda.

Qeveria poloneze nuk ju përmbajt jo vetëm normave diplomatike, po as edhe frymës miqësore dhe internacionaliste, pas këtyre dy incidenteve shumë të rënda që jo për fajin tonë i ndodhën ambasadës dhe ambasadorit tonë në Varshavë. Përveç kësaj, notë-përgjigjja e qeverisë poloneze drejtuar qeverisë sonë është hartuar me një ton përbuzës dhe në një mënyrë të tillë që le qartë të kuptohet se qeveria poloneze jo vetëm nuk ka ndër mend të njohë gabimin e vet, por as edhe të marrë masa në të ardhmen. Notës poloneze ne do t'i përgjigjemi.

Është shumë e arësyeshme ajo që thoni Ju, se kjo çështje, deri sa nuk u rregullua në vijën diplomatike, të rregullohet në vijë partie, sido që për ne çdo veprim i qeverisë përpunohet me vijën dhe vendimet e Komitetit Qendror të Partisë. Ne Ju themi se edhe këtë vijë e tentuam. Kur ndodhi incidenti në fjalë, ndodhej në Shqipëri për pushime zëvendësministri i punëve të jashtme të Republikës Popullore të Polonisë, shoku Nashkovski Marian, i cili kërkoi të bisedonte për këtë çështje në rrugë partie, si anëtar i komitetit qendror. Ne e pranuan një gjë të tillë dhe ai bisedoi me anëtarin e Byrosë Politike dhe sekretarin e Komitetit Qendror të Partisë sonë, shokun Rita Marko. Megjithëse kjo çështje u shtrua nga ana jonë me ton dhe frymë partie, zëvendësministri i punëve të jashtme të Republikës Popullore të Polonisë, shoku Nashkovski, u suall jo si njeri partie, po si një diplomat. Toni i tij ishte toni i notës poloneze dhe nuk u arrit asnjë rezultat.

Përveç kësaj ne duhet të theksojmë se shokët polonezë, në vazhdim të këtyre incidenteve të rënda, muarën edhe një masë tjetër, që nuk i përshtatet frymës miqësore dhe internacionaliste që duhet të ekzistojë në mes të dy vendeve dhe partive tona. Zë-

vendësministri polonez i punëve të jashtme, shoku Nashkovski, i cili kishte paraqitur shumë herë dëshirën të vinte dhe të pushonte në Shqipëri dhe që kjo dëshirë ju plotësua, la pushimet dhe u largua, duke i kthyer Komitetit Qendror, nëpërmjet të ambasadorit të Republikës Popullore të Polonisë në Tiranë, edhe të hollat e xhepit që i kishte dhënë Komiteti Qendror i Partisë sonë, sipas zakonit që praktikohet me miqtë kur vijnë të pushojnë, për të blerë disa kujtime nga Shqipëria. Edhe këtë akt ne nuk kemi si të mos e konsiderojmë si përbuzje të miqësisë vëllazërore që tregon Partia jonë karshi shokëve polonezë.

Ne mendojmë se incidentet e rënda dhe aktet jomiqësore në drejtim të vendit tonë tregojnë se shokët polonezë jo vetëm janë larg të njohin gabimet e tyre, por dëshirojnë gjithashtu të lozin ndaj Shqipërisë socialiste motër kartën e një shteti të madh ndaj një shteti të vogël. Sigurisht ata gabojnë adresë dhe harrojnë se populli shqiptar dhe Partia e Punës e Shqipërisë as nuk kanë lindur dhe as nuk rrojnë me mëshirën e shokëve polonezë.

Ne kurdoherë kemi dashur dhe dëshirojmë që me popullin, partinë dhe qeverinë poloneze të kemi marrëdhënje shumë të mira dhe shumë të ngushta, në frymën marksiste-leniniste, në frymën e barazisë dhe të internacionalizmit proletar dhe këtë rrugë do ta vazhdojmë me këmbëngulje deri në fund. Ne nuk kemi ndonjë kundërshtim që çështja të zgjidhet midis komiteteve qendrore të të dyja partive, sikurse rekomandoni ju me plot të drejtë, por mendojmë se i takon udhëheqjes poloneze, qoftë në rrugë partie, qoftë në rrugë shtetërore që të marrë iniciativën për të ndrequr këto gabime të rënda të saj dhe të japë garanci që në të ardhshmen të mos ndodhin.

Ne do të jemi të lumtur që Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, në interes të marrëdhënjeve midis Republikës Popullore të Polonisë dhe Republikës Popullore të Shqipërisë, në interes të unitetit të kampit të socializmit, të përdorë autoritetin e vet për të influencuar brenda mundësisë të tij pranë shokëve polonezë që t'i shikojnë marrëdhënjet me ne në bazë të barazisë, në mënyrë shoqërore, marksiste-leniniste dhe ne jemi kurdoherë gati të bisedojmë me ta për incidentin e Varshavës, sikurse rekomandoni Ju, veçse çdo gjë varet nga shokët polonezë.

Me përshëndetje komuniste.

SEKRETARI I PARË I KOMITETIT QENDROR TË
PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

ENVER HOXHA

Botohet sipas origjinalit që ndodhet në Arkivin Qendror të Partisë.

LETËR E KQ TË PPSH DREJTUAR KOMITETIT QENDROR TË PARTISË KOMUNISTE TË BASHKIMIT SOVJETIK LIDHUR ME NDËRHJRJEN E HAPËT NË PUNËT E BRENDSHME TË PPSH DHE TË SHITIT SHQIPTAR NGA DISA FUNKSIONARË TË AMBASADËS SË BS NË TIRANË

MOSKË

6 gusht 1960

Partia e Punës e Shqipërisë, në marrëdhënjet e saj me Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, është udhëhequr dhe udhëhiqet nga parimet e mëdha të marksizëm-leninizmit dhe të internacionalizmit proletar...

Populli shqiptar dhe Partia e tij e Punës janë të lidhur me miqësi të përjetshme me popullin e madh sovjetik dhe Partinë e lavdishme të Leninit, kjo miqësi është mbrujtur me gjakun e bijve më të mirë të popujve tanë dhe të partive tona dhe nuk ka forcë në botë që ta thyejë atë.

Njerëzit sovjetikë, që kanë punuar dhe punojnë në Shqipëri, qofshin këta persona zyrtarë apo specialistë e teknikë, na kanë dhënë një ndihmë jashtëzakonisht të çmueshme në punën tonë të përditshme...

Por me keqardhjen më të madhe Ju vëmë në dijeni se këto kohët e fundit, pas Mbledhjes së Bukureshtit të përfaqësuesve të partive komuniste dhe punëtores, konstatojmë një ndryshim rrënjësor në qëndrimin e disa personave që janë funksionarë të Ambasadës Sovjetike në Tiranë, qëndrim i cili nuk mund të sjellë veçse dëm në marrëdhënjet miqësore midis të dy vendeve tona dhe të të dy partive tona, sepse ka të bëjë me ndërhyrjen e hapët të këtyre personave në punët e brendshme të Partisë dhe të shtetit tonë, në kundërshtim me qëndrimin marksist-leninist që është mbajtur kurdoherë nga njerëzit sovjetikë ndaj çështjeve tona të brendshme.

Ne konstatojmë me hidhërim të madh se shoku K. I. Novikov, këshilltar i Ambasadës Sovjetike në Tiranë, jashtë çdo rregulli

partie dhe normash që përcaktojnë marrëdhënjet tona vëllazërore, është orvatur shumë herë për të mbledhur informata nga kuadrot dhe funksionarët e Partisë sonë si në Tiranë, Elbasan, Durrës dhe gjetkë, mbi çështje kaq të rëndësishme mbi Partinë tonë, siç janë ato që shqyrton Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë, të cilat kanë të bëjnë me vijën e përgjithshme politike të Partisë së Punës të Shqipërisë. Ai u ka folur kuadrove tanë të Partisë haptas kundër vijës së përgjithshme të Partisë dhe u ka bërë atyre agjitacion për t'i vënë në pozita të gabuara kundër Komitetit Qendror të Partisë sonë.

Sekretari i parë i Ambasadës Sovjetike shoku F. P. Bepallov, bashkë me ambasadorin, shokun V.I. Ivanov, dhe këshilltarin e ambasadës, shokun K. I. Novikov, me anën e metodave të palejueshme në marrëdhënjet midis partive marksiste-leniniste, kanë mundur të influencojnë negativisht në shokun Koço Tashko, kryetar i Komisionit të Revizionimit në Partinë tonë, duke e tërhequr atë në pozita të hapta kundër vijës së përgjithshme të Partisë sonë.

Një veprimtari e këtitillë është ndërhyrje flagrante dhe e palejueshme në punët e brendshme të Partisë sonë marksiste-leniniste nga ana e këtyre funksionarëve të Ambasadës Sovjetike, është veprimtari e hapët kundër unitetit të Partisë sonë dhe kundër vijës së saj të përgjithshme.

Ne jemi shumë të prekur sidomos nga qëndrimi i ambasadorit sovjetik, shokut Ivanov, këto kohët e fundit, i cili shkoi aq larg në veprimtarinë e tij jomiqësore ndaj Partisë sonë, sa që pati guximin që t'u bëjë gjeneralëve dhe oficerëve tanë, publikisht, në aerodromin e Tiranës, pyetjen e çuditshme dhe të dyshimtë: «Kujt i qëndron besnike ushtria?». Gjeneralët tanë i dhanë atij përgjigjen e duhur aty për aty dhe kanë ardhur me lotë ndër sy në Komitetin Qendror të Partisë, të revoltuar nga një pyetje e këtitillë tendencioze e shokut Ivanov dhe duke bërë pyetjen e logjikshme se përse shoku Ivanov bën një pyetje të këtitillë, përse ai të vëjë në dyshim besnikërinë e ushtrisë sonë ndaj Partisë, atdheut, popullit dhe kampit të socializmit? Për të gjithë ne është krejtësisht i paquptueshëm ky qëndrim i shokut Ivanov.

Këto fakte (dhe ka edhe shumë të tjera si këto) ne na kanë dëshpëruar pa masë. Deri më sot ne kemi bërë veshin të shurdhër dhe kemi mbyllur një sy ndaj këtyre veprimeve të këtyre funksionarëve të Ambasadës Sovjetike, dhe këtë e kemi bërë vetëm për hir të miqësisë së madhe që ekziston midis dy vendeve tona. Por tani që veprimet e disa funksionarëve të Ambasadës Sovjetike kundër vijës së përgjithshme dhe unitetit të Partisë sonë po marrin përpjesëtime të padurueshme, ne e ndjejmë për detyrë t'Ju informojmë shoqërisht, me shpresë se Ju do të merrni masat përkatëse. Këto veprime të disa funksionarëve të Ambasadës Sovjetike nuk ndihmojnë në forcimin e miqësisë që ekziston midis të dy

vendeve tona, ato dëmtojnë marrëdhënjet internacionaliste që ekzistojnë midis të dy partive tona marksiste-leniniste.

Ne e ndjejmë për detyrë që t'Ju informojmë mbi këto gjëra, të flasim me Ju haptas dhe drejt, siç kemi bërë kurdoherë, siç na mëson vetë Partia-mëmë e Leninit të madh. Ne nuk kuptojmë se përse të ndodhë një ndryshim i këtillë në qëndrimin e këtyre funksionarëve të Ambasadës Sovjetike. Ata flasin me kuadrot tanë haptas kundër qëndrimit që mbajti Partia jonë në Mbledhjen e Bukureshtit të partive komuniste dhe punëtoare dhe përpiqen intensivisht që të përçajjnë unitetin e Partisë sonë dhe të udhëheqjes së saj.

Qëndrimi i Partisë sonë në Mbledhjen e Bukureshtit është i qartë si drita e diellit. Partia jonë në atë mbledhje shprehu haptas dhe qartë pikëpamjet e veta dhe askujt nuk i lejohet që të shtrembërojë realitetin mbi qëndrimet e Partisë sonë. Ashtu sikundër në Mbledhjen e Bukureshtit ne folëm haptas dhe qartë mbi çështjet që u shtruan në atë mbledhje, ashtu do të flasim haptas dhe qartë edhe në mbledhjen e ardhshme që do të bëhet në Moskë, sikurse është vendosur nga të gjitha partitë që muarën pjesë në Mbledhjen e Bukureshtit. Nuk i lejohet askujt, për asnjë arsye, që të ndërhyjë në punët tona të brendshme për të ndryshuar qëndrimin e drejtë marksist-leninist të Partisë sonë, sikundër po orvaten që të bëjnë disa funksionarë të Ambasadës Sovjetike në Tiranë.

Partia jonë, sikurse të gjitha partitë e tjera marksiste-leniniste, ka të drejtë të ketë pikëpamjen e vet dhe t'i shfaqë pikëpamjet e veta lirisht, ashtu siç i mendon, siç na mëson Lenini i madh. Këtë të drejtë për të thënë pikëpamjet e veta lirisht Partisë sonë ja ka dhënë marksizëm-leninizmi, dhe është krejtësisht e palejueshme që të bëhen orvatje për ta paraqitur Partinë tonë sikur gjoja ajo këto kohët e fundit qenka futur në rrugë të shtrembëra, siç përpiqen «të vërtetojnë» disa funksionarë të Ambasadës Sovjetike në Tiranë. Kushdo që përpiqet të shtrembërojë realitetin mbi qëndrimin e Partisë sonë gabon rëndë. Partia e Punës e Shqipërisë ka qenë, është dhe do të jetë gjithë jetën besnike e marksizëm-leninizmit, për këtë dëshmon më së miri e gjithë rruga e lavdishme që ka përshkuar Partia jonë, që nga krijimi i saj dhe deri më sot.

... Dashuria e pakufishme që ndjen Partia dhe populli ynë për Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe popullin sovjetik nuk mund të cënohet nga veprimi i pandërgjegjshëm dhe i gabuar i disa personave... Bashkimi Sovjetik ka patur dhe ka për të patur kurdoherë në popullin shqiptar një mik të tij besnik deri në fund; Partia e Punës e Shqipërisë, si kurdoherë, do të luftojë me të gjitha forcat e veta për t'i qëndruar besnike deri në fund marksizëm-leninizmit, siç na mëson i madhi Lenin.

Komiteti Qendror i Partisë sonë konsideron se ndryshimi në qëndrimin e mbajtur nga Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik dhe Partia e Punës e Shqipërisë në Mbledhjen e Bukureshtit nuk duhet të bëhet shkak për të ndërhyrë në punët e brendshme të njëri-tjetrit nga asnjë person, sepse kjo nuk do t'i ndihmonte çështjes dhe do të cënonte interesat e përbashkëta midis të dy partive tona.

Ne kemi bindje se Ju do të na kuptoni drejt dhe do të merrni masat e nevojshme për të mos u përsëritur më raste të tilla në veprimtarinë e funksionarëve të Ambasadës Sovjetike në Tiranë.

Përshëndetje komuniste

NË EMËR TË KOMITETIT QENDROR TË PARTISË
SË PUNËS TË SHQIPËRISË
SEKRETARI I PARË

ENVER HOXHA

**Botohet sipas origjinalit
që ndodhet në Arkivin
Qendror të Partisë**

**LETËR E KQ TË PPSH DREJTUAR GJITHË ORGANIZATAVE
BAZË TË PARTISË MBI ZHVILLIMIN E MBLEDHJES SË BU-
KURESHTIT TË QERSHORIT 1960 DHE MBI MOSMARRË-
VESHJET QË KISHIN LINDUR MIDIS PARTISË KOMUNISTE
TË BASHKIMIT SOVJETIK DHE PARTISË KOMUNISTE
TË KINËS**

9 gusht 1960

Midis Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste të Kinës kanë lindur disa mosmarrëveshje të rëndësishme ideologjike e politike. Për këto mosmarrëveshje ka filluar të flitet edhe në shtypin kinez e atë sovjetik, si edhe në fjalimet e udhëheqësve të këtyre dy vendeve, natyrisht pa përmendur njëri-tjetrin me emër, por duke bërë aluzione, të cilat çdo njeri është lehtë t'i kuptojë. Për këto çështje është folur e diskutuar hapur edhe në Mbledhjen që patën në Bukuresht përfaqësuesit e partive komuniste e punëtore që ishin delegatë të partive të tyre në Kongresin III të Partisë Punëtore Rumune.

Me anën e kësaj letre Komiteti Qendror i Partisë e quan të nevojshme t'u njoftojë gjithë organizatave të Partisë qëndrimin tonë ndaj këtij problemi.

Me datën 2 qershor 1960 Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik i dërgoi një letër Komitetit Qendror të Partisë sonë, me anën e së cilës propozonte që në fund të muajit qershor të bëhej një mbledhje e përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore të vendeve të kampit të socializmit «për këmbimin e mendimeve mbi çështjet e gjendjes së sotme ndërkombëtare dhe për përcaktimin e vijës sonë të mëtejshme të përbashkët». Komiteti Qendror i Partisë sonë menjëherë ju përgjigj kësaj letre, duke theksuar se ishte plotësisht dakord që të zhvillohej në fund të qershorit mbledhja që propozohej dhe se delegacionin e Partisë sonë për këtë qëllim do ta kryesonte shoku Enver Hoxha. Mirëpo më datën 7 qershor Komitetit tonë Qendror i erdhi një letër tjetër nga ana e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Me këtë letër Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të

Bashkimit Sovjetik njoftonte se të gjitha partitë ishin shprehur në parim dakord për zhvillimin e mbledhjes së përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore të kampit të socializmit, por disa prej tyre propozonin që mbledhja të shtyhej për një datë të mëvonshme. Lidhur me këtë në letrën e 7 qershorit të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik thuhej: «Për kohën e thirrjes së mbledhjes do të mund të bisedonim në mënyrë paraprake me përfaqësuesit e Partisë suaj, në kohën që do të mbahet Kongresi III i Partisë Punëtore Rumune më 20 qershor, pas të cilit, në marrëveshje me komitetet qendrore të partive motra të vendosim përfundimisht datën e mbledhjes. Kjo, natyrisht, nuk përjashton këmbimin e mendimeve midis përfaqësuesve të partive motra në Bukuresht, në qoftë se ata do të dëshirojnë këtë, pa aprovuar asnjë farë vendimi». Komiteti Qendror i partisë sonë i ktheu përgjigje Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, me anën e së cilës njoftonte se ishte dakord që mbledhja të shtyhej dhe që në Bukuresht të mirreshin vesh për caktimin e datës se kur do të zhvillohej ajo. Për këtë Byroja Politike e Komitetit Qendror autorizoi shokun Hysni Kapo, i cili kryesoi delegacionin e Partisë sonë në Kongresin III të Partisë Punëtore Rumune, që të shkëmbente mendime bashkë me përfaqësuesit e partive motra që ndodheshin në kongres për caktimin e datës së mbledhjes që propozohej në letrat e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik.

Por në fakt delegacioni ynë, që shkoi për Kongresin e Partisë Punëtore Rumune dhe për t'u marrë vesh për caktimin e datës së mbledhjes së përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore të kampit socialist, u gjend në Bukuresht përpara një mbledhjeje ndërkombëtare të pregatitur. Kjo mbledhje ishte në kundërshtim me çka ishte vendosur, ajo ishte në kundërshtim me vetë përmbajtjen e letrave të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, për të cilat bëmë fjalë më sipër. Edhe rendi i ditës ishte krejt tjetër: në vend që të shkëmbeheshin mendime për të caktuar datën e mbledhjes së përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore, siç thoshte letra e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, atje akuzohej Partia Komuniste e Kinës. Për këtë qëllim vetëm 10 orë përpara mbledhjes ju shpërndanë gjithë delegatëve të huaj (shumica e të cilëve ishin vetëm anëtarë të komiteteve qendrore) një material prej 65 faqesh, i pregatitur nga shokët sovjetikë, në të cilin shpreheshin pikëpamjet e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik mbi mosmarrëveshjet që kanë me shokët kinezë. Dhe për këtë çështje kaq të rëndësishme e delikate mbas 10 orësh kërkohet që përfaqësuesit e më se 50 partive komuniste e punëtore të vendeve të ndryshme, të cilët kishin ardhur në Bukuresht për tjetër punë, të mbanin qëndrim, të akuzonin Partinë Komuniste të Kinës.

Është fare e qartë se kjo mbledhje ishte organizuar në mënyrë të nxituar dhe në kundërshtim me rregullat më elementare organizative leniniste. Jua e dini mirë, të dashur shokë, se edhe në organizatat bazë të Partisë, kur shtrohet për diskutim çështja e një anëtari të thjeshtë, Partia na mëson që të jemi të kujdesshëm, të matur, të drejtë dhe asnjëherë të nxituar. Duke zbatuar këtë parim leninist të Partisë, organizatat bazë mbledhen një herë, dy herë e shpesh edhe tri herë, njoftohen komunistët të paktën tri ditë përpara për rendin e ditës dhe për përmbajtjen e tij, caktohen komisione që pregatisin materialet e nevojshme etj. Dhe kjo, e vetëm kjo, është rruga e drejtë e Partisë, rruga organizative që na mëson marksizëm-leninizmi. Po në qoftë se ne veprojmë kështu për një anëtar partie, a është e rregullt që një parti të tërë, e cila ka në radhët e saj disa miliona anëtarë partie, e cila udhëheq një popull prej gati 700 milionësh, të akuzohet në mënyrë aq të shpejtuar, duke thyer çdo rregull organizativ?

Në këto rrethana, siç u përgatit dhe u zhvillua Mbledhja e Bukureshtit, Byroja Politike e Partisë sonë mbajti një qëndrim të drejtë, të vetmin qëndrim të drejtë, parimor e marksist-leninist, që mund të mbahej. Cili është ky qëndrim?

Me pak fjalë ai mund të përmblihet: *e para*, mosmarrëveshjet për të cilat bëhet fjalë janë mosmarrëveshje midis Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik e Partisë Komuniste të Kinës; *e dyta*, mbledhja e Bukureshtit ishte e parakohshme dhe e zhvilluar në kundërshtim me rregullat organizative leniniste; *e treta*, Partia jonë do ta thotë fjalën e saj për këto mosmarrëveshje në mbledhjen e ardhshme, e cila duhet të përgatitet sipas rregullave dhe praktikës që ekziston në partitë komuniste e punëtore.

Partia jonë e Punës mendon se mbledhja e organizuar në Bukuresht ishte e parregullt, ajo ishte në kundërshtim me marrëveshjen e arritur me anë të letërkëmbimit midis Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe partive të tjera motra, sipas të cilit në Bukuresht do të caktohej vetëm data e mbledhjes së ardhshme, ajo ishte e parakohshme dhe në kundërshtim me rregullat organizative që zbatohen në partitë komuniste e punëtore. Prandaj, nga njëra anë, duke patur parasysh sa më sipër dhe, nga ana tjetër, duke qenë se vetëm 10 orë para mbledhjes morëm një material ku shprehej vetëm pikëpamja e shokëve sovjetikë, Partia jonë nuk mund të prononcohej në Bukuresht mbi mosmarrëveshjet që ka midis Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik e Partisë Komuniste të Kinës. Partia jonë do ta thotë fjalën e saj, pikëpamjen e saj mbi mosmarrëveshjet në fjalë në mbledhjen e ardhshme të përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore, që do të bëhet më vonë, mbasi t'i ketë studjuar me kujdes në mënyrë të matur dhe me drejtësinë marksiste-leniniste materialet e të dyja palëve. Partia jonë, e cila kurdoherë ka luftuar e ka mbrojtur me besnikëri

parimet e marksizëm-leninizmit, është e mendimit se vetëm në një mbledhje të organizuar sipas rregullave organizative leniniste, mbasi të jenë dëgjuar argumentat e të dyja palëve, me durim e gjakftohtësi, në një frymë shoqërore, mund të konkludohet se kush ka të drejtë e kush e ka gabim, se si duhet punuar bashkërisht në të ardhshmen për të mirën e socializmit dhe të komunizmit, për të mirën e unitetit të kampit tonë socialist.

Këtë qëndrim të urtë, parimor e leninist, sipas udhëzimeve të Byrosë Politike, mbajti në Mbledhjen e Bukureshtit shoku Hysni Kapo. Këtë qëndrim, siç jeni në dijeni nga komunikata e botuar në shtyp, e aprovoi tërësisht dhe njëzëri Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë që u mbajt më 11-12 korrik 1960. Komiteti Qendror është i bindur se këtë qëndrim të drejtë e parimor do ta aprovojë njëzëri edhe çdo anëtar i Partisë sonë heroike. Qëndrimi ynë i drejtë mund të mos u pëlqejë vetëm atyre që nuk duan të respektojnë normat leniniste.

Mosmarrëveshjet që ekzistojnë midis Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste të Kinës kanë të bëjnë me dy vendet e partitë më të mëdha të kampit socialist. Partia jonë nuk mund të jetë indiferente ndaj tyre... Partia jonë si më parë edhe në të të ardhshmen do të punojë për të forcuar në bazë të marksizëm-leninizmit dashurinë e miqësinë tonë të madhe me Bashkimin Sovjetik, me popujt sovjetikë, me Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, sepse nuk ka dashuri më të fortë e më të sinqertë se sa ajo që bazohet në mësimet fitimtare të marksizëm-leninizmit dhe të internacionalizmit proletar. Por në të njëjtën kohë është e pamohueshme dhe e padiskutueshme që për ne, ashtu si edhe për të gjitha vendet e kampit të socializmit, Kina e madhe, populli dhe partia e saj janë të dashura dhe të shtrenjta.

Prandaj Partia jonë, ashtu si gjithë partitë e tjera, është e interesuar që kjo çështje e rëndësishme të zgjidhet drejt, mbi bazën e mësimëve të marksizëm-leninizmit. Partia jonë ka besim se kjo çështje do të zgjidhet në mbledhjen e ardhshme, që do të bëhet pas 2-3 muajsh, për përgatitjen e së cilës është ngarkuar edhe një komision me përfaqësues të shumë partive motra, midis të cilëve edhe të Partisë sonë. Ne e kemi këtë besim të patundur, sepse kemi besim në marksizëm-leninizmin, i cili u ka bërë ballë shumë furtunave dhe kurdoherë ka dalë fitimtar.

Partia jonë e Punës gjithnjë ka punuar dhe ka luftuar për triumfin e marksizëm-leninizmit, për zbatimin e tij në jetë, për ruajtjen e pastërtisë së parimeve të tija. Për këtë arsye Partia jonë gjatë gjithë historisë së saj të lavdishme ka patur dhe ka një vijë krejtësisht të drejtë, një vijë që u përgjigjet mësimëve të Leninit, që u përgjigjet interesave të popullit shqiptar, interesave të socializmit dhe të komunizmit. Këtë vijë, të bazuar mbi këto parime, Partia jonë do ta ndjekë pa asnjë lëkundje edhe në

të ardhshmen. Ne do të luftojmë e do të punojmë për fitoren e marksizëm-leninizmit, për zbatimin e parimeve të Deklaratës së Moskës të vitit 1957 dhe të Komunikatës së Bukureshtit, të cilën, siç është njoftuar në shtyp, Komiteti Qendror i Partisë sonë e aprovoi njëzëri.

Partia jonë do të rrisë e do të forcojë vigjilencën revolucionare, e cila kurdoherë duhet të jetë në nivelin e duhur, ashtu siç i ka hije Partisë sonë heroike. Sepse armiqtë e Partisë e të popullit, elementët e dobët, oportunistë e frikacakë, si kurdoherë do të përpiqen në mënyra të ndryshme të sulmojnë Partinë dhe vijën e saj të drejtë, të ngjallin dyshime dhe të shpifin për miqësinë tonë me Bashkimin e madh Sovjetik dhe me Republikën Popullore të Kinës, të përhapin parulla e pikëpamje të ndryshme, me qëllim që të shkaktojnë konfuzion ideologjik në radhët tona. Duke qenë vigjilentë, të gjithë anëtarët e Partisë sonë të lavdishme duhet të luftojnë me guxim e vendosmëri kundër çdo përpjekjeje të armiqve për të arritur këto qëllime të poshtra.

Partia jonë duhet të forcojë edhe më shumë unitetin e çelikut të radhëve të saj, unitetin e gjithë Partisë rreth Komitetit Qendror leninist të Partisë sonë, unitetin e Partisë me popullin tonë heroik. Kurdoherë uniteti ynë i pathyeshëm ka qenë kushti vendimtar për të kapërcyer me sukses çdo pengesë, për të shkuar përpara drejt sukseseve të reja. Ai edhe tani është kushti vendimtar për triumfin e vijës së Partisë, për të dërmuar çdo veprimtari të armiqve tanë, për të shpartalluar oportunistët, elementët e dobët dhe frikacakë.

Komiteti Qendror i Partisë ka besim të patundur se gjithë organizatat bazë, gjithë anëtarët e Partisë, të cilët janë edukuar nga Partia si bij besnikë të saj dhe të popullit tonë, besnikë deri në vdekje të marksizëm-leninizmit, do të tregohen si gjithnjë edhe në gjykimin e kësaj çështjeje të rëndësishme të matur, të drejtë, të guximshëm dhe parimorë dhe do të shtrëngojnë edhe më shumë radhët rreth Komitetit Qendror leninist të Partisë sonë.

SEKRETARI I PARË I KOMITETIT QENDROR TË
PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

ENVER HOXHA

Botohet sipas origjinalit
që ndodhet në Arkivin
Qendror të Partisë

Nr. 125

**LETËR E KQ TË PPSH DREJTUAR KOMITETIT QENDROR TË
PARTISË KOMUNISTE TË BASHKIMIT SOVJETIK LIDHUR
ME PROPOZIMIN E BËRË NGA KQ I PKBS PËR ORGANIZI-
MIN E NJË TAKIMI TË PËRFAQËSUESVE TË PKBS DHE TË
PPSH PARA MBLEDHJES SË NËNTORIT TË VITIT 1960 TË
PARTIVE KOMUNISTE DHE PUNËTORE NË MOSKË.**

MOSKË

29 gusht 1960

Këto ditë muarëm letrën Tuaj të datës 13 gusht të këtij viti, në të cilën bëhet fjalë mbi Mbledhjen e përfaqësuesve të partive komuniste dhe punëtoare në Bukuresht dhe me anën e së cilës Ju propozoni që të organizohet një takim i përfaqësuesve të partive tona, përpara mbledhjes së nëntorit të partive komuniste dhe punëtoare, me qëllim që «në mbledhjen e ardhshme të nëntorit Partia e Punës e Shqipërisë dhe Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik të shkojnë me një unitet të plotë mendimesh» dhe «të shuhej në kohën e duhur shkëndija e keqkuptimit të lindur, në mënyrë që ajo të mos ndizej...»

Siç dihet, marksizëm-leninizmi na mëson që, kur lindin keqkuptime, kontradikta dhe mosmarrëveshje midis dy partive marksiste, këto duhet të zgjidhen me anën e bashkëbisedimeve midis të dy partive të interesuara, duke u bazuar në parimet e marksizëm-leninizmit. Marksizëm-leninizmi na mëson, gjithashtu, që do të ishte shkelje e normave elementare marksiste-leniniste që rregullojnë marrëdhënjet midis partive komuniste dhe punëtoare po të ndodhte që dy parti të zhvillonin bashkëbisedime që do të kishin për objekt kritikën ndaj vijës së përgjithshme të një partie tjetër marksiste.

Dihet se në Mbledhjen e Bukureshtit të partive komuniste e punëtoare nuk u shqyrtuan marrëdhënjet midis Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Në atë mbledhje, në kundërshtim me çka qe vendosur qysh më parë nga të gjitha partitë e vendeve të kampit socialist mbi rendin e ditës, në mënyrë të papritur dhe me nxitim u diskutua një çështje kaq e madhe dhe jetike, siç janë mosmarrëveshjet parimore

ideologjike dhe politike që kanë lindur midis Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste të Kinës.

Në Mbledhjen e Bukureshtit qëndrimi ynë që i qartë, ai nuk u muar nga ne si rezultat i ndonjë «keqkuptimi», sikurse bëhet aluzion në letrën Tuaj, por u muar me ndërgjegje të plotë nga ana jonë dhe ne mbajmë të gjithë përgjegjësinë përpara popullit tonë dhe lëvizjes komuniste ndërkombëtare për këtë qëndrim.

Qëndrimi ynë në Mbledhjen e Bukureshtit është zbatimi konsekuent i vijës së përgjithshme ideologjike dhe politike të Partisë sonë, e cila vijë, sikurse është njohur edhe nga ana Juaj, ka qenë kurdoherë parimore, marksiste-leniniste dhe në përputhje të plotë me Deklaratën e Moskës.

Kundërshtimi që lindi në Bukuresht midis qëndrimit tonë dhe qëndrimit Tuaj lindi si rezultat i shqyrtimit jo të marrëdhënjëve midis Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë së Punës të Shqipërisë, por si rezultat i «shkëmbimit të mendimeve» mbi gabimet që i atribuohen Partisë Komuniste të Kinës nga Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik.

Prandaj, në qoftë se do të bëhej një takim midis përfaqësuesve të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, sikurse propozohet me anën e letrës së mësipërme, në këtë takim do të bisedohej për gabimet që i atribuohen Partisë Komuniste të Kinës nga Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, dhe kjo do të bëhej nga përfaqësuesit e të dy partive tona pa qenë prezent partia e tretë e interesuar, d.m.th. Partia Komuniste e Kinës. Vetëkuptohet që një veprim i këtillë nuk do të ishte i drejtë, nuk do t'i ndihmonte çështjes, por do ta dëmtonte atë.

Ashtu sikurse çdo parti tjetër marksiste, edhe Partia jonë e ndjen për detyrë të japë kontributin e vet për zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve. Indiferentizmi dhe neutraliteti mbi këto çështje kaq të mëdha nuk pajtohet me marksizëm-leninizmin. Prandaj, sikurse e kemi deklaruar shumë herë, përsa i përket çështjes së mosmarrëveshjeve të lindura midis Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste të Kinës, Partia jonë do ta thotë pikëpamjen e vet në mbledhjen e ardhshme të partive komuniste dhe punëtore.

Ne ju sigurojmë se Partia e Punës e Shqipërisë do t'i qëndrojë kurdoherë besnike marksizëm-leninizmit, unitetit të kampit të socializmit me Bashkimin Sovjetik në krye, interesave të popullit dhe të atdheut të vet.

Ne jemi të bindur se nuk jemi ne që prodhuam «shkëndijën e keqkuptimit» në Mbledhjen e Bukureshtit dhe Ju sigurojmë se as që kemi për të qenë kurrë «ndezësit» e kësaj shkëndije.

Ne kemi besim se Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik

dhe të gjitha partitë e tjera motra do të na kuptojnë drejt për qëndrimin tonë marksist-leninist.

Ne kemi gjithashtu besim se Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik dhe Partia Komuniste e Kinës do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të dhënë kontributin maksimal në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ekzistuese, sidomos nëpërmjet bashkëbisedimeve midis tyre, të cilat do të ndihmonin shumë për arritjen e suksesit në mbledhjen e ardhshme të Moskës, në interes të unitetit të kampit të socializmit me Bashkimin Sovjetik në krye dhe të unitetit të lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Përhëndetje vëllazërore

KOMITETI QENDROR I PARTISË SË PUNËS
TË SHQIPËRISË

ENVER HOXHA

Botohet sipas origjinalit
që ndodhet në Arkivin
Qendror të Partisë

PLENUMI XVIII I KQ TË PPSH

Tiranë, 5-8 shtator 1960

KOMUNIKATË

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH u mbledh nën kryesinë e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të PPSH, shokut Enver Hoxha, për të shqyrtuar dhe aprovuar raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH «Mbi disa çështje të punës organizative të Partisë», mbajtur nga shoku Rita Marko, anëtar i Byrosë Politike dhe sekretar i Komitetit Qendror të PPSH, dhe mori për këtë çështje vendimin përkatës.

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH, pasi shqyrtoi gjithashtu gabimet e rënda në vijën e Partisë të shoqes Liri Belishova, anëtare e Byrosë Politike dhe sekretare e Komitetit Qendror të PPSH, vendosi njëzëri ta përjashtojë atë nga radhët e Plenumit të Komitetit Qendror të PPSH.

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH në këtë mbledhje zgjodhi sekretar të Komitetit Qendror të PPSH shokun Ramiz Alia, kandidat i Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH.

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH, në mbledhje të përbashkët me Komisionin Qendror të Revizionimit, shqyrtoi edhe veprimtarinë armiqësore kundër Partisë të Koço Tashkos, kryetar i Komisionit Qendror të Revizionimit, dhe vendosi njëzëri ta përjashtojë atë nga Komisioni Qendror i Revizionimit dhe nga Partia.

* * *

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH gjatë punimeve të tij mësoi me hidhërim lajmin e vdekjes së militantit të shquar të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, Presidentit të Republikës Demokratike Gjermane dhe mikut të shtrenjtë të popullit shqiptar,

shokut Vilhelm Pik. Plenumi i Komitetit Qendror nderoi kujtimin e tij duke mbajtur një minutë zi.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Nr. 126

RAPORT

I BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH «MBI DISA ÇËSHTJE TË PUNËS ORGANIZATIVE TË PARTISË»

Shokë,

Që nga dita e themelimit, Partia jonë i ka kushtuar kurdoherë kujdes të veçantë forcimit organizativ të radhëve të saj, duke e konsideruar këtë çështje — ashtu siç mëson marksizëm-leninizmi — kusht të dorës së parë, vendimtar, për realizimin me sukses të rolit të saj drejtues, udhëheqës dhe organizues.

Në këto 19 vjet të jetës së saj Partia jonë ka ndjekur kurdoherë e pa lëkundje një vijë të drejtë, ka mbajtur gjithmonë qëndrim të pjekur e parimor. Kjo për arsye se ajo është udhëhequr vazhdimisht, në tërë veprimtarinë e saj, nga mësimet e pavdekshme të marksizëm-leninizmit, nga eksperiencia e pasur e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, nga parimet e internacionalizmit proletar. Besnikëria e patundur ndaj marksizëm-leninizmit ka qenë dhe mbetet faktori kryesor i forcës dhe i vendosmërisë së Partisë sonë. Nga ana tjetër, kjo ka ardhur për arsye se Partia jonë është udhëhequr kurdoherë, në tërë veprimtarinë e saj, nga interesat e larta jetike të popullit tonë punonjës, që e ka lindur e rritur. Besnikëria ndaj popullit, lidhja e pazgjdhshme e saj me masat e gjera punonjëse, ka qenë dhe mbetet faktori tjetër kryesor i forcës dhe i pathyeshmërisë së Partisë sonë.

Karakteristikë dalluese e Partisë sonë është uniteti i saj i çeliktë rreth Komitetit të saj Qendror leninist, me shokun Enver Hoxha në krye. Si sytë e ballit e ka ruajtur e gjithë Partia unitetin e saj, duke luftuar me të tëra forcat e saj e pa më të voglin ngurrim kundër çdo armiku që ka tentuar ta cënojë sado pak këtë unitet. Dhe në luftë me armiqtë, duke spastruar me guxim radhët e saj prej tyre, është forcuar e kalitur Partia jonë.

Një shkollë e madhe për kalitjen ideologjike dhe politike të Partisë ka qenë lufta e vendosur dhe parimore që ka bërë e tërë Partia kundër revizionizmit dhe posaçërisht kundër revizionizmit jugosllav, agjenturë e regjur e imperializmit, dhe agjentëve të saj në Partinë tonë Koçi Xoxe, Tuk Jakova, Bedri Spahiu etj., të ci-

lët kanë dashur të prishin unitetin e Partisë sonë, ta degjenerojnë e ta shkatërrojnë atë.

Partia jonë është treguar kurdoherë e kujdesshme dhe shumë e matur me ata komunistë që kanë gabuar dhe kanë njo-hur gabimet e tyre. Por me armiqtë e marksizëm-leninizmit, me deviatorët ajo është treguar e ashpër dhe e pamëshirshme, dhe e tillë do të jetë kurdoherë.

Partia jonë, e udhëhequr kurdoherë nga mësimet e pavdekshme të marksizëm-leninizmit, ka luftuar dhe lufton që t'i zbatojë ato në jetë me besnikëri dhe e ka konsideruar atë, në tërë veprimtarinë e saj, si një domosdoshmëri objektive. Me guxim dhe besnikëri ndaj parimeve të Marksit e Leninit, duke e thënë kurdoherë hapur e pa lëkundje fjalën e saj, Partia jonë ka luftuar dhe do të luftojë edhe në shkallë ndërkombëtare që të mos preken nga armiqtë këto parime, siç është çështja e solidaritetit të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare — mbështetur në internacionalizmin proletar, uniteti i kampit socialist, me Bashkimin Sovjetik në krye, lufta kundër revizionizmit, si agjenturë e imperializmit, Deklarata e Moskës dhe Manifesti i paqes.

Lufta kundër revizionizmit, e posaçërisht kundër revizionizmit jugosllav, është parë gjithnjë nga Partia jonë jo nën prizmin e ngushtë nacional, siç mendojnë disa, por si një detyrë internacionaliste, si një detyrë e madhe që i takon çdo partie për të mbrojtur marksizëm-leninizmin, unitetin e kampit e të lëvizjes komuniste ndërkombëtare nga armiku më i rrezikshëm, siç e cilëson Deklarata e Moskës.

Me luftën e saj të vendosur kundër revizionizmit, me qëndrimin e saj parimor e të palëkundur për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit, Partia jonë ka dhënë kontributin e saj modest në forcimin e unitetit të kampit të fuqishëm socialist, në forcimin e unitetit të lëvizjes komuniste dhe punëtore ndërkombëtare.

Në këtë plenum shtrojmë disa çështje të punës organizative të Partisë. Gjithnjë Partia jonë është udhëhequr nga parimi i njo-hur leninist se sukseset ekonomike, stabiliteti dhe vazhdueshmëria e tyre varen kryesisht nga sukseset e punës organizative dhe politike të Partisë, se pa këtë kusht sukseset ekonomike janë si të ngritura mbi rërë.

Një periudhë e re historike hapet para popullit tonë. Kongresi IV i Partisë, që do të mbledhet në nëntor të këtij viti, do të bëjë bilancin e sukseseve të shkëlqyera të arritura gjatë kësaj kohe dhe do të përcaktojë detyrat madhështore për të ardhmen. Plani i tretë pesëvjeçar, direktivat e të cilit do të aprovojë kongresi, e fut vendin tonë në rrugën e transformimit me hapa të shpejta nga një vend agraro-industrial në një vend industrialo-agrar. Detyra shumë të mëdha në të gjitha fushat shtrohen para popullit tonë. Tërë këto detyra do të realizohen nën udhëheqjen e drejtpërdrejtë

të Partisë. Prandaj çështja e forcimit organizativ të Partisë, ngritja e nivelit të punës së Partisë në nivelin e kërkesave të kohës, të detyrave që qëndrojnë para saj është sot një nga çështjet themelore në punën tonë. Jo pa qëllim ky plenum i Komitetit Qendror, tamam në prakun e Kongresit IV, u kushtohet çështjeve organizative të Partisë.

Ne kemi një Parti të mrekullueshme, të lindur e të kalitur në luftëra, të gjallë e luftarake, të fortë e të paepur, të papajtueshme me armiqtë, besnike deri në vdekje ndaj marksizëm-leninizmit, kompakte e monolite, me të cilën krenohemi, jo vetëm ne anëtarët e PPSH, por edhe i gjithë populli ynë, i cili ka ndjekur kurdoherë me bindje dhe besnikëri të plotë vijën e saj, ka përkrahur me gjithë zemër qëndrimet e drejta të saj dhe nuk ka kursyer asgjë për të vënë në jetë porositë e saj.

Edhe në të ardhshmen duhet ta forcojmë edhe më shumë Partinë, ta rrisim aftësinë e saj drejtuese dhe organizuese, ta ngrëmë përgjithësisht nivelin e punës së saj.

— I —

Të përmirësojmë edhe më shumë punën për forcimin e mëtejshëm të përbërjes së Partisë.

Nga marksizëm-leninizmi, nga eksperiencia e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe nga vetë jeta dhe eksperiencia e Partisë sonë mësojmë se përbërja e Partisë përcakton në një shkallë të madhe aftësinë luftarake, kompaktësinë, disiplinën, ndërgjegjen dhe më në fund vetë fatin e vendimeve të Partisë. Për këtë arsye Komiteti Qendror i Partisë sonë i ka kushtuar dhe i kushton këtij problemi kujdes të veçantë dhe të vazhdueshëm. Herë pas here Sekretariati i Komitetit Qendror dhe shpeshherë bile edhe Byroja Politike e KQ kanë shqyrtuar raportet mbi përbërjen e Partisë dhe kanë caktuar masat që duheshin marrë për forcimin e saj të mëtejshëm. Me shumë rëndësi në këtë drejtim kanë qenë orientimet që dha Byroja Politike për zbatimin e detyrave që shtroi Plenumi i majit 1953 i Komitetit Qendror, si dhe Kongresi III i Partisë lidhur me vendin që duhej të zinin punëtorët në numrin e përgjithshëm të të pranuarve në Parti. Duke rritur radhët e Partisë me punëtorë, duke punuar me shumë kujdes për kalitjen komuniste të anëtarëve dhe të kandidatëve për anëtarë partie, duke spastruar radhët e Partisë nga elementët e papërshtatshëm e të padenjë për titullin e lartë të anëtarit të Partisë, është forcuar përbërja e Partisë. Dhe sot, me gjithë të metat që ende vihen re e për të cilat do të flasim më poshtë, *ne mund t'i raportojmë me kënaqësi plenumit se Partia jonë ka një përbërje të shëndoshë, të vërtetuar gjatë gjithë jetës së Partisë, në të gjitha situatat, një përbërje monolite.*

Gjatë periudhës midis dy kongreseve Partia jonë është rritur përsa i përket numrit dhe sidomos përsa i përket cilësisë së radhëve të saj.

Me 1 korrik 1960, Partia numëronte në radhët e saj 52.992 anëtarë dhe kandidatë për anëtarë partie, ose 4.348 vetë më shumë se në Kongresin III. Në efektivin e Partisë tani punëtorët dhe anëtarët e kooperativave të artizanatit zënë 28,74 për qind të të gjithë efektivit të Partisë, nga 19,7 për qind që zinin në Kongresin III, dmth 9 për qind më shumë. Komunistët me gjendje shoqërore anëtarë të kooperativave bujqësore, si rezultat i kolektivizimit me ritme të shpejta të bujqësisë, zënë tani 24,09 për qind të efektivit të Partisë nga 10 për qind që zinin më 1 prill 1956, ndërsa komunistët e fshatrave të pakolektivizuara zënë vetëm 3,35 për qind të efektivit, nga 21,3 për qind që zinin në pragun e Kongresit III. Nëpunësit zënë tani 42,21 për qind të efektivit nga 45,1 për qind, kurse shtëpiakët dhe studentët 1,6 përqind nga 5,6 për qind në pranun e Kongresit III.

Siç shihet detyra që vuri Kongresi III për forcimin e përbërjes së Partisë është plotësuar në mënyrë të kënaqshme. Ndryshimet për forcimin e përbërjes së Partisë me punëtorë shpjegohen në radhë të parë me pranimet nga klasa punëtore dhe pastaj me kalimin në qendrat e prodhimit dhe në NBSH-të të një pjese komunistësh nga fshati dhe nga administratat shtetërore.

Në raportin e Komitetit Qendror para Kongresit III shoku Enver shtronte porosinë: «që përqindjen dërmuese mbi numrin e të pranuarve ta zënë punëtorët».⁴² Organizatat e Partisë të rretheve e kanë patur kurdoherë parasysh këtë porosi dhe kanë arritur rezultate. Në periudhën para Kongresit III vendin kryesor në pranimet e zinin fshatarët me 43,68 për qind (ndërsa anëtarët e kooperativave bujqësore 6,18 për qind), vendin e dytë e mbanin nëpunësit e studentët me 30,15 për qind, kurse punëtorët zinin vendin e tretë me 26,17 për qind. Ky përpjesëtim gjatë periudhës midis Kongresit III dhe IV është ndryshuar rrënjësisht. Tani vendin e parë e zënë punëtorët me 48,5 për qind, vendin e dytë e zënë anëtarët e kooperativave bujqësore me 22,8 për qind, nëpunësit e studentët zënë vendin e tretë me 14,6 për qind dhe vendin e katërt e zënë fshatarët e fshatrave të pakolektivizuara me 13,9 për qind.

Por rëndësi i është kushtuar jo vetëm faktit që punëtorët të zënë vendin e parë në pranimet, por dhe cilësisë së atyre që pranohen, që në Parti të vijnë sidomos punëtorët më të ndërgjegjshëm, ata që punojnë në degët më të rëndësishme, më të vështira dhe që kanë stazh më të vjetër në punë. Kështu gjatë vitit 1959, duke krahasuar numrin e kandidatëve për anëtarë partie të pranuar mbi numrin e punëtorëve sipas degëve, del se nga punëtorët e industrisë dhe të transportit kanë ardhur në Parti

1,2 për qind e tyre, nga të minierave 0,8 për qind, nga bujqësia dhe ndërtimi 0,5 për qind, nga tregëtia 0,3 për qind. Po kështu rreth 55 për qind të kandidatëve janë punëtorë me më tepër se 5 vjet stazh në punë, 32 për qind deri 3 vjet dhe vetëm 12 për qind me një vit stazh në punë.

Me gjithë përmirësimet e arritura duhet të themi se puna për edukimin dhe pregatitjen e punëtorëve për në Parti është ende e pamjaftueshme, gjë që vërtetohet edhe nga këto dy aspekte negative.

Së pari, në disa organizata, ku kemi si të thuash të përqëndruar klasën punëtore, si në Tiranë, Durrës e Shkodër, ka ende pak kërkesa nga punëtorët për t'u pranuar në Parti dhe si rrjedhim duhet thënë se në këto rrethe përqindja e punëtorëve të ardhur në Parti, mbi numrin e përgjithshëm të punëtorëve që kanë, është nën përqindjen mesatare si republikë.

Së dyti, vihen re shumë lëkundje, nga viti në vit e nga tremujori në tremujori, në ritmet e pranimet të punëtorëve në Parti. Kështu Korça, p.sh., në 1957 pranoi 64 punëtorë, më 1958 — 36 dhe më 1959 — 26. E njejtja gjë mund të thuhet edhe për mjaft rrethe të tjera.

Kuptohet se këtu nuk është fjala për pranime në bazë të një plani, i cili, si të thuash, duhet të realizohet në mënyrë ritmike, siç bëhet për degët e ekonomisë. Kjo praktikë do të ishte e gabuar. Por theksojmë nevojën për një punë të rregullt, sistematike dhe të vazhdueshme me klasën punëtore, si nga ana e organizatave të Partisë dhe nga çdo komunist, ashtu edhe nga organizata e Bashkimeve Profesionale dhe organizata e BRPSH-së. *Një punë e rregullt me punëtorët, me aktivin në radhë të parë, do të sjellë patjetër edhe një rritje të rregullt e normale të Partisë me elementë të rinj, të ardhur nga radhët e klasës punëtore.*

Dëshira për t'u bërë një ditë anëtar i PPSH duhet të jetë nxitje kryesore për çdo punëtor e në mënyrë të veçantë për çdo të ri punëtor, që të plotësojë me nder e në mënyrë shembullore tërë detyrat që i shtrohen në punë, në shkollë, në shoqëri e në familje.

Gjatë periudhës midis dy kongreseve, siç ishte e natyrshme në bazë të orientimit që dha Kongresi III, ka patur një farë kufizimi për pranimin në parti nga shtresat e tjera. Kështu, ndërsa vetëm gjatë vitit 1955 u pranuan në Parti 1.618 fshatarë dhe 840 nëpunës e studentë, gjatë 3 vjetëve pas kongresit (1957-1959) u pranuan gjithsej 1.541 fshatarë, kryesisht anëtarë të kooperativave bujqësore, dhe 612 nëpunës e studentë. Duke gjykuar mbi shifrat mesatare, ky fakt nuk përbën ndonjë problem serioz për gjithë Partinë, meqenëse ne kemi në Parti rreth 3,4 për qind të popullsisë (rreth 7 për qind të zgjedhësve), 10,5 për qind të punëtorëve, rreth 39 për qind të nëpunësve dhe rreth 4,6 për qind të anëtarëve të kooperativave bujqësore. Por për disa zona, ku

shtrirja e Partisë nuk është ende e kënaqshme, e sidomos për disa organizata bazë të vogla fshati, që kanë vite me radhë pa bërë fare pranime, kjo çështje duhet parë me shumë kujdes.

Pa dyshim në krijimin e kësaj situatë kanë influencuar edhe përqindjet orientuese që kemi patur për pranimin e punëtorëve, por arsyeja kryesore për mospërtëritjen e Partisë në disa zona e fshatra do gjetur jo këtu, por kryesisht *te dobësitë në punën me njerëzit*, në punën për edukimin, aktivizimin dhe përgatitjen e njerëzve për në Parti. Pse dihet që përqindjet orientuese në i kemi vënë në vitin 1957, kurse disa organizata, si ajo e Kuçit (Vlorë), e Bilalajt (Durrës) e Bubullimës (Lushnjë) etj. kanë afërsisht 10 apo më shumë vjet që s'kanë bërë pranime fare. Ose për Kolonjën, Skraparin, Gramshin etj. ne s'kemi patur fare përqindje orientuese, kurse edhe atje ka organizata si ajo e Borovës etj., që kanë vite të tëra pa bërë fare pranime.

Prandaj detyra jonë është që sidomos atje ku kemi organizata të vogla, ose pak komunistë, të forcojmë punën për edukimin e njerëzve, duke përtërirë kështu rregullisht e vazhdimisht Partinë me gjak të ri. Ndërsa në organizatat që kanë shumë komunistë, pa prerë krejt pranimet, të luftohet për përtëritjen e Partisë kryesisht me anë të ngritjes së nivelit, edukimit komunist, të anëtarëve dhe të kandidatëve të Partisë, duke gjallëruar jetën e organizatave të Partisë.

Nga sa u tha më lart del pyetja: A duhet të përcaktojmë edhe për të ardhmen përqindje orientuese për pranimet në Parti dhe nëse po çfarë orientimi duhet të kemi?

Eksperiencia e deritashme vërtetoi se është e domosdoshme që edhe në të ardhshmen të kemi përqindje orientuese për pranimin në Parti të njerëzve të prodhimit e posaçërisht të punëtorëve. Në asnjë mënyrë nuk duhet t'i lihet spontaneitetit një çështje kaq e rëndësishme. Por për të siguruar një rritje normale të Partisë, në të gjithë sektorët, posaçërisht në fshat, del nevoja që të ulen për të ardhshmen deri në një farë mase përqindjet orientuese për pranimin e punëtorëve, kryesisht në favor të pranimet nga anëtarët e kooperativave bujqësore.

Nga studimi që i bëri kësaj çështjeje aparati i Komitetit Qendror në bashkëpunim me gjithë organizatat e Partisë në rrethe dhe në repartet e Ushtrisë Popullore e të kufirit del që për të ardhshmen orientimi i përgjithshëm për pranimet në Parti të jetë si vijon: *Shumicën dërmuese të të pranuarve në Parti ta bëjnë njerëzit e prodhimit (në radhë të parë punëtorët dhe pastaj anëtarët e kooperativave bujqësore), ndërsa ndaj nëpunësve të shtrohen përsëri kërkesa më të mëdha.* Nga radhët e nëpunësve duhet të tregohet kujdes për pranimin e personelit inxhiniero-teknik të ndërmarrjeve, të arsimtarëve e të njerëzve të tjerë të krijimtarisë, si

dhe të oficerëve të Ushtrisë Popullore dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Duke u bazuar në konkluzionin e mësipërm, Byroja Politike propozon që përqindjet orientuese për të ardhshmen të jenë afërsisht si vijon: *Rreth 85 përqind e të gjithë të pranuarve të vijin nga radhët e njerëzve të prodhimit. Prej tyre rreth 45 përqind nga punëtorët dhe rreth 40 përqind nga anëtarët e kooperativave bujqësore, ndërsa nga shtresat e tjera, nëpunës e studentë, deri 15 përqind të të pranuarve.*

Dhe me këto përqindje orientuese për pranimet në Parti jo vetëm do të ruhet përqindja që zënë punëtorët në efektivin e Partisë, por, duke marrë parasysh edhe ndryshimet që do të bëhen në gjendjen shoqërore të komunistëve, do të mund të ketë edhe rritje. Kështu parashikohet që në Kongresin V të Partisë punëtorët të zënë rreth 32-33 përqind të efektivit të Partisë.

Një problem tjetër në përbërjen e Partisë është edhe çështja e edukimit, e aktivizimit dhe e pranimet në Parti të grave dhe të të rejave.

Më 1 korrik 1960 ne kishim në parti 5.239 shoqe komuniste ose 9,9 përqind të efektivit të Partisë nga 9,2 përqind që ishte në Kongresin III. Që nga kongresi e këtej në Parti janë pranuar 579 shoqe ose 0,7 përqind më shumë. Ritmi i pranimet nga radhët e grave dhe të të rejave në përgjithësi është krejt i pakënaqshëm. Po të shikojmë rezultatet e vitit 1959 dhe 1960, mund të themi se është shënuar një farë përmirësimi. Në vitet e kaluara shoqet zinin rreth 9 përqind të të pranuarve, ndërsa në 1959 ato zunë 16,4 përqind dhe në gjashtëmujorin e parë të 1960-ës 20,4 përqind.

Njëfarë kthese është bërë gjithashtu këtë vit edhe në pranimin e grave nga fshati, mbasi 45,8 përqind e grave të pranuar në Parti janë nga anëtarët e kooperativave bujqësore. Disa rrethe kanë filluar të punojnë më mirë në këtë drejtim. P.sh. rrethi i Gjirokastrës, në gjashtëmujorin e parë të vitit 1959 pranoi gjithsej 11 gra (ose 42,3 përqind të të pranuarve), nga të cilat 9 nga fshati, dhe në gjashtëmujorin e parë të 1960-ës pranoi 26 shoqe (ose 56,5 përqind të të pranuarve), nga të cilat 20 nga fshati. Lushnja në gjashtëmujorin e parë të 1959-ës pranoi 5 shoqe, nga fshati vetëm 1, kurse në gjashtëmujorin e parë të vitit 1960 pranoi 8 shoqe, ose 34,7 përqind të të pranuarve, dhe që të 8-ta nga fshati.

Por këto janë rezultate të vogla e të pjesshme, se ka edhe rrethe si Durrësi, që gjatë 4 vjetëve ka pranuar në Parti vetëm 4 shoqe nga fshati.

Komiteti Qendror shpeshherë ka tërhequr vëmendjen e organizatave të Partisë mbi punën e pakënaqshme që bëhet në këtë drejtim. Ne kemi tani rreth 24 përqind të fuqisë punëtore dhe rreth 50 përqind të krahëve të punës në kooperativat bujqësore gra. Vetëm në organet e zgjedhura të pushtetit, të rinisë, të Bash-

kimeve Profesionale janë mbi 6.000 gra e të reja, kurse në kryesitë e kooperativave bujqësore mbi 1.200. Ky është një aktiv mjaft i konsiderueshëm, përveç mijëra grave të tjera të dalluara si punëto-re, kooperativiste etj.

Pse atëhere vijnë ende shumë pak gra në Parti? Shumë sho-kë thonë se kjo vjen për arsye se niveli arësimor-kultural i tyre është shumë i ulët. Por edhe në këtë drejtim faktet flasin ndryshe: rreth 60 për qind e grave punëtore janë me shkollë filllore dhe 7-vjeçare. Punëtorët burra me filllore e 7-vjeçare zënë 67 për qind, dmth një diferencë fare e vogël. Në fshat gratë me filllore e 7-vjeçare zënë 41.22 për qind të tyre, burrat 50,95 për qind.

Që këtej del se pranimin e grave në Parti nuk e pengon as pjesëmarrja e tyre në punë, as edhe niveli arësimor e kultural. Porse punohet dobët për përgatitjen e grave për t'u pranuar në Parti. Dhe kjo sepse në mjaft komunistë, bile edhe kuadro, me gjithë ndryshimet e mëdha që kanë ndodhur në vendin tonë, ekzistojnë mendime prapanike mbi punën dhe rolin e gruas në sho-qëri. Organizatat bazë nga ana e tyre bëjnë një punë shumë të do-bët për të çrrënjësuar konservatorizmin, mosbesimin dhe nënvlef-tësimin që ekziston pothuajse kudo për punën e gruas. Zakonet prapanike si dhe mosbesimi në forcat e veta janë gjithashtu në shumë gra pengesë në këtë drejtim.

Prandaj është e domosdoshme që organizatat e Partisë në rre-the dhe në bazë të marrin masa që të bëhet një punë shumë më e organizuar me masën e grave dhe sidomos të të rejave. Duke punuar për zbatimin e detyrave që shtron vendimi i Komitetit Qendror të Partisë për ngritjen e grave në përgjegjësi, të bëhet një punë sistematike me ato gra që do të ngarkohen me detyra, jo vetëm që ato të mbajnë me nder vendin e besuar, por edhe që ato të rriten e të edukohen, për t'u bërë të denja për në radhët e Partisë.

Puna me kandidatët për anëtarë partie dhe përgjithësisht edu-kimi i komunistëve të rinj është një nga çështjet e tjera me shu-më rëndësi për forcimin e përbërjes së Partisë. Këtu ne kemi ende mjaft të meta. Në jetën e shumë organizatave të Partisë nuk është çrrënjësuar akoma praktika e zvarrisjes së stazhit të kandidatit. Shumë kandidatë për anëtarë partie plaken si të tillë dhe organi-zatat bazë as që kujtohen për t'i shqyrtuar...

Duhet që kjo çështje të gjejë zgjidhje përfundimtare dhe jo me fushata. Koha prej një viti e caktuar në statut për stazhin e kandidatit është plotësisht e mjaftueshme që kandidati të njohë Partinë dhe që organizata të provojë nëse kandidati i pranuar i ka konditat për t'u bërë anëtar partie. Për rastet kur kandidati, për shkaqe që organizata i gjen me vend, nuk ka mundësi të japë pro-va të mjaftueshme, ose kur organizata bazë e Partisë nuk mund të njohë mirë cilësitë vetiake të tij, sikurse përcaktohet në statut,

mund të shqyrtohet çështja e tij dhe t'i zgjatet koha e stazhit edhe për një vit, por vetëm edhe për një vit. Në qoftë se edhe pas zgjatjes së stazhit kandidati nuk jep prova për të qenë anëtar par-tie, kuptohet lehtë se ai nuk meriton për të qenë në radhët e Par-tisë. Pra duke zbatuar pikë për pikë statutin e Partisë duhet të kemi kandidatë me stazh deri në një vit dhe kandidatë që u është zgjatur stazhi edhe deri në një vit tjetër.

Arësyeja kryesore e qëndrimit për një kohë shumë të gjatë të kandidatëve në stazhin e kandidatëve duhet gjetur jo vetëm te gabimet që në zgjedhjen e tyre, por edhe te dobësitë e punës së organizatave bazë me ta, sepse s'i ngarkojnë si duhet e sa duhet me detyra, si dhe te vetë përpjekjet e pamjaftueshme të kandi-datëve...

Organizatat bazë të Partisë duhet të merren seriozisht me përgatitjen, aktivizimin dhe edukimin e kandidatëve posaçërisht, si dhe të gjithë komunistëve të rinj. Siç mëson marksizëm-leniniz-mi, puna për edukimin dhe kalitjen e komunistëve nuk përfundon me pranimin e tyre në Parti. Përkundrazi, ajo atëhere fillon të bëhet e organizuar dhe sistematike.

Për gjithë dobësitë e përmendura më lart në punën për forcim-in e përbërjes së Partisë, veç përgjegjësisë që kanë organizatat e Partisë në rrethe, një përgjegjësi të veçantë ka Drejtoria e or-ganeve të Partisë, të rinisë e të Bashkimeve Profesionale e Kom-itetit Qendror, e cila duhej të kishte dhënë në këtë drejtim një ndihmë më të efektshme. Në të ardhshmen kjo çështje duhet patur mirë parasysh.

Byroja Politike e pa të arësyeshme t'i shtroje plenumit për diskutim çështjen e heqjes së kategorive të ndryshme për prani-met në Parti.

Në statutin e aprovuar nga Kongresi I i Partisë, të nisur nga mësimet e marksizëm-leninizmit, duke u mbështetur në eksperi-encën e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe në për-shtatje me kushtet konkrete të vendit tonë, ne vendosëm kategori të ndryshme për pranimet në Parti, duke patur parasysh gjendjen shoqërore të të pranuarve. Vendosja e këtyre kategorive për pranimin në Parti, në atë kohë, ka qenë e nevojshme dhe ka ndihmuar që të kufizoheshin rastet e hyrjes në radhët e Partisë të elementëve mikroborgjezë dhe të padëshirueshëm.

Tani ka ardhur koha që Komiteti Qendror ta rishikojë këtë çështje. Rregullat e përcaktuara për pranimin e komunistëve të rinj në Parti nuk u përgjigjen ndryshimeve të mëdha që kanë ndodhur gjatë këtyre vjetëve si në sektorët ekonomikë, ashtu edhe në strukturën e klasave në vendin tonë. Tek ne tashmë është ndërtuar baza ekonomike e socializmit. Si rrjedhim, është ndry-shuar rrënjësisht struktura e klasave. Tani në vendin tonë ekzistojnë dy klasa punonjëse mike, klasa punëtore dhe fshatarësia

punonjëse, si edhe shtresa e inteligjencies popullore e dalë nga gjiri i tyre. Prandaj mbajtja akoma e kushteve të diferencuara për pranimet në Parti nuk ka më kuptim. Nga ana tjetër ato kanë filluar të krijojnë disa pengesa artificiale lidhur me pranimin në Parti të disa kategori punonjësish.

Gjatë këtyre 16 vjetëve të pushtetit popullor dhe sidomos viteve të fundit, me qindra punëtorë dhe bij punëtorësh e fshatarësh, ish-partizanë të djeshëm e luftëtarë të vendosur sot për ndërtimin e socializmit, kanë hyrë dhe po vazhdojnë shkollat. Ata janë bërë e po bëhen agronomë, inxhinierë, mjekë etj. Këta i kanë të gjitha garancitë mbasi, qoftë në luftë edhe sot në punë për ndërtimin e socializmit kanë dhënë prova të shumta besnikërie për t'u pranuar në Parti. Mirëpo, sipas kategorive të caktuara në statutin e Partisë, këta, duke qenë me gjendje shoqërore studentë ose nëpunës, hyjnë në grupin e katërt, prandaj pranohen në Parti me kushte më të rënda. Jeta shtron me të drejtë pyetjen: përse vallë duhet të vihet në kondita më të vështira për t'u pranuar në parti partizani i djeshëm ose djali i tij, punëtori ose djali i tij, që dëgjoji fjalën e Partisë, mësoi në shkollë dhe u bë intelektual ose drejtues prodhimi? Me të drejtë të tillë shokë mund të na pyesin: Çfarë gjëje të keqe kanë bërë?

Pastaj, për shkak të këtyre rregullave të caktuara, organizatave bazë dhe komiteteve të Partisë u duhet të bëjnë disa llogari për kombinimin e drejtë të gjendjes dhe të origjinës shoqërore, që të caktojnë se në cilin nga të 4 grupet hyn i pranuari. Dhe në këtë drejtim bëhen edhe gabime, bile ndodhin dhe absurditete: Origjina prej nëpunësi (kur ishte fjala për nëpunës të regjimeve të kaluara) pa dyshim duhej të ndikonte për keq mbi pranimin në parti të atij me gjendje shoqërore punëtor apo fshatar. Por ta zbatosh këtë tani edhe për fëmijët e nëpunësve të pushtetit popullor është e padrejtë. Për punëtorin që e ka babanë e vet nëpunës të pushtetit popullor, oficer të ushtrisë apo të Sigurimit të shtetit, kjo duhet të jetë në dobi dhe jo në dëm të tij.

Prandaj ne mendojmë se në kushtet e reja të krijuara jo vetëm s'është më e nevojshme mbajtja e kategorive, por është bërë dhe e dëmshme. Ne ja shtrojmë për diskutim këtë çështje plenumit dhe po u pa e arësyeshme t'i propozohet kongresit për të bërë ndryshim në statut lidhur me rregullat për pranimet në Parti, duke vendosur në këtë drejtim kondita unike, dhe konkretisht që *çdo njeri që dëshiron të hyjë në Parti të jetë i detyruar të paraqesë rekomandime nga 3 anëtarë partie, të cilët të kenë jo më pak se 3 vjet jetë partie dhe ta njohin atë në punë të përbashkët jo më pak se një vit...*

Është e qartë, shokë, se janë dy gjëra krejt të ndryshme çështja e orientimit se në ç'shtresa duhet të drejtojmë në radhë të parë punën për pranimet në Parti, dhe çështja e kategorive për

pranimet në Parti. Duke hequr kategoritë, në asnjë mënyrë nuk duhet të bjerë kujdesi për gjendjen shoqërore të të pranuarve. Me heqjen e kategorive bëjmë vetëm atë që, për efekt të pranimeve, i vemë të gjithë në kushte të barabarta, por çdo rast organizatat e Partisë do ta shikojnë në mënyrë individuale, me shumë kujdes, duke patur parasysh gjithë udhëzimet dhe orientimet që ka dhënë Komiteti Qendror për forcimin e përbërjes së Partisë.

Kërkesa kryesore, ajo që ka qenë dhe mbetet për gjithnjë e përndryshueshme, është zgjedhja individuale e atyre që pranohen në Parti. Prandaj qofshin punëtorë, gra, anëtarë të kooperativave bujqësore ose nëpunës, që të pranohen në radhët e Partisë, duhet të jenë plotësisht të denjë për këtë titull. Në këtë drejtim s'duhet bërë asnjë lëshim.

— II —

Të ngremë edhe më lart rolin e organizatave bazë të Partisë.

Periodha që nga Kongresi III i Partisë karakterizohet gjithashtu nga një rritje e mëtejshme e veprimtarisë së organizatave bazë të Partisë në të gjithë sektorët. Lufta e përditshme për realizimin e detyrave dhe ndihma e vazhdueshme e Komitetit Qendror dhe e komiteteve të Partisë në rrethe i ka kalitur organizatat dhe komunistët në përgjithësi, i ka edukuar dhe aftësuar ata. Gjithë organizatat e Partisë sonë karakterizohen nga një unitet i çeliktë mendimi dhe veprimi për të gjitha çështjet e vijës së Partisë, nga besnikëria e patundur ndaj marksizëm-leninizmit. Është për këto arsye që organizatat bazë të Partisë kanë treguar një pjekuri politike dhe ideologjike të plotë për të gjitha çështjet dhe në të gjitha situatat.

Ndryshimet që kanë ndodhur në vendin tonë në dobi të socializmit, e veçanërisht me kolektivizimin e bujqësisë, kanë sjellë ndryshime jo vetëm në përbërjen shoqërore të Partisë, por edhe në edukimin e të gjithë efektivit, në përmirësimin e gjithë punës së organizatave bazë të Partisë.

Një faktor me rëndësi, që ka influencuar në ngritjen e punës së organizatave bazë të Partisë, është edhe ngritja e nivelit kulturor, profesional e ideologjik të komunistëve. Në krahasim me Kongresin III të Partisë, tani kemi rreth 14,7 për qind më shumë komunistë me arësim 7-vjeçar e lart dhe rreth tri herë më shumë komunistë me arësim të lartë. Në radhët e komunistëve në prodhim kemi një numër të madh njerëzish të pararojës, heronj të punës socialiste, punëtorë të dalluar, mjeshtra të prodhimit, racionalizatorë, iniciatorë dhe përhapës të iniciativave të reja. Rreth 80 për qind e komunistëve në prodhim janë punëtorë të kualifikuar. Në shkolla e kurse partie kanë kaluar 21 për qind e komunistëve,

ndërsa rreth 89 për qind e efektivit të Partisë çdo vit ndjek shkollat e kulturës së përgjithshme ose format e arësimit në Parti.

Një kujdes më i madh është treguar gjithashtu gjatë kësaj kohe për përmirësimin e shtrirjes dhe të shpërndarjes së forcave të Partisë, si midis sektorëve, ashtu edhe brenda përbrenda ndërmarrjeve, kooperativave etj. Është rritur numri i organizatave bazë të Partisë, i organizatave të sektorëve dhe i grupeve të Partisë. Sot veprojnë 3.429 organizata bazë partie (ose 352 më shumë se në Kongresin III), 358 organizata partie sektori (ose 105 më shumë se më 1958) dhe 1592 grupe partie (ose 950 më shumë se në 1958). Në Kongresin III në minierat, në industri, në artizanat, në transport, në ndërtim e në tregëti kishim 24,2 për qind të efektivit të Partisë, kurse tani kemi 30,7 për qind; në bujqësi (ferma, SMT, kooperativa dhe fshatra individuale) kishim 41,2 për qind të efektivit, tani kemi 39 për qind. Efektivi i Partisë në sektorin socialist të bujqësisë është rritur nga 12,3 për qind në 34,2 për qind, ndërsa në sektorin privat, si rezultat i kolektivizimit të bujqësisë, është ulur nga 28,9 për qind në 4,3 për qind. Në administratat shtetërore, ushtri, sigurim, shëndetësi dhe arësim, si rezultat i shtimit të pranimeve nga njerëzit e prodhimit dhe i dërgimit të afro 2000 komunistëve nga administratat në prodhim dhe si rezultat i shkurtimeve që janë bërë në sektorët administrativë, është ulur efektivi i Partisë nga 45,16 në 39,20 për qind.

Në përgjithësi shpërndarja e komunistëve në prodhim dhe administratë është përmirësuar. Në kohën e Kongresit III ne kishim 51,22 për qind të efektivit të Partisë në prodhim, kurse tani kemi 56,18 për qind. *Në bazë të kësaj gjendjeje mund të thuhet se shtrirja dhe shpërndarja aktuale e forcave të Partisë është e atillë që siguron plotësisht kontrollin dhe rolin udhëheqës të Partisë në të gjithë sektorët e jetës së vendit.*

Orientimi i Kongresit III, sipas të cilit duhej të përmirësohej shpërndarja e forcave të Partisë, duke shtuar numrin e komunistëve në prodhim dhe duke pakësuar ato të administratës, është realizuar në mënyrë të kënaqshme.

Por me gjithë këto, edhe në të ardhshmen, Partia duhet ta konsiderojë çështjen e ngritjes së nivelit të punës së organizatave bazë në nivelin e kërkesave të kohës, veçanërisht rritjen e rolit të tyre në prodhim, forcimin e jetës së brendshme dhe aktivizimin e kalitjen e komunistëve, si një nga problemet më të rëndësishme organizative të saj. Dhe kjo duhet konsideruar kështu, nga njëra anë, sepse pa punën e organizatave bazë asnjë detyrë nuk mund të kryhet, ato janë themeli i Partisë, dhe, nga ana tjetër, sepse ne kemi ende të meta dhe të meta të rëndësishme në punën e organizatave bazë, siç do ta shohim më poshtë; dhe më

në fund, sepse detyrat që kemi përpara janë më të mëdha dhe kërkojnë jo vetëm më shumë punë, por edhe punë më të kualifikuar e më konkrete.

Detyra e parë themelore, ku duhet të përqëndrohet vëmendja jonë në të ardhmen, është të rrisim edhe më shumë rolin e organizatave të Partisë në prodhim:

Me gjithë përmirësimet e bëra në këtë drejtim, jo gjithnjë organizatat e Partisë u përgjigjen plotësisht detyrave që kanë dhe mund të themi se puna e tyre në mjaft raste është nën nivelin e kërkesave. Influenca e tyre për realizimin me sukses të detyrave të planit në të gjithë treguesit si dhe për forcimin ekonomik-organizativ të kooperativave bujqësore është ende e pamjaftueshme. Prandaj vërehen shumë të meta dhe mjaft detyra mbeten ende pa u zbatuar ose zbatohen pjesërisht.

Kushtet e reja, të krijuara me zhvillimin në thellësi të industrisë, me kolektivizimin e bujqësisë etj., si dhe detyrat shumë të mëdha që qëndrojnë përpara gjithë degëve të ekonomisë në vendin tonë, kërkojnë një ndryshim rrënjësor edhe në metodën e format e punës së organizatave bazë të Partisë. Për t'ja arritur këtij qëllimi organizatat e Partisë duhet të përqëndrojnë vëmendjen në këto çështje kryesore.

Së pari, organizatat bazë të partisë në ndërmarrjet dhe në kooperativat bujqësore duhet të ushtrojnë plotësisht të drejtën e kontrollit që u është dhënë me statut mbi veprimtarinë e administratës së ndërmarrjes. Kjo është një çështje me rëndësi të madhe për organizatat bazë të sektorëve ekonomikë, për të cilat akoma tregohet pak kujdes. Duhet thënë se në praktikën e punës ka një kuptim të ngushtë mbi këtë çështje; mendohet se e drejta e kontrollit mbi veprimtarinë e administratës së ndërmarrjes është e drejta për të thirrur në raport para organizatës bazë drejtorin ose zëvendësat e tij. Kjo pa dyshim është një nga format dhe jo pa rëndësi në ushtrimin e kësaj të drejte. Por gjithnjë vetëm një nga format. Thelbi i së drejtës së kontrollit mbi veprimtarinë e administratës së ndërmarrjes, që u është dhënë organizatave bazë të sektorëve ekonomikë, qëndron para së gjithash në rritjen e përgjegjësisë dhe të influencës së tyre në tërë veprimtarinë e ndërmarrjes, në futjen e tyre në thellësi të çështjeve të organizimit të prodhimit, në zbulimin e dobësive dhe në përcaktimin e masave për zbatimin e plotë e të përpiktë të detyrave sipas të gjitha kërkesave që shtrojnë vendimet e Partisë.

Këtu ne kemi të meta serioze. Mjaft organizata partie, si ajo e Kombinatit të drurit në Elbasan, e Konservimit të peshkut në Vlorë etj., vazhdojnë të merren në përgjithësi me problemet e planit, pa u ndalur në hallka të veçanta të tij; kështu edhe detyrat i nxjerrin të përgjithshme, prandaj edhe influenza e tyre në pro-

dhim është e pakët. Gjithashtu ka organizata bazë që nuk e shikojnë nën prizmin e Partisë realizimin e detyrave të planit, nuk ngulin këmbë në zgjidhjen e detyrave, por pranojnë e pajtohen me justifikimet e disa njerëzve të administratës. Shpeshherë ndodh kështu: për mungesa në furnizimin etj. në vend që organizata ta verë para përgjegjësisë drejtorinë për ta zgjidhur çështjen, duke u bërë copë, dhe të mos e lerë rehat deri sa ta zgjidhë, drejtori «ndan punën» me sekretarin e organizatës bazë: i pari merr ministrinë në telefon (zgjidhje operative!) dhe i dyti zë derën e komitetit të Partisë. Dhe kur ndodh që çështja nuk zgjidhet e problemi shtrohet në byro apo në organizatën bazë, drejtori dhe sekretari lavdërojnë përpjekjet(!) e njëri-tjetrit, kritikojnë të tjerët që s'i ndihmuan dhe justifikojnë gjendjen. Jo, kështu nuk duhet të punojnë organizatat bazë! Sikur të kishte vepruar sipas këtij parimi organizata bazë e SMT-së në Shkodër, kombajnati edhe sot e kësaj dite nuk do t'i kishte nxjerrë dot në fushë. Ajo s'priti të justifikonte gjendjen me mosdërgimin e pjesëve të këmbimit nga ministria, por studjoi mundësitë e prodhimit të tyre në vend, ngarkoi administratën me detyra dhe ndihmoi efektivisht në organizimin e punës për kapërcimin e kësaj vështirësie. Si rrjedhim, SMT-ja e Shkodrës arriti të prodhojë vetë 60 për qind të pjesëve të këmbimit që i nevojiteshin. Kështu duhet të punojnë organizatat bazë që të mund të rrisin rolin dhe influencën e tyre në prodhim. Sa herë që shqyrtojnë një çështje, ose u del ndonjë problem serioz në prodhim, ato duhet të thellohen mirë mbi gjendjen, të caktojnë qartë detyrat për administratën e ndërmarrjes, për veten e tyre dhe për organizatat e masave, dhe të organizojnë kontrollin për të ndjekur zbatimin e tyre. Por një punë e tillë kërkon para së gjithash që organizata të njohë mirë e me hollësi çështjet e prodhimit, të njohë rezervat e mundësitë që ekzistojnë në ndërmarrje ose kooperativë, të mbështetet shumë te njerëzit, te specialistët, të dëgjojë mendimet dhe vërejtjet e tyre e të dijë të mobilizojë me entuziazëm forcat e tyre.

... Një aspekt tjetër me shumë rëndësi i mosushtrimit të së drejtës së kontrollit mbi veprimtarinë e administratës së ndërmarrjes nga mjaft organizata bazë është edhe fakti që ato nuk qëndrojnë plotësisht si duhet në roje të interesave të Partisë dhe të shtetit.

Në Parkun automobilistik të Urës Vajguore në Berat u zbuluan raste falsifikimesh dhe vjedhjesh të rënda, kurse organizata bazë as e kishte bërë ndonjëherë çështje këtë gjë. Në Fabrikën e qelqit në Korçë gjithashtu realizohet plani në sasi, në dëm të cilësisë, ndërsa në Kombinatin e naftës porositen nga importi maqineri të panevojshme që kapin vleftën prej 91 milion lekësh dhe organizatat bazë gjithashtu heshtin. Në kooperativat shkelet herë-

-herë statuti, nuk përdoren drejt kreditë që jep shteti etj. dhe përsëri organizatat bazë bëjnë sehir.

Disa herë, kur këto zbulohen nga kontrollet, organizatat mbledhin supet. S'ka dyshim se kontrolle e revizione janë bërë e do të bëhen edhe në të ardhshmen, bile duhet të bëhen më shpesh e më mirë, por pse duhet të mbështetemi më shumë te këto për t'i zbuluar gjërat e padrejta në ndërmarrje ose kooperativa, kur kemi atje organizatën e Partisë? Ka ardhur koha t'u jepet fund këtyre qëndrimeve të padrejta dhe kjo do të arrihet kur të gjitha organizatat e Partisë, çdo komunist, të vihen plotësisht në roje të mbrojtjes së interesave të Partisë e të shtetit dhe t'i shikojnë e t'i gjykojnë gjërat gjithnjë nga pikëpamja politike, nga prizmi i Partisë.

Për të luftuar kundër këtyre dobësive duhet të aktivizohen më shumë komunistët në kontrollin e zbatimit të detyrave dhe kështu të mund të kërkohet edhe mendimi i tyre për masat që duhen marrë, që ato të zbatohen mirë e si duhet. Nga ana tjetër duhet që kuadrot kryesorë drejtues të ndërmarrjes të sigurojnë medoemos udhëheqjen e organizatës bazë dhe jo vetëm ta vlerësojnë si duhet punën dhe rolin e saj e të marrin rregullisht dhe gjallërisht pjesë në të, por dhe të kërkojnë që çdo çështje që preokupon prodhimin, bile dhe çdo mendim dhe ide e tyre, që ka të bëjë me punën e ndërmarrjes, të shtrohet për shqyrtim në organizatën bazë. Kjo do të ndihmojë që organizatat bazë të jenë më në dijeni të çështjeve që të preokupohen më seriozisht të gjithë për to dhe që të ndihmojnë siç duhet për zgjidhjen e tyre. Natyrisht edhe më e frytshme do të jetë puna e Partisë në drejtim të prodhimit, kur për këto çështje do të tërhiqet mendimi kolektiv, jo vetëm i komunistëve, por edhe i punonjësve të tjerë pa parti.

Së dyti, për rritjen e influencës së organizatave të Partisë në prodhim është e domosdoshme të rritet roli i grupeve të Partisë. Mjaft shembulla pozitive të këtyre viteve të fundit flasin qartë për rolin e tyre. Kështu, me iniciativën e grupit të Partisë në TEC-in e Tiranës u zgjidh problemi i tubetave të mazutit, në NIL-Prodhime në Vlorë me propozimin e grupit u ngrit laborator i për analizën e prodhimeve, në portin e Durrësit u hoq nga rruga e keqe një punëtor dhe u forcua familja e tij etj. Por me gjithë këto, në punën e grupeve ne kemi ende të meta, gjë që shpjegohet me një farë nënvleftësimi që i bëhet ende punës së tyre dhe me formalizmin që shprehet si në mënyrën e ngritjes, ashtu edhe në funksionimin e tyre.

Komiteti Qendror e ka theksuar edhe herë tjetër se, sidomos për organizatat e mëdha që punojnë në ndërmarrje të gjera, zgjidhja operative e çështjeve konkrete, që dalin për ditë në punën e prodhimit dhe në punën me njerëzit, nuk mund të bëhet si duhet pa përaurur mirë e drejt grupet e Partisë. Duke marrë

parasysh se qëllimi kryesor i punës së grupeve është të ndërhyjnë operativisht në zhdukjen e çdo pengese që del në rrugë për realizimin e detyrave që shtron organizata bazë, të merren edhe me çdo njeri, me hallet e tyre dhe me gjërat më intime të tyre etj; duhet treguar shumë kujdes që edhe ndërtimi i tyre t'i përgjigjet këtij qëllimi, d.m.th. të ngrihen atje ku është hallka bazë, njësia më e vogël e prodhimit dhe gjithmonë mbi bazë prodhimi të caktuar.

Pikërisht këtu, në grup, duhet të mësohen shokët të mos lënë t'u shpëtojë asgjë që pengon zhvillimin e prodhimit, që influencën për keq në zbatimin si duhet të detyrave, që shpie në prishjen e ndërgjegjes së njerëzve etj. Këto gjëra duhet të shtrohen në grup, këto duhet kryesisht të zgjidhen operativisht, me mbledhje të shkurtëra e të shpejta. Dhe po arritëm që çdo grup të bëjë mirë e si duhet këtë punë, kemi siguruar një bazë të shëndoshë për realizimin e të gjitha detyrave dhe planeve.

Me kolektivizimin e bujqësisë, veçanërisht me bashkimin e kooperativave bujqësore të vogla në më të mëdha, me zgjerimin e fermave dhe të disa sektorëve të tjerë të përhapur si gjeologjia e transporti detar, si edhe me shtimin e komunistëve në disa qendra të mëdha, kanë lindur edhe disa probleme të ndërtimit të organizatave bazë në këta sektorë. Me qëllim që të mund të sigurohet më mirë roli udhëheqës i Partisë dhe ndërtimi i Partisë t'u përshtatet më mirë kushteve të krijuara, Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH ka vendosur që në organizatat bazë të Partisë në kooperativat bujqësore, ku ka mbi 40 komunistë, si dhe në organizatat bazë të NBSH-ve, të gjeologjisë, të shpim-kërkimit dhe të transportit detar, ku ka mbi 80 komunistë, të ngrihen komitete partie dhe organizatave të Partisë të sektorëve, sipas brigadave e njësive të tjera të prodhimit, t'u jepen të drejtat e organizatave bazë. Gjithashtu është vendosur që komiteteve të Partisë të ndërmarrjeve dhe të institucioneve të mëdha, ku ka mbi 500 komunistë, t'u jepen të drejtat e komiteteve të Partisë të rretheve për pranimit në Parti, regjistrimin e komunistëve dhe për masat ndëshkimore, me kusht që vendimet për përjashtime nga Partia të hyjnë në fuqi vetëm pasi të merret aprovimi i komitetit të Partisë të rrethit ose të qytetit prej nga varen. Nuk ka dyshim se këto dy masa do të ndihmojnë për rritjen e rolit të organizatave bazë dhe për forcimin e mëtejshëm të punës së tyre.

Detyra tjetër me rëndësi për ngritjen e rolit të organizatave bazë të Partisë është forcimi i mëtejshëm i jetës së brendshme të tyre.

Siç u tha edhe më lart, jeta e brendshme e organizatave është forcuar dhe uniteti i tyre për çka i përket vijës së Partisë është i plotë. Por në jetën e brendshme të organizatave të Partisë ka ende dobësi e mungesa. Nuk ka në të gjitha organizatat një veprimtari të gjallë. Në disa organizata bazë shumë të më-

dha mbledhjet e përgjithshme nuk bëhen në rregull, si p.sh. në Kombinatin e sheqerit në Maliq, ku mbledhje bëhej një herë në vit, por edhe kur bëhen nuk përgatiten me kujdes dhe nuk marrin pjesë gjallërisht të gjithë shokët, ndërsa në disa organizata të vogla, që kanë edhe shumë kohë pa bërë pranime në Parti, është krijuar një situatë joluftarake, anëtarët dhe kandidatët e Partisë sikur janë familjarizuar me gjendjen dhe me të metat në punë dhe nuk luftojnë për ta shkundur organizatën. Në disa organizata fshati veçanërisht vihen re dhe grindje e tarafe, kryesisht për të zënë vende të rehatshme, ku nuk punohet me norma, por me rrogë mujore e ditë fikse ose për të zënë postin e kryetarit. Ka ende komunistë që nuk janë në lartësinë e detyrave dhe që bien në gabime, nuk kryejnë si duhet detyrat në prodhim e si anëtar partie, thyejnë disiplinën, nuk kujdesen për ruajtjen e pasurisë socialiste, por dhe e dëmtojnë atë, mbajnë qëndrime oportuniste karshi armiqve, nuk janë korrekt as në shoqëri, as në familje etj. Këto dobësi, që vihen re në jetën e organizatave bazë dhe në komunistët, vërtetohen edhe nga masat e shumta ndëshkimore që jepen në Parti. . . Ky problem duhet të na preokupojë më shumë, sepse kjo ka të bëjë edhe me vetë rritjen e Partisë. Në shumicë masat ndëshkimore jepen për thyerje discipline, për shturje në jetën personale e për mbeturina të zakonave prapanike, si dhe për dëmtime e shpërdorime të pasurisë socialiste. Ne mendojmë se veç dobësive që ka që në pranimin në Parti, veç punës së pamjaftueshme që bëhet për edukimin e komunistëve, masat ndëshkimore tregojnë edhe se disa herë komitetet e Partisë shpejtohen në dhënjën e tyre. . . Të gjitha masat ndëshkimore tregojnë se puna për edukimin komunist të anëtarëve dhe të kandidatëve të Partisë, kritika dhe autokritika, jeta e brendshme e organizatave bazë, kontrolli për zbatimin e detyrave janë të dobëta dhe komitetet e Partisë vazhdojnë të nxjerrin pak mësim nga masat e shumta ndëshkimore që japin, ndihmojnë në mënyrë të pamjaftueshme organizatat bazë dhe komunistët që gabojnë.

Shpesh, në organizatat bazë, bile dhe në disa komitete partie, shqyrtohen shumë thatë çështjet personale të komunistëve, vetëm sa tregohet faji dhe merret masa. Dhe shpeshherë mendohet se sa më e rëndë të jetë masa, aq më e fortë është kritika, aq më efekt do të bëjë qëndrimi i mbajtur. Kurse në fakt duhet të ngjasë ndryshe: efekti i masës duhet të gjykohet jo me atë se sa e lehtë ose e rëndë është ajo, porse sa e ndjen atë i interesuari, si dhe gjithë komunistët e tjerë. Diskutimi i veprimtarisë së një komunisti në organizatën bazë duhet konsideruar si një çast shumë i rëndësishëm nga duhet

të nxirren mësim se si duhet të jetë komunisti, jo vetëm shoku që ka gabuar, por e gjithë organizata.

Me këtë rast theksojmë pak edhe problemin e të përjashtuarve nga Partia. Dihet se në shumicë këta janë përjashtuar jo për fajë politike, jo për qëndrime kundër vijës së Partisë, por për dobësi në punë, për të kaluarën jo të pastër etj. Pra këta njerëz nuk janë armiq të Partisë. Si rrjedhim këta duhet të aktivizohen e të mbahen afër, të mos izoloohen, por të vihen në luftë për shlyerjen e gabimeve, duke u lënë të hapur edhe perspektivën se po punuan mirë, po u ndreqën, dyert e Partisë janë hapur dhe mund të ripranohen në Parti. Ndërsa ndaj atyre që janë përjashtuar nga Partia si armiq duhet të forcohet vigjilënca e Partisë.

Ku duhet të përqëndrohet vëmendja e organizatave të Partisë për të forcur jetën e brendshme të Partisë?

Së pari, komitetet e Partisë duhet të japin një ndihmë të madhe për zhvillimin e mbledhjeve të Partisë në rregull e në një nivel të lartë, duke siguruar një pjesëmarrje të gjallë e aktive të të gjithë komunistëve. Të gjitha çështjet në organizatën bazë duhet të diskutohen në frymën e një analize të shëndoshë, luftarake, duke u thelluar plotësisht mbi vendimet e Partisë dhe mbi gjendjen në ndërmarrje, kooperativë, dikaster apo shkollë. Disa komitete partie kanë organizuar një ndihmë më të mirë nëpërmjet kontrolleve. Kështu, p.sh., komiteti i Partisë i rrethit të Përmetit, gjatë vitit 1959, analizoi punën në 29 organizata bazë, ndërsa gjatë gjashtë muajve të këtij viti vetëm 1 sekretar i komitetit të Partisë ka drejtuar 6 ekipe për kontroll e ndihmë në organizatat bazë. Konkluzionet i kanë shqyrtuar në byro dhe i kanë përgjithësuar pastaj në të gjitha organizatat e tjera. Duke u kapur kështu mirë pas organizatave bazë, Përmeti vjet arriti të merrte flamurin. Për zhvillimin e një jete më aktive në organizatat bazë i duhet kushtuar shumë kujdes zhvillimit të rregullt e në nivel të lartë të mbledhjeve të organizatave bazë. Rëndësi të posaçme ka në këtë drejtim zgjedhja me kujdes dhe pregatitja e mirë e çështjeve që do të shqyrtohen me to. Ato duhet të jenë rezultate të një pune serioze e të thelluar, jo vetëm të sekretarit të organizatës bazë apo të ndonjë komunisti tjetër... por të të gjithë komunistëve, bile edhe të njerëzve të tjerë pa parti. Gjërat që studjohen me grupe shokësh, që diskutohen me grupe punonjësish etj. dalin gjithnjë më të pjekura dhe si rrjedhim krijojnë baza më të shëndosha për diskutim kur i shtrohen organizatës bazë. Gjithashtu studimi më parë i çështjes në vend, nga një grup shokësh, jep edhe material të gjallë për punën e njërit apo të tjetrit shok, ndikon të bëhen dhe kritika e lavdërime me emër, kështu që vetëvetiu i jep më tepër gjallëri mbledhjes.

Ne duhet të punojmë me të tëra forcat që organizatat bazë të Partisë të bëhen në fakt shkolla të edukimit komunist të anëtarëve dhe të kandidatëve të Partisë, kudhër ku të kaliten me vetitë e duhura të moralit tonë gjithë komunistët. Kemi organizata që e kryejnë shumë mirë këtë detyrë dhe kanë kalitur të tillë kolektiv, që s'i trembet syri nga asnjë detyrë. Kemi organizata që kur zhvillojnë mbledhjet për dhënje llogari dhe zgjedhje bëjnë zakonisht një jetë shumë të gjallë. Kështu në mbledhjet që u zhvilluan këtë vit më tepër se 50 për qind e komunistëve morën pjesë në diskutime dhe rreth 50-60 për qind e tyre bënë vërejtje, propozime e kritika për byronë apo sekretarin e organizatës bazë si dhe për organet drejtuese të Partisë e të shtetit. Por jo gjithnjë e në të gjitha organizatat bazë bëhet një diskutim i tillë i gjallë i problemeve.

Në këtë drejtim duhet më shumë dhe më mirë ta zhvillojmë kritikën dhe autokritikën në Parti. Mbeturinat e ideologjisë borgjeze në ndërgjegjen e njerëzve janë një pengesë serioze për ta çuar punën përpara dhe për zhvillimin e një jete të gjallë në organizatat bazë të Partisë. Prandaj lufta për t'i zhveshur njerëzit nga këto mbeturina duhet të jetë në qendër të vëmendjes së organizatave bazë të Partisë, për ta bërë çdo anëtar e kandidat partie të gjykojë e të veprojë në bazë të interesit të Partisë, të vijës së saj, që të jetë parimor, i drejtë, i ndershëm dhe shembull në punë, në shoqëri e në familje, ashtu siç kërkon Partia, ashtu siç i njuh e i do populli komunistët. Vetë ekzistenca e mbeturinave mikroborgjeze e pengon zhvillimin e kritikës dhe të autokritikës, i bën disa komunistë që të mos kritikojnë njëri-tjetrin apo përgjegjësit e tyre, ose përkundrazi të kritikojnë pa të drejtë ose edhe të shpifin. Prandaj lufta për zhvillimin e kritikës dhe të autokritikës është lufta për edukimin komunist të anëtarëve dhe të kandidatëve të Partisë.

Zhvillimi i kritikës dhe i autokritikës pengohet ngandonjëherë edhe nga qëndrimi jo i drejtë i disa shokëve me përgjegjësi, të cilët jo vetëm nuk e ushtrojnë kritikën dhe autokritikën, por disa herë edhe e pengojnë duke mos e pranuar, duke mbajtur qëndrim formal ndaj saj dhe në ndonjë rast edhe duke u hakmarrë për kritikën që u drejtohet. Ose ngandonjëherë bëhet autokritikë formale, e cila bie sapo bëhet, sepse i futet pas një «por» i fortë dhe kalohet shpejt në kritikën për të tjerët, bëhet «shkarkimi», si të thuash... Kuadrot kanë përgjegjësi më shumë, prandaj edhe gabimet e tyre janë më të kushtueshme; por ata do të gabojnë më pak në qoftë se do t'ja nënshtrojnë veprimtarinë e tyre kontrollit të organizatës bazë, nëse do të kritikohen e do të ndihmohen nga organizatat bazë dhe këtë gjë ata duhet ta sigurojnë patjetër nëse duan që të punojnë gjithnjë e më mirë. Organizatat e Partisë e komitetet e Partisë duhet të dënojnë me

forcë çdo formë apo qëndrim që e mbyl kritikën, sidomos kritikën nga poshtë.

Komitetet e Partisë shqyrtojnë shpesh masa ndëshkimore, analizojnë raportet 3-mujore, hasin shpesh në dobësi e gabime të komunistëve në organizata bazë, në takime me ta etj., por nuk nxjerrin gjithnjë mësimet e duhura për të edukuar Partinë me vetë jetën e saj. Një gjë e tillë është më e efektshme se sa shumë leksione të përgjithshme.

Së dyti, aktivizimi i komunistëve dhe ngritja në përgjithësi e aftësive të tyre është kusht i domosdoshëm për rritjen e rolit të organizatës bazë, për gjallërimin e jetës së saj. Në këtë kuptim duhet t'i kushtohet kujdes forcimit të disiplinës në Parti, duke kërkuar që çdo komunist të kryejë si duhet detyrat që përcakton statuti i Partisë dhe duke rritur përgjegjësinë të çdo komunist për zbatimin nga ai vetë dhe nga organizata e tij e të gjitha vendimeve që shtron Partia. Duhet thënë se, me gjithë përmirësimet e bëra në këtë drejtim, ka ende organizata ku një numër komunistësh nuk aktivizohen me detyra partie e nuk janë në rregull edhe me sektorin e punës së tyre. Për këtë në radhë të parë kanë përgjegjësi organizatat bazë të Partisë. Është bërë zakon në disa organizata që një pjesë të komunistëve t'u ngarkojnë nga 5-6 detyra, kurse të tjerëve asnjë.

Në këtë drejtim është e domosdoshme të luftohet në radhë të parë kundër një mendimi që ka fituar si të thuash «të drejtë qytetarie», sipas të cilit komunistët ndahen në «të aftë» për të plotësuar detyra shoqërore dhe «të paaftë» për këtë punë. Një mendim i tillë është krejt i padrejtë. Çdo komunist, përderisa është pranuar në Parti, goftë dhe ai më i riu, është patjetër në gjendje të kryejë një detyrë shoqërore në përshtatje me aftësitë e tij. Aktivizimi me detyra i të gjithë komunistëve jo vetëm që do të sigurojë një realizim më të mirë të këtyre detyrave, por edhe do t'i gjallërojë komunistët, do t'i bëjë ata ta ndjejnë veten më të lidhur me Partinë, të mendojnë për të vazhdimisht dhe jo vetëm kur paguajnë kuotizacionin ose marrin pjesë në mbledhje. Një detyrë e përgjithshme dhe e përhershme për çdo komunist pa përjashtim është të jetë propagandist dhe agjitor i flaktë i vijës dhe i vendimeve të Partisë. Kjo duhet kërkuar pa dallim nga të gjithë komunistët.

Të nisur nga qëllimet për të siguruar një aktivizim më të mirë të komunistëve, në disa organizata bazë partie, si në NISH-Këpuca në Tiranë, në parkun automobilistik në Shkodër etj., është marrë iniciativa për krijimin e komisioneve me anëtarë dhe kandidatë partie për probleme të caktuara. Megjithëse ende jemi në fillim të kësaj pune, praktika e deritashme tregon se kjo është një formë mjaft e dobishme që tërheq në punë aktive gjithë komunistët, ndihmon si për përgatitjen e mirë të çështjeve që

shqyrtojnë organizatat e Partisë, për kontrollin e zbatimit të vendimeve, ashtu edhe për forcimin e kontrollit të Partisë mbi veprimtarinë e administratës së ndërmarrjes. Ne duhet ta përgjithësojmë këtë eksperiencë të mirë, por duhet pasur parasysh gjithashtu që, nga njëra anë, të mos krijohen komisione për komisione ose komisione paralele me ato që kemi në Bashkimet Profesionale ose në kooperativat bujqësore, dhe, nga ana tjetër, sidomos tani në fillim, të tregohet kujdes për aktivizimin e mirë të tyre. Atje ku nuk kuptohet mirë nevoja e komisioneve dhe ngrihen formalisht, është më mirë të mos krijohen fare.

Aktiviteti i çdo komunisti varet shumë edhe nga aftësia e tij, nga niveli i tij arësimor e kultural, nga përgatitja profesionale si dhe nga shkalla e ndërgjegjes së tij si komunist. Në shumicën dërmuese anëtarët e Partisë sonë po e mbajnë me nder titullin e lartë të anëtarit të Partisë, ata janë shembull në punë e në jetë dhe janë njerëzit më të përparuar e më të vendosur të popullit tonë, gjë që vërtetohet edhe nga këto të dhëna: 88 për qind e heronjve të popullit dhe 90 për qind e heronjve të punës socialiste janë komunistë. Ndërsa në radhët e klasës punëtore ne kemi vetëm 25,15 për qind me arësim 7-vjeçar e lart dhe në anëtarët e kooperativave bujqësore 6,56 për qind, në radhët e komunistëve në prodhim ata që kanë këtë nivel arësimor në qytet zënë 40,28 për qind dhe në kooperativat bujqësore 19,57 për qind të tyre. E njëjta gjë duhet thënë dhe për nivelin tekniko-profesional. Por përderisa ende kemi në Parti rreth 58 për qind të efektivit me shkollë fillore e poshtë dhe rreth 45 për qind të komunistëve të prodhimit me kategori IV e poshtë, çështja e ngritjes së nivelit arësimor e tekniko-profesional të komunistëve mbetet problem shumë serioz. *Prandaj edhe në të ardhshmen çështja e marrjes së arësimit, të paktën fillor për shokët e fshatit dhe 7-vjeçar për ata të qytetit, brenda vitit 1965 duhet të bëhet një kërkesë e domosdoshme për çdo komunist, duke e vënë këtë punë plotësisht nën kontrollin e organizatave bazë.* Ka ardhur koha gjithashtu që të gjithë komunistët, kudo që punojnë, të bëhen zotër të zanatit, prandaj duhet të ngrëmë edhe më shumë nivelin e tyre tekniko-profesional. Të gjithë komunistët çdo vit duhet të punojnë që të ngrënë si nivelin e tyre kultural, ashtu dhe nivelin e tyre teknik.

Për forcimin e rolit dhe për ngritjen e nivelit të punës së organizatave bazë duhet t'i kushtohet kujdes i dorës së parë kalitjes ideologjike dhe politike të komunistëve, ngritjes së nivelit të punës politike në Parti. Kjo çështje ka rëndësi shumë të madhe që Partia të kryejë si duhet rolin e udhëheqësit politik. Ne mund të krenohemi me pjekurinë politike që tregojnë në përgjithësi të gjithë anëtarët dhe kandidatët e Partisë sonë. Të kalitur në jetën e përditshme të Partisë, në luftën me armiqtë

e Partisë e të popullit, ata kanë ditur të mbajnë kurdoherë qëndrim të drejtë dhe të palëkundur. Por në kushtet kur imperializmi, me mjete të shumta dhe të shumëllojshme, përhap helmet e ideologjisë së tij borgjeze, kur revizionizmi, me revizionizmin jugosllav në krye, s'kursen asgjë për të përhapur idetë e veta armiqësore kundër marksizëm-leninizmit, kundër kampit të fuqishëm socialist, kundër partive dhe vendeve tona, kur në lëvizjen komuniste dhe punëtore ndërkombëtare shtrohet me tërë forcën çështja e mbrojtjes së pastërtisë së marksizëm-leninizmit dhe më në fund kur para popullit tonë shtrohen detyra të rëndësishme për ndërtimin e socializmit, forcimi i punës ideologjike dhe politike në Parti merr një rëndësi edhe më të madhe.

Edukimi ideologjik e politik i të gjithë komunistëve dhe forcimi i ndërgjegjes së tyre komuniste rrisin aftësitë e Partisë, kompaktësinë dhe unitetin e saj. Marksizëm-leninizmi nga vetë natyra e tij është i papajtueshëm me çdo shmangje dhe lëkundje nga parimet, pse çdo shmangje dhe lëkundje e tillë është largim nga ligjet e përgjithshme dhe objektive. Prandaj, duke forcuar punën ideologjike në Parti, forcojmë njëkohësisht unitetin e pafytyrës dhe monolit të Partisë. Komiteti Qendror i Partisë kurdoherë i ka kushtuar e vazhdimisht do t'i kushtojë kësaj çështjeje kujdes të posaçëm, sepse kjo ka të bëjë me një nga çështjet themelore, jetike për Partinë. Të gjitha organet dhe organizatat e Partisë duhet të rrisin edhe më shumë kujdesin për edukimin ideo-politik të Partisë dhe të masave. Organizatat e Partisë duhet të sigurojnë, si gjithnjë, nga çdo komunist unitetin e mendimit dhe të veprimit për të gjithë vijën dhe vendimet e Partisë, duke filluar që nga gjërat më të rëndësishme deri te vendimet më të thjeshta të organizatës bazë.

Duhet ta themi, shokë, se kujdesi i drejtë që ka filluar të duket në organizatat e Partisë për ngritjen e nivelit kultural dhe tekniko-profesional të komunistëve ka dobësuar ca kujdesin për edukimin ideo-politik të tyre. Gjatë viteve 1959-1960 kanë kaluar në format e arësimit në Parti rreth 48 për qind e gjithë efektivit. Por ajo që ka rëndësi është se cilësia e punës, në shumë nga këto forma, është mjaft e ulët, sepse edhe niveli i propagandistëve, me pak përjashtime, është gjithashtu i ulët. Drejtoria e propagandës e Komitetit Qendror dhe komitetet e Partisë në rrethe duhet të marrin masa më të efektshme për zgjidhjen më me sukses të këtij problemi. Nga ana tjetër, duhet të na tërheqë vëmendjen edhe fakti se mjaft komunistë, nga ata që vazhdojnë shkollat e kulturës së përgjithshme, lënë pothuajse fare pas dore edukimin ideologjik dhe politik të tyre. Prandaj i duhet dhënë rëndësi zbatimit të porosisë së Komitetit Qendror të Partisë, që për këto raste në mbledhjet mujore të organizatave bazë të Partisë të punohet të paktën një temë edukative dhe njëkohësisht t'i kush-

tohet më tepër kujdes, duke e vënë nën kontrollin e organizatës bazë, shfrytëzimit të literaturës politike e marksiste-leniniste.

Komiteti Qendror i Partisë ka ngritur me forcë nevojën e zhvillimit të një pune më të madhe nga ana e organizatave të Partisë për forcimin e ndërgjegjes socialiste në anëtarët dhe në kandidatët e Partisë për kalitjen e tyre me qëndrimin komunist ndaj punës dhe pronës shoqërore. Në këtë drejtim duhet të bëhet një punë e vazhdueshme dhe me ngulm kundër mbeturinave të ideologjisë së vjetër në ndërgjegjen e njerëzve, kundër psikologjisë së pronës private, kundër influencave të besimeve fetare e të zakoneve prapanike etj. Forcimi i ndërgjegjes socialiste të komunistëve duhet të bëhet në radhë të parë duke luftuar çdo shfaqje të ideologjisë borgjeze, çdo rrymë oportuniste, revizioniste që kërkon të depërtojë. Lenini i madh theksonte me forcë se atje ku nuk luftohet si duhet kundër ideologjisë borgjeze, atje i lihet vend përhapjes së saj. «Ose ideologji borgjeze, ose ideologji socialiste. Rugë të mesme nuk ka»⁴³ — thoshte Lenini — prandaj bashkekzistencën në lëmin e ideologjisë është vdekjeprurëse për Partinë. Organizatat tona të Partisë, ashtu si edhe deri sot, duhet të vazhdojnë me të gjitha forcat luftën kundër ideologjisë borgjeze, kundër oportunitizmit dhe revizionizmit në çfarëdo forme që do të paraqiten ato.

Forcimi i punës ideologjike në Parti do të sigurojë edhe rritjen e mëtejshme të vigjilencës revolucionare. Partia jonë është treguar kurdoherë vigjilente dhe ka zbuluar e dënua me kohë çdo veprimtari armiqësor në radhë të saj dhe në vendin tonë, i ka dërmuar ato dhe ka dalë gjithnjë fitimtare. Organizatat e Partisë kanë tanimë një eksperiencë të pasur në luftë kundër armiqve dhe pikërisht në luftë me armiqtë e popullit e të Partisë, e veçanërisht në luftë me revizionistët jugosllavë, armiq të tërbuar të Partisë, të shtetit tonë dhe të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare, është forcuar e kalitur Partia jonë dhe çdo komunist. Por armiqtë tanë, si revizionistët jugosllavë, monarko-fashistët grekë, neofashistët italianë me padronin e tyre të për-bashkët SHBA dhe agjentët e tyre jashtë dhe brenda vendit tonë, nuk e kanë pushuar veprimtarinë e tyre armiqësore dhe nuk do ta pushojnë derisa do të vazhdojnë të ekzistojnë. *Prandaj asnjë iluzion oportunist nuk duhet të lindë në këtë drejtim te asnjëri, qoftë për shkak të përparimeve të mëdha të vendit tonë, qoftë për shkak të forcimit të kampit tonë. . . Eksperiencia e vendit tonë dhe vetë zhvillimi i ngjarjeve ndërkombëtare e vërtetojnë këtë. Këtë porosi Partia jonë na e ka theksuar gjithnjë. Por duhet të themi se në disa organizata bazë ka shenja të zbutjes së vigjilencës, nënvleftësohet veprimtaria e armikut, ka preokupim më shumë për problemet ekonomike dhe lihet në dorë të dytë puna politike dhe organizative e Partisë, lufta kundër armiqve të Par-*

tisë dhe të vendit tonë, duke e konsideruar këtë si detyrë që duhet të ndiqet e të kryhet nga organet shtetërore të mbrojtjes dhe të sigurimit.

... Partia na mëson se në asnjë çast nuk duhet të lemë pas dore punën politike dhe ideologjike, punën organizative të Partisë, luftën kundër armiqve, duke e përqëndruar vëmendjen në problemet ekonomike. Asnjë problem, asnjë detyrë ekonomike nuk mund të zgjidhet me sukses po qe se ndahet nga jeta e Partisë, nga puna politike dhe ideologjike. *Lufta kundër armiqve të Partisë dhe të popullit dhe vigjilenca në Parti duhet të jenë detyra të përditshme në jetën e Partisë dhe të çdo komunisti.* Kështu Partia vetë, dhe nëpërmjet organeve të diktaturës që udhëhiqen prej saj, do të mund të shpartallojë gjithnjë çdo armik dhe çdo veprimtari armiqësor. Organizatat e Partisë duhet të ndejnë përgjegjësi të plotë për gjithshka ndodh në territorin e tyre, ato duhet të njohin shumë mirë gjendjen moralo-politike të masave dhe të njoftojnë për këtë, herë pas here, komitetet e Partisë dhe Komiteti i Partisë, Komitetin Qendror.

Hallkë e rëndësishme, nga duhet të kapemi për ngritjen në përgjithësi të nivelit të punës dhe të rolit të organizatave bazë, është puna për rritjen e aftësive të sekretarëve të organizatave bazë. Me rritjen e Partisë janë shtuar si numër dhe janë aftësuar edhe sekretarët e organizatave bazë. Kështu ndërsa në vitin 1956 35,2 për qind e sekretarëve të organizatave bazë ishin me arsim 7-vjeçar e lart dhe 2,2 për qind me shkolla partie, sot me këtë nivel përkatësisht kemi 48,5 për qind dhe 6,7 për qind të tyre. Gjithashtu mjaft sekretarë organizatash bazë ndjekin natën apo me korrespondencë shkollat e kulturës së përgjithshme. Puna e përditshme, lufta me vështirësitë për zbatimin e detyrave të Partisë dhe ndihma që u është dhënë nga organet e Partisë ka qenë gjithashtu një shkollë e madhe për gjithë komunistët e veçanërisht për sekretarët e organizatave bazë.

Por megjithkëtë, në përgjithësi, nivelin e sekretarëve të organizatave bazë, aftësitë e tyre për të drejtuar si duhet organizatat bazë i kemi ende nën nivelin e kërkesave të kohës. Sidomos në fshatra, me kolektivizimin e bujqësisë, shumë nga ish-sekretarët u bënë kryetarë kooperativash, ose në kooperativat e bashkuara si kryetarë u dërguan shokë mjaft të mirë, kurse sekretarët kanë diferencë të dukshme me ta. Kjo deri në një farë mase influencon që disa kryetarë të veprojnë pa u mbështetur si duhet te organizatat bazë.

Prandaj duhet të merremi më mirë e më seriozisht me zgjedhjen, përgatitjen dhe aftësimin e sekretarëve të organizatave bazë, sidomos të sekretarëve të organizatave bazë të fshatit. S'duhet harruar se sekretarët e organizatave bazë janë «reparti» më i gjërë i kadrove të Partisë dhe «reparti» i vijës së parë të sulmit.

Dhe në të ardhshmen, në radhë të parë, duhet të interesohemi për ngritjen e nivelit kultural e ideologjik të sekretarëve. Fakti që kemi ende rreth 7,5 për qind të tyre pa shkollë filllore ose që rreth 50% e tyre nuk kanë asnjë shkollë ose kurs partie duhet të na preokupojë. Nën kujdesin e drejtpërdrejtë të komiteteve të Partisë duhet të arrijmë që pothuaj të gjithë sekretarët të kenë të paktën arsimin 7-vjeçar.

Deri tani si formë kryesore për përgatitjen e sekretarëve të organizatave bazë kemi patur kurset 2-mujore të Partisë. Dhe në të ardhshmen ne duhet t'i mbajmë këto kurse, por kryesisht për sekretarët e organizatave të vogla, sidomos të fshatrave të pakolektivizuara ose të kooperativave të pabashkuara, si edhe për përgjegjësit e organizatave të sektorëve dhe të grupeve të Partisë, kurse për sekretarët e organizatave bazë të qendrave industriale e të ndërmarrjeve të tjera dhe sidomos të kooperativave të bashkuara duhet të shfrytëzohet kryesisht kursi njëvjeçar pranë Shkollës së Partisë «V.I. Lenin» dhe për disa edhe shkolla 3-vjeçare.

Por pa nënvleftësuar aspak rëndësinë dhe vlerën e formave të mësipërme për edukimin e sekretarëve të organizatave bazë, mendojmë se kryesorja në këtë drejtim është ndihma praktike që u duhet dhënë atyre për punën e tyre të përditshme nga komitetet e Partisë e, para së gjithash, organizimi i mirë i seminareve për shkëmbimin e eksperiencës. Duhet thënë se seminare me sekretarët e organizatave bazë te ne bëhen shumë, por kryesisht për t'i ngarkuar me detyra e pak për të zgjeruar horizontin e tyre e për t'i mësuar praktikisht, me shembullin e më të mirëve, se si duhet të punojnë për të kryer mirë detyrën e tyre. Eksperiencë të mirë në këtë drejtim ka organizata e qytetit të Tiranës, e cila për edukimin e sekretarëve ka përdorur deri kuadrot kryesore të Partisë e të qeverisë. Kurse në disa rrethe nga kjo punë, si të thuhet, kanë hequr dorë edhe vetë sekretarët e komiteteve të Partisë. Shoku Enver disa herë ka theksuar që me edukimin e sekretarëve duhet të merren patjetër drejt për së drejti sekretarët e komitetit të Partisë, dhe jo formalisht, por të përgatiten seriozisht për këtë punë. Asnjë punë tjetër nuk duhet ta largojë sekretarin nga plotësimi i kësaj detyre. Eksperienca që grumbullon aparatit të Partisë, eksperienca e mirë e njërës apo tjetrës organizatë duhet t'u transmetohet gjithë sekretarëve. Kjo është ndihma më e mirë që mund t'u jepet atyre. Veç kësaj, sekretarët e komitetit të Partisë dhe shokët e aparatit etj., që shkojnë për ndihmë në bazë, duhet gjithashtu të mos harrojnë as për një çast se nga ndihma e tyre në radhë të parë duhet të përfitojë sekretari i organizatës bazë, të shikojë ai si duhet kontrolluar, si duhet punuar me njerëzit, si duhen zgjidhur problemet etj. Prandaj në tërë punën duhet bashkëpunuar ngushtë me sekretarët e organizatës bazë.

S'është keq bile që, edhe kur shkohet me ekipe nga komiteti i Partisë për të kontrolluar punën e njërës ose tjetrës organizatë bazë, të merren me vete edhe sekretarët e organizatave të tjera. Këta edhe do të ndihmojnë në terren punën e ekipit, edhe do të mësojnë për vete nga puna e ekipit.

Pra forcimi i punës dhe rritja e rolit të organizatave bazë të Partisë sot përbën detyrën themelore në çështjet organizative të Partisë. Rritja e aftësive të sekretarëve të organizatave bazë është hallka kryesore nga duhet kapur për zgjidhjen e kësaj detyre.

— III —

Të përmirësojmë edhe më shumë metodën e punës së organeve udhëheqëse të Partisë.

Në kushtet tona, kur Partia është në fuqi, metoda e punës, drejtimi i mirë nga ana e komiteteve të Partisë kanë një rëndësi të dorës së parë. Partia te ne drejton pa përjashtim dhe për ditë tërë sektorët e jetës së vendit. Absolutisht asnjë aktivitet në vendin tonë, që nga mbrojtja e pavarësisë së atdheut e deri te çështja më e thjeshtë, nuk kryhet pa dorën, frymën, drejtimin dhe kontrollin e Partisë. Është pikërisht kujdesi i veçantë i Partisë, udhëheqja e saj e sigurt në çdo sektor, në çdo çështje që ka të bëjë me jetën e popullit, me zhvillimin e vendit dhe me ndërtimin e socializmit, që kanë bërë që vendi ynë të ecë me hapa kaq të mëdha përpara. Duke e çmuar kështu rolin e Partisë, çdo komitet partie, çdo organizatë bazë dhe çdo komunist duhet të kuptojnë se çfarë përgjegjësi e madhe rëndon mbi ta për ta organizuar dhe për ta udhëhequr punën ashtu si na mëson Partia.

Kongresi III i PPSH porositi që «Të vazhdohet lufta kundër metodave burokratike, kundër drejtimit nga zyra me letra e vendime dhe të forcohet puna e gjallë me bazën, me njerëzit».⁴⁴

Duke u mbështetur në këto vendime dhe në vendimet e herë-pashershme të plenumeve të Komitetit Qendror, organizatat e Partisë kanë bërë një luftë të madhe për përmirësimin e metodës së drejtimit. Rezultatet që janë arritur në vendin tonë, që nga Kongresi III i Partisë e këtej, i detyrohen në një masë shumë të rëndësishme edhe përmirësimit të metodës së punës nga të gjitha instancat si të Partisë, të organeve shtetërore dhe të ekonomisë, ashtu edhe të organizatave të masave.

Por, duke patur parasysh detyrat e mëdha që kemi përpara, ne duhet ta përmirësojmë edhe më shumë punën tonë në këtë drejtim.

Në radhë të parë duhet të rrisim akoma më shumë rolin drejtues të komiteteve të Partisë.

Që nga Kongresi III e këtej është bërë një përparim i duk-

shëm përse i përket ngritjes së nivelit të punës së komiteteve të Partisë. Kjo si rezultat i ndihmës së dhënë nga Komiteti Qendror i Partisë, por edhe si rezultat i përmirësimit të përbërjes dhe nivelit të tyre. Tani në plenumet e komiteteve të Partisë marrin pjesë 30 për qind më tepër anëtarë se sa në kohën e Kongresit III. Në mënyrë të veçantë është rritur numri i njerëzve nga prodhimi; kështu numri i punëtorëve është rritur 60 për qind dhe i anëtarëve të kooperativave bujqësore 70 për qind. Gjithashtu është ngritur edhe niveli kulturalo-arësor i anëtarëve të plenumeve. Ndërsa në Kongresin III kishim 48,6 për qind me 7-vjeçare e lart dhe 51,3 për qind me 7-vjeçare e poshtë, tani kemi respektivisht 67,3 për qind e 32,7 për qind. Kjo ka ndihmuar jo vetëm në zgjerimin dhe forcimin e demokracisë në Parti, por ka përmirësuar shumë edhe vetë punën e plenumeve. Zhvillimi i plenumeve është bërë më i gjallë, kritika dhe autokritika ndaj të metave është shtuar, diskutimi i problemeve bëhet në nivel më të lartë dhe më konkret. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për byrotë e komiteteve të Partisë.

Një rëndësi të veçantë, për përmirësimin e metodës pati organizimi i ri që u bë në vitin 1958. Siç mëson V.I. Lenini, format e organizimit të Partisë dhe metoda e punës së saj nuk janë një gjë e dhënë një herë e përgjithmonë, ato nuk janë të njëjta për çdo vend e në çdo kohë. Përkundrazi, ato ndryshojnë së bashku me ndryshimin e kushteve, ato ndërtohen në përputhje me detyrat e reja. Organizimi i ri, siç tregoi dhe eksperienca, ishte forma më e përshtatshme që i përgjigjej më mirë kushteve të krijuara. Në sajë të tij është siguruar një ndihmë më e mirë për bazën, organizatat bazë janë bërë më operative, më vetëvepruese dhe merren më konkretisht me problemet që kanë. Nga ana tjetër është rritur përgjegjësia e instruktorëve dhe e sekretarëve të komiteteve të Partisë për zonën dhe po lidhet më mirë puna politike e organizative e Partisë me problemet ekonomike.

Por natyrisht kjo s'do të thotë se tani gjithshka ecën shumë mirë, përkundrazi, në këtë drejtim kemi ende shumë për të bërë.

Një problem me shumë rëndësi për të rritur rolin e plenumeve dhe të byrove është *aktivizimi i anëtarëve të tyre, në mënyrë që ata të ndjejnë përgjegjësinë jo vetëm në mbledhje, jo vetëm për marrjen e vendimeve, por edhe për zbatimin e tyre.* Inisiativat që kanë lindur, si në Vlorë, Fier e gjetkë, për krijimin e komisioneve me shokët e plenumeve për sektorë të caktuar ose për vendime e probleme të caktuara janë të dobishme dhe ndihmojnë si për përgatitjen më të mirë të çështjeve që shtrohen në plenum, ashtu edhe për kontrollin e zbatimit të vendimeve dhe për vetë aktivizimin e anëtarëve të plenumeve. E dobishme është edhe praktika e shokëve të Elbasanit, të cilët si rregull kanë caktuar që çdo anëtar byroje të vejë gjatë muajit në dy orga-

nizata bazë partie për ndihmë e kontroll dhe çdo anëtar plenumi të paktën në një organizatë bazë partie. Mirë po i aktivizojnë anëtarët e plenumit në rrethin e Gjirokastrës dhe qytetin e Tiranës, duke i vënë në krye të ekipeve për probleme të caktuara, për organizata ose zona të caktuara. Këto dhe forma të tjera pune janë të rëndësishme, se konkretizojnë detyrën e vënë për aktivizimin e anëtarëve të plenumëve, i rrisin vetë ata dhe rolin e plenumit e të byrosë.

Sekretarët e komiteteve të Partisë duhet të mbajnë mirë në dijeni të problemeve dhe të vendimeve më të rëndësishme të Partisë anëtarët e plenumëve. Ata nuk duhet të takohen me ta vetëm në mbledhjet, por të këshillohen vazhdimisht gjatë punës me ta, të kërkojnë ndihmën e tyre, të sillen në mënyrë të barabartë me ta. Nga ana e tyre anëtarët e plenumit duhet të ndjejnë më shumë përgjegjësi për mbarëvajtjen e punëve në rreth. Në mënyrë të veçantë duhet të ndjehet roli i tyre në qendrën ku punojnë.

Që të sigurohet një drejtim efektiv nga ana e komiteteve të Partisë në rrethe, duhet hequr dorë nga drejtimi i përgjithshëm dhe të përqëndrohet vëmendja në çështjet kryesore. Në këtë drejtim vihet re një rendje pas shumë problemeve. Të gjithë merren me të gjitha nga një çikë dhe nuk çojnë asnjë deri në fund, vijnë vërdallë njerëzit me maqina, lëshojnë direktiva të përgjithshme dhe nuk ndalen për një kohë të caktuar në atë që është kryesore. Një praktikë të tillë në punë kanë patur shokët e Sarandës. Ndonëse të gjithë vinin vërdallë e lodheshin, aq sa nuk mund t'i kritikojë për përtesë, punët nuk u shkonin mirë, rezultatet ishin të këqia, sepse drejtonin me shumë rrëmujë e në mënyrë individuale, zëvendësonin njëri-tjetrin në vend që të drejtonin me kokë, të aktiviznin e të vinin para përgjegjësisë anëtarët e plenumit, kuadrot kryesorë e organizatat bazë të Partisë dhe njëkohësisht t'i mësonin si duhej të punonin.

Nëse sot ka mjaft komitete partie që punojnë me të meta për sa i përket zgjedhjes dhe kapjes së çështjeve kryesore, kjo vjen edhe për shkak të aftësive të kuadrove tanë, por vjen gjithashtu edhe pse disa shokë përgjegjës, të zënë shpesh me gjëra të vogla të ditës dhe që nuk u takojnë, i lënë pak kohë vetes që të mendojnë si duhet.

Rëndësi të posaçme ka këtu kapja pas çështjeve kryesore që caktojnë vendimet e Komitetit Qendror që të mund të sigurohet realizimi i tyre me sukses. Komitetet e Partisë të rretheve Peshkopi, Lezhë etj. duket se sivjet kanë filluar të punojnë më mirë lidhur me zbatimin e detyrave të plenumit të Komitetit Qendror për forcimin organizativo-ekonomik të kooperativave bujqësore dhe deri tani kanë të dhëna të mira për prodhimet bujqësore. Por nuk mund të thuhet kjo për të gjithë. Në këtë vit shumë të rëndë, përsa u përket kushteve atmosferike, duhej të

ishte bërë një punë e jashtëzakonshme për zbatimin e vendimit të Komitetit Qendror lidhur me ujtitjen...

Në këtë drejtim rrethet duhen ndihmuar më mirë edhe nga qendra. Tematika e problemeve të Byrosë Politike e të Sekretariatit ka ndihmuar si qeverinë, organet qendrore të organizatave të masave, ashtu edhe rrethet. Por rrethet kanë nevojë të ndihmohen edhe praktikisht për këtë çështje, të analizohet bashkë me ta çfarë është më preokupante në këtë ose në atë kohë dhe si duhet planifikuar e organizuar puna për realizimin e këtij ose të atij problemi, për një përdorim më të mirë të pushtetit dhe të organizatave të masave etj. Ngandonjëherë edhe kërkesat e shumta e diktimi i shumë problemeve nga aparatet qendrore i pengojnë rrethet të mobilizohen për atë që ata mendojnë se është më e rëndësishme. Prandaj duhet hequr dorë edhe në aparatet qendrore nga mania për t'i zgjidhur njëherësh të gjitha gjërat, sepse efektivisht kjo s'bëhet. Nga ana tjetër t'i lihet më tepër iniciativë bazës për kohën dhe mënyrën e punimit të çështjeve që i dërgohen nga lart. E rëndësishme është që rrethet ose sektorët të kontrollohen e të ndihmohen për të siguruar zbatimin e detyrave që u shtrohen. Pa se si i punojnë e ku i punojnë, me përjashtim të disa vendimeve të rëndësishme, kjo t'u lihet ta gjykojnë vetë rretheve. Kështu duhet të veprojnë edhe rrethet për bazën.

Ndihma sistematike dhe e organizuar për bazën duhet të konsiderohet si detyrë kryesore si për organet qendrore, ashtu edhe për ato të rretheve.

Të gjitha detyrat që shtron Partia para popullit dhe vendit tonë zgjidhen atje, në bazë. Pa mobilizimin dhe punën direkte të komunistëve dhe të masave nuk ka se si të zgjidhet asnjë detyrë. Problemet janë të shumta dhe të mëdha, por niveli i punonjësve në bazë është ende i ulët. E vërteta është se atyre kurrë nuk u ka munguar vullneti për punë, optimizmi dhe entuziazmi, besimi i patundur në detyrat që shtron Partia. Ata çdo fjalë dhe porosi të Partisë e vënë në jetë pa diskutim dhe punojnë e luftojnë me vetëmohim e heroizëm për t'i kryer me nder detyrat. Por ata kanë nevojë për ndihmën e afërt të Partisë, të organeve dhe të kuadrove të saj me eksperiencë, si edhe të organeve shtetërore në qendër e në rrethe. Është për këtë arsye që Komiteti Qendror e ka ngritur me forcë ndihmën për bazën.

Në këtë drejtim një ndihmë të mirë kanë patur rrethet nga Komiteti Qendror dhe qeveria nëpërmjet të studimit e të trajtimit të problemeve, me vendimet e ndryshme, analizat, thirrjet më të shpeshta në raport, seminarët e konsultat e ndryshme dhe sidomos nëpërmjet ndihmës në vend. Shpesh janë organizuar ekipe për rrethe e sektorë të rëndësishëm, për probleme të ndryshme, të cilat janë drejtuar nga kuadro kryesorë të Partisë e të shtetit dhe kanë dhënë një ndihmë të mirë. Vajtja shpesh e kua-

drove kryesorë në rrethe, në mbledhje të konferencave, të aktiveve, të plenumëve, të byrove e deri në organizatën bazë e në mbledhje me punonjës dhe posaçërisht patronazhi i shokëve të Komitetit Qendror dhe të qeverisë për rrethe të caktuara kanë qenë gjithashtu një ndihmë e madhe për bazën, i kanë mësuar shokët si të punojnë, u kanë hapur perspektivën, i kanë sqaruar për gjithshka kanë patur nevojë, kanë ngjallur entuziazëm në punonjësit dhe kuadrot dhe kanë ndihmuar për zgjidhjen në vend të shumë problemeve.

Nën shembullin e qendrës, edhe rrethet nga ana e tyre kanë organizuar më mirë ndihmën për bazën. Një praktikë të mirë në këtë drejtim kanë shokët e Gjirokastrës, të cilët, pasi venë për kontroll e ndihmë në organizata bazë të një krahine, analizën e punës e bëjnë në mbledhje të hapët të byrosë në qendrën e krahinës. Shokët e Elbasanit gjithashtu kanë praktikuar që çdo sekretar partie të drejtojë një ekip dhe të shkojë në 4 organizata bazë partie çdo muaj, ndërsa shokët e qytetit të Tiranës kanë organizuar ekipe për ndërmarrje të veçanta për probleme të caktuara me afat të gjatë.

Por me gjithë përmirësimet, ndihma për bazën mbetet një problem shumë i rëndësishëm edhe për të ardhshmen. Kjo jo vetëm sepse ende ka dobësi, se ndihma nuk jepet gjithnjë me një cilësi të lartë e në kohë, e ngandonjëherë bile shumë rrallë, sidomos për disa rrethe të vogla dhe zona malore, por edhe sepse kërkesat në të ardhshmen, qoftë ndaj rretheve e veçanërisht ndaj organizatave bazë, janë më të mëdha.

Eksperiencia ka treguar se ndihma me ekipe jep rezultate më të mira, prandaj kjo formë duhet përdorur në radhë të parë, pa hequr krejt dorë nga format e tjera të ndihmës e të kontrollit, të cilat janë të njohura për Partinë tonë. Veç duhet insistuar në këto gjëra:

E para, që ekipet, instruktorët ose kushdo që dërgohet për ndihmë të ndihmojnë me të vërtetë. Të hiqet dorë nga kalimi fluturimthi. Prandaj duhet qëndruar më shumë kohë nëpër organizatat dhe të shkohet për probleme të caktuara e jo për shumë probleme. Që të ketë efekt ndihma duhet të jetë e përqëndruar, por kjo ama nuk do të thotë që brenda një kohe të shkojnë në një ndërmarrje 5 ekipe, siç ndodhi në NTLUS-in e Tiranës.

Duam të tërheqim vemendjen e shokëve kryesorë kur shkojnë si të deleguar poshtë edhe për një gjë: të mos e kufizojnë punën e tyre me një rreth të ngushtë njerëzish, në zyrë me drejtorin apo kryetarin e kooperativës ose me sekretarin dhe byronë e organizatës bazë, por të merret domosdo kontakt me masat punonjëse. Çdo punonjës i aparatit qendror dhe çdo udhëheqës i Partisë ose i pushtetit në rreth duhet ta ndjejë detyrë që shpeshherë të organizojë biseda apo konferenca politike me masat.

E dyta, njerëzit që shkojnë për kontroll e ndihmë t'i venë si detyrë vetes që në metodën e punës së tyre të kenë kujdes të mos zëvendësojnë organet e bazës dhe të kërkojnë të realizojnë vetë ndonjë sukses të pjesshëm, por në radhë të parë ta aftësojnë bazën, t'i mësojnë njerëzit si të punojnë, t'i bëjnë ata të ndërgjegjshëm për detyrat që kanë. Ekipet ose të deleguarit do të ikin përsëri, ata që mbeten në bazë për të realizuar detyrat janë komunistët dhe kuadrot e tjerë pa parti, prandaj ose t'i bëjmë ata të zotët e punës, ose puna jonë nuk do të ketë sukses.

E treta, dhe kjo është kryesorja, duhet të ngrëmë edhe më shumë nivelin e punës së instruktorëve. Me gjithë përmirësimet, edhe në këtë drejtim niveli i punës së instruktorëve është ende i ulët dhe kujdesi i sekretarëve të komiteteve të Partisë për ta nuk është në lartësinë e duhur. Disa sekretarë partie mendojnë se kanë më shumë rezultate, duke ardhur vetë vërdallë se sa të merren me instruktorët. Shpeshherë nuk dëgjohen me vëmendje instruktorët kur kthehen nga baza, nuk bisedohet me ta shtruar për gjërat që u kanë dalë, dhe kështu, duke rrahur mendimet, t'u tregohet edhe se si duhet të punohet etj. Gjithashtu nuk tregohet kujdesi i duhur për t'i ndihmuar instruktorët kur përgatiten për të shkuar në bazë si edhe gjatë punës së tyre. S'duhet harruar se sidomos pas riorganizimit të aparateve të Partisë instruktori është bërë figura qendrore e aparatit. Nga puna e tij varet shumë edhe puna e organizatës bazë të Partisë. Instruktorët tani merren me të gjitha çështjet e punës së Partisë, për këtë arsye është e domosdoshme që të ndihmohen nga afër nga të gjithë sekretarët e komitetit të Partisë, që të mos jenë të njëanshëm në punën e tyre. Këtë porosi Komiteti Qendror i Partisë e dha që kur u bë riorganizimi i aparateve të komiteteve të Partisë, por kjo edhe sot mbetet një detyrë me shumë rëndësi. Sekretarët e komiteteve të Partisë duhet të punojnë vazhdimisht me instruktorët për t'u zgjeruar atyre horizontin, për të rritur aftësitë e tyre organizative, për t'i bërë njerëz politikë dhe jo thjesht njerëz që të shpien disa udhëzime e të bien disa konstatime nga baza. Prandaj kujdesi për të mësuar instruktorin që të bëjë mirë punën e tij është një nga detyrat më të rëndësishme të sekretarëve të komiteteve të Partisë. Qoftë nëpërmjet shkollave, e sidomos shkollës së Partisë, qoftë me anën e seminarëve për shkëmbim eksperiencë e sidomos në punë e sipër duhet t'u jepet atyre ndihmë e vazhdueshme. Instruktori mëson të tjerët, prandaj, që ta bëjë këtë punë, ai duhet të mësojë vazhdimisht për vete. Pra të merresh me instruktorët jo vetëm që s'është «kohë e humbur», por përkundrazi është një punë me shumë përgjegjësi. Një ndihmë të mirë për aftësimin e instruktorëve duhet të japë edhe aparatit i Komitetit Qendror, si nëpërmjet seminarëve që organizohen nga qendra, ashtu edhe kur punonjësit e aparatit të qendrës shkojnë

poshtë. Të bëhet rregull që çdo instruktor i Komitetit Qendror të Partisë, ose punonjës tjetër i aparatit të Komitetit Qendror të Partisë, kur shkon poshtë, të merret konkretisht me punën e instruktorëve dhe të sekretarëve të organizatave bazë, t'i mësojë ata si duhet të punojnë, të paktën për problemet e sektorit të tyre.

Disa rrethe, si Durrësi etj, kanë vepruar drejt duke aktivizuar në ndihmë të instruktorëve disa kadro të tjerë si instruktorë vullnetarë. Këta shokë japin një ndihmë të mirë për organizatat bazë, vetëm duhet kujdes që të ndihmohen për punën e tyre, të mos ngarkohen me më shumë se 2 organizata dhe të mos ngarkohen me detyra të tjera shoqërore.

Drejtimi më i mirë i ekonomisë nga ana e komiteteve të Partisë është një nga çështjet kryesore sot në përmirësimin e metodës së punës.

Detyrat që vuri Kongresi III i Partisë, si dhe vendimet e mëvonshme të Komitetit Qendror të PPSH për të forcuar kujdesin për treguesit cilësorë të prodhimit, për blegtorinë, pyjet, ndërtime, detyrat për forcimin ekonomiko-organizativ të kooperativave bujqësore etj. kanë bërë që komitetet e Partisë në rrethe jo vetëm të njohin më mirë ekonominë, por ta drejtojnë më konkretisht atë. Ka tani një kujdes më të madh për treguesit tekniko-ekonomikë të ndërmarrjeve, për cilësinë, koston etj., po punohet më me kujdes për edukimin e punonjësve, dhe për këto probleme është organizuar më mirë puna politike dhe emulacioni. Duhet thënë gjithashtu se po vihen re fillimet e një pune të mirë për t'u kapur pas gjërave të reja, iniciativave të përparuara, të cilat jo vetëm po studjohen më me kujdes, por po luftohet më mirë për vënjen e tyre në jetë. Mjaft komitete partie po përdorin gjithashtu më mirë organet e pushtetit për problemet ekonomike. Po kështu ka një punë më të kujdesshme për aktivizimin e specialistëve dhe të njerëzve të pararojës.

Por me gjithë këto në praktikën e punës së komiteteve të Partisë për drejtimin e ekonomisë ka të meta e dobësi, kundër të cilave duhen marrë masa serioze, që të mund t'u përgjigjemi detyrave shumë të rëndësishme që kemi përpara. Në këtë drejtim është e nevojshme të mbahen parasysh këto dy çështje kryesore:

Në radhë të parë, duhet tërhequr vëmendja e organeve të Partisë për një përdorim më të mirë të organeve të pushtetit dhe të organizatave të masave, të luftohet kundër një lloj paralelizmi dhe ortakllëku, si dhe kundër marrjes me gjëra të vogla dhe në rrugë shtetërore që vihet re në praktikën e punës së komiteteve të Partisë të disa rretheve për drejtimin e ekonomisë. Të tilla të meta vihen re që në planifikimin e problemeve nga komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive, në marrjen e vendimeve në frymë shtetërore, si edhe në ndjekjen e problemeve. . .

Në punën e përditshme kuadrot e Partisë futen shumë në çështje dhe detyra konkrete që duhen zgjidhur nga pushteti, siç janë problemet e furnizimit të ndërmarrjeve, të transportit, lëvizjet e traktorëve etj. Bile ka sekretarë partie që japin edhe urdhëra për këto, gjë që nuk është e drejtë.

Kur thuhet që Partia duhet të kryejë punën e saj dhe organet ekonomike punën e tyre, kjo nuk do të thotë aspak që organet e Partisë nuk duhet të merren me problemet ekonomike, përkundrazi, Partia duhet t'u futet thellë problemeve ekonomike, t'i njohë ato me hollësi që të mund t'u japë një ndihmë të efektshme organeve të pushtetit, të kontrollojë dhe t'u hapë perspektivën, të jetë në gjendje të mobilizojë organizatat e Partisë dhe masat për të gjitha problemet ekonomike. Këtu qëndron çështja se në ç'rugë duhet të ndjekë Partia këto probleme.

Për të mënjeluar paralelizmin që ekziston në shqyrtimin e problemeve duhet të bëhet koordinimi më i mirë i planeve që në fillim, ndërsa kur shqyrtojnë probleme ekonomike komitetet e Partisë duhet të përcaktojnë mirë detyrat për organet shtetërore dhe ato ekonomike, në mënyrë që më pas të jenë në gjendje të kontrollojnë zbatimin e këtyre detyrave. Po komiteti i Partisë, duke patur të qartë rolin e organizatës bazë të Partisë, rëndësinë dhe rolin që luan puna politike, emulacioni për mobilizimin me entuziazëm të punonjësve në punë, rëndësinë që ka edukimi i punonjësve me shembullin e më të mirëve, rolin e vendimtar që lozin kuadrot në realizimin e detyrave etj., duhet të caktojë për këto çështje posaçërisht detyra shumë konkrete, si për organizatat e Partisë, ashtu edhe për organizatat e masave. Në qoftë se për drejtimin e ekonomisë në rrugë shtetërore ekzistojnë të gjitha aparatet e pushtetit dhe të ekonomisë, për realizimin e detyrave të tjera të Partisë përgjigjet Partia, sepse s'ka kush përgjigjet tjetër. Komiteti i Partisë duhet të punojë për të ngritur rolin e organeve të pushtetit dhe kjo nuk arrihet duke i zëvendësuar ato, por duke u caktuar qartë detyrat kryesore, duke edukuar dhe duke forcuar përgjegjësinë të kuadrot që punojnë në këtë sektorë dhe duke forcuar kontrollin e Partisë mbi këto organe.

V. I. Lenini theksonte:

«duhen ndarë në një mënyrë shumë më të saktë funksionet e partisë (edhe të KQ të saj) dhe të Pushtetit Sovjetik; duhet të rritet përgjegjësia dhe pavarësia e funksionarëve të pushtetit dhe e institucioneve të pushtetit, kurse partisë t'i lihet drejtimi i përgjithshëm i punës së të gjitha organeve të pushtetit së bashku, pa ndërhyrjen e tanishme shumë të dendur, jo të rregullt, që shpeshherë ka të bëjë me çështje të vogla».⁴⁵

Që mjaft komitete partie merren shpeshherë në rrugë shtetërore edhe me çështje të vogla e korrente të ekonomisë, kjo vjen, mendojmë ne, edhe për disa arsye objektive. Nga njëra anë, sepse me kolektivizimin e bujqësisë, dhe veçanërisht me bashkimin e kooperativave, u krijuan në fshat ndërmarrje të mëdha, drejtimi administrativ, tekniko-operativ i të cilave duhet të bëhet nga komiteti ekzekutiv i rrethit. Por me ato forca që ka ai nuk është në gjendje ta përballojë si duhet këtë detyrë, kështu që detyrohet edhe komiteti i Partisë të futet në këto punë. Nga ana tjetër, nëpër rrethet po shtohen vazhdimisht ndërmarrjet e ndryshme ekonomike. Prirja e përgjithshme është që të gjitha këto të jenë ndërmarrje nacionale, kështu që pushteti lokal s'përgjigjet për to. Dikasteret nga ana e tyre, duke patur shumë ndërmarrje në vartësi, të mëdha e të vogla, nuk u përgjigjen si duhet e në kohë tërë kërkesave të tyre, kështu që ato detyrohen të përplasen te komitetet e Partisë. Kjo gjë u merr atyre shumë kohë të vlefshme. Çfarë duhet bërë? Ne mendojmë se është e nevojshme të studjohet ky problem në këto tre drejtime: e para, të zgjerohen kompetencat e pushtetit lokal, duke vënë në drejtimin e tyre më shumë ndërmarrje etj. E dyta, si rrjedhim të forcohen seksionet e bujqësisë dhe të ekonomisë lokale në komitetet ekzekutive të rretheve, duke i plotësuar ato me kuadro më të aftë me anën e një shpërndarjeje më të drejtë të kuadrit teknik midis qendrës dhe bazës. Raporti që ekziston sot ndërmjet kuadrove specialistë që kanë komitetet ekzekutive dhe aparatet e institucionet qendrore nuk është i drejtë. Kjo s'do të thotë se dikasteret i kanë tepër, pasi dihet që dhe këtu kemi mungesa, por nuk është e drejtë që deficitin të rëndojë në masë të tillë mbi komitetet ekzekutive, ku janë tërë masa dhe tërë sektorët e jetës: industria, bujqësia, tregëtia, arësimi etj. A nuk ka ardhur koha të mendohet më seriozisht për këtë çështje? Këtu lind nevoja të shikohet edhe forcimi i komiteteve ekzekutive të qyteteve. E treta, dikasteret qendrore të përmirësojnë punën e tyre dhe t'u përgjigjen me kohë e si duhet, në bazë të planeve, kërkesave të ndërmarrjeve të tyre e të pushtetit lokal, duke siguruar një ndihmë më efektive për to.

Së dyti, për të forcuar drejtimin e Partisë në ekonomi duhet t'i jepet rëndësi mobilizimit me entuziazëm të masave dhe edukimit të tyre me shembullin e më të mirëve. Tërë puna politike e propagandistike e Partisë dhe masat organizative duhet të shërbejnë për të mobilizuar me entuziazëm punonjësit për zbatimin e vendimeve të Partisë e të qeverisë. Për t'ja arritur kësaj ata duhet të binden për përfitimet që do të kenë nga zbatimi i këtij apo atij vendimi, si dhe për mundësitë reale që ekzistojnë për zbatimin e tyre. Eksperienca e ka vërtetuar plotësisht këtë gjë. Fshatarësia jonë punonjëse u mobilizua dhe përqafoi kolektivizimin,

u organizua në kooperativa bujqësore me vullnet të plotë, sepse u bind plotësisht për epërsinë e ekonomisë së kolektivizuar ndaj ekonomisë së vogël private. Fshatarët tanë po mbjellin dhe po tregojnë më tepër kujdes për kulturat industriale, pasi kanë kuptuar leverdinë për veten e tyre dhe për ekonominë kombëtare. Punëtorët tanë kanë bërë akte heroizmi për realizimin e detyrave të planit etj. Por kjo ndërgjegje e lartë nuk krijohet vetë, atë e krijon Partia me punën e saj. Prandaj tërë format e punës duhen përdorur në radhë të parë për t'u shpjeguar masave vendimet e Partisë dhe vijën e saj.

Në metodën e punës së komiteteve të Partisë për drejtimin e ekonomisë, një mjet shumë i fuqishëm, që rrit influencën e punës së organizatave të Partisë, është zbulimi, studimi dhe përhapja e eksperiencës së përparuar. Në këtë drejtim ka tani një punë më konkrete dhe mund të themi se ka një fillim të mirë nga shumë organizata dhe komitete partie, por ende nuk është futur kjo gjë në tërë metodën e punës së organizatave të Partisë dhe të shtetit. Veçanërisht organet shtetërore interesohen edhe më pak në këtë drejtim. E keqja më e madhe është se nuk shpiten deri në fund iniciativat e marra dhe nuk luftohet si duhet për të kapërcyer vështirësitë që lindin. Komiteti i Partisë i qytetit të Tiranës ka një eksperiencë të mirë në këtë drejtim. Ai ka studjuar në byro, nëpër ndërmarrje, eksperiencën e përparuar të punonjësve të ndryshëm, ka organizuar konsulta dhe seminare për përhapjen e tyre, ka vënë para përgjegjësisë organizatat e masave, sidomos Bashkimet Profesionale për këtë punë e u ka ngarkuar atyre detyra konkrete. Vetë punonjësit e pararojës janë aktivizuar për të përhapur eksperiencën e tyre. Punonjësit e aparatit të komitetit të Partisë tani po merren më konkretisht me këto gjëra. Kjo është një punë e mirë, është një punë partie.

Sa më shumë komitetet e Partisë dhe organizatat bazë do të thellohen në vendimet e Partisë, sa më mirë do të studjojnë kushtet konkrete të vendit të tyre, aq më shumë forma dhe metoda interesante do të gjejnë, aq më shumë rezultate të mira do të arrijnë. Janë të mira ato forma pune që kanë rezultat, prandaj në këtë drejtim nuk lejohet as shabllonizmi, as formalizmi. Duke zbatuar me përpikmëri vijën e Partisë dhe rregullat bazë organizative, çdo organizatë bazë, çdo komitet partie duhet të gjejë ato forma pune që janë më të përshtatshme dhe që japin rezultat. Në këtë drejtim duhet të ketë më shumë iniciativë.

Duke folur për kujdesin e posaçëm që duhet të tregojnë organizatat e Partisë për problemet ekonomike, në asnjë mënyrë nuk duhet kuptuar që të lihen pas dore problemet e tjera të arësimin, të kulturës, të shëndetësisë etj. Përkundrazi, Partia duhet të tregojë dhe për këto çështje kujdes të vazhdueshëm, me qëllim

që dhe në këta sektorë të realizohen drejt e plotësisht të gjitha detyrat që shtrohen.

Puna e mirë me kuadrin është kusht i domosdoshëm për një udhëheqje të drejtë të Partisë në tërë sektorët.

Siç dihet, midis Kongresit III dhe IV është bërë një plenum i veçantë i Komitetit Qendror të Partisë për punën me kuadrin, i cili pati një rëndësi shumë të madhe në përmirësimin e punës së Partisë në këtë drejtim. Njëkohësisht, duke konkretizuar detyrat e Kongresit III, ky plenum përcaktoi masat që duheshin marrë për përgatitjen e kuadrove lidhur me kërkesat e pesëvjeçarit të dytë dhe në perspektivë.

Mund të thuhet se, në përgjithësi, detyrat e këtij plenumi janë realizuar në mënyrë të kënaqshme. Tani politika e kuadrit është plotësisht në dorën e Partisë, organet dhe organizatat bazë jo vetëm kontrollojnë politikën e kuadrit, por kanë rritur përgjegjësinë e tyre për këtë problem kaq të rëndësishëm.

Kuadrot tanë i kanë kaluar me sukses provat e kohës dhe kanë arritur rezultate të ndjeshme në punë. Karakteristika dalluese e tyre është besnikëria e patundur ndaj Partisë dhe popullit, ndaj marksizëm-leninizmit... dhe urrejtja për armiqtë. Kuadrot tanë janë entuziastë në punë, gjë që buron nga besimi në vijën e Partisë, në të ardhmen e lumtur dhe marrin mbi kurrizin e tyre përgjegjësi të mëdha pa u trembur, sepse ata i udhëheq me siguri Partia.

Detyrat e reja, kërkesat gjithnjë në rritje na vënë përpara disa problemeve të rëndësishme edhe në këtë fushë të veprimtarisë së Partisë.

Së pari, duhet të rrisim edhe më shumë kujdesin e organeve dhe të organizatave të Partisë si dhe të organeve shtetërore për punën me kuadrin. Me gjithë përmirësimet që ka, jo gjithnjë dhe nga të gjithë mbahet parasysh se pa kuadro, pa kujdesin për t'i përgatitur dhe aftësuar ata për ditë nuk mund të realizohen detyrat. Është e domosdoshme të futet mirë në tërë metodën e punës së të gjitha organeve dhe të organizatave, të të gjitha instancave, që sa herë shqyrtojnë probleme, sa herë mendojnë e vendosin për një detyrë duhet të shikojnë çfarë njerëz po merren e do të merren me zbatimin e tyre, cila është përgatitja e tyre për këtë ose për atë detyrë të caktuar, sa janë këta të ndërgjegjshëm për këtë detyrë e çfarë duhet bërë me ta. Dhe ajo që ka rëndësi më shumë është puna e vazhdueshme e përditshme dhe e organizuar që duhet bërë me kuadrin.

Partia jonë ka një eksperiencë shumë të mirë në përgatitjen e kuadrit nëpërmjet aksioneve të ndryshme. Qindra e qindra kuadro, që punojnë e drejtojnë sot në sektorë të ndryshëm të ekonomisë e të kulturës, janë zhvilluar nëpërmjet punës që u bë në kurse etj., të ngritura në aksionet e mëdha. Gjatë 5-vjeçarit

të tretë ne kemi për të ndërtuar vepra madhështore që do të jenë mburrja e industrisë sonë. Prandaj komitetet e Partisë dhe dikasteret duhet të mendojnë qysh tani për kurset e ndryshme dhe format e tjera që duhet të organizohen në këto vepra për përgatitjen e kuadrove, jo vetëm për ata sektorë ku do të bëhen ndërtimet, por dhe për degë të tjera sipas nevojave që do të ketë shteti. Në mënyrë të veçantë duhet treguar kujdes nga organizatat e Partisë për të dërguar në këto aksione, që të ngrënë nivelin e tyre kultural e tekniko profesional, disa komunistë të fshatrave, ku s'ka mundësi të organizohen shkolla nate, ose disa komunistë nëpunës të administratës që, për shkak të aftësisë së tyre të kufizuar, mbajnë përgjegjësi të ulëta.

Së dyti, duke punuar për të çuar përpara kuadrin e vjetër, duhet të ngremë me guxim kuadro të rinj, veçanërisht nga njerëzit e prodhimit dhe nga gratë.

Edhe në këtë drejtim ka përmirësime. Por këtu do të ndalemi në disa probleme që nuk shkojnë ende mirë dhe që po nuk u kuptuan drejt e po nuk u punua me kujdes, do të bëhen pengesë për të ardhmen.

Në radhë të parë disa komitete partie dhe kuadro disa herë nuk nisen drejt në vlerësimin e punës së njerëzve.

Sipas V. I. Leninit, në zgjedhjen dhe vendosjen e kuadrit duhet ndjekur parimi i «besnikërisë dhe i aftësisë në punë». Pa një shqyrtim të mirë të të dy këtyre anëve nuk mund të bëhet një politikë e drejtë kuadri. Gabimi i disa shokëve qëndron pikërisht këtu, që disa herë shikohet vetëm ana e besnikërisë — dhe me këtë kuptohet qëndrimi gjatë luftës nacional-çlirimtare, kurse këto 16 vjet të luftës për ndërtimin e socializmit nuk merren shumë parasysh — dhe lihet pas dore ana e aftësive në punë. Kjo ka krijuar mendimin te disa kuadro se, cilat do qofshin rezultatet në punë, ata duhet patjetër ta mbajnë përgjegjësinë që kanë...

Partia ka treguar dhe do të tregojë kujdes të veçantë që kuadrot e vjetër të ecin përpara dhe shumica e tyre kanë kryer e i kryejnë me nder detyrat. Ky është interesi i Partisë dhe i çdo kuadri. Por njëkohësisht duhet punuar për të ngritur me kujdes e guxim kuadrot e rinj.

Në këtë drejtim para së gjithash duhet që të dalim nga rrethi i ngushtë i kuadrove që kemi në organikat. Numri i kuadrove është shumë më i gjerë, sepse kuadro nuk janë vetëm gjithë komunistët, por kuadro janë edhe specialistët e të gjitha kategorive në industri, në miniera, në bujqësi etj. Kuadro janë gjithë njerëzit e pararojës, gjithë këshilltarët, anëtarët e plenumëve, aktivistët shoqërorë etj. etj. Me këta mijëra vetë duhet punuar në mënyrë të organizuar dhe nga radhët e tyre të ngremë kuadrot që na duhen. Veçanërisht duhet t'i japim rëndësi ngritjes së kuadrove punëtorë dhe gra dhe kjo jo si një qëllim në vetëvete, por pse

njerëzit e prodhimit janë më të kalitur, janë më konkretë dhe ata sjellin në aparatet dhe në organet e Partisë e të shtetit eksperiencën e prodhimit dhe të gjitha cilësitë e mira të klasës punëtore. Në këtë drejtim Bashkimet Profesionale punojnë dobët. Si «shkolla edukimi, shkolla administrimi, shkolla të komunizmit»⁴⁶ ato duhet të pregatisin e të rrisin kuadro për të gjithë sektorët, kurse ato me të meta po pregatisin e po çojnë përpara dhe kuadro për veten e tyre.

Gratë duhen konsideruar si një burim i madh kuadrosh, që deri tani nuk është shfrytëzuar mirë. Vendimi i fundit i Sekretariatit të Komitetit Qendror duhet të na shërbejë për një punë më të mirë në këtë drejtim.

Më konkretisht duhet përqëndruar vëmendja në disa kategori kuadrosh siç janë:

a) Anëtarët e plumeve, të këshillave dhe aktivistë të tjerë shoqërorë, të cilët i kemi sjellë në forume si elementët më të dalluar. Kujdesi i Partisë për këta duhet të jetë në tri drejtime: për të rritur në ta ndjenjën e përgjegjësisë për detyrën përpara zgjedhësve të tyre, për t'i aftësuar ata, duke i aktivizuar e duke i edukuar në bazë të një programi të veçantë, dhe, së fundi, duke i inkurajuar në punë, të rrisim autoritetin e tyre.

b) Kuadrot që drejtojnë drejtpërdrejt prodhimin, siç janë përgjegjësit e repartëve, të skuadrave, brigadierët, mjeshtërit e prodhimit si dhe njerëzit e pararojës, me të cilët duhet të punohet për të rritur aftësitë e tyre profesionale e drejtuese, si edhe për t'i edukuar nga ana ideopolitike e kulturele. Kur flasim për të ngritur kuadro nga njerëzit e prodhimit, rezerva e parë, si të thuash, janë këta, pse këta kanë filluar të drejtojnë qoftë dhe njësitet e vogla.

c) Teknikët që punojnë në rrethe, veçanërisht në rrethe të vogla e në lokalitete, me të cilët bëhet një punë shumë e dobët për edukimin e tyre dhe vetë disa nga këta interesohen pak në këtë drejtim. Kjo është një e metë e madhe. Dihet se njohuritë e marra në shkollë nuk janë të mjaftueshme për të zgjidhur gjithë problemet që vë përpara jeta. Për këtë problem duhet të mendojnë seriozisht dikasteret, secili për kuadrot e vet, për literaturën që duhet të vënë në dispozicion si edhe për format e ndryshme të punës, për edukimin e tyre nëpërmjet seminareve, kurseve pa shkëputje nga puna, konsultave etj.

Një masë tjetër e dobishme, si për edukimin e specialistëve ashtu edhe të kuadrove të tjerë, është edhe qarkullimi që duhet bërë midis kuadrove që punojnë në aparatet qendrore dhe në bazë, gjë që do t'i shërbejë punës dhe kuadrove për të përfutur reciprokisht nga të mirat që ka puna në qendër e në bazë.

Nga radhët e specialistëve, që kanë një stazh relativisht të gjatë pune, janë ngritur tani, veçanërisht në dikastere e në ndër-

marrje, një numër i mirë kuadrosh në vende drejtuese dhe rezultatet e punës së tyre nuk janë të këqia. Tani edhe kërkesat e mundësitë janë që edhe në komitetet ekzekutive e në sektorë të tjerë të ngrihen më shumë nga këta shokë në vende me përgjegjësi, domosdo kur këtë e meritojnë, në bazë të besimit politik si dhe të rezultateve të punës së tyre, e jo në bazë të diplomës, pse siç dihet diploma nuk i jep të drejtën askujt për të patur këtë ose atë gradë, këtë ose atë vend me përgjegjësi.

Më në fund duhet punuar për të ngritur edhe më lart figurën morale të kuadrove tanë. Sa më i vetëdijshëm të jetë kuadri për detyrat që ka, aq më me entuziazëm punon, më shumë iniciativë ka, më shumë përgjegjësi merr dhe vetë do të gjejë rrugë për kapërcimin e vështirësive. Këtij qëllimi i shërben puna e Partisë për edukimin ideo-politik, për edukimin komunist të kuadrove.

Te Partia kanë gjetur forcën kuadrot tanë për të kryer të gjitha detyrat, si gjatë luftës edhe pas çlirimit. Partia i mësoi si të bëhen trima e të luftojnë, si të drejtojnë repartet dhe të fitojnë mbi oficerët me diplomë të armikut, si të drejtojnë ekonominë, arësimin, kulturën, tërë jetën e vendit, gjë që i habiti të ashtuquajturit kuadro «me eksperiencë» të regjimit të vjetër. Nën udhëheqjen e Partisë, me kujdesin e saj të vazhdueshëm, të edukuar nga ajo për ditë, kuadrot tanë jo vetëm po ndërtojnë me sukses socializmin, por kanë treguar gjithnjë pjekuri të plotë marksiste-leniniste në të gjitha situatat e për të gjitha çështjet.

Megjithkëtë në punën për edukimin komunist të kuadrove kemi ende boshllëqe, që shfaqen edhe në qëndrimin në punë e në shoqëri. Siç dihet, para disa kohësh Byroja Politike ka kritikuar disa shfaqje të huaja në ndërgjegjen e njerëzve, që janë dukur në qëndrimin ndaj punës dhe pronës së përbashkët, në disa qëndrime të padrejta lidhur me shpërblimet për të marrë nga shoqëria më tepër se ç'i jep, gjë që i ka çuar disa kuadro edhe në disa falsifikime e mashtrime. Gjithashtu Byroja Politike, duke analizuar çështjen e përdorimit të materialeve të importit, ka kritikuar rëndë qëndrimin pa përgjegjësi të disa kuadrove të dikastereve.

Në këto gabime kanë rënë jo vetëm njerëz të thjeshtë, por edhe disa kuadro, e për këta kanë përgjegjësi edhe ata që i kanë lejuar e veçanërisht kuadrot kryesorë të dikastereve, të cilët i kanë firmosur e vulosur këto veprime të padrejta.

Prandaj Partia jonë ka shtruar me forcë detyrën për forcimin e qëndrimit socialist në punë dhe ndaj pronës, si dhe në familje e shoqëri. E kjo arrihet nëpërmjet një lufte të ashpër, të përditshme, në punë e sipër, kundër çdo shfaqjeje që është në kundërshtim me normat e moralit komunist, duke forcuar kritikën dhe autokritikën, duke rritur gjithnjë efikasitetin e kësaj arme të fuqishme për kalitjen e njerëzve.

Partia jonë ka bërë e po bën gjithnjë një luftë të vendosur kundër bashkekzistencës në lëmin ideologjik. Këtë gjë duhet ta kenë parasysh kuadrot tanë e në radhë të parë komunistët që nga gjërat më të mëdha parimore në fushën e teorisë dhe deri në gjërat më të vogla. Dhe kjo do të thotë se nuk mund të jesh edhe komunist edhe dembel, edhe komunist edhe gënjeshtar ose mendjemadh ose edhe komunist dhe përvetësues ose hatërxi etj.

Edhe në të ardhshmen dunet ta shikojmë çështjen e edukimit ideologjik, edukimin komunist të kuadrove si kushtin kryesor për të rritur aftësitë e tyre në punë.

Kontrolli i zbatimit të vendimeve është, mund të themi, pika më e dobët në metodën e punës së komiteteve të Partisë. Pa dyshim, si rezultat i përmirësimit të gjithanshëm të metodës së punës dhe i aftësimit të kuadrove tanë, është përmirësuar edhe kontrolli i zbatimit të vendimeve. Po ndërsa te ne bëhet tani një punë më e kujdesshme, me një cilësi më të lartë për studimin e çështjeve, për marrjen e vendimeve, në punën për përmirësimin e kontrollit të zbatimit të tyre kemi ecur me ngadalë dhe nuk po kuptohet ende mirë se marrja e vendimit dhe organizimi i zbatimit të tij është një çështje e vetme. Sado i mirë dhe konkret që të jetë një vendim, në qoftë se nuk organizohet zbatimi i tij, ai mbetet një akt burokratik. S'duhet harruar as për një çast se kryesorja në tërë punën tonë është zbatimi i vendimeve. Kjo i ve vulën gjithshkaje. Dhe nga çdo komunist kërkohet që pikërisht këtu të verë të tëra forcat e tij. Pikërisht këtu, në luftën e vendosur të të gjithë komunistëve, pa përjashtim, për zbatimin e vendimeve, gjen shprehjen në praktikë uniteti i çeliktë i Partisë sonë. Kontrolli, vërtetimi i zbatimit të vendimeve janë mjete që duhet t'i përdorim në mënyrë të atillë që të sigurojmë sa më mirë kryerjen me kohë e pikë për pikë të të gjitha detyrave që shtrojnë vendimet. Të metat kryesore në punën për kontrollin e zbatimit të vendimeve mund t'i përmbledhim në këto dy çështje:

Së pari, nuk fillohet nga puna praktike për organizimin e kontrollit, pra dhe të ndihmës për zbatimin e vendimit, menjëherë pas daljes së tij, por me vonesë. Kjo bën që kontrolli të marrë më tepër karakterin e zbulimit të të metave. Këto ngjasin edhe këtu, në aparatën tonë qendror... Kontrolli ynë duhet të bëhet me kohë dhe të ndihmojë që të mos bihet në gabime, të zbatohen të gjitha detyrat. Ky është kontrolli efektiv. Veç këtu ka rëndësi edhe fakti që detyrat e vendimeve të jenë sa më konkrete e të përcaktuara, që të dish e të kesh ç'të kontrollosh.

Së dyti, cilësia e kontrollit nga organet më të larta, deri në bazë, nuk është në lartësinë e duhur dhe nuk shoqërohet me një ndihmë efektive. Kur kontrollorët bëjnë një varg konstatimesh, pa marrë masa në vend për zbatimin e vendimeve, pa i ndihmuar njerëzit për t'i mësuar se si duhet të punojnë, edhe ky kontroll

nuk është efektiv, nuk është i dobishëm. Prandaj duhet të përmirësojmë cilësinë e kontroleve, duke u marrë me këtë punë kuadrot kryesorë dhe më të kualifikuar, dhe t'i nisim këta pas një pregtitjeje shumë serioze për kontroll e ndihmë poshtë. Njëkohësisht duhen vënë mirë para përgjegjësisë kontrollorët. Cilësia e kontrollit rritet shumë në qoftë se do të dihet të lidhet drejt kontrolli nga lart me kontrollin nga poshtë, d.m.th. në qoftë se do të dihet të tërhiqen në këtë punë masat. Shumë veprime burokratike të administratave tona janë vënë në vend në bazë të mbikqyrjes, të propozimeve dhe të kritikave të punonjësve. Ne jemi Parti në fuqi, që drejtojmë shtetin e punëtorëve dhe të fshatarëve, prandaj sa më e madhe të jetë pjesëmarrja e njerëzve në punët tona, sa më shumë vërejtje e kritika të dobishme të ketë, aq më shpejt do të zhduken të metat, aq më shpejt do të shkojmë përpara.

— IV —

Të forcojmë më shumë punën e Partisë me organizatat e masave.

Lidhja e ngushtë dhe e organizuar e Partisë me masat, dëgjimi i vazhdueshëm e me kujdes i zërit të tyre, shpjegimi atyre kurdoherë drejt, me kujdes dhe me durim i vijës dhe i detyrave që shtron Partia, mobilizimi i tyre me ndërgjegje dhe entuziazëm për zbatimin e vijës dhe të detyrave të Partisë kanë qenë dhe mbeten një nga çështjet themelore në punën e përditshme të të gjitha organizatave të Partisë. Në këtë drejtim një ndihmë të madhe i japin Partisë si «leva», si «rripa transmissioni», siç i ka quajtur Lenini, organizatat e masave.

Periudha që nga Kongresi III e deri sot ka qenë periudha e forcimit të mëtejshëm të këtyre organizatave, e gjallërimit të tyre më të madh.

Nën udhëheqjen e Partisë, Bashkimet Profesionale të Shqipërisë kanë punuar më mirë për të zbatuar orientimin «të kthejmë fytyrën nga prodhimi» dhe janë bërë një nga levat më të rëndësishme për tërheqjen e masës së punëtorëve, të nëpunësve, të inxhinierëve dhe të teknikëve në luftën për rritjen e rendimentit të punës, për shtimin e prodhimit, për zhvillimin e mëtejshëm të iniciativës dhe të veprimtarisë krijuese të klasës punëtore. Ato kanë rritur kujdesin për edukimin politik, kultural dhe tekniko-profesional të punëtorëve, si dhe për përmirësimin e kushteve të punës e të jetës së punëtorëve, për zbatimin e legjisllacionit të punës.

Nën drejtimin e drejtpërdrejtë të Partisë Bashkimi i Rinisë së Punës të Shqipërisë, duke e konsideruar drejt edukimin komunist të rinisë si detyrën kryesore të tij, ka përmirësuar mjaft punën në këtë drejtim, ka dhënë kështu një kontribut të rëndësi-

shëm në përgatitjen e njeriut të ri të shoqërisë sonë socialiste, duke e bërë rininë tonë një forcë të madhe e të gatshme kudo dhe kurdoherë për të plotësuar detyrat që i ngarkon Partia.

Bashkimi i Grave të Shqipërisë, nën udhëheqjen e Partisë, realizoi me sukses detyrën e tij kryesore për tërheqjen e masës së grave të qytetit e të fshatit në prodhim. Organizata e Bashkimit të Grave të Shqipërisë është karakterizuar nga një njohje dhe studim i afërt i problemeve të veçanta të gruas, gjë që e ka ndihmuar atë të gjejë e të praktikojë forma e aktivitetit të përshtatshme, sipas nivelit politik-kultural të grave, vendit të punës e të banimit. Një kontribut të rëndësishëm për edukimin politik e patriotik të popullit dhe për mobilizimin e tij në aksionet ekonomike e veçanërisht ato politike ka dhënë organizata e Frontit Demokratik të Shqipërisë.

Më poshtë po ndalemi në disa probleme, për të cilat, me gjithë përmirësimet e bëra, kërkohet një punë më e mirë e më e kujdesshme.

Para së gjithash duhet të përmirësohet puna përse i përket ushqimit të rregullt të Partisë me mendimet, vërejtjet dhe propozimet e masës. Këtë problem s'e ngremë sot për herë të parë; dhe mjaft punë është bërë e po bëhet në këtë drejtim. Kështu, p.sh., duke dëgjuar diskutimet, vërejtjet dhe sugjerimet e masës lidhur me problemin që shtroi Komiteti Qëndror i Partisë: «Të harxhojmë me vend vlerat materiale», ekonomia kombëtare pati një përfitim vjetor prej një miliard e treqind milion lekësh. Sugjerime të mira kanë ardhur gjithashtu nga anketat e organizuara prej aktivistëve të këtyre organizatave për shërbimin e popullit në tregëti, për kujdesin që tregohet në institucionet shëndetësore të nënës e të fëmijës, për mbrojtjen në punë etj.

Por duhet thënë se shpeshherë konsiderohen si probleme për t'i sjellë në Parti vetëm ato që dalin nga mbledhje të organizuara për diskutimin e kësaj apo të asaj çështjeje, nga organizimi i kësaj apo i asaj ankete etj. Kjo s'është e drejtë. Partia ka nevojë të jetojë për ditë, çdo orë me problemet që preokupojnë masat, me hallet e tyre, të dijë mendimet e tyre, të mbajë kurdoherë në dorë pulsën e tyre. Prandaj nga njëra anë duhet organizuar më mirë puna për dëgjimin e zërit të masës nga aktiviteti dhe, nga ana tjetër, duhet siguruar e tillë lidhje e aktiviteti të këtyre organizatave me kuadrot drejtues të tyre, që këta rregullisht të mund të bien ato çka dëgjojnë e konstatojnë.

Për të jetuar më afër me problemet që preokupojnë masat, duhet t'i jepet rëndësi sidomos punës individuale me njerëzit, kontaktit të aktivitetit, të drejtuesve të organizatave të masave, të kuadrove kryesore të Partisë e të pushtetit me masat. Partia jonë ka në këtë drejtim një eksperiencë të pasur, të grumbulluar qysh nga koha e luftës.

Kontakti me masat duhet të shërbejë natyrisht jo vetëm për të dëgjuar mendimet e tyre, por në të njëjtën kohë edhe për të sqaruar e bindur ato për çështjet që ngrënë e për t'i mobilizuar për detyrat që shtrohen. Në këtë drejtim duhet të tregohet durim dhe pjekuri, që t'u jepet njerëzve përgjigje e qartë dhe e prerë.

Lidhur me këtë po ndalem në një çështje, kundër së cilës duhet luftuar me forcë. Vazhdon të ekzistojë, në mjaft njerëz, mendimi se për të zgjidhur një çështje ose një hall duhet të ndërhyjë dikush. Dhe e keqja është se kundër këtij mendimi nuk luftohet si duhet e sa duhet, po përkundrazi edhe ushqehet. Ushqehet në dy drejtime; nga njëra anë, pse bëhen herë-herë veprime në rrugë të padrejtë, ndërhyrje e hatërlleqe... dhe, nga ana tjetër, pse kur pyesin njerëzit për ndonjë hall ose kërkesë, nuk u jepet përgjigje e prerë e të dërgohen atje ku duhet, por i çojnë te ndonjë i «njohur».

Pa dyshim, këto gjëra ndodhin, sepse ende janë të rrënjosura thellë në ndërgjegjen e njerëzve mbeturinat e psikologjisë së pronës private, të interesit personal dhe sepse kundër tyre nuk luftohet me forcë në çdo rast, duke i bërë çështje të masave e duke u shpjeguar atyre se sa të dëmshme janë këto veprime dhe se si duhet t'i kuptojnë gjërat.

Prandaj duhet të punojmë që të shkulen nga rrënjët mendime të tilla, duke i luftuar me tërë forcën si shfaqje të huaja, krejt në kundërshtim me vijën dhe ideologjinë e Partisë ndërhyrjet dhe hatëret. Ndaj atyre, të cilëve Partia u ka besuar detyra për zgjidhjen e halleve të ndryshme dhe kërkesave të popullit dhe që i zgjidhin këto jo drejt, jo si mëson Partia, por me anësi e miqësi, të merren masa të rrepta. Nga ana tjetër të mbahet qëndrim i drejtë dhe i prerë nga ana e të gjithë shokëve, me çfarëdo përgjegjësie qofshin, ndaj atyre njerëzve që vijnë e kërkojnë të ndërhyhet për t'u zgjidhur kjo apo ajo kërkesë. Të dërgohen njerëzit t'i zgjidhin kërkesat në rrugën e rregullt, në atë zyrë apo sektor, ku duhet të zgjidhen, pa u dhënë absolutisht asnjë premtim për ndërhyrje.

Në këtë drejtim duhet patur parasysh gjithashtu se disa njerëz kërkojnë ndërhyrje nga lart, për t'i shpëtuar kontrollit të bazës; mirëpo njerëzit që dikur kanë punuar bashkë mund të flasin për njëri-tjetrin për periudhën e kaluar, por se si punojnë e veprojnë tani asgjë s'dinë. Prandaj edhe në këtë kuptim ndërhyrja është krejt e dëmshme. S'duhet harruar gjithashtu se në socializëm nuk mund të plotësohen të gjitha dëshirat e njerëzve si në komunizëm. Ka njerëz që duan edhe punë të lehtë edhe rrogë të mirë (!), ka të tjerë që duan vetëm punë në administratë, strehim, çerdhe, bursë për të gjithë fëmijët, bile mundësisht dhe jashtë shtetit etj. Pa dyshim, s'do të ishte keq që të gjitha këto kërkesa të plotësoheshin, por kjo s'varet vetëm nga dëshira. Ndërtimi

i socializmit bëhet në luftë me vështirësitë, e këtë duhet ta kuptojnë mirë e drejt të gjithë. Detyra e gjithë komunistëve dhe e organizatave të masave është që, duke përdorur të gjitha format e mundshme të punës, t'i sqarojnë njerëzit që t'i kuptojnë kërkesat e padrejta e të heqin dorë prej tyre, njëkohësisht të jenë kurdoherë të gatshëm edhe për sakrificë, kur ta kërkojnë nevoja.

Duke folur për kontaktet personale të aktivistëve dhe të kuadrove të organizatave të masave me njerëzit, si një nga format e rëndësishme për dëgjimin me kujdes të zërit të masave, kurrsesi nuk duhet të nënvlehtësohet rëndësia e dëgjimit të zërit kolektiv të tyre, sidomos dëgjimit të zërit si organizata. S'ka dyshim se një problem që ngrihet nga një organizatë e tërë, e Frontit qoftë apo e rinisë, e gruas apo Bashkimeve Profesionale, është shumë më me rëndësi, më serioz dhe natyrisht më i studjuar. Detyra jonë është që t'i mësojmë organizatat e masave, nga qendra deri në bazë, të ngrënë më tepër e vazhdimisht probleme që kanë të bëjnë me zgjidhjen e detyrave që shtrun Partia. Zëri i veçuar i njërit apo i tjetrit anëtar mund edhe të humbasë, por zëri i kolektivit, i organizatës nuk mund të lihet në harresë. Në këtë drejtim organizatat e masave, si të thuash, duhet të ndihmojnë Partinë për të luftuar me sukses kundër qëndrimeve burokratike të drejtuesve të ndryshëm të sektorëve të ekonomisë, të kulturës etj.

Në dëgjimin e zërit të masës, në sjelljen e tij në Parti, aq sa ka rëndësi puna për të mbajtur kontakt të vazhdueshëm e të rregullt me masat, aq rëndësi ka edhe kujdesi që duhet të tregojnë organizatat dhe organet e Partisë për të dëgjuar dhe, sipas rastit, për t'i zgjidhur këto çështje që sjellin shokët e organizatave të masave. Një kujdes i dyanshëm në këtë drejtim do të ndihmojë për ushqimin e rregullt e sistematik të Partisë me zërin e masave, kusht i domosdoshëm për të udhëhequr kurdoherë drejt.

Së dyti, Partia duhet të punojë për të përmirësuar punën e organizatave të masave përsa i përket sqarimit dhe mobilizimit të masave për zbatimin e detyrave të prodhimit.

Duke zbatuar direktivat e Kongresit III të Partisë, është bërë një punë e madhe për të gjallëruar dhe për të forcuar punën për sa i përket prodhimit si nga ana e Bashkimeve Profesionale, ashtu edhe nga organizatat e rinisë, të gruas edhe të Frontit Demokratik. Dhe në këtë drejtim janë arritur përmirësime të dukshme. Ato shfaqen në rritjen e mëtejshme të iniciativës dhe të veprimtarisë krijuese të klasës punëtore, të fshatarësisë punonjëse dhe të inteligjencies popullore, në luftën për plotësimin para afatit të pesëvjeçarit të dytë, në rritjen e vazhdueshme të interesimit të popullit për problemet e rëndësishme ekonomike, kulturore e shoqërore, që preokupojnë Partinë dhe shtetin tonë.

Por Bashkimet Profesionale, organizatat e rinisë, të gruas e të Frontit Demokratik duhet të mbajnë kurdoherë parasysh se

sa më përpara ecim në rrugën e ndërtimit të socializmit, aq më shumë rriten detyrat tona dhe, për pasojë, edhe kërkesat ndaj shtresave të gjera që rrethojnë Partinë, ndaj çdo punonjësi në veçanti. Prandaj duhen shfrytëzuar më me efikasitet të gjitha format e punës së organizatave të masave, që ndihmojnë për mobilizimin me ndërgjegje dhe entuziazëm të masave në zbatimin e detyrave që shtrun Partia në prodhim.

Një rëndësi të dorës së parë në këtë drejtim kanë marrë, sidomos pas vendimit të Plenumit të Komitetit Qendror për punën me Bashkimet Profesionale, mbledhjet e prodhimit. Vetëm në gjashtëmujorin e parë të vitit 1960 në ndërmarrjet ekonomike të vendit tonë janë zhvilluar mbi 4900 mbledhje prodhimi, në të cilat janë bërë më se 6.900 propozime dhe janë zbatuar 4.581. Eksperienca ka treguar se kur u kushtohet kujdes këtyre mbledhjeve, ato japin mjaft rezultate. Në fillim të këtij viti, p.sh., fabrika e kadifesë e Kombinatit të tekstitit «Stalin» e pakësoi prodhimin e cilësisë së parë deri në 42,5 për qind të sasisë së përgjithshme të kadifesë së prodhuar. Kur ky problem u shqyrtua në mbledhjen e prodhimit, që u thirr për këtë qëllim, punëtorët e teknikët bënë propozime të vlefshme dhe zbatimin e tyre dha rezultate. Si gjashtëmujor prodhimi i kadifesë së cilësisë së parë u rrit deri në 52 për qind të prodhimit të nxjerrë.

Por jo kudo Bashkimet Profesionale dhe drejtuesit e ndërmarrjeve i vlerësojnë, i pregatisin mirë këto mbledhje dhe marrin masa për zbatimin e menjëhershëm të vërejtjeve e të propozimeve të drejta që bëhen nga punëtorët në to.

Komiteti Qendror i Partisë ka theksuar që mbledhjet e prodhimit të çmohen si tribuna ku klasa punëtore kërkon llogari nga secili pjesëtar i kolektivit, qoftë ky drejtues ose punëtor i thjeshtë, komunist ose pa parti, për zbatimin e detyrave të planit. Aty të kritikohen të metat, të përcaktohet përgjegjësia personale dhe rrugët për kapërcimin e pengesave dhe të vështirësive, siç e kërkojnë interesat e klasës punëtore, të shtetit dhe të popullit. Detyra e organizatave të Partisë është që edhe në të ardhshmen të kërkojnë më shumë nga organizatat profesionale për gjallërimin e mbledhjeve të prodhimit, të luftojnë kundër nënvlehtësimit e formalizimit në punën e tyre.

Më shumë kujdes kërkohet gjithashtu për të gjallëruar edhe mbledhjet e Frontit, të gruas, të rinisë, duke shtruar aty për diskutim masat për plotësimin e vendimeve dhe të detyrave të Partisë e të pushtetit, çështjet kryesore të ndërmarrjes, të kooperativës, të lagjes, të fshatit ose të qytetit, me qëllim që, nga njëra anë, masat të shprehin mendimet dhe propozimet e tyre për zgjidhjen e këtyre çështjeve dhe, nga ana tjetër, të sigurohet një mobilizim më i plotë e i ndërgjegjshëm i tyre për realizimin e detyrave.

Emulacioni socialist është bërë një nga format më të rëndësishme për zhvillimin e iniciativës krijuese të masave, një mjet i fuqishëm për edukimin me qëndrim të ri ndaj punës, për kalitjen e njeriut të ri. Veçanërisht për nder të 15-vjetorit të çlirimit dhe tani për nder të Kongresit IV të Partisë, emulacioni socialist ka marrë një hov të madh, ka përfshirë shumicën dërmuese të punonjësve, duke rritur mobilizimin dhe entuziazmin e tyre në punë.

Në procesin e zhvillimit të garave socialiste kanë lindur dhe zhvillohen me sukses mjaft lëvizje dhe iniciativa të përparuara. Pë rritet dhe po zgjerohet lëvizja e brigadave të punës socialiste, e cila kombinon drejt punën me edukimin e punonjësve dhe e ka ngritur emulacionin socialist në një shkallë më të lartë. Sot numërohen 934 brigada me 8748 pjesëmarrës në sektorët shtetërorë dhe 434 skuadra me 4226 pjesëmarrës në kooperativat bujqësore, që luftojnë për të fituar titullin brigada e skuadra të punës socialiste.

Rreth 150 vetë kanë ndjekur shembullin e Vita Ikonomit, duke vënë në jetë një nga veçoritë e edukatës komuniste të njerëzve tanë, një nga parimet themelore të emulacionit socialist, që thotë «Shko vetë përpara dhe jepi dorën shokut që edhe ai të vijë pas teje».

Mjaft e rëndësishme është edhe lëvizja 1+2, në të cilën kanë marrë pjesë deri më sot rreth 8000 vetë. Dobia e madhe e kësaj lëvizjeje është se problemin e kualifikimit të punëtorëve e bën problem të vetë masave, shpejton ritmet e përgatitjes teknike, kursen fondet shtetërore, forcon ndërgjegjen e punonjësve.

Aksione të rëndësishme janë ndërmarrë nga organizatat e rinisë, të gruas, e të Frontit. Po zgjerohet kudo lëvizja për 300 ditë-punë në kooperativat bujqësore. Suksese janë shënuar gjithashtu për kalimin e të rinjve në sektorin e blegtorisë, në mbjelljen e pemëve frutore dhe të ullinjve, në organizimin e jetës së kulturuar në fshat etj.

Por organizatat e Partisë duhet të tregojnë shumë kujdes dhe të mos lejojnë formalizmin e punën me hope në zhvillimin e emulacionit socialist dhe të iniciativës së masave. Këto i sjellin dëm punës dhe i edukojnë keq punonjësit. Është bërë, si të thuash, një fenomen tashmë i përgjithshëm, që t'i kushtohet rëndësi fillimit të punës; nxiten njerëzit të marrin zotime, ndiqen këto iniciativa në fillim me vrull, bëhet shumë zhurmë për to, por pas një kohe vrulli bie, zotimet harrohen dhe për to nuk kërkon njeri llogari.

Me zotimet që merren duhet të sillemi më seriozisht. S'ka dyshim se para se të merret zotimi duhet menduar mirë, por pasi merret, ai duhet të realizohet me çdo kusht. Në këtë frymë organizatat e masave të edukojnë anëtarët e tyre dhe të krijohet një

gjendje e tillë që çdo njeri të kuptojë, të ndjejë se, për atë që është zotuar, opinioni publik do t'i kërkojë llogari.

Nga ana tjetër nuk mund të mos vëmë në dukje edhe një dobësi të rëndësishme. Zakonisht organizatat e Partisë, Bashkimet Profesionale, organizatat e tjera të masave e kufizojnë punën e tyre duke vënë në dukje dhe duke popullarizuar njerëzit e dalluar që kanë arritur rezultate rekord. Kjo sigurisht duhet bërë, por vetëm kaq nuk mjafton. Është me vend të përmendim këtu fjalën e urtë popullore që thotë se «me një lule s'vjen behari». Rekordet e njerëzve të përparuar janë shembulli më i mirë që tregojnë çka është e mundur të arrihet nga çdo punëtor. Por të tilla s'ka një as dhjetë, por kudo. Në çdo sektor pune, në çdo brigadë, ka njerëz që tejkalojnë norma, thyejnë rekorde; këtu duhet të drejtohet lufta: të arrihet më i miri i skuadrës, i repartit tonë, pse kur rekordet janë të pakta mbulohen nga masa ende jo e vogël e punonjësve të prapambetur.

... Të kënaqesh me rekordet më të larta dhe të mos orientosh punonjësit për arritjen e rekordeve të qendrës sate, do të thotë të ngopesh me lugë të zbrazët. Preokupacioni kryesor i organizatave të Partisë dhe i organizatave të masave duhet të jetë që realizimet e punonjësve të përparuar të çdo sektori e brigade të bëhen pronë e të gjithë punonjësve. Nga kjo do të ketë dobi ekonomia popullore dhe çështja e ndërtimit të socializmit do të ecë me ritme më të shpejta përpara. Por kjo kërkon që puna boshe e plot zhurmë që bëhet shpeshherë me punonjësit e përparuar të zëvendësohet nga një punë e organizuar mirë e me kujdes për t'i mësuar e për t'i bindur edhe punonjësit e tjerë që të ngrihen në nivelin e të përparuarve, që i kanë në qendrën e tyre. Një punë e tillë nuk është e lehtë. Vetëm masat organizative nuk janë të mjaftueshme. Kërkohet një punë e madhe edukative, këmbëngulëse për të shkëputur njerëzit nga e vjetra, për të luftuar kryelartësinë boshe dhe sedrën mikroborgjeze, për të edukuar çdo punonjës me ndjenjën e thjeshtësisë dhe të gatishmërisë për të mësuar nga shoku.

Më në fund Partia jonë ka kërkuar kurdoherë që të kuptohet mirë se nuk mund të sigurohet një rritje e vazhdueshme e veprimtarisë dhe e iniciativës krijuese të masave përsa i përket prodhimit, në qoftë se nuk tregohet kujdesi i nevojshëm për ngritjen e nivelit kulturalo-teknik të masave. Në këtë drejtim është punuar dhe po punohet vazhdimisht. Kështu, në vitin shkollor 1959-1960 u regjistruan në shkollën e natës 19.565 vetë, i ndoqën ato 14.466 dhe në shkollat me korrespondencë u regjistruan 4.657 vetë. Në kurset e kualifikimit e të perfeksionimit kaluan 31.074 punonjës. Por megjithatë në këtë punë ka të meta të rëndësishme. Organizatat e masave bëjnë lëshime dhe me ngadalësi po e kryejnë detyrën e tyre. Ka mjaft raste që njerëzit regjistrohen në shko-

lla e kurse, por nuk venë rregullisht ose nuk venë fare; në të regjistrohen pak gra, kurse organizatat profesionale, të rinisë e të gruas ende pak i bëjnë këto çështje të të gjithë organizatës, të të gjithë punonjësve.

Komitetet e Partisë duhet të merren më seriozisht me problemet e edukimit kultural dhe tekniko-profesional të masave, të aktivizojnë më mirë në këtë drejtim organizatat e masave. Të punohet në mënyrë të atillë që çdo punonjës të ndjejë dashuri për dije, për të përvetësuar teknikën, duke kërkuar në të njejtën kohë që çdo anëtar i organizatave të masave të ndjejë dhe përgjegjësi për të mësuar, për t'u përsosur, për t'u bërë i aftë për detyrën e ngarkuar.

Së treti, duhet të përmirësojmë punën për forcimin organizativ të organizatave të masave, për gjallërimin e tyre si organizata.

Kongresi III i Partisë e ngriti me forcë çështjen e forcimit të punës organizative dhe edukative të organizatave të masave, luftimin e formalizmit, të sektarizmit dhe të burokratizmit në këtë drejtim, që ndrydhin energjitë krijuese dhe iniciativat e gjera të masave. Duke punuar për zbatimin e këtyre detyrave, organizatat e masave kanë shënuar përparime të dukshme edhe përse i përket forcimit të tyre organizativ, gjallërimit të jetës së organizatave, rritjes së autoritetit dhe të iniciativës së tyre, janë kapërcyer në një masë të mirë formalizmi dhe burokratizmi. Janë bërë përpjekje me sukses, sidomos nga organizata e rinisë dhe e gruas, për të gjetur forma të reja pune, që kanë gjallëruar organizatat, kanë rritur veprimtarinë e anëtarëve.

Por duhet të themi se ende nga shumë organizata partie dhe nga vetë organet drejtuese të organizatave të masave nuk u kushtohet kujdesi i duhur çështjeve organizative, jetës së tyre. Duke u marrë kryesisht me disa aksione konkrete, harrohet se realizimi i tyre me sukses kërkon një punë më të mirë si organizatë, aktivizimin e mirë të të gjithë anëtarëve, rritjen e rolit dhe të përgjegjësisë së tyre si anëtarë të organizatës. Dhe, nga ana tjetër, harrohet se aksionet nga ana e tyre duhet të shërbejnë si një shkollë e mirë, ku të rriten forcat e organizatës, të rriten aktivitetet e saj.

Në radhë të parë, duhet të na preokupojë çështja e tërheqjes së masës së anëtarëve të organizatave në diskutimin e problemeve që shtrohen në mbledhjet e tyre, çështja e forcimit dhe e rritjes së ndjenjës së përgjegjësisë së çdo anëtarë për mbarëvajtjen e punëve të përgjithshme, për zgjidhjen e drejtë e të shpejtë të të gjitha problemeve. Kjo mund të themi se përbën një nga problemet kryesore në çështjet organizative.

Prëndësi të dorës së parë ka këtu organizimi i mirë i mbledhjes së organizatës e sidomos zgjedhja me kujdes e çështjes që do

të shtrohet në mbledhje. Ne duhet të themi që në shumë raste as mbledhjet vetë të organizatave të masave s'bëhen në rregull e brenda afateve të caktuara, por ajo që është më e zakonshme është fakti që shpeshherë mbledhjet zhvillohen për gjëra jo fort interesante, herë-herë për çështje të ngjashme me ato që janë diskutuar nëpër mbledhje të tjera, gjë që i bën mbledhjet pa jetë, të zbeta e të mërzitshme...

Zgjedhja me kujdes e çështjes që do të diskutohet në mbledhje, çështje kjo që me gjithë mend u intereson të gjithëve, dhe përgatitja e mirë e vetë mbledhjes janë kushtet kryesore për të siguruar një jetë të gjallë në organizatë, një pjesëmarrje aktive të anëtarëve në diskutimin e problemeve dhe rritjen e përgjegjësisë së të gjithë anëtarëve për zgjidhjen e tyre.

Çështja kryesore në punën organizative të organizatave të masave është krijimi i një aktivi të gjerë, të gjallë njerëzish të ndërgjegjshëm që s'ja përtojnë punës shoqërore. Për këtë çështje Komiteti Qendror i Partisë shpeshherë ka tërhequr vëmendjen e organizatave të masave. Dhe duhet thënë se në këtë drejtim çdo organizatë masash në çdo rreth ka të tillë aktivistë, që me tërë mend meritojnë të quhen fond i artë i organizatës. Si Bashkimet Profesionale, rinia, gruaja ashtu edhe Fronti kanë disa shokë, shumë nga të cilët edhe pa parti, që bëhen copë për realizimin e detyrave që u ngarkohen...

Por ne themi se numri i aktivistëve të vërtetë në çdo organizatë është shumë i kufizuar. Formalisht të ngarkuar me detyra në çdo organizatë ne kemi plot anëtarë. Kështu, p.sh., në tërë organet dhe komisionet e Bashkimeve Profesionale kemi 35.600 vetë (rreth 26 për qind e tërë efektivit), por aktivistë të vërtetë nga ta kemi ende pak. E njëjta gjë mund të thuhet dhe për organizatat e tjera.

Këtë duhet të nxjerrim detyrën për të punuar më mirë me aktivin, për ta edukuar më mirë atë, për të rritur tek ai ndjenjën e krenarisë për faktin që kryen një detyrë shoqërore. Duhet të punojmë që të krijohet opinioni se të kryesh një detyrë shoqërore, sado e vogël qoftë ajo, është një çështje nderi. Kjo ka rëndësi për rritjen e përgjegjësisë së çdo njërit anëtar të shoqërisë për punën e përbashkët të gjithë shoqërisë. S'duhet harruar se aktivisti i mirë i çdo organizate është një patriot i flaktë i vendit të tij, një luftëtar i paepur për çështjen e Partisë.

* * *

Si në çdo sektor tjetër të jetës edhe në punën e organizatave të masave garanci për sukseset është udhëheqja e drejtë dhe e urtë e Partisë. Të gjitha organizatat e masave e kanë njohur me statutet e tyre domosdoshmërinë e udhëheqjes së tyre nga ana e

Partisë së Punës të Shqipërisë. Dhe kjo është e kuptueshme, përdërisa të gjitha këto organizata punojnë për një qëllim të caktuar, për ndërtimin e socializmit në Shqipëri, kanë nevojë për një dorë që ta përqëndrojë tërë veprimtarinë e tyre dhe ta drejtojë atë drejt këtij qëllimi të caktuar. Partia është e vetmja forcë që e bën dhe që mund ta bëjë këtë gjë, nga njëra anë, sepse është e pajisur me marksizëm-leninizmin, që i jep në dorë busullën për t'u orientuar në çdo situatë, dhe, nga ana tjetër, sepse në gjirin e saj bëjnë pjesë njerëzit më të mirë e më të dalluar të çdo njërës organizatë, të cilët vullnetarisht edhe zgjidhen nga masat në udhëheqje të tyre. Kjo çështje e rëndësishme parimore te ne është zgjidhur drejt dhe një herë e mirë qysh në kohën e luftës, dhe kjo është arsyeja kryesore që organizatat e masave në vendin tonë kanë ecur kurdoherë drejt, pa zikzake dhe gjithnjë u kanë shërbyer interesave të atdheut, të popullit, të socializmit.

Dhe në punën konkrete të drejtimit të organizatave të masave, organizatat e Partisë kanë shkuar vazhdimisht duke e përmirësuar veprimtarinë e tyre. Që nga Komiteti Qendror i Partisë dhe deri në organizatat bazë është treguar kujdes i vazhdueshëm për ngarkimin e organizatave të masave me detyra, për inkurajimin e iniciativave të tyre dhe për t'i mbështetur ato në tërë punën e tyre. Për tërë organizatat tona të Partisë tashmë është më se e qartë se vetëm me forcat e tyre, pa u mbështetur si duhet në organizatat e masave, jo detyra të tilla madhështore siç ishte kolektivizimi i bujqësisë etj, por as detyra shumë të vogla nuk mund të realizoheshin. Dhe në rast se këto detyra u realizuan me sukses, kjo ndodhi pikërisht sepse Partia përdori si duhet organizatat e masave. Mund të përmendim për mirë këtu komitetin e Partisë të qytetit të Tiranës për përdorimin e Bashkimeve Profesionale, Fierin për rininë, Shkodrën për Frontin në qytet, Peshkopinë për gruan etj.

Por e keqja është se jo kudo në praktikë udhëhiqen mirë nga organet dhe organizatat e Partisë të gjitha organizatat e masave. Ku duhet përqëndruar kryesisht vëmendja?

Së pari, në aktivizimin e vazhdueshëm e me detyra konkrete në çdo kohë të çdo njërës organizatë masash. Çdo herë që organizata bazë apo komiteti i Partisë shqyrton çështje të caktuara, duhet të llogarisë mirë çdo organizatë masash: çfarë do t'i ngarkojë çdonjërës dhe ç'do të kërkojë prej secilës. Kjo gjë edhe organizatat e masave i gjallëron, edhe për detyrat krijon baza të shëndosha që të realizohen, natyrisht në qoftë se i bën llogaritë drejt dhe i ngarkon çdonjërës organizatë atë peshë që mund të mbajnë shpatullat e saj. Pra ngarkimi kurdoherë me detyra konkrete, me aksione, sipas forcave të tyre, i çdo organizatë masash dhe pastaj ndjekja e zbatimit të tyre, ndihma praktike për organizimin e zba-

timit përbëjnë kushtin e parë vendimtar për drejtimin e mirë të organizatave të masave nga Partia.

Së dyti, duhet ngritur niveli i kuadrove që punojnë në organizatat e masave. Partia ka patur gjithnjë parasysh që në organizatat e masave të caktohen kuadro që të çojnë drejt vijën e Partisë në masa, të gëzojnë besimin e simpatinë e tyre. Dhe në përgjithësi këto kuadro po i kryejnë mirë detyrat e ngarkuara nga Partia. Por detyrat e mëdha që shtrun Partia para popullit, detyrat e forcimit të mëtejshëm të organizatave të masave kërkojnë ngritjen e nivelit kultural e ideologjik të kuadrove të këtyre organizatave. . . Komiteti Qendror i Partisë ka përcaktuar nivelin arësivor që duhet të kenë kuadrot e organizatave të masave deri në fund të vitit 1965, prandaj Drejtoria e organeve të Partisë, të rinisë e të Bashkimeve Profesionale, komitetet e Partisë në rrethe dhe vetë organet e organizatave të masave duhet të marrin të gjitha masat e t'i ndihmojnë këto kuadro që të ngrënë shpejt nivelin e tyre kultural dhe ideologjik, ndryshe jeta do t'i lërë prapa.

Dhe në fund një problem tjetër i rëndësishëm në punën e Partisë me organizatat e masave është puna e mirë që duhet të bëjnë dhe shembulli që duhet të japin komunistët që janë zgjedhur në këto organizata. Me të kaluarën ka shumë përmirësime në këtë drejtim, komunistët në përgjithësi dallohen në krye të masave. Shumë komunistë kryetarë të komiteve profesionale, sekretarë rinie, përgjegjëse të grave dhe kryetarë të Frontit dallohen për punë të mirë dhe për vite me radhë zgjidhen në krye të këtyre organizatave. Partia duhet të bëjë që shembulli i tyre të përhapet në të gjithë komunistët e tjerë, sepse vërehet se jo të gjithë komunistët i kuptojnë drejt detyrat shoqërore. . . Ne duhet t'u a bëjmë të qartë gjithë komunistëve, se ai që s'punon vullnetarisht një kohë për shoqërinë, ai s'mund të jetë kurrë komunist i mirë. Rastet e heqjes dorë nga puna shoqërore duhen dënuar rëndë nga Partia e të konsiderohen si shfaqje shumë të dëmshme. Gjithashtu ka raste që komunistët e zgjedhur në organizatat e masave s'punojnë mirë, lënë pas dore detyrën, prandaj dhe masa nuk i do e nuk i zgjedh përsëri. Dhe ndodh shpeshherë që organizatat bazë të Partisë, apo komitetet e Partisë, as nuk e analizojnë fare çështjen përse këta komunistë nuk u zgjedhën përsëri, në ç'drejtim u bëhen kritikata dhe të mbahet qëndrim ndaj tyre e të nxirren mësim për punën në përgjithësi. Organizatat e Partisë duhet të shqyrtojnë herë pas here punën e komunistëve që drejtojnë organizatat e masave, të dëgjojnë mendimet e tyre, t'i udhëzojnë e t'i ndihmojnë që ta kryejnë mirë e me nder detyrën e ngarkuar. Të punosh me masat, aq më tepër të drejtosh një organizatë masash, është një punë me shumë përgjegjësi dhe njëkohësisht një nder i madh. Partia duhet t'i mësojë anëtarët e saj që ta meritojnë plotësisht besimin e masave.

Këto janë çështjet kryesore të punës organizative të Partisë, ku e pa të arësyeshme të ndalej Byroja Politike.

Së shpejti Partia jonë do të festojë përvjetorin e saj të 19-të. Të shkëlqyera dhe heroike kanë qenë të tërë këta vjet të jetës së Partisë. Plot dallgë e furtuna kanë kaluar mbi vendin tonë në këta vjet, por Partia jonë, edhe në çastet më të vështira, e ka mbajtur kurdoherë lart e të papërlyer flamurin ngadhënjimtar të marksizëm-leninizmit. Lufta me armiqtë e çdo kallëpi e ka kalitur Partinë tonë edhe çdo anëtar të saj. Është karakteristikë dalluese e gjithë Partisë sonë se sa herë është çështja për të mbrojtur marksizëm-leninizmin, ajo di të kapë pa zor çdo tingëllim fals, sado i kamfluar që të jetë ai. Dhe ashtu siç mëson leninizmi, ajo kurdoherë është treguar e rreptë dhe e pamëshirshme ndaj çdo shfaqjeje të huaj antimarksiste. Në luftë të papajtueshme me armiqtë është farkëtuar uniteti i pathyeshëm i Partisë sonë, uniteti i shëndoshë i ndërtuar mbi bindjet e forta marksiste-leniniste. Të ruajmë, shokë, si gjënë më të shtrenjtë këtë unitet.

Ne jemi në prakun e Kongresit IV të Partisë. Ky kongres do të mblidhet në një kohë kur kampi socialist... ka arritur suksese të shkëlqyera, por edhe në një kohë kur imperialistët luftënxi-tës, me imperializmin amerikan në krye, po bëjnë çmos për të mbajtur të ngritur tensionin në marrëdhënjet ndërkombëtare, për të mbajtur të gjallë psikozën e luftës, në një kohë kur në lëvizjen komuniste ndërkombëtare janë vënë re disa shfaqje jo të shëndosha, të cilat i kanë dhënë armë armikut për të luftuar e për të goditur vendet tona, unitetin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare, unitetin e kampit socialist. Në mënyrë të veçantë në këtë drejtim është aktivizuar revizionizmi modern, flamurin e reckosur të të cilit e mban revizionizmi jugosllav. Partia jonë, si gjithnjë, nuk mund të harrojë gjithashtu se vendi ynë është rrethuar nga armiq të tërbuar, të cilët me të gjitha mjetet dhe mënyrat janë përpjekur e do të përpiqen të na pengojnë në punën tonë për ndërtimin e socializmit.

Duke patur parasysh këto kushte politike, si dhe detyrat madhështore që do të na shtrojnë përpara Kongresi IV i Partisë, kërkohet nga të gjithë, nga çdo komunist dhe nga çdo kuadër, nga çdo organizatë dhe nga çdo forum partie të vënë të gjitha fuqitë e tyre për ta forcuar gjithnjë e më tepër Partinë tonë të lavdishme — organizatoren e të gjitha fitoreve të popullit tonë, për të ngritur gjithnjë e më lart rolin e saj udhëheqës në tërë jetën e vendit.

Botohet sipas origjinalit që ndodhet në Arkivin Qendror të Partisë.

VENDIM**I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË «MBI DISA ÇËSHTJE TË PUNËS ORGANIZATIVE TË PARTISË»**

8 shtator 1960

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH, i mbledhur nën kryesinë e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të PPSH, shokut Enver Hoxha, prej datës 5-8 shtator 1960, pasi dëgjoi raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror «Mbi disa çështje të punës organizative të Partisë», mbajtur nga shoku Rita Marko, anëtar i Byrosë Politike dhe sekretar i Komitetit Qendror të PPSH,

Vendosi:

1. — Të aprovojë raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH «Mbi disa çështje të punës organizative të Partisë».

2. — Të ngarkojë aparatën e Komitetit Qendror të PPSH, organet qendrore të organizatave të masave dhe komitetet e Partisë të rretheve dhe të qyteteve që të nxjerrin detyra konkrete e të udhëhiqen në veprimtarinë e tyre organizative nga raporti i Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH..

SEKRETARI I PARË I KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

ENVER HOXHA

Botohet sipas origjinalit që ndodhet në Arkivin Qendror të Partisë

VENDIM

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË «MBI RIORGANIZIMIN E SHKOLLËS DHE ZHVILLIMIN E MËTEJSHËM TË SISTEMIT ARËSIMOR»

8 tetor 1960

PLENUMI XIX I KQ TË PPSH

Tiranë, 7-8 tetor 1960

KOMUNIKATË**■ PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË**

Më 7 dhe 8 tetor 1960 u mbledh Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH, nën kryesinë e Sekretarit të Parë, shokut Enver Hoxha.

1. — Plenumi i Komitetit Qendror shqyrtoi dhe aprovoi projekt-direktivat e Kongresit IV të PPSH «Mbi planin e tretë pesëvjeçar të zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës së Republikës Popullore të Shqipërisë për vitet 1961-1965» dhe vendosi t'ja paraqesë punonjësve, në të gjithë vendin, për diskutim.

2. — Plenumi dëgjoji raportin e Byrosë Politike të KQ «Mbi riorganizimin e shkollës dhe zhvillimin e mëtejshëm të sistemit arësimit», mbajtur nga anëtari i Byrosë Politike dhe ministër i arësimit e i kulturës, shoku Manush Myftiu.

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH, pasi diskutoi rreth raportit, e aprovoi atë njëzëri dhe, duke patur parasysh edhe konkluzionet e diskutimit popullor, vendosi riorganizimin e shkollës dhe të sistemit arësimit në bazën e parimeve të shprehura në tezat e Komitetit Qendror të PPSH dhe të Këshillit të Ministrave të RPSH.

3. — Plenumi i Komitetit Qendror vendosi gjithashtu të shtyjë mbledhjen e Kongresit IV të PPSH nga muaji nëntor në muajin dhjetor 1960.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Plenumi i Komitetit Qendror, i mbledhur më 7 dhe 8 tetor 1960, nën kryesinë e Sekretarit të Parë, shokut Enver Hoxha, dëgjoji raportin e Byrosë Politike të KQ «Mbi riorganizimin e shkollës dhe zhvillimin e mëtejshëm të sistemit arësimit», mbajtur nga anëtari i Byrosë Politike dhe ministër i arësimit dhe i kulturës, shoku Manush Myftiu.

Plenumi i KQ, pasi diskutoi rreth raportit, e aprovoi atë njëzëri dhe, duke patur parasysh edhe konkluzionet e diskutimit popullor mbi tezat e KQ të PPSH dhe të Këshillit të Ministrave të RPSH,

VENDOSI:

1. — Të merren të gjitha masat e nevojshme për riorganizimin e shkollës në vendin tonë në frymën e tezave të Komitetit Qendror të PPSH dhe të Këshillit të Ministrave të RPSH «Për lidhjen e ngushtë të shkollës me jetën dhe zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të arësimit popullor», në bazën e të cilave është lidhja e shkollës me jetën, e mësimin me punën e prodhimit.

2. — Shkolla e arësimit të përgjithshëm të jetë shkolla e mesme e plotë e arësimit të përgjithshëm, politeknike, e punës, me mësimin e prodhimit. Plenumi aprovoi që etapa e saj e parë të jetë tetëvjeçare, në vend të shtatëvjeçares së sotme. Përsa i përket afatit të etapës së dytë, në se duhet të jetë 3 apo 4-vjeçare, plenumi vendosi të përcaktohet më vonë, pasi të jenë diskutuar më gjerë e më konkretisht nga organet e arësimit e masa e arësimitarëve projektplanin mësimor dhe projektprogramet e lëndëve të veçanta dhe pasi të jenë studjuar edhe rezultatet e shkollave eksperimentale.

3. — Riorganizimi i shkollës së arësimit të përgjithshëm të bëhet pjesërisht në vitin shkollor 1963-1964 dhe pjesa tjetër 1964-1965, duke filluar njëkohësisht nga klasa e parë deri në të pestën dhe pastaj duke e zbatuar nga viti në vit.

4. — Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH ngarkoi Këshillin e Ministrave të RPSH që të pregatitë projektligjin «Mbi rior-

ganizimin e sistemit arësimor» dhe t'ja paraqesë në kohën e duhur Kuvendit Popullor për shqyrtim e aprovim.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Botohet sipas gazetës
«Zëri i Popullit», Nr. 242,
datë 9 tetor 1960

Nr. 129

PLENUMI XX I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 1 nëntor 1960

KOMUNIKATË

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Më datën 1 nëntor 1960 u mbajt mbledhja e Plenumit të Komitetit Qendror të PPSH, nën kryesinë e shokut Enver Hoxha.

Plenumi dëgjoi dhe diskutoi raportin e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të PPSH, shokut Enver Hoxha, mbi situatën politike ndërkombëtare dhe mbi përgatitjet për kongresin IV të PPSH dhe e aprovoi atë njëzëri. Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH caktoi gjithashtu delegacionin e Partisë së Punës të Shqipërisë që do të marrë pjesë në festimin e 43-vjetorit të Revolucionit të madh socialist të Tetorit.*

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Botohet sipas gazetës
«Zëri i Popullit», Nr. 262,
datë 2 nëntor 1960

* Fjala e shokut Enver Hoxha që u mbajt në mbledhjen e përfaqësuesve të 81 partive komuniste e punëtore në Moskë në nëntor 1960.

**FJALA E MBAJTUR NGA SHOKU ENVER HOXHA NË EMËR
TË KQ TË PPSH NË Mbledhjen e 81 PARTIVE KOMUNISTE
DHE PUNËTORE NË MOSKË***

16 nëntor 1960

Të dashur shokë,

Kjo konferencë e partive komuniste dhe punëtoare ka një rëndësi historike për lëvizjen komuniste ndërkombëtare, pse po i bën një analizë të hollësishme situatës politike ndërkombëtare, po bën bilancin e sukseseve dhe të gabimeve që mund të jenë vërtetuar në rrugën tonë, dhe na ndihmon ne të përcaktojmë më qartë vijën që duhet të ndjekim paskëta për të korrur suksese të reja në dobi të socializmit, të komunizmit dhe të paqes.

Në botë tashmë ekziston kampi i socializmit, me Bashkimin Sovjetik në krye. Lëvizja komuniste në përgjithësi është zgjeruar, forcuar dhe kalitur. Partitë komuniste dhe punëtoare në të gjithë botën janë bërë një forcë kolosale, që çon njerëzimin përpara drejt socializmit, drejt paqes.

Siç theksohet edhe në projektdeklaratën që është përgatitur, kampi ynë i socializmit është shumë më i fortë se kampi i imperializmit. Socializmi çdo ditë forcohet dhe ngjitet, kurse imperializmi dobësohet, kalbëzohet. Ne me të gjitha mjetet dhe forcat duhet ta shpejtojmë këtë proces. Kjo do të ngjasë në qoftë se i qën-

* Mbledhja e 81 partive komuniste e punëtoare u mbajt në Moskë prej 10 nëntorit deri më 1 dhjetor 1960. Ajo u zhvillua në një gjendje tepër të ndërlikuar të lëvizjes komuniste ndërkombëtare si pasojë e përhapjes së revizionizmit modern dhe sidomos e veprimtarisë përçarëse antimarksiste të udhëheqjes sovjetike me Hrushovin në krye.

Delegacionin e PPSH e kryesonte shoku Enver Hoxha. Fjala që mbajti ai në Mbledhjen e Moskës u aprovua nga Plenumi i KQ të PPSH më 1 nëntor 1960.

Veprimtaria e delegacionit të KQ të PPSH në Mbledhjen e Moskës u aprovua plotësisht dhe njëzëri nga Plenumi i KQ të PPSH më 19-20 dhjetor 1960.

drojmë besnikë të patundur marksizëm-leninizmit dhe e zbatojmë atë drejt. Përndryshe ne do ta frenojmë këtë proces, pse kemi përpara armiq të egër, që duhet t'i mundim dhe t'i shkatërrojmë, kemi imperializmin me imperializmin amerikan në krye.

Ne e duam paqen, kurse imperializmi nuk e do paqen dhe po përgatitet për një luftë të tretë botërore. Ne duhet të luftojmë me të gjitha forcat që të shmangët lufta botërore dhe të triumfojë në botë një paqe e drejtë dhe demokratike. Kjo do të arrihet kur imperializmin do ta detyrojmë të çarmatoset. Me vullnetin e tij imperializmi nuk i lëshon armët. Të besosh një gjë të tillë është njësoj si të gënjesh veten dhe të tjerët. Duhet t'i vëmë, pra, imperializmit përballë forcën kolosale ekonomike, ushtarake, moralopolitike dhe ideologjike të kampit të socializmit dhe njëkohësisht forcën e bashkuar të popujve të të gjithë botës, për të sabotuar me të gjitha mënyrat luftën që përgatit imperialistët.

Partia e Punës e Shqipërisë këtë situatë dhe kërcënimin që i turret njerëzimit paqedashës nga imperialistët as nuk ja ka fshehur dhe as do t'ja fshehë popullit të vet. Populli shqiptar, i cili e urren luftën, mund t'ju sigurojmë se nuk është frikësuar nga ky veprim i drejtë i Partisë së tij: as pesimist nuk është bërë, as në vend nuk ka ngecur përse i përket ndërtimit të socializmit. Perspektivat e së ardhshmes ai i ka të qarta dhe punon me besim të plotë, duke qenë kurdoherë vigjilent, duke mbajtur në njërën dorë kazmën dhe në tjetrën pushkën.

Pikëpamja jonë është se imperializmi, me imperializmin amerikan në krye, duhet demaskuar pa mëshirë, politikisht dhe ideologjikisht dhe asnjëherë nuk duhet lejuar t'i bëhen lajka, përkëdhelje, lustrime imperializmit. Asnjë lëshim parimor nuk duhet t'i bëhet imperializmit. Taktikat dhe kompromiset e lejueshme nga ana jonë duhet të ndihmojnë çështjen tonë dhe jo të armikut.

Përpara armikut të egër garanci për fitoren e çështjes sonë është uniteti ynë i plotë, i cili do të sigurohet duke zhdukur mosmarrëveshjet e thella ideologjike që janë shfaqur dhe duke e bazuar këtë unitet në bazat e marksizëm-leninizmit, në barazi, në vëllazërim, në frymën shoqërore dhe të internacionalizmit proletar. Partia jonë mendon se jo vetëm nuk duhet të ketë asnjë të çarë ideologjike, por rrjedhimisht duhet të kemi edhe një qëndrim politik unik për të gjitha çështjet. Taktika dhe strategjia jonë ndaj armiqve duhet të jenë të përpunuara prej të gjitha partive tona, të mbështetura në parimet marksiste-leniniste, në kritere të drejta politike dhe që t'u përshtaten situatave konkrete dhe reale.

Kampi i socializmit, që ka në krye Bashkimin e lavdishëm Sovjetik, është bërë një forcë kolosale nga çdo pikëpamje, qoftë

nga potenciali i tij ekonomiko-kultural, qoftë nga ai ushtarak. Në qendër të sukseseve, në qendër të forcës së kampit tonë qëndron forca kolosale moralo-politike, ekonomike, kulturele dhe ushtarake e Bashkimit Sovjetik. Sukseset në industri, në bujqësi, në arësim e kulturë, në shkencë dhe në lëmin ushtarak në Bashkimin Sovjetik janë jashtëzakonisht të mëdha. Ato ndihmojnë gjithashtu pa masë edhe për arritjen e sukseseve të mëdha në vendet e tjera të kampit të socializmit.

Me të drejtë theksohet në projektdeklaratën që është pregtitur se forca e madhe dhe e pashtershme e kampit të socializmit, me Bashkimin Sovjetik në krye, është faktori vendimtar i triumfit të paqes në botë, ajo është forca moralo-politiko-ideologjike që frymëzon popujt e botës që luftojnë për t'u çliruar nga zgjedha e kolonizatorëve gjakpirës, nga kthetrat e imperializmit, dhe të kapitalizmit, është forca e madhe e shembullit dhe e ndihmës ekonomike që ndihmon dhe frymëzon popujt e tjerë për të fituar betejën e çlirimit total nga kapitalizmi shfrytëzues.

Është për këtë arsye të madhe që Bashkimi Sovjetik dhe kampi i socializmit janë bërë qendra dhe shpresa e popujve të botës, janë bërë mbështetja moralo-politike dhe ekonomike e tyre, janë bërë mbrojtësit e sigurt dhe besnikë kundrejt kërcënimeve të agresorëve luftënxitës amerikanë, anglezë, francezë dhe aleatëve të tyre.

Të gjithë popujt e botës aspirojnë dhe luftojnë për liri, pavarësi, sovranitet, drejtësi shoqërore, kulturë, për paqe. Këto aspirata të shenjta ua ka shtypur dhe po ua shtyp kapitalisti, feudali, imperialisti dhe është, pra, e natyrshme që lufta e këtyre popujve të zhvillohet me rreptësi të madhe kundër kapitalistëve, kundër feudalëve, kundër imperialistëve. Është gjithashtu e natyrshme që popujt e botës të kërkojnë aleatët e tyre në këtë luftë për jetën, që bëjnë kundër xhelatëve të tyre. Aleatët e mëdhenj e të fuqishëm, besnikë të tyre, janë vetëm Bashkimi Sovjetik dhe kampi i socializmit.

Prandaj në luftën për paqen, për çarmatimin, për përparimin shoqëror në botë kampi i socializmit nuk është i vetëm përballë kampit imperialist, porse është në aleancë të ngushtë me të gjithë popujt përparimtarë të botës, kurse imperialistët ndodhen të vetëmuar përballë kampit të socializmit.

Po jetojmë në një kohë, kur shohim të shkatërrohet fund e krye kolonializmi, të zhduket kjo murtajë që shfaroste popujt nga faqja e dheut. Shtete të reja po lindin në Afrikë, në Azi. Shtete ku sundonte kapitali, kërbaci dhe plumbi po zhdukin zgjedhën e robërisë dhe popujt po marrin në dorë fatet e tyre. Kjo gjë u arrit dhe po arrihet në sajë të luftës së këtyre popujve dhe të ndihmës morale që u japin këtyre popujve Bashkimi Sovjetik, Kina popullore dhe vendet e tjera të kampit të socializmit.

Tradhëtarë të marksizëm-leninizmit, agjentë të imperializmit dhe intrigantë si Josif Broz Titua përpiqen me njëmijë mënyra, duke kurdisur plane djallëzore, siç është krijimi i forcës së tretë, për të çorientuar popujt dhe shtetet e reja, për t'i shkëputur këta nga aleatët e tyre të natyrshëm, për t'i lidhur këta drejtpërdrejt me imperializmin amerikan. Ne duhet të vëmë të gjitha forcat për t'ua shpartalluar këto plane këtyre shërbëtorëve të imperializmit.

Ne po asistojmë në shturjen e imperializmit, të kalbëzimit të tij, të agonisë së tij. Ne rrojmë dhe luftojmë në epokën që karakterizohet nga kalimi i pandalshëm nga kapitalizmi në socializëm. Po vërtetohen të gjitha mësimet gjeniale të Karl Marksit dhe të Vladimir Iliç Leninit, të cilat kurrë nuk janë vjetëruar, siç pretendojnë revizionistët.

Imperializmi botëror po ha grushte të rënda të atilla që tregojnë qartë se ai nuk është më në «moshën e artë» të tij, kur bënte ligjin kur të donte dhe si të donte. Iniciativa i iku tani nga duart dhe këtë nuk e la nga qejfi dhe me dëshirën e vet. Kjo iniciativë nuk ju muar atij me fjalë dhe vetëm me fjalime, por pas një procesi të gjatë luftrash dhe revolucionesh të përgjakshme, që kapitalizmi vetë provokoi kundër proletariatit, kundër forcës së popujve që po ngriheshin për të shkatërruar botën e urisë dhe të mjerimit, botën e skllavërisë. Këtë faqe të lavdishme e hapi Revolucioni i madh socialist i Tetorit, e hapi Bashkimi i madh Sovjetik, e hapi Lenini i madh.

Imperializmi botëror, me imperializmin amerikan në krye, edhe tani, kur shikon se i afrohet vdekja, kur shikon se përpara tij ka kundërshtarë të fortë dhe të vendosur, siç janë kampi i socializmit dhe aleanca e tij e madhe me të gjithë popujt e botës, po përqëndron, organizon dhe armatos forcat e tij të sulmit. Ai pregtitet për luftë. Kush nuk e sheh këtë, ai është qorr. Kush e sheh por e mbulon, ai është tradhëtar në shërbim të imperializmit.

Partia e Punës e Shqipërisë mendon se me gjithë vështirësitë e mëdha që hasim në rrugën për vendosjen e paqes në botë, për çarmatimin dhe për zgjidhjen e problemeve të tjera ndërkomëtare nuk ka pse të jemi pesimistë. Vetëm armiqtë tanë që po pësojnë humbje janë dhe duhet të jenë pesimistë. Ne kemi fituar, fitojmë dhe do të fitojmë, prandaj kemi qenë dhe jemi optimistë dhe jemi të bindur se përpjekjet tona do të kurorëzohen me sukses.

Por ne mendojmë se optimizmi i tepruar, jorealizmi, jo vetëm s'është i mirë, por është i dëmshëm. Kush mohon, kush zvogëlon, kush s'ka besim në forcën tonë të madhe ekonomike, politike, ushtarake, morale, ai është disfatist dhe s'meriton të quhet komunist. Por edhe ai, që, i dehur nga forca jonë, i duken kundërshtarët mi-za, kujton se armiku ka humbur çdo shpresë, se ai u bë i parre-

zikshëm dhe është plotësisht në mëshirën tonë, ai nuk është realist dhe blufon, i vë në gjumë njerëzit, vë në gjumë popujt përpara këtyre situatave të ndërlikuara dhe plot rreziqe, që kërkojnë prej të gjithëve një vigjilencë shumë të madhe, që kërkojnë ngritjen e hovit revolucionar të masave dhe jo uljen, shthurjen, dekompozimin dhe rrehatinë. Populli ynë i vuajtur thotë: Uji fle, por armiku nuk fle.

Le të shohim drejt në sy faktet. Imperializmi botëror, me rpartin e tij më agresiv, imperializmin amerikan në krye, po drejton ekonominë e tij drejt përgatitjes së luftës. Ai po armatohet deri në dhëmbë. Imperializmi amerikan po armatohet me çfarëdo armë Gjermaninë e Bonit, Japoninë dhe të gjithë aleatët dhe satelitët e tij. Ai ka organizuar dhe i përsos organizatat ushtarake agresive, ai ka krijuar dhe po krijon baza ushtarake nga të katër anët rreth kampit të socializmit. Ai po i shton stoget e armëve bërthamore, ai s'pranon të çarmatohet, ai s'pranon t'i ndalojë provat e armëve bërthamore, ai punon në ethe për shpikje të reja të shfarosjes në masë. Të gjitha këto përse i bën? Për të shkruar në damë? Jo! Për të shkruar në luftë kundër nesh, për të zhdukur socializmin dhe komunizmin, për të skllavëruar popujt.

Partia e Punës e Shqipërisë mendon se po të flasim dhe të mendojmë ndryshe, atëherë gënjejme veten dhe të tjerët. Ne nuk do të qubeshim komunistë, në rast se do të na trembnin vështirësitë e jetës. Ne, komunistët, e urrejmë luftën, ne, komunistët, do të luftojmë deri në fund që t'i shkatërrojmë planet djallëzore dhe të luftës, që përgatit imperializmi amerikan, por po na shpalli ai luftë, ne duhet t'i japim grushtin përfundimtar, që imperializmi të zhduket përgjithmonë nga faqja e dheut.

Përpara kërcënimeve të imperializmit botëror, të kryesuar nga imperializmi amerikan, për luftë atomike, ne duhet të jemi plotësisht të përgatitur si ekonomikisht, politikisht, moralisht, ashtu edhe ushtarakisht, për t'i bërë ballë çdo eventualiteti.

Luftën botërore ne duhet ta shmangim, ajo nuk është fatalisht e pashmangshme, por askush nuk do të na falë kurrë në rast se rrojmë me ëndrra dhe armiku na gjen në befasi, sepse s'ka ndodhur kurrë që armiku të jetë ose të quhet loyal, ndryshe s'do të quhej armik. Armiku është dhe qëndron armik dhe i pabesë. Kush i zë besë armikut, ai e humb shpejt ose vonë davanë.

Që të shmanget lufta duhet shumë të bëjmë, duhet të luftojmë me të gjitha mjetet. Politika e Bashkimit Sovjetik dhe e kampit tonë të socializmit ka qenë dhe mbetet një politikë paqësore. Të gjitha propozimet sovjetike dhe të qeverive të vendeve tona të demokracisë popullore në arenën ndërkombëtare kanë synuar në uljen e tensionit ndërkombëtar, në zgjidhjen e çdo çështjeje të mbetur pezull me anë bisedimesh dhe jo me anë të luftës.

Politika paqësore e Bashkimit Sovjetik dhe e vendeve të

kampit të socializmit ka ndikuar shumë në demaskimin e qëllimeve agresive të imperializmit, në mobilizimin e popujve kundër luftënxitësve, në zhvillimin e luftës së tyre të lavdishme kundër shtypësve imperialistë dhe veglave të tyre. Shembulli i Kubës heroike, i luftës së popullit japonez dhe i ngjarjeve në Korenë e Jugut e në Turqi dëshmojnë më së miri për një gjë të tillë.

Por, megjithëkëtë, shumë probleme konkrete, të cilat janë shtruar në tavolinë, si propozimet për çarmatimin, konferenca e nivelit të lartë⁴⁷ etj., nuk janë zgjidhur dhe po sabotohen sistematikisht nga imperialistët amerikanë.

Ç'konkluzione duhet të nxjerrim nga këto? Partia e Punës e Shqipërisë mendon se imperializmi, dhe në radhë të parë imperializmi amerikan, s'e ka ndërruar lëkurën, as qimen, as natyrën. Ai është agresiv, ai do të jetë agresiv, sikur edhe një dhëmb t'i mbetet në gojë. Dhe duke qenë agresiv, ai mund ta hedhë botën në luftë. Prandaj ne, ashtu siç theksuam edhe në komisionin redaktues, vazhdojmë të ngulim këmbë se duhet t'u bëhet e qartë popujve se garanci absolute që nuk do të ketë luftë botërore mund të kemi vetëm pasi të ketë triumfuar socializmi në të gjithë botën, ose në pjesën më të madhe të vendeve të botës. Hapur flasin amerikanët, ata s'pranojnë çarmatim, por i shtojnë armatimet, ata përgatisin luftën, prandaj duhet të jemi vigjilentë..

Armikut s'duhet t'i bëjmë asnjë lëshim parimor, të mos krijojmë asnjë iluzion për imperializmin, pse duke menduar se i vëmë vetulla, mund t'i nxjerrim sytë çështjes. Armiku jo vetëm po armatohet dhe po përgatit luftën kundër nesh, por zhvillon edhe një propagandë të shfrenuar për të helmatisur shpirtërat, për t'i hutuar njerëzit. Ai harxhon me miliona dollarë për të blerë agjentë dhe spiunë, harxhon me miliona dollarë për të organizuar në vendet tona akte spiunazhi, diversioni dhe atentate. Imperializmi amerikan u ka dhënë dhe po u jep miliarda dollarë agjentëve të tij besnikë, bandës tradhëtare të Titos. Të gjitha këto ai i bën që të dobësojë frontin tonë të brendshëm, të na përçajë ne, të dobësojë dhe të çorganozë prapavijat tona.

Shumë diskutohet rreth çështjes së bashkekzistencës paqësore, bile disa afirmojnë edhe absurditete të atilla, sikur Kina popullore dhe Shqipëria qenkan kundër bashkekzistencës paqësore. Më duket se duhen hedhur poshtë një herë e mirë pikëpamje të tilla të dëmshme dhe të gabuara. Nuk mund të ketë shtet socialist, nuk mund të ketë komunist që të jetë kundër bashkekzistencës paqësore, që të jetë luftëdashës. Lenini i madh ka shtruar i pari parimin e bashkekzistencës paqësore të shteteve me rende shoqërore të ndryshme si një domosdoshmëri objektive, deri sa në botë krahas njëri-tjetrit ekzistojnë si shtetet socialiste ashtu edhe ato kapitaliste. Partia jonë e Punës, duke i qëndruar besnike këtij parimi të madh të Leninit, gjithnjë ka menduar dhe mendon se politika

e bashkekzistencës paqësore u përgjigjet interesave rrënjësore të të gjithë popujve, i përgjigjet qëllimit të forcimit të mëtejshëm të pozitave të socializmit, prandaj këtë parim të Leninit ajo e ka në bazë të të gjithë politikës së jashtme të shtetit tonë popullor.

Bashkekzistencë paqësore midis dy sistemeve të kundërta nuk do të thotë, siç pretendojnë revizionistët modernë, se duhet hequr dorë nga lufta e klasave. Përkundrazi lufta e klasave duhet të vazhdojë, lufta politike dhe ideologjike kundër imperializmit, kundër ideologjisë borgjeze dhe asaj revizioniste duhet të forcohet gjithnjë e më shumë. Duke luftuar me konsekuencë për vendosjen e bashkekzistencës paqësore leniniste, duke mos i lëshuar aspak në parime imperializmit, duhet të zhvillohet më tej lufta e klasave në vendet kapitaliste, si edhe lëvizja nacional-çlirimtare e popujve të vendeve koloniale dhe të varura.

Sipas pikëpamjes sonë, partitë komuniste dhe punëtore të vendeve kapitaliste duhet të luftojnë që të vendoset bashkekzistenca paqësore në mes të vendit të tyre, që është akoma me sistem kapitalist, dhe vendeve tona socialiste. . . Por detyra e tyre s'mbaron me kaq. Në këto vende duhet të zhvillohet, të rritet, të forcohet lufta e klasave, dhe masat punonjëse, të udhëhequra nga proletariati vendas me partinë komuniste në krye dhe në aleancë me të gjithë proletariatin botëror, t'ja bëjnë jetën të pamundur imperializmit, t'i dërmojnë atij bazat e luftës dhe të ekonomisë, t'i rrëmbejnë atij nga duart forcën ekonomike dhe politike dhe të shkojnë drejt shkatërrimit të pushtetit të tij të vjetër dhe të vendosin pushtetin e ri të popullit. Këtë do ta bëjnë me dhunë apo me rrugën paqësore e parlamentare?

Kjo çështje ka qenë e qartë, kot na e ngatërroi shoku Hrushov në Kongresin XX dhe e ngatërroi në atë drejtim që u pëlqeu në fakt oportunistëve. Përse duhej t'u bëheshin gjithë këto parodi tezave të qarta të Leninit dhe të Revolucionit socialist të Tetorit? Partia e Punës e Shqipërisë e ka pasur të qartë dhe nuk lëviz nga mësimet e Leninit në këtë çështje. Deri tani asnjë popull, asnjë proletariat dhe asnjë parti komuniste ose punëtore s'e ka marrë pushtetin pa gjak dhe pa dhunë.

Është e padrejtë kur disa shokë pretendojnë se ata e kanë marrë pushtetin pa gjak; ata harrojnë që për ta ka derdhur gjakun si lumë Ushtria e lavdishme Sovjetike në Luftën e dytë botërore.

Partia jonë mendon për këtë çështje se duhet të përgatitemi për të dyja rrugët dhe të përgatitemi mirë, sidomos për marrjen e pushtetit me anën e dhunës, pse po të përgatitemi mirë nga kjo anë, edhe mundësia e parë ka më tepër shans të ketë sukses. Borgjezia mund të të lerë të psallsh, pastaj të fut një grusht fashist në kokë dhe të dërmon, pse s'ke përgatitur as kuadrot e sulmit, as punën në ilegalitet, as vendet ku të ruhesh dhe të punosh, as

mjetet me se të luftosh. Këtij eventualiteti tragjik duhet t'i dalim përpara.

Partia e Punës e Shqipërisë është, do të jetë dhe do të luftojë në rrugën marksiste-leniniste dhe në bazë të Deklaratës së Moskës për paqen, për bashkekzistencën paqësore, ashtu sikurse na mëson Lenini. Ajo ka qenë, është dhe do të jetë e do të luftojë në mënyrë aktive për çarmatimin e përgjithshëm. Në asnjë rast dhe për asnjë çast Partia e Punës e Shqipërisë nuk do të pushojë t'u bëjë një luftë politike dhe ideologjike veprimeve të imperializmit dhe të kapitalistëve si dhe ideologjisë borgjeze, nuk do të pushojë t'i bëjë një luftë të ashpër, të pandërprerë dhe pa asnjë kompromis revizionizmit modern dhe në veçanti revizionizmit titist jugosllav. Mund të ketë shokë që të na akuzojnë ne, shqiptarët, për kokëfortë, për piper të kuq, për gjaknxehtë, për sektarë, për dogmatikë e për çfarë të duash, por ne i hedhim poshtë të gjitha këto akuzat false dhe u themi këtyre se ne s'lëvizim nga këto pozita, se janë marksiste-leniniste.

Thuhet se ne duam luftën dhe jemi kundër bashkekzistencës. Bile shoku Kozllov neve, shqiptarëve, na ka vënë këtë alternativë: ose bashkekzistencë, siç e kupton këtë ai, ose një bombë atomike nga imperialistët, e cila do ta bëjë hi Shqipërinë dhe asnjë shqiptar s'do të mbetet i gjallë. Një kërcënim të tillë atomik asnjë përfaqësues i imperializmit amerikan nuk ja ka bërë deri tani popullit shqiptar. Por ja që atë ja bën një anëtar i Presidiumit të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, dhe kujt ja bën? Një popull të vogël heroik, që në shekuj ka luftuar me armiq të egër dhe të panumërt dhe që kurrë s'është përkulur, një popull të vogël, që luftoi me heroizëm të pashoq kundër hitlerianëve dhe fashistëve italianë, ja thotë një popull që është i lidhur si mishi me kockën me Bashkimin e lavdishëm Sovjetik, ja thotë një parti që i qëndron besnike konsekuente deri në fund marksizëm-leninizmit dhe Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Por, shoku Froll Kozllov, ti ke gabuar adresë, ti nuk na frikëson dot ne që t'i përulemi vullnetit tënd të gabuar dhe ne s'e ngatërrojmë kurrë Partinë e lavdishme të Leninit me ju, që silleni kaq keq dhe kaq patrupësisht me popullin shqiptar dhe me Partinë e Punës të Shqipërisë. Partia e Punës e Shqipërisë do të luftojë dhe do t'i mbështesë të gjitha propozimet e drejta dhe paqësore të Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të tjera të kampit të socializmit, si dhe të vendeve të tjera paqedashëse.

Partia e Punës e Shqipërisë do t'i shkrijë të gjitha forcat, do t'i përdorë të gjitha të drejtat dhe do t'i kryejë të gjitha detyrat e saj për forcimin e unitetit të kampit të socializmit, të një uniteti marksist-leninist. Është absurde të mendohet që Shqipëria e vogël socialiste kërkon të shkëputet dhe të rrojë jashtë kampit të socializmit, jashtë vëllazërisë së popujve tanë socialistë. Qenjen

në gjirin e kampit të socializmit s'ja ka falur njeri Shqipërisë, por atë e ka vendosur vetë populli ynë dhe Partia e Punës e Shqipërisë me gjak, me punë, me sakrificë, me djersë, me sistemin e qeverimit që ka vendosur dhe me rrugën marksiste-leniniste që ndjekim. Por askujt gjithashtu të mos i shkojë ndër mend se meqë Shqipëria është e vogël, se meqë Partia e Punës e Shqipërisë është e vogël duhet të bëjë ashtu si thotë ndokush, kur ajo është e bindur se ai ndokushi gabohet.

Sikundër që u shpreha edhe më lart, Partia e Punës e Shqipërisë mendon se kampi ynë i socializmit, që ka një qëllim, që udhëhiqet nga marksizëm-leninizmi, duhet të ketë edhe strategjinë e taktikën e vet dhe këto të përpunohen së bashku nga partitë dhe nga shtetet tona të kampit të socializmit. Në gjirin e kampit tonë ne kemi krijuar disa forma organizimi pune, por është e drejtë të themi se këto kanë mbetur disi formale ose, më mirë me thënë, nuk funksionojnë në mënyrë kolegjiale, si p.sh. organet e Traktatit të Varshavës dhe Këshilli Ekonomik i Ndhmës Reciproke. Të kuptohemi. Këtu s'e kemi çështjen të pyetemi ose jo edhe ne. Natyrisht asnjeri nuk na e mohon të drejtën të pyetemi, por duhet të mblidhemi që të pyetemi. Çështjen e ngrëmë në parim dhe themi se këto forma organizimi duhet të funksionojnë rregullisht, atje të shtrohen problemet, të merren vendime dhe të kontrollohet zbatimi i këtyre vendimeve.

Zhvillimi dhe fuqizimi i mëtejshëm i ekonomisë së vendeve të socializmit ka qenë dhe është kurdoherë në planin e parë të partive dhe të qeverive tona dhe përbën një nga faktorët vendimtarë të forcës së pamposhtur të kampit të socializmit.

Ndërtimi i socializmit dhe i komunizmit po ecën me hapa të vrullshme në vendet tona. Kjo u detyrohet përpjekjeve të mëdha të popujve tanë dhe ndihmës që i jepet shoqi-shoqit. Në këtë drejtim një rol të rëndësishëm kanë luajtur dhe luajnë koordinimi i planeve të vendeve tona dhe Këshilli i Ndhmës Ekonomike Reciproke.

Republika Popullore e Shqipërisë s'i ka dhënë ndihmë ekonomike njeri deri tani, e para, se jemi të varfër dhe, e dyta, se s'ka njeri nevojë për ndihmën tonë ekonomike. Por brenda normave të drejta ne kemi bërë dhe bëjmë të gjitha përpjekjet që me eksportin tonë të ndihmojmë sado pak vendet miq dhe vëllezër. Ne jemi ndihmuar nga miqtë tanë dhe në radhë të parë nga Bashkimi Sovjetik. Ne jemi ndihmuar me kredi dhe me specialistë, pa të cilët do të ishte shumë e vështirë që vendi dhe ekonomia jonë të zhvilloheshin me ritmet që janë zhvilluar.

Këtë ndihmë bujare të Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të tjera të demokracisë popullore Partia e Punës e Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë e kanë shfrytëzuar sa më mirë në interes të popullit. Për këtë ndihmë populli ynë

u është për jetë mirënjohës popujve sovjetikë, Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Qeverisë Sovjetike, popujve, partive dhe qeverive të vendeve të demokracisë popullore. Ne këtë ndihmë e kemi kuptuar, e kuptojmë dhe do ta kuptojmë jo sikur na është dhënë si lëmoshë, por si ndihmë vëllazërore, si ndihmë internacionaliste.

Populli ynë, si një popull që ka qenë i varfër në kulm, si një popull që luftoi me heroizëm, si një popull që u vra e u dogj, e kishte për detyrë t'u kërkonte ndihmë miqve dhe vëllezërve më të mëdhenj e më të pasur ekonomikisht se ai. Edhe miqtë e kishin dhe e kanë për detyrë internacionaliste ta japin këtë ndihmë. Prandaj duhet hedhur poshtë çdo pikëpamje e errët dhe antimarksisiste që mund të shfaqet në lidhje me karakterin dhe qëllimin e kësaj ndihme nga ndokush. Presionet ekonomike mbi Partinë e Punës të Shqipërisë, mbi Qeverinë Shqiptare dhe mbi popullin tonë s'do të kenë kurrë sukses.

Unë dëshiroj të shtroj këtu çështjen që ndihmat nga vendet ekonomikisht më të forta për vendet më të dobëta ekonomikisht, sikurse është rasti i popullit tonë, duhet të jenë më të mëdha. Populli shqiptar nuk mendon aspak që të lidhë duart dhe të hapë gojën ta ushqejnë të tjerët. Ky s'është zakoni i tij. Populli ynë gjithashtu nuk ka ato pretendime që niveli i jetesës në vendin tonë të ngrihet menjëherë në nivelin e jetesës së shumë prej vendeve të demokracisë popullore, por një ndihmë më e madhe duhet t'i jepet vendit tonë për zhvillimin e mëtejshëm të forcave prodhuese. Ne mendojmë se vendet ekonomikisht të forta të kampit të socializmit duhet t'u japin kredi edhe vendeve kapitaliste asnjane, edhe popujve të porsaçliruar nga kolonializmi, kur udhëheqjet e këtyre vendeve kapitaliste janë kundër imperializmit, mbështesin politikën paqesore të kampit të socializmit dhe nuk pengojnë e nuk kundërshtojnë luftën legjitime të forcave revolucionare, por në radhë të parë duhet të shikohen më me kujdes dhe të plotësohen nevojat e vendeve të kampit të socializmit. Sigurisht ka nevojë India për hekur dhe çelik, por ka nevojë më shumë dhe më përpara Shqipëria socialiste, ka nevojë për vaditje dhe për energji elektrike Egjipti, por ka nevojë më shumë dhe më përpara Shqipëria socialiste.

Në shumë probleme politike të dorës së parë kampi ynë i socializmit ka pasur dhe ka pikëpamje të njëjta. Por duke mos i bërë në rregull konsultimet kolegjiale, mjaft herë është vënë re se shtete nga të kampit tonë të socializmit marrin iniciativa politike, (në parim ne s'jemi kundër marrjes së iniciativave), të cilat shumë herë prekin edhe shtete të tjera të kampit të socializmit. Disa nga këto iniciativa nuk janë të drejta dhe kjo ndodh sidomos kur këto iniciativa nuk merren në formë kolegjiale nga pjesëtarët e Traktatit të Varshavës.

E tillë është iniciativa e Qeverisë Bullgare, e cila i njoftoi Qeverisë Greke, pa e përfillur aspak Shqipërinë, se vendet e demokracisë popullore të Ballkanit pranojnë të çarmatosen në rast se vepron po kështu edhe qeveria greke. Kjo iniciativë ka qenë e gabuar për pikëpamjen tonë, sepse edhe sikur ta pranonte Greqia një propozim të tillë, atë nuk do ta pranonte Qeveria Shqiptare. Shqipëria është dakord me propozimin sovjetik që bëri Nikita Hrushovi në muajin maj 1959,⁴⁸ por jo me propozimin bullgar që dëshiron të çarmatosë vendet e Ballkanit, duke lënë pa prekur Italinë. Apo harruan shokët bullgarë se Italia borgjeze dhe fashiste e ka sulmuar disa herë gjatë këtij shekulli Shqipërinë?

A mund t'u lejohet shokëve bullgarë rasti tjetër, që duke mos u konsultuar aspak me Qeverinë Shqiptare, me të cilën ata janë të lidhur me një traktat mbrojtjeje, t'i propozojnë Qeverisë Greke një traktat miqësie dhe mossulmimi, në një kohë kur Greqia mban me Shqipërinë gjendjen e luftës dhe ka pretendime territoriale mbi atdheun tonë? Të tilla veprime ne na duket se janë të rrezikshme të merren në mënyrë të njëanshme.

Nga këto kundërshtime të drejta dhe legjitime tonat mundet që shokët bullgarë të kenë arritur në konkluzionet se gjoja ne shqiptarët nuk kuptojmë mirë bashkekzistencën, duam luftën etj. Këto pikëpamje janë të gabuara.

Veprime të tilla janë shfaqur gjithashtu nga shokët polinezë në Kombet e Bashkuara, ku shoku Gomulka deklaroi në mënyrë të njëanshme përpara Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara se Polonia propozon të ruhet statu quoja aktuale e vendosjes së forcave ushtarake në botë dhe konkretisht të mos krijohen më baza ushtarake, po të qëndrojnë këto që janë, të mos vihen më raketa, por të qëndrojnë këto që janë, të ruajnë sekretin e bombës atomike ato shtete që e kanë dhe të mos ua japin atë shteteve të tjera. Një propozim i tillë, sipas mendimit tonë, është në kundërshtim me interesat e kampit tonë. Të mos vihen më raketa, po kush e ku? Të gjithë anëtarët e NATO-s, duke përfshirë edhe Italinë, Gjermaninë Perëndimore e Greqinë, janë pajisur me raketa. Të mos i jepet sekretin e bombës atomike, kujt? Atë e ka Anglia, e ka Franca e ka edhe Gjermania Perëndimore. Është e qartë se një propozim i tillë do të na detyrojë ne, vendet e demokracisë popullore, të mos vendosim raketa, ose ndonjë vend tjetër i kampit socialist, veç Bashkimit Sovjetik, të mos e ketë bombën atomike.

Ne shtrojmë çështjen, përse Kina komuniste të mos e ketë bombën atomike? Ne mendojmë se ajo duhet ta ketë dhe kur edhe Kina t'i ketë bombën dhe raketat, atëherë do të shohim se me çfarë gjuhe do të flasë imperializmi amerikan, do të shohim se a do të vazhdohet t'i mohohen të drejtat Kinës në arenën ndërkombë-

tare, do të shohim se a do të guxojnë imperialistët amerikanë të vringëllojnë armët siç bëjnë sot.

Pse, duke e pasur bombën dhe duke e hedhur bombën do t'i fitojë këto të drejta Kina mbi Shtetet e Bashkuara të Amerikës, mund të na pyesi ndokush? Jo, Kina, ashtu sikurse edhe Bashkimi Sovjetik, nuk e hedh bombën kurrë në rast se nuk sulmohemi nga ata që e kanë në gjak agresionin dhe luftën. Por po të mos e kishte Bashkimi Sovjetik bombën, imperializmi do të fjaloste ndryshe me ne. Me bomba ne kurrë nuk do të sulmojmë, ne jemi kundër luftës, ne jemi gati t'i shkatërrojmë ato, por bombën ne e kemi për t'u mbrojtur. Frika i ruan vreshtat, thotë populli ynë. Imperialistët duhet të na e kenë frikën dhe bile të na e kenë shumë.

Partia e Punës e Shqipërisë, e mbështetur në marksizëm-leninizmin dhe në Deklaratën dhe Manifestin e paqes të Moskës, në çështjet e politikës ndërkombëtare dhe në problemet e rëndësishme të ndërtimit të socializmit ka ndjekur një vijë të drejtë marksiste-leniniste. Në marrëdhënjet ndërkombëtare vija e Partisë sonë ka qenë e përputhur me politikën e kampit të socializmit dhe ajo ka ndjekur orientimin e politikës paqësore të Bashkimit Sovjetik.

Partia e Punës e Shqipërisë e ka konsideruar, e konsideron dhe do ta konsiderojë Bashkimin Sovjetik shpëtimtarin e popullit tonë dhe eksperiencën e tij të madhe si universale, shumë të nevojshme dhe të domosdoshme për të gjithë. Partia e Punës e Shqipërisë e ka ndjekur, e ka zbatuar dhe e ka adaptuar këtë eksperiencë të madhe pa rezerva, në të gjitha fushat dhe ka korrur suksese. Ne kemi korrur suksese në krijimin e industrisë sonë dhe në fuqizimin e saj, në kolektivizimin e bujqësisë, në zhvillimin e arësimit dhe të kulturës, që ka marrë një hov të madh, në ndërtimin e shtetit dhe të Partisë sonë. Partia jonë ka fituar tani një pjekuri dhe eksperiencë të mirë në punë në këtë drejtim.

Partia jonë e ka edukuar, e edukon dhe do ta edukojë popullin tonë me një dashuri dhe me një besnikëri të madhe ndaj popujve të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Kjo dashuri është e kalitur dhe çdo ditë do të kalitet, pse është mbrojtur me gjak, pse është zhvilluar në bazat e marksizëm-leninizmit dhe të internacionalizmit proletar. Me gjithë shpirt i kemi dashur dhe i duam njerëzit sovjetikë, po ashtu edhe ata e kanë dashur dhe e duan popullin dhe Partinë e Punës të Shqipërisë. Kjo është miqësi popujsh, miqësi partish marksiste-leniniste dhe prandaj ajo në shekuj do të lulëzojë dhe s'do të ketë mortje kurrë. Kjo është bindja e patundur e komunistëve shqiptarë dhe këtë bindje e kanë rrënjësuar dhe do të vazhdojnë ta kalitin në popullin e tyre. E kemi thënë dhe e përsërisim, pa këtë miqësi nuk mund të kishte liri për popullin tonë. Ky është fruti i leninizmit.

Problemet e mëdha të kohës e kanë preokupuar edhe Partinë e Punës të Shqipërisë, edhe popullin tonë të vogël. Republika jonë Popullore ka qenë dhe është e rrethuar gjeografikisht nga shtete kapitaliste dhe revizionistët jugosllavë; ne na është dashur të jemi shumë vigjilentë, të gozhdojmë njerëz dhe fonde të konsiderueshme për mbrojtjen e kufive tanë, për mbrojtjen e lirisë dhe të pavarësisë së atdheut nga tentativat e panumërta të imperialistëve dhe të satelitëve, shërbëtorë të tyre.

— Ne jemi një vend i vogël dhe një popull i vogël, që kemi vuajtur jashtëzakonisht shumë, por që kemi luftuar gjithashtu shumë. Lirinë që kemi sot s'na e ka falur kurrkush, por e kemi fituar me gjak. I kemi njohur dhe vazhdojmë t'i njohim çdo ditë armiqtë imperialistë, manevrat e tyre kundër kampit të socializmit dhe kundër vendit tonë në veçanti, prandaj asnjë iluzion s'kemi pasur dhe as do të kemi se ata do të ndërrojnë natyrën dhe qëllimet kundër popujve, kundër kampit tonë dhe kundër Shqipërisë socialiste në veçanti. Partia jonë ka qenë dhe është për paqen dhe do të luftojë pa pushim, përkrah Bashkimit Sovjetik, Kinës popullore, vendeve të tjera të kampit të socializmit dhe gjithë popujve përparimtarë për ta mbrojtur paqen. Për këtë qëllim të shenjtë Partia e Punës e Shqipërisë dhe qeveria jonë kanë mbështetur me të gjitha forcat politikën paqësore të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe të Qeverisë Sovjetike dhe të të gjitha vendeve të kampit të socializmit. Në çdo gjë, në çdo propozim kemi qënë solidarë.

Imperialistët amerikanë dhe anglezë na kanë akuzuar dhe na akuzojnë ne, shqiptarët, për «të egër dhe luftëdashës». Kjo është e kuptueshme, pse populli shqiptar u ka rënë duarve dhe turinjve tentativave të tyre të shumta për të na robëruar dhe u ka prerë kokën agjentëve të tyre që komplotonin kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe regjimit tonë të demokracisë popullore.

Banda e Titos, ajo e shovinistëve monarko-fashistë grekë dhe sundimtarët e Romës na kanë akuzuar dhe na akuzojnë për «luftënxitës, për turbullues të Ballkanit», pse ne u kemi rënë, u biem dhe do t'u biem kokës, pa hezituar asnjëherë, pse qëllimet e tyre kanë qenë, mbeten dhe do të mbeten kurdoherë të copëtojnë Shqipërinë në mes tyre, të robërojnë popullin tonë.

As është e rastit, na duket neve, të vërtetojmë këtu në këtë mbledhje që lufta është e huaj për vendet socialiste, për partitë tona marksiste-leniniste, por çështja qëndron në atë: pse imperialistët dhe agjentët e tyre akuzojnë Kinën dhe Shqipërinë për luftëdashëse dhe gjoja kundër bashkekzistencës paqësore?

Të marrim çështjen e Shqipërisë. Kundër kujt do të bëjë luftë Shqipëria dhe përse? Do të jetë qesharake të rrimë dhe t'i përgjigjemi kësaj pyetjeje. Por atyre që na akuzojnë ne për këtë u duhet të mbulojnë qëllimet e tyre agresive ndaj Shqipërisë.

Rankoviçi dëshiron që ne t'i bëjmë kufitë tanë han me dy porta, ku të hyjnë e të dalin «pa vizë» agjentë dhe armë jugosllave, italiane dhe greke, për të na sjellë «Kulturën e tyre të thikës në dhëmbë», për të realizuar Titua ëndrrën e tij që Shqipëria të bëhet republikë e shtatë e Jugosllavisë, ose borgjezia reaksionare italiane të vërë në zbatim për të tretën herë qëllimet e saj grabitqare kundër Shqipërisë, ose monarko-fashistët grekë të realizojnë ëndrrën e tyre të çmendur për grabitjen e Shqipërisë së Jugut. Pse ne s'i kemi lënë dhe s'do t'i lejojmë kurrë këta, prandaj jemi «luftënxitës»? Ata e dinë fare mirë që në rast se i prekin kufitë tanë, atëhere do të kenë luftë me ne dhe me gjithë kampin e socializmit.

Qëllimi i tyre, pra, ka qenë dhe është të na izolojnë nga kampi dhe nga miqtë, të na akuzojnë si «luftënxitës dhe të egër», pse ne nuk u hapim kufitë tanë të livadhisin lirisht, të na akuzojnë që ne gjoja s'jemi për bashkekzistencën. Por ironia e fatit qëndron në atë që ka shokë që e besojnë këtë lodër të revizionistëve dhe këto shpifje kundër Partisë së Punës të Shqipërisë. Natyrisht ne jemi kundër një bashkekzistence të atillë, për hir të së cilës ne, shqiptarët, duhet t'i bëjmë koncesione territoriale dhe politike Sofokli Venizellosit. Jo, ato kohëra kanë vdekur përgjithmonë, kur tokat e Shqipërisë bëheshin monedhë tregu. Ne jemi kundër një bashkekzistence të atillë me shtetin jugosllav, që vë si konditë shuarjen e luftës ideologjike e politike kundër revizionistëve jugosllavë, këtyre agjentëve të imperializmit ndërkombëtar, këtyre tradhëtarëve të marksizëm-leninizmit. Ne jemi kundër një bashkekzistence të atillë me anglezët apo amerikanët, për hir të së cilës ne duhet t'u njohim, siç kërkojnë, koncesionet e vjetra politike, diplomatike e tregëtare që u kishte akorduar atyre regjimi i mbretit Zog.

Si konkluzion i përgjithshëm, Partia e Punës e Shqipërisë është plotësisht e bindur se çështja jonë e madhe, ajo e fitores së socializmit dhe të paqes do të triumfojë. Forcat e bashkuara të kampit socialist, me Bashkimin Sovjetik në krye, të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare dhe të të gjithë njerëzve e popujve paqëdashës me aksione të vendosura kanë mundësi të detyrojnë imperialistët për të pranuar bashkekzistencën paqësore e të shmangin luftën botërore. Por në të njëjtën kohë ne do të forcojmë gjithnjë e më shumë vigjilencën revolucionare, me qëllim që asnjëherë armiqtë të mos na kapin në befasi. Ne jemi të bindur se fitorja në këtë luftë fisnike për paqen në botë dhe triumfin e socializmit do të jetë e jona. Populli shqiptar dhe Partia e Punës e Shqipërisë, ashtu si deri tani, nuk do të kursejnë asgjë për të ndihmuar me të gjitha forcat e veta triumfin e çështjes sonë të përbashkët. Ne, si gjithnjë, do të ecim përpara në unitet të çeliktë me të gjithë kampin socialist, me Bashkimin e lavdishëm Sovjetik, me të gjithë lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare.

Të dashur shokë,

Uniteti i lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare është faktori vendimtar për realizimin e qëllimeve fisnike të triumfit të paqes, të demokracisë, të pavarësisë kombëtare dhe të socializmit. Kjo çështje theksohet në mënyrë të posaçme si në Deklaratën e Moskës të vitit 1957, ashtu edhe në projektdeklaratën që është pregatitur për mbledhjen tonë. Në Deklaratën e vitit 1957 theksohet se

«partitë komuniste e punëtore mbajnë përgjegjësi historike veçanërisht serioze për fatet e sistemit socialist botëror dhe të lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Partitë komuniste e punëtore, që marrin pjesë në mbledhje, deklarojnë se ato do të forcojnë pa u lodhur unitetin e tyre dhe bashkëpunimin shoqëror, në interes të bashkimit të mëtejshëm të familjes së shteteve socialiste, në interes të lëvizjes punëtore ndërkombëtare, të çështjes së paqes dhe të socializmit»⁴⁹.

Duhet thënë se, veçanërisht në kohët e fundit, në lëvizjen komuniste ndërkombëtare dhe në marrëdhënjet midis disa partive kanë lindur mosmarrëveshje të thella ideologjike e politike, thellimi i të cilave mund t'i sjellë vetëm dëm çështjes sonë të madhe. Prandaj Partia e Punës e Shqipërisë mendon se që të shkojmë përpara, të bashkuar, drejt fitoresh të reja, duhet të dënojmë gabimet dhe shfaqjet negative që janë vënë re deri tani dhe t'i ndreqim ato.

Këtu ne duam të ndalemi në çështjen e Mbledhjes së Bukureshtit, në të cilën Partia jonë, siç dihet, nuk shfaqi mendimin e saj përse u përket mosmarrëveshjeve që kanë lindur midis Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste të Kinës, por rezervoi qysh atëherë të drejtën ta bëjë një gjë të tillë në këtë mbledhje të përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore. Atëherë Partia e Punës e Shqipërisë u akuzua nga shokët sovjetikë dhe nga disa shokë të partive të tjera motra për çdo gjë që mund të imagjinohet, por askujt nuk i shkoi ndër mend që të mendonte për një çast përse kjo Parti mbajti një qëndrim të tillë kundër të gjithë korrentit, pse kjo Parti, që ka qëndruar deri në fund besnike e marksizëm-leninizmit dhe e Deklaratës së Moskës, akuzohet papritur se gjoja është «kundër marksizëm-leninizmit dhe Deklaratës së Moskës», pse kjo Parti, e lidhur kaq ngushtë me Bashkimin Sovjetik dhe me Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, përnjëherë del në kundërshtim me udhëheqjen e Bashkimit Sovjetik.

Tani që të gjithë shokët kanë në duar si materialin informativ sovjetik ashtu edhe materialin e Partisë Komuniste të Kinës

le të reflektojnë vetë. Ne kemi lexuar e studjuar si materialin sovjetik, ashtu edhe atë kinez, i kemi diskutuar me aktivin e Partisë me kujdes këto dokumenta dhe vijmë kështu në këtë mbledhje me pikëpamje unanime të të gjithë Partisë.

Siç dihet, më 24 qershor të këtij viti, me rastin e kongresit të Partisë Punëtore Rumune, papritur dhe pa patur asnjë paralajmërim paraprak, të paktën përse i përket Partisë sonë, me iniciativën e shokëve të udhëheqjes së Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik u organizua Konferenca e Bukureshtit. Në vend që ajo, simbas marrëveshjes së arritur me letrat e datës 2 e 7 qershor,⁵⁰ «të shkëmbente mendime» dhe të caktonte datën e kësaj konference që mbajmë sot, u muar me një çështje tjetër, me akuzën ideologjike e politike drejtuar kundër Partisë Komuniste të Kinës, në bazë të materialit «informativ sovjetik». Mbi këtë material, krejtësisht të panjohur deri disa orë përpara mbledhjes së konferencës, duhej të prononcoheshin në favor të pikëpamjeve të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik delegatët e partive komuniste dhe punëtore motra që ndodheshin në Bukuresht për çështje tjetër dhe që s'kishin (të paktën delegacioni i Partisë sonë) asnjë mandat nga partitë e tyre për të diskutuar, pa le për të vendosur për një çështje kaq të rëndësishme të komunizmit ndërkombëtar. As mund të mendohej për një diskutim serioz të këtij materiali, që mbante akuza kaq të mëdha kundër një partie tjetër marksiste-leniniste, kur nuk u lejohej delegatëve dhe sidomos udhëheqjeve të partive komuniste dhe punëtore ta studjonin atë nga të gjitha anët dhe t'i lihej koha e duhur palës së akuzuar të parashtronte edhe ajo me kohë dhe në të gjitha format, që përdor edhe pala akuzuese, pikëpamjet e saj. Fakti është se udhëheqja sovjetike kishte vetëm si preokupim dominonjës të kalonin me shpejtësi akuzat e saj kundër Partisë Komuniste të Kinës dhe të dënohej me çdo kusht Partia Komuniste e Kinës.

Ky ishte preokupimi i shokut Hrushov dhe i shokëve të tierë sovjetikë në Bukuresht dhe aspak çështjet e politikës ndërkombëtare që preokuponin kampin tonë dhe të gjithë botën në tërësi, të krijuara pas dështimit të konferencës së nivelit të lartë në Paris.

Partia jonë do të ishte plotësisht dakord me një konferencë ndërkombëtare të partive komuniste e punëtore, do të ishte dakord edhe me çfarëdo konference tjetër, me çfarëdo rend dite që mund të caktohej, por me konditë që këto konferenca të ishin të rregullta, të kishin aprovimin e të gjitha partive, të përcaktohej qartë dhe më parë rendi i ditës, t'u jepej partive komuniste dhe punëtore material i nevojshëm dhe t'u lihej koha e përshtatshme për të studjuar materialet, për t'u pregatitur dhe për të marrë byrotë politike të partive, në qoftë se e lypte nevoia, edhe aprovimin e plenumëve të komiteteve qendrore për vendimet që eventualisht mund të merreshin me këto konferenca. Konferencat duhet të zhvi-

llohen, pra, brenda normave leniniste që rregullojnë marrëdhënjet në mes partive komuniste dhe punëtorë, duhet të zhvillohen në barazi të plotë në mes partive, në frymën shoqërore komuniste, internacionaliste dhe me moral të lartë komunist.

Konferenca e Bukureshtit nuk u përgjigjej këtyre normave, prandaj partia jonë, megjithëse mori pjesë në të, e dënoi dhe e dënosi si të parregullt këtë konferencë në të cilën u thyen normat leniniste.

Ne mendojmë se Konferenca e Bukureshtit i shërbeu shumë keq çështjes së lëvizjes komuniste ndërkombëtare, çështjes së solidaritetit ndërkombëtar të punonjësve, çështjes së forcimit të unitetit të kampit të socializmit, çështjes së shembullit marksist-leninist të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ideologjike, politike dhe organizative, që mund të ngjasin në gjirin e partive komuniste dhe punëtorë dhe që dëmtojnë marksizëm-leninizmin. Faji për këtë u bie shokëve të udhëheqjes së Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, që e organizuan këtë konferencë, që e konceptuan në këto forma dhe që zbatuan këto norma jomarksiste për këtë çështje.

Qëllimi ka qenë të dënohej Partia Komuniste e Kinës nga lëvizja komuniste ndërkombëtare për gabime dhe faje të paqena dhe pa baza. Kjo është bindja e plotë e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, në bazë të studimit të fakteve, në bazë të materialit sovjetik dhe të atij kinez, që Partia e Punës e Shqipërisë disponon tani, në bazë të një analize të hollësishme që Partia e Punës e Shqipërisë u ka bërë zhvillimit të situatës ndërkombëtare dhe qëndrimeve zyrtare të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe të Partisë Komuniste të Kinës.

E gjithë Partia e Punës e Shqipërisë mendon njëzëri se shokët sovjetikë kanë gabuar rëndë në Bukuresht, ata kanë dënuar padrejtësisht Partinë Komuniste të Kinës se gjoja ajo ka devijuar nga marksizëm-leninizmi, se gjoja ka shkelur dhe braktisur Deklaratën e Moskës të vitit 1957, ata e kanë akuzuar Partinë Komuniste të Kinës si «dogmatike», «sektare», se është «për luftën», se është «kundër bashkekzistencës paqësore», se «do vend të privilegjuar në kamp dhe në lëvizjen komuniste ndërkombëtare» etj.

Shokët sovjetikë kanë gabuar rëndë gjithashtu edhe në drejtimin që, duke përfituar nga dashuria dhe besimi i madh që kanë komunistët për Bashkimin Sovjetik dhe për Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, u përpoqën t'ua impononin edhe partive të tjera komuniste dhe punëtorë pikëpamjet e tyre jo të drejta ndaj Partisë Komuniste të Kinës.

Për Partinë e Punës të Shqipërisë ka qenë e qartë, që në momentet e para, që kur filloi përpunimi i ethshëm dhe i palejueshëm nga ana e shokëve sovjetikë ndaj shokëve të delegacionit tonë në Bukuresht, se shokët sovjetikë dëshironin me argumentime të pa-baza e me presion ta tërhiqnin delegacionin e Partisë së Punës të

Shqipërisë në kurthin që pregatisnin, ta radhisnin atë në pikëpamjet e shtrembëra të shokëve sovjetikë.

Rëndësi për shokun Hrushov ka pasur fakti (edhe këtë shoku Antropov ja tha shokut Hysni Kapo) «nëse do të radhiteshim në në anën sovjetike apo jo». Këtë mendim shoku Hrushov e shfaqti edhe në forma të tjera, në ndërhyrjet që bëri kundër Partisë sonë në Konferencën e Bukureshtit. Këtë e vërtetuan edhe shumë qëndrime të padrejta dhe jomiqësore të udhëheqjes sovjetike dhe të njerëzve të Ambasadës Sovjetike në Tiranë, pas Konferencës së Bukureshtit, për të cilat do të flas më vonë. Për shokët udhëheqës sovjetikë nuk kishte asnjë rëndësi pikëpamja e një partie marksiste-leniniste, siç ishte Partia jonë, por rëndësi kishte që ajo të mbante po atë qëndrim që mbajti Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik në Bukuresht.

Asnjë paralajmërim nuk i është bërë Partisë së Punës të Shqipërisë nga ana e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, që organizoi Mbledhjen e Bukureshtit, se me rastin e kongresit të Partisë Punëtorë Rumune do të ngriheshin akuza kundër Partisë Komuniste të Kinës për gjoja gabime të rënda në vijë. Kjo gjë i erdhi në mënyrë krejt të papritur Partisë së Punës të Shqipërisë. Kurse tani ne po marrim vesh se partitë e tjera të kampit, me përjashtim të Partisë së Punës të Shqipërisë, Partisë Komuniste të Kinës, Partisë së Punës të Koresë, Partisë së Punonjësve të Vietnamit, ishin në dijeni se në Bukuresht do të organizohej konferenca për të akuzuar Kinën. Në qoftë se ka ndodhur kështu, atëherë është fare e qartë se çështja bëhet shumë më serioze dhe merr formën e një fraksioni me karakter ndërkombëtar.

Por megjithatë Partia jonë nuk u gjend në befasi dhe asaj nuk i mungoi vigjilenca, e kjo ngjau pse ajo respekton kurdoherë normat leniniste në marrëdhënjet midis partive, se ka respekt të madh marksist për Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, për Partinë Komuniste të Kinës dhe për të gjitha partitë e tjera komuniste dhe punëtorë, pse respekton ndjenjën e barazisë në mes partive, barazi që duhet ta respektojnë edhe partitë e tjera ndaj Partisë së Punës të Shqipërisë, pavarësisht se ajo është e vogël në numër.

Partia jonë pa që në fillim se të gjitha këto norma u shkelën në Mbledhjen e Bukureshtit dhe prandaj mbajti qëndrimin që dihet nga të gjithë dhe e quajti e e quan të vetmin qëndrim të drejtë përpara ngjarjeve si u zhvilluan.

Disa udhëheqës të partive motra na quajtën ne «neutralistë», disa na akuzuan se «u shkëputëm nga vija e drejtë marksiste-leniniste» dhe këta udhëheqës shkuan gjer atje sa që në partitë e tyre ndërmorën diskreditimin e Partisë sonë. Të gjitha këto ne i hedhim poshtë me përbuzje, pse këto janë shpifje, këto s'janë të ndershme dhe as pajtohen me moralin komunist.

U bëjmë pyetjen atyre që ndërmorën këto veprime të dënueshme kundër Partisë së Punës të Shqipërisë: a ka të drejtë një parti të shfaqë lirisht mendimin e vet, ashtu si e gjykon ajo? Çfarë mendimi shfaqi Partia e Punës e Shqipërisë në Bukuresht? Ne shprehëm besnikërinë tonë ndaj marksizëm-leninizmit dhe këtë e vërtetoi gjithë jeta dhe lufta e Partisë së Punës të Shqipërisë, ne shfaqëm besnikërinë tonë ndaj vendimeve të Deklaratës së Moskës dhe Manifestit të paqes të vitit 1957 dhe këtë e vërtetoi vija e ndjekur me konsekuencë nga Partia e Punës e Shqipërisë, ne shfaqëm besnikërinë tonë dhe mbrojtëm unitetin e kampit të socializmit, dhe këtë e vërtetoi e gjithë lufta e Partisë së Punës të Shqipërisë, ne shfaqëm dashurinë, besnikërinë ndaj Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe popujve sovjetikë, dhe këtë e vërtetoi gjithë jeta e Partisë së Punës të Shqipërisë. Ne nuk pranuan të gjykonim «gabimet» e Partisë Komuniste të Kinës dhe ca më pak ta «dënonim» Partinë Komuniste të Kinës, pa pasur parasysh edhe pikëpamjet e Partisë Komuniste të Kinës për çështjet që ngriheshin kaq shtrembër, në mënyrë të shpejtuar dhe antimarksiste kundër saj. Ne këshilluam të tregoheshim të matur, gjakftohtë dhe shoqërorë në zgjidhjen e kësaj çështjeje jetike dhe jashtëzakonisht serioze për komunizmin ndërkombëtar. Ky ishte i gjithë «krimi» ynë, për të cilin na u hodh guri. Por ne mendojmë se guri që u ngrit për të na goditur ne u ra vetë në kokë atyre që e lëshuan. Sa ditë shkuan dhe sa kohë do të shkojnë po vërtetojnë drejtësinë e qëndrimit të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Pse u shpejtuan kaq shumë shoku Hrushov dhe shokët e tjerë sovjetikë për të akuzuar pa baza dhe pa fakte Partinë Komuniste të Kinës? A mund t'u lejohet komunistëve dhe veçanërisht udhëheqësve kryesorë të një partie kaq të madhe e të lavdishme siç është Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik të bënin një veprim të tillë të shëmtuar? Ata le të përgjigjen vetë, por edhe Partia e Punës e Shqipërisë ka plotësisht të drejtën të thotë mendimin e vet.

Partia e Punës e Shqipërisë mendon se Mbledhja e Bukureshtit jo vetëm që qe një gabim i madh, por edhe se ky gabim u thellua me ndërjegje. Mbledhja e Bukureshtit me asnjë mënyrë nuk duhet lënë në harresë, por duhet të dënohet rreptësisht si një njollë në lëvizjen komuniste ndërkombëtare.

S'ka as më të voglin dyshim që mosmarrëveshjet ideologjike kanë qenë dhe janë të mëdha dhe këto kanë lindur e janë zhvilluar në mes Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste të Kinës. Këto duhej të ishin zgjidhur në kohë dhe në rrugën marksiste-leniniste në mes të dy partive.

Në bazë të dokumentit kinez, Partia Komuniste e Kinës thotë se këto mosmarrëveshje parimore kanë lindur fill që pas Kon-

gresit XX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe këto janë ngritur nga shokët kinezë. Disa janë marrë parasysh nga shokët sovjetikë, disa janë hedhur poshtë.

Partia e Punës e Shqipërisë mendon se për këto mosmarrëveshje, në rast se nuk zgjidheshin në mes të dy partive, duhej kërkuar organizimi i një mbledhjeje të partive komuniste dhe punëtorë, ku të shtroheshin këto çështje, të diskutoheshin dhe të mbahej qëndrim. Këto çështje s'është e drejtë që u lanë dhe faji u bie shokëve sovjetikë, që i dinin këto mosmarrëveshje, që s'i përfillnin, pse ata ishin të bindur në vijën e tyre dhe në «paprëshmërinë» e saj dhe kjo është pikëpamje idealiste dhe metafizike, mendojmë ne.

Në rast se shokët sovjetikë ishin të bindur për drejtësinë e vijës së tyre dhe të taktikës së tyre, përse nuk organizuan me kohë një mbledhje të tillë dhe të zgjidheshin këto mosmarrëveshje? A ishin të vogla çështjet që ngriheshin, si për shembull dënimi i J.V. Stalinit, çështja e madhe e kundërrevolucionit hungarez, çështja e formave të marrjes së pushtetit, dhe për të mos folur për shumë çështje të tjera shumë të rëndësishme siç dolën më vonë? Jo! S'ishin aspak të vogla. Të gjithë kemi pikëpamjet tona për këto probleme, pse të gjithëve si komunistë na interesojnë, pse të gjitha partitë tona janë përgjegjëse përpara popujve të tyre, por janë përgjegjëse edhe përpara komunizmit ndërkombëtar.

Për të dënuar Partinë Komuniste të Kinës për fajet dhe mëkatet imagjinare, shoku Hrushov dhe udhëheqësit e tjerë sovjetikë ishin shumë të interesuar që çështjet të shtroheshin sikur mosmarrëveshjet ishin në mes të Kinës dhe të gjithë komunizmit ndërkombëtar, por çështjet si ato që përmendëm më lart i ka gjykuar dhe vendosur vetëm shoku Hrushov e shokët e tij përreth, duke menduar se s'ka qenë nevoja të diskutoheshin në mënyrë kolegjiale nga një mbledhje e përfaqësuesve të të gjitha partive, megjithëse çështjet ishin me karakter të madh ndërkombëtar.

Ngjau kundërrevolucionin hungarez, por çështjet nuk u zbuluan. Pse kjo taktikë e mbylljes së gjërave, kur nuk u intereson shokëve sovjetikë, ndërsa kur u intereson atyre jo vetëm që organizojnë mbledhje si ajo e Bukureshtit, por bëjnë çmos që t'u imponojnë të tjerëve pikëpamjen se Kina «është në kundërshtim vije me të gjitha partitë komuniste dhe punëtorë të botës»?

Një përpjekje të tillë shokët sovjetikë bënë edhe ndaj nesh. Në muajin gusht të këtij viti udhëheqja sovjetike i drejtoi një letër Partisë sonë, me anën e së cilës na propozonte që «me qëllim që shkëndija e mosmarrëveshjeve të mos ndizet» të takoheshin përfaqësuesit e të dy partive tona, në mënyrë që Partia jonë të radhitej në anën e Bashkimit Sovjetik, kundër Partisë Komuniste të Kinës, dhe të dy partitë tona të shkonin në një front të bashkuar në këtë konferencë. Natyrisht, Komiteti Qendror i Partisë

sonë nuk e pranoi një gjë të tillë dhe në përgjigjen e tij zyrtare e konsideroi këtë si një punë aspak marksiste, si një veprim fraksionist të drejtuar kundër një partie të tretë motër, kundër Partisë Komuniste të Kinës. Sigurisht ky qëndrim i drejtë e parimor i Partisë sonë nuk i ka pëlqyer udhëheqjes së Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik.

Që këto çështje janë të një rëndësie të dorës së parë, kjo s'ka dyshim, që këto na interesojnë shumë të gjithëve, kjo s'ka dyshim, por s'ka aspak dyshim gjithashtu për Partinë e Punës të Shqipërisë që çështjet si u shtruan në Bukuresht kundër Kinës ishin tendencioze dhe kishin për qëllim të dënonin dhe të veçonin Partinë Komuniste të Kinës nga gjithë lëvizja komuniste ndërkombëtare.

Kjo për Partinë e Punës të Shqipërisë ishte e tmerrshme dhe e papranueshme, jo vetëm se ajo nuk ishte e bindur për një gjë të tillë, por dyshoi me të drejtë se po organizohej një veprim jo në rrugë marksiste kundër një partie motër të madhe e të lavdishme, siç është Partia Komuniste e Kinës, se po organizohej nën petkun e akuzës për dogmatizëm kundër Kinës një sulm kundër marksizëm-leninizmit dhe parimeve të Deklaratës dhe të Manifestit të paqes të Moskës.

Në mbledhje u akuzua Partia Komuniste e Kinës për shumë faje. Kjo duhej të pasqyrohej në komunikatë. Pse s'u bë? Në qoftë se akuzat ishin me baza, pse u hezitua dhe doli një komunikatë që s'i përgjigjej qëllimit të konferencës? Pse nuk u fol atje për «rrezikun e madh të dogmatizmit» që kërcënonte gjoja komunizmin ndërkombëtar?

Jo, shokë, Konferenca e Bukureshtit nuk mund të mbrohet, ajo s'ishte parimore, ajo ishte tendencioze për të arritur disa qëllime dhe qëllimi kryesor ishte, sipas mendimit të Partisë së Punës të Shqipërisë, që, duke u akuzuar Partia Komuniste e Kinës për dogmatizëm, të fshiheshin disa gabime të rënda në vijë, që i kanë lejuar vetes shokët udhëheqës sovjetikë.

Shokët sovjetikë kishin nevojë për përkrahjen e partive të tjera për këtë çështje. Prandaj tentuan hapur për t'i zënë ato në befasi. Shokët sovjetikë ja arritën një gjysmë qëllimi dhe fituan të drejtën të shtronin në partitë e tyre dënimin e Kinës, si frut i një «konference ndërkombëtare të komunizmit». Në partitë komuniste dhe punëtoare, me përjashtim të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të disa partive komuniste e punëtoare të tjera, u shtruan «gabimet e rënda në vijë të bëra nga ana e Partisë Komuniste të Kinës», u raportua dënimin «unanim» që u muar kundër Kinës në Bukuresht, u luftua për të krijuar opinionin në parti dhe në popull në këtë drejtim. Në disa nga këto mbledhje partie u dënua gjithashtu edhe Partia e Punës e Shqipërisë.

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë vendosi, dhe vendosi drejt, që pas Konferencës së Bukureshtit në Parti të

punonte vetëm komunikatën, t'i thoshte Partisë së tij se ekzistojnë divergjenca parimore në mes Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste të Kinës, të cilat duhet të shtrohen dhe të zgjidhen në konferencën e ardhshme që do të bëhet në nëntor në Moskë. Dhe kështu u bë.

Por ky qëndrim i Partisë sonë nuk u pëlqeu shokëve të udhëheqjes së Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, dhe këtë ne shumë shpejt filluam ta ndjejmë. Fill pas Bukureshtit, kundër Partisë sonë dhe Komitetit të saj Qendror filloi një sulm i papritur, joparimor, një ndërhyrje brutale dhe presion i gjithanshëm. Sulmin e filloi shoku Hrushov në Bukuresht dhe e vazhdoi shoku Kozllov në Moskë. Shokët e Byrosë Politike, që rastësisht kalonin nëpër Moskë, ju nënshtruan një përpunimi, me qëllim që të vihehin kundër udhëheqjes së Partisë sonë, duke ua shtruar çështjen se «udhëheqja e Partisë së Punës të Shqipërisë tradhëtoi miqësinë me Bashkimin Sovjetik», se «vija që ndjek udhëheqja e Partisë së Punës të Shqipërisë karakterizohet nga «zikzake», se «Shqipëria duhet të vendosë që të shkojë ose me 200 milionët (pra me Bashkimin Sovjetik) ose me 650 milionët (pra me Kinën popullore)» dhe më në fund se «e vetëmuar Shqipëria është në rrezik, se mjafton një bombë atomike të hidhet nga amerikanët dhe e shuan fare Shqipërinë dhe gjithë popullsinë e saj» e të tjera kërcënime të tilla. Është fare e qartë se qëllimi ka qenë që të krijohej përçarje në udhëheqjen e Partisë sonë, të eliminoheshin nga udhëheqja e Partisë së Punës të Shqipërisë ata elementë që udhëheqësit sovjetikë mendonin se i pengonin në ndërmarrjen e tyre të shtrembër e jo të ndershme.

Rezultat i kësaj pune përçarëse ishte kapitullimi i shoqes Liri Belishova, anëtare e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, përpara lajkave të udhëheqësve sovjetikë, përpara shantazheve dhe frikësimeve dhe vënja e saj në opozicion të hapët me vijën e Partisë.

Përpjekja që bëjnë shokët sovjetikë në letrën që i drejtojnë Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës për ta paraqitur këtë çështje sikur në Shqipëri po dënohen miqtë e Bashkimit Sovjetik është false. Miq për jetë të Bashkimit Sovjetik dhe të Partisë së tij Komuniste, miq për kokë të popujve sovjetikë kanë qenë, janë dhe do të jenë të një milion e gjysmë shqiptarët dhe Partia e Punës e Shqipërisë, që e ka farkëtuar dhe çelnikosur këtë miqësi të kalitur me gjak, dhe jo kapitullantët, përçarësit dhe deviatorët e ndryshëm.

Por përpjekjet për të ngjallur dyshime në qëndrimin e drejtë të Partisë sonë në Bukuresht nuk u kufizuan vetëm në Moskë. Ato u bënë, bile me zjarr të madh, edhe në Tiranë nga punonjës të Ambasadës Sovjetike me në krye vetë ambasadorin sovjetik në Tiranë.

Siç e thashë më lart, para Konferencës së Bukureshtit nuk mund të imagjinoheshin lidhje më të ngushta, më të sinqerta, më vëllazërore në mes nesh dhe shokëve sovjetikë. Nuk kishte asgjë të fshehtë për shokët sovjetikë nga ana jonë, qoftë të fshehta partie, qoftë shtetërore. Ky ishte vendimi i Komitetit tonë Qendror. Këto lidhje pasqyronin dashurinë dhe besnikërinë e madhe që kaliti me gjak Partia jonë në mes të popullit shqiptar dhe atij sovjetik.

Mbi këto ndjenja të shenjta të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të popullit tonë shkelën disa elementë të sëmurë, me ambasadorin sovjetik në krye. Ata, duke përfutur nga lidhjet miqësore, duke përfutur nga mirëbesimi i kuadrove, filluan me ethe dhe me intensitet të sulmonin vijën marksiste-leniniste të Partisë së Punës të Shqipërisë, të përçanin Partinë, të krijonin panik dhe konfuzion në radhët e saj, të ndanin udhëheqjen nga Partia, dhe puna arriti deri atje sa ambasadori sovjetik në Tiranë tentoi të nxiste gjeneralët e ushtrisë sonë për të ngritur Ushtrinë Popullore të Shqipërisë kundër udhëheqjes së Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të shtetit shqiptar. Por sharra u hasi në gozhdë, pse uniteti i Partisë sonë është i çeliktë. Kuadrot tanë, të kalitur në Luftën nacional-çlirimtare dhe në luftën e ashpër për jetë a për vdekje me revizionistët jugosllavë, mbrojtën në mënyrë marksiste Partinë e tyre heroike dhe ata dinë fare mirë të ndajnë Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik të Leninit nga përçarësit, dinë mirë të mbrojnë dhe të kalitin dashurinë dhe besnikërinë e tyre ndaj Bashkimit Sovjetik. Dhe në fakt këtyre denigruesve ua treguan vendin.

Punonjësit e Ambasadës Sovjetike në Tiranë, me ambasadorin në krye, arritën megjithkëtë që me anë të metodave të palejueshme e antimarksiste të bënin që kryetari i Komisionit të Revizionimit në Partinë e Punës të Shqipërisë, i cili 15 ditë më parë u tregua solidar me vijën e ndjekur nga Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë në Bukuresht, të bjerë në kthetrat e këtyre intrigantëve dhe të dalë plotësisht nga binarët e marksizëm-leninizmit dhe në kundërshtim flagrant me vijën e Partisë. Është e qartë se këto përpjekje të dënueshme të këtyre shokëve sovjetikë synonin të përçanin udhëheqjen e Partisë së Punës të Shqipërisë, ta ndanin atë nga masat e Partisë. Dhe kjo si dënim për «krimin» që bëmë ne në Bukuresht, për guximin që morëm për të shfaqur lirisht pikëpamjen tonë, ashtu siç e quanim ne të drejtë.

Në këtë rrugë funksionarët e Ambasadës Sovjetike në Tiranë vazhduan edhe më tej. Ata u sulën te njerëzit shqiptarë që kishin mbaruar studimet në Bashkimin Sovjetik për t'i nxitur kundër udhëheqjes shqiptare, duke menduar se ata ishin kontingjente të përshtatshme për qëllimet e tyre të shtrembëra. Por njerëzit

shqiptarë, qofshin ata që kanë mbaruar studimet në Bashkimin Sovjetik, qofshin ata që s'kanë mbaruar, që e donin, e duan dhe do ta duan kurdoherë me një dashuri të zjarrtë dhe me sinqeritet të pastër Bashkimin Sovjetik dhe Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, dinë e do të dinë se të tilla metoda të ulëta, që përdorin punonjësit e Ambasadës Sovjetike në Tiranë, janë krejt të huaja për Bashkimin Sovjetik dhe Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Njerëzit shqiptarë janë bijtë e popullit të vet, janë bijtë e Partisë së tyre, janë marksistë-leninistë, janë internacionalistë.

Mund të radhitim edhe shumë shembuj të tjerë, por për të mos i marrë shumë kohë kësaj mbledhjeje të rëndësishme do të përmend edhe dy raste të tjera tipike. Presionet mbi Partinë tonë vazhduan edhe në ditët kur këtu në Moskë ishte mbledhur komisioni për redaktimin e projektdeklaratës që na është paraqitur, kur shokët sovjetikë thoshin se duhet të shohim përpara dhe jo prapa. Ato ditë në Moskë, në një mbledhje të gjerë të shefave të shtatmadhorive të vendeve të Traktatit të Varshavës, anëtari i Komitetit Qendror dhe ministri i Bashkimit Sovjetik, marshali Malinovski, sulmoi hapur popullin shqiptar, Partinë e Punës të Shqipërisë, Qeverinë Shqiptare dhe udhëheqjen tonë. Ky sulm jomiqësor e publik është shumë i ngjashëm me sulmin diversionist të ambasadorit sovjetik në Tiranë, që kërkonte të nxiste Ushtrinë tonë Popullore kundër udhëheqjes së Partisë dhe të shtetit tonë. Por ashtu si edhe ambasadori sovjetik, gabohet shumë rëndë edhe marshali Malinovski. Askush nuk mund t'ja arrijë këtij qëllimi dhe aq më pak prishjes së miqësisë së popullit tonë me popujt e Bashkimit Sovjetik. Lufta e drejtë e Partisë së Punës të Shqipërisë kundër këtyre veprimeve minonjëse e forcon miqësinë e sinqertë të popullit tonë me popujt e Bashkimit Sovjetik dhe me Partinë e lavdishme Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Këtë miqësi nuk mund ta prishin as deklaratat e çuditshme të marshalit Greçko, kryekomandantit të Traktatit të Varshavës, i cili i tha delegacionit tonë ushtarak se jo vetëm paska vështirësi që të plotësojë nevojat e ushtrisë sonë me disa armatime shumë të nevojshme që parashikoheshin simbas kontratave të nënshkruara, por tha hapur se «ju hë për hë jeni në Traktatin e Varshavës», duke lënë të kuptohet se marshali Greçko paska vendosur të na nxjerrë jashtë. Por për fat të mirë nuk është shoku marshal që e vendos një gjë të tillë.

Në tetor të këtij viti shoku Hrushov, me seriozitetin më të madh, u deklaroi shokëve kinezë se «ne do ta trajtojmë Shqipërinë si Jugosllavinë». Ne ja themi këtë kësaj mbledhjeje të komunizmit ndërkombëtar me qëllim që të shihet se sa larg po shkojnë punët, se ç'qëndrime po mbahen kundër një vendi të vogël socialist. Cili është «krimi» i Partisë së Punës të Shqipërisë që vendi

ynë të trajtohet si Jugosllavia titiste? Mos vallë ne tradhëtuam marksizëm-leninizmin, siç bëri klika e Titos? Apo u larguam nga kampi socialist dhe u lidhëm me qerren e imperializmit amerikan, siç është lidhur revizionizmi jugosllav? Jo, dhe për këtë është dëshmitare gjithë lëvizja komuniste ndërkombëtare, për këtë është dëshmitare gjithë veprimtaria konkrete politike, ideologjike dhe ekonomike e Partisë dhe e shtetit tonë gjatë gjithë Luftës nacional-çlirimtare dhe gjatë këtyre 16 vjetëve që nga çlirimi i atdheut, për këtë dëshmon edhe vetë Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, i cili në letrën drejtuar Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë më datën 13 gusht 1960 thekson: «Marrëdhënjet midis Partisë së Punës të Shqipërisë e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, të bazuara në parimet e internacionalizmit proletar, kanë qenë gjithnjë me të vërtetë vëllazërore. Miqësia midis partive dhe popujve tanë nuk është errësuar asnjëherë nga ndonjë mosmarrëveshje ose largim. Pozitat e Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik mbi të gjitha çështjet më të rëndësishme të lëvizjes komuniste dhe punëtore ndërkombëtare dhe të politikës së jashtme janë përputhur». Atëhere cili është faji ynë? «Krimi» ynë i vetëm është se ne në Bukuresht nuk pranuan të dënohej padrejtësisht një parti motër komuniste siç është Partia Komuniste e Kinës, «krimi» ynë i vetëm është se ne hapur dhe në një mbledhje komuniste ndërkombëtare (dhe jo në pazar) patëm guximin të kundërshtojmë veprimin e padrejtë të shokut Hrushov, «krimi» ynë i vetëm është se ne jemi një Parti e vogël e një populli të vogël dhe të varfër, i cili, sipas pikëpamjes së shokut Hrushov, vetëm duhet të duartrokasë, të aprovojë dhe të mos shfaqë mendim. Por kjo nuk është as marksiste, as e pranueshme. Të drejtën që të themi fjalën tonë na e ka dhënë marksizëm-leninizmi dhe këtë të drejtë ne nuk mund të na e heqë askush, as me presione politike apo ekonomike, as me kërcënime apo epitete që mund të na ngjiten. Me këtë rast donim të pyesnim shokun Hrushov: pse një deklaratë të tillë nuk na e bëri neve, por një përfaqësuesi të një partie të tretë? Apo shoku Hrushov mendon se Partia e Punës e Shqipërisë nuk ka pikëpamjet e saj, por ka bërë kauzë të përbashkët me Partinë Komuniste të Kinës në mënyrë të paprincipitë dhe prandaj për çështjet e Partisë sonë mund të bisedohet me shokët kinezë? Jo, shoku Hrushov, ju vazhdoni të gaboni dhe të kini pikëpamje shumë të këqia për Partinë tonë. Partia e Punës e Shqipërisë ka pikëpamjet e saj dhe për to përgjigjet si përpara popullit të saj, ashtu edhe përpara lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare.

Ne jemi të detyruar t'i njoftojmë kësaj mbledhjeje se në fakt udhëheqja sovjetike nga kërcënimet për ta trajtuar Shqipërinë si Jugosllavinë titiste ka kaluar në veprime konkrete. Sivjet në ven-

din tonë na kanë ngjarë shumë fatkeqësi të natyrës. Tërmet i madh ra te ne, në tetor pati përmytje, por sidomos thatësira ka qenë e tmerrshme, 120 ditë vazhdimisht nuk ra një pikë shi. Gati i gjithë drithi u dogj. Popullin e kërcënonte uria. Rezervat shumë të pakta u konsumuan. Qeveria jonë i kërkoi të blente me urgjencë bukë Bashkimit Sovjetik, duke i shpjeguar situatën shumë të rëndë. Kjo ngjau pas Mbledhjes së Bukureshtit. Ne pritëm 45 ditë përgjigje nga Qeveria Sovjetike, kurse për popullin kishim vetëm 15 ditë bukë. Pas 45 ditësh dhe pas disa kërkesave të përsëritura zyrtare Qeveria Sovjetike, nga 50 mijë ton që i kërkuam, na akordoi vetëm 10 mijë ton, që do të thotë 15 ditë bukë, dhe këtë sasi do të na i livronte në muajt shtator-tetor. Ky ishte presion i hapët mbi Partinë tonë për t'ju përlurur vullnetit të shokëve sovjetikë.

Në ato ditë të vështira ne provuam shumë gjëra. A s'kishte Bashkimi Sovjetik, që i shet drithë gjithë botës, t'i jepte popullit shqiptar, besnik e vëlla i popullit sovjetik, besnik i marksizëm-leninizmit dhe i kampit të socializmit, 50 mijë ton drithë, në një kohë kur jo për fajin e tij e kërcënonte uria? Shoku Hrushov na kishte thënë dikur: «mos u bëni merak për bukë, çka ju konsumoni në një vit, te ne e hanë minjtë». Minjtë në Bashkimin Sovjetik, pra, mund të hanin, por populli shqiptar le të vdiste nga uria, deri sa udhëheqja e Partisë së Punës të Shqipërisë t'i nënshtrohej vullnetit të udhëheqjes sovjetike. Kjo është e tmerrshme, shokë, por kështu është. Populli sovjetik nuk do t'ua falë këtë, në qoftë se e merr vesh, pse kjo s'është as marksiste, as internacionaliste, as shoqërore. As miqësore nuk është gjithashtu që të mos pranohet kleringju ynë për të blerë bukë në Bashkimin Sovjetik, dhe të detyroheshim të nxirrnim rezervën e vogël të floririt të Bankës sonë kombëtare për të blerë misër për bukën e popullit në Bashkimin Sovjetik.

Këto veprime janë të lidhura me njëri-tjetrin; ato nuk janë diçka e rastit. Veçanërisht ditët e fundit sulmet e shokut Hrushov kundër Partisë sonë të Punës kanë arritur kulmin. Ju, shoku Hrushov, më datën 6 nëntor deklaruat se «shqiptarët sillen me ne ashtu siç sillte Titua me ne». Ju u thatë shokëve kinezë «se ne humbëm një Shqipëri, kurse ju kinezët fituat një Shqipëri». Dhe më 11 fund deklaruat se Partia e Punës e Shqipërisë është hallka jonë e dobët.

Ç'janë këto akuza monstruoze, këto trajtime prej «tregëtari» ndaj Partisë sonë, popullit tonë dhe një vendi socialist, i cili u humbka dhe u fituoka si një lojë bixhozi? Ç'janë këto konsiderata për një Parti motër, e cila, sipas jush, qenka hallkë e dobët në lëvizjen komuniste ndërkombëtare? Ne e kemi të qartë dhe e kuptojmë fare mirë se qëndrimi ynë i drejtë e parimor marksist-leninist, se guximi ynë për të mos rënë dakord dhe për të dënuar

ato veprime tuaja që janë të shtrembëra ju shtyn të sulmoni Partinë tonë, të bëni gjithfarë presionesh kundër saj, të thoni edhe monstrozitetet më ekstreme në adresë të Partisë sonë. Por këtu nuk ka asgjë shoqërore, asgjë komuniste. Ju na krahasoni ne me revizionistët jugosllavë. Por të gjithë e dinë se si ka luftuar e lufton kundër revizionistëve jugosllavë Partia jonë. Nuk jemi ne që veprojmë si jugosllavët, por jeni ju, shoku Hrushov, që po përdorni kundër Partisë sonë metoda që janë të huaja për marksizëm-leninizmin. Ju e konsideroni Shqipërinë si plaçkë tregu, që mund të fitohet ose të humbitet nga njëri apo nga tjetri. Ka qenë një kohë kur Shqipëria konsiderohej si plaçkë tregu, kur të tjerët mendonin se varej nga ata nëse Shqipëria do të ekzistonte apo jo, por ajo kohë ka marrë fund qysh me triumfin e ideve të marksizëm-leninizmit në vendin tonë. Ju po përsërisni të njëjtën gjë, derisa arritët në përfundimin se «e humbët» Shqipërinë ose se dikush tjetër e «fitoi» atë dhe se Shqipëria nuk është më vend socialist, siç del nga letra që na dorëzuar më 8 nëntor, ku nuk përmendet vendi ynë si vend socialist.

Faktin që Shqipëria ecën në rrugën e socializmit dhe bën pjesë në kampin e socializmit nuk e përcaktoni ju, shoku Hrushov, kjo nuk varet nga dëshira juaj. Këtë e ka vendosur populli shqiptar me Partinë e tij të Punës në krye, me luftën e tij, dhe nuk ka forcë që ta largojë atë nga kjo rrugë.

Përsa i përket çështjes se Partia jonë e Punës qenka hallka më e dobët në kampin socialist dhe në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, ne themi se historia njëzetvjeçare e Partisë sonë, lufta heroike e popullit dhe e Partisë sonë kundër pushtuesve fashistë dhe 16 vjetët që nga çlirimi e këtej, gjatë së cilës Partia dhe populli ynë i vogël u kanë bërë ballë të gjitha furtunave, tregojnë të kundërtën. E rrethuar nga armiq, si ishull në mes të dallgëve, Republika Popullore e Shqipërisë u ka qëndruar me guxim të gjitha sulmeve dhe provokacioneve të imperialistëve dhe shërbëtorëve të tyre. Ajo si shkëmb graniti ka mbajtur dhe mban lart flamurin e socializmit në prapavijat e armikut. Ju, shoku Hrushov, ngritët dorën kundër popullit tonë të vogël dhe Partisë së tij, por ne jemi të bindur se populli sovjetik, i cili ka derdhur gjak edhe për lirinë e popullit tonë, se Partia e madhe e Leninit nuk do të jenë dakord me këtë veprim tuajin. Ne kemi besim të plotë në marksizëm-leninizmin, ne jemi të sigurt se partitë motra, të cilat kanë dërguar përfaqësuesit në këtë mbledhje, do ta shikojnë dhe do ta gjykojnë këtë çështje me drejtësinë marksiste-leniniste.

Partia jonë e ka quajtur kurdoherë Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik si parti mëmë, dhe këtë e ka thënë pse ajo është partia më e vjetër, partia e lavdishme e bolshevikëve, e ka thënë për eksperiencën e saj universale, për pjekurinë e saj të madhe. Por Partia jonë kurrë nuk ka pranuar dhe kurrë nuk do të

pranojë që ndonjë udhëheqës sovjetik t'i imponojë asaj pikëpamjet e tij që ajo i gjykon të gabuara.

Udhëheqja sovjetike e shikoi këtë çështje me rëndësi parimore krejt gabim, në mënyrë idealiste dhe metafizike; asaj i është rritur mendja nga sukseset kolosale të arritura nga popujt sovjetikë dhe Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik dhe shkel parimet marksiste-leniniste, e quan veten të pagabueshme, e quan të pagabueshëm dhe të palëvizshëm çdo vendim, çdo veprim, çdo fjalë dhe çdo gjest të saj. Të tjerët mund të gabojnë, të tjerët janë të dënueshëm, kurse ajo jo. «Vendimet tona janë të shenjta, ato janë të paprekshme», «Asnjë lëshim, asnjë kompromis nuk mund t'i bëjmë ne Partisë Komuniste të Kinës», u thoshin njerëzve tanë udhëheqësit e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Atëhere përse po na mbledhnin në Bukuresht? Sigurisht të votonim me sy mbyllur për pikëpamjet e udhëheqjes sovjetike. A është marksiste kjo? A është normale kjo?

A mund të lejohen akte diversioni në një parti nga një parti tjetër për të përçarë unitetin, për të rrëzuar udhëheqjen e një partie ose të një shteti tjetër? Kurrresi! Udhëheqësit sovjetikë akuzuan shokun Stalin gjoja për ndërhyrje në partitë e tjera dhe për t'ju imponuar të tjerëve pikëpamjet e Partisë Bolshevike. Ne mund të dëshmojmë se asnjëherë nuk e bëri shoku Stalin një gjë të tillë kundër nesh, ai në çdo kohë u suall me popullin shqiptar dhe me Partinë e Punës të Shqipërisë si një marksist i madh, si një internacionalist i shquar, si një shok, vëlla dhe mik i sinqertë i popullit shqiptar. Shoku Stalin në 1945, kur populli ynë rrezikohej nga uria, i ktheu nga rruga vaporët me bukë, që ishin destinuar për popullin sovjetik, që atëhere gjithashtu ishte keq për bukë, dhe ja dërgoi menjëherë popullit shqiptar. Kurse udhëheqja e sotme sovjetike i lejoi vetes veprime të shëmtuara.

A mund të lejohen të atilla presione ekonomike, a mund të lejohet që të kërcënohet populli shqiptar, siç bëri udhëheqja sovjetike pas Bukureshtit? Në asnjë mënyrë. Bashkimi Sovjetik na ka ndihmuar kurdoherë në mënyrë bujare, me kredi e me çfarëdo gjërash. Shqipëria e re nuk mund të ndërtohej pa këtë ndihmë të Bashkimit Sovjetik, në radhë të parë, dhe të vendeve të tjera të demokracisë popullore.

Ne themi të drejtën dhe i jemi shumë mirënjohës Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik e Qeverisë Sovjetike për ndihmat e mëdha që i kanë dhënë vendit tonë për të ngritur industrinë, për të mëkëmbur bujqësinë, me një fjalë për të përmirësuar jetën e popullit tonë dhe për shpejtimin e ndërtimit të socializmit. Ne e dimë se kjo ndihmë, që i jepet popullit tonë të vogël, i cili para luftës vuante në mjerim të madh nga çdo pikëpamje dhe që Lufta e dytë botërore e dogji, e shkatërroi vendin tonë, por nuk e përkuli popullin shqiptar, i cili nën udhëheqjen e

lavdishme të Partisë Komuniste Shqiptare luftoi me heroizëm të madh dhe u çlirua, është një ndihmë internacionaliste.

Por pse ndryshoi qëndrimi i udhëheqjes sovjetike ndaj nesh pas Bukureshtit, derisa ta linin popullin shqiptar të vuante nga uria? Këtë gjë e bëri edhe udhëheqja rumune, e cila nuk dëgjoi t'i jepte me klering asnjë kokërr grurë popullit tonë, në një kohë kur Rumania bën tregëti me drithëra me vendet kapitaliste dhe ne u detyruam të blejmë misër me valutë nga fermerët francezë.

Disa muaj përpara Konferencës së Bukureshtit, shoku Dezh ftoi apostafat një delegacion të Partisë sonë për të biseduar për zhvillimin në perspektivë të Shqipërisë. Ky ishte një preokupim i lavdërueshëm dhe marksist. Shoku Dezh i tha Partisë sonë se «ne, vendet e tjera të demokracisë popullore, nuk duhet më të diskutojmë se duhet t'i jepet Shqipërisë kaq ose aq kredi, por se në Shqipëri duhet të vendoset të ndërtohen këto e këto fabrika, të ngrihen në një shkallë të lartë mjetet e prodhimit, pa sa milion rubla kushtojnë këto, kjo s'ka rëndësi». Këtë gjë, tha shoku Dezh, «e kemi biseduar edhe me shokun Hrushov dhe kemi qenë dakord».

Por erdhi Mbledhja e Bukureshtit dhe Partia jonë mbajti qëndrimin që dihet. Shokët rumunë harruan ç'kishin thënë më parë dhe zgjodhën rrugën e lënjes së popullit shqiptar të vuante nga uria.

Këto gjëra ne ja kemi bërë të njohura më parë zyrtarisht Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, këto gjëra ne nuk i kemi shtruar as i kemi diskutuar pazarit, as vesh në vesh, por po i themi për herë të parë në një mbledhje partie. siç është mbledhja jonë e sotme. Përse atëhere i shtrojmë ne këto çështje? Ne nisemi nga qëllimi që t'u jepet fund këtyre shfaqjeve negative, të cilat nuk e forcojnë, por e dobësojnë unitetin tonë. Ne nisemi nga dëshira që midis partive komuniste e punëtore, midis shteteve socialiste të forcohen marrëdhënjet dhe lidhjet marksiste-leniniste, duke flakur tej çdo shfaqje të keqe që ka lindur deri tani. Ne jemi optimistë dhe kemi bindje të plotë e besim të patundur se shokët sovjetikë, si edhe shokët e tjerë, kritikantë tona i kuptojnë drejt, ato janë të ashpra, por të hapëta dhe të sinqerta dhe synojnë në forcimin e marrëdhënjeve tona. Partia dhe populli ynë, pavarësisht nga këto qëndrime të padrejta dhe të dëmshme që mbahen ndaj nesh, të cilat ne kemi besim se do të ndalohen në të ardhshmen, do të çelënikosin edhe më shumë dashurinë dhe besnikërinë e pafund ndaj popujve sovjetikë, Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, ndaj popujve dhe partive komuniste e punëtore të kampit të socializmit, kurdoherë duke pasur në themel mësimet marksiste-leniniste.

Miqësinë Partia jonë e kupton vetëm në drejtësi, në respektin reciprok në baza marksiste-leniniste. Kështu thuhet në Deklara-

tën e Moskës të vitit 1957, kështu theksohet edhe në projektdeklaratën që na është paraqitur. Ne deklarojmë me seriozitetin më të madh se Partia e Punës e Shqipërisë dhe populli shqiptar do të jenë si gjithnjë luftëtarë të vendosur për forcimin e marrëdhënjeve dhe të unitetit të kampit socialist dhe të lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Për miqtë me kokë populli shqiptar hidhet në zjarr dhe në radhë të parë Bashkimi Sovjetik është i tillë mik për popullin shqiptar. Dhe këto s'janë fjalë boshe të miat, por unë shpreh këtu ndjenjat e popullit tim dhe të Partisë sime dhe duhet të dihet mirë se Bashkimin Sovjetik dhe Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik nuk e duam për sytë e bukur të ndonjërit, apo për t'i bërë qejfin ndonjë personi, por sepse pa Bashkimin Sovjetik s'do të kishte sot jetë të lirë në botë aktualisht, por do të sundonte fashizmi dhe tmerrri kapitalist. Ja pse e duam dhe do t'i qëndrojmë për jetë besnikë Bashkimit Sovjetik dhe Partisë së Leninit të madh.

Të dashur shokë,

Në Deklaratën e Moskës të vitit 1957, si dhe në projektin e deklaratës që na është paraqitur, konstatohet se revizionizmi përbën sot rrezikun kryesor në lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare. Në Deklaratën e Moskës të vitit 1957 theksohet me të drejtë se burimi i brendshëm i revizionizmit është ekzistenca e influencës borgjeze, kurse kapitullimi përpara presionit të imperializmit është burimi i tij i jashtëm. Jeta ka vërtetuar plotësisht se revizionizmi modern, i maskuar nën parulla pseudomarksiste e revolucionare, me të gjitha mjetet është përpjekur të diskreditojë doktrinën tonë të madhe, marksizëm-leninizmin, të cilën e ka shpallur si «të vjetëruar» dhe që nuk i përgjigjet më zhvillimit shoqëror. Duke u fshehur prapa parullës së marksizmit krijues, të kushteve të reja, revizionistët janë përpjekur, nga njëra anë, të hedhin poshtë frymën revolucionare të marksizmit dhe të minojnë besimin e klasës punëtore dhe të popullit punonjës ndaj socializmit dhe, nga ana tjetër, me të gjitha mjetet kanë punuar që të zbukurojnë imperializmin, ta paraqesin atë si të zbutur e paqesor. Të tre vjetët që kanë kaluar, qysh nga Konferenca e Moskës, kanë vërtetuar plotësisht se revizionistët modernë nuk janë tjetër veçse përçarës të lëvizjes komuniste dhe të kampit të socializmit, shërbëtorë besnikë të imperializmit, armiq të vendosur të socializmit dhe të klasës punëtore.

Flamurtarë të revizionizmit modern, përfaqësuesit më agresivë dhe më të rrezikshëm të tij, siç ka treguar deri tani vetë jeta, janë revizionistët jugosllavë, klika tradhëtare e Titos me shokë. Në kohën kur u aprovua Deklarata e Moskës, megjithëse për mendimin tonë kishte fakte dhe të dhëna të mjaftueshme, ky grup armiqësor dhe kjo agjenturë e imperializmit amerikan nuk u denon-

cua publikisht. Dhe jo vetëm kaq, por edhe më vonë, kur filloi të duket më qartë rrezikshmëria e tij, lufta kundër revizionizmit jugosllav, lufta konsekuente dhe e pandërprerë për shkatërrimin e tij ideologjik e politik nuk është bërë me forcën e duhur. Përkundrazi. Dhe kjo ka qenë dhe është burimi i shumë të këqiave e dëmeve në lëvizjen tonë komuniste e punëtore ndërkombëtare. Si-pas pikëpamjes së Partisë sonë, në mosdemaskimin total të grupit revizionist të Titos, në mbjelljen e «shpresave» false për një gjoja «përmirësim» dhe «kthesë» pozitive të këtij grupi tradhëtar ka influencuar prirja pajtuese, pikëpamja e gabuar dhe vlerësimi jo i drejtë nga ana e shokut Hrushov dhe e disa udhëheqësve të tjerë sovjetikë për grupin e rrezikshëm revizionist titist.

Është thënë se, në vlerësimin e revizionistëve jugosllavë si edhe në ashpërsimin e qëndrimit ndaj tyre, ka gabuar J. V. Stalini. Partia jonë asnjëherë nuk ka qenë dakord me një pikëpamje të tillë, sepse koha dhe jeta ka vërtetuar të kundërtën. Stalini shumë drejt e ka vlerësuar rrezikun e revizionistëve jugosllavë, ai është përpjekur ta zgjidhë në kohën e duhur dhe në rrugën marksiste këtë çështje: u mblodh Informbyroja, si organ kolegjal në atë kohë, dhe pas demaskimit të grupit titist ju bë një luftë e pamëshirshme këtij grupi. Koha përsëri vërtetoi dhe vërteton se një gjë e tillë ishte e domosdoshme dhe e drejtë.

Partia e Punës e Shqipërisë ka qenë kurdoherë e mendimit dhe është e bindur se grupi i Titos është tradhëtar i marksizëm-leninizmit, agjenturë e imperializmit, armik i rrezikshëm i kampit socialist dhe i gjithë lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare, prandaj kundër tij duhet zhvilluar një luftë e pamëshirshme. Nga ana jonë ne e kemi bërë dhe e bëjmë këtë luftë si komunistë internacionalistë dhe sepse ne mbi kurrizin tonë e kemi ndjerë dhe e ndjejmë për ditë peshën e veprimtarisë armiqësore të klikës revizioniste të Titos kundër Partisë dhe vendit tonë. Por ky qëndrim i Partisë sonë nuk i ka pëlqyer dhe as i pëlqen shokut Hrushov e disa shokëve të tjerë.

Grupi titist është një grup trockistësh dhe renegatësh prej shumë kohe. Të paktën për Partinë e Punës të Shqipërisë ai është i tillë që prej vitit 1942, domethënë 18 vjet më parë.

Që në vitin 1942, kur lufta e popullit shqiptar mori një hov të madh, grupi trockist i Beogradit, nën maskën e miqësisë dhe në mirëbesimin tonë, u përpoq me të gjitha mjetet të pengonte zhvillimin e luftës sonë të armatosur, u përpoq të pengonte krijimin e reparteve të fuqishme sulmuese partizane shqiptare dhe, në pamundësi t'i ndalonte, u përpoq të merrte drejtpërdrejt drejtimin e tyre politik dhe ushtarak. Ai tentoi që çdo gjë të varej nga Beogradi dhe Partia jonë, ushtria jonë partizane të ishin apendise të thjeshta të Partisë Komuniste Jugosllave dhe të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare Jugosllave.

Partia jonë, duke e ruajtur miqësinë me partizanët jugosllavë, u bëri ballë me sukses këtyre qëllimeve djallëzore. Që në atë kohë grupi titist përpiquej të vinte themelet e Federatës Ballkanike, nën drejtimin e titistëve të Beogradit, të lidhte partitë komuniste pas qerres së Partisë Komuniste Jugosllave, të bënte që ushtritë partizane të popujve të Ballkanit të ishin nën vartësinë e shtabit titist jugosllav. Për këtë qëllim ai, dakord që në atë kohë me anglezët, u përpoq të krijonte shtabin ballkanik dhe ta lidhte e ta vinte atë, domethënë ushtritë tona, nën drejtimin e anglo-amerikanëve. Partia jonë u rezistoi me sukses këtyre planeve djallëzore. Dhe kur valoi flamuri i çlirimit në Tiranë, banda titiste e Beogradit u dha urdhër agjentëve të saj në Shqipëri të diskreditonin suksesin e Partisë Komuniste Shqiptare dhe të organizonin puçin⁵¹ për të rrëzuar udhëheqjen e Partisë, atë që organizoi Partinë, që udhëhoqi Luftën nacional-çlirimtare dhe që e çoi popullin shqiptar në fitore. Dhe puçi i parë u organizua nga Titua, tok me agjentët e tij të fshehtë në Partinë tonë. Por komplotin e Titos e shkatërroi Partia Komuniste Shqiptare.

Komplotistët e Beogradit s'i hodhën armët dhe tok me krye-agjentin e tyre në Partinë tonë, tradhëtarin Koçi Xoxe, vazhduan riorganizimin e komplotit kundër Shqipërisë së re me forma të tjera, me forma të reja. Qëllimi ishte: Shqipëria të bëhej republikë e shtatë e Jugosllavisë.

Në një kohë kur vendi ishte i shkatërruar dhe i djegur e duhej rindërtuar nga e para, kur populli ishte pa bukë e pa strehë, por me një moral të lartë, kur popull e ushtri me armë në dorë bënin roje vigjilente kundër kompleteve të reaksionit që organizoheshin nga misionet anglo-amerikane dhe që e kërcënonin Shqipërinë e re me invazione të reja, kur një pjesë e madhe e ushtrisë partizane shqiptare kapërceu kufirin e atdheut dhe u vajti në ndihmë vëllezërve jugosllavë, luftonte krah për krah me ta dhe së bashku çlironin Malin e Zi, Bosnjën, Hercegovinën, Kosovën e Metohinë, Maqedoninë, komplotistët e Beogradit kurdisnin plane për të robëruar Shqipërinë.

Por Partia jonë u bëri ballë heroikisht këtyre agjentëve të fshehur nën maskën e komunistit. Kur panë trockistët e Beogradit se e humbën davanë, se komplotet po ua shkatërronte Partia jonë, provuan kartën e fundit: të invadonin Shqipërinë me ushtritë e tyre, të mbysnin rezistencën, të arrestonin udhëheqësit e Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të shtetit shqiptar dhe ta deklararin Shqipërinë republikë të shtatë të tyre. Partia e prishi edhe këtë plan djallëzor të tyre. Ndihma dhe ndërhyrja e J. V. Stalinit në ato çaste që vendimtare për Partinë tonë dhe për lirinë e popullit shqiptar. Ishte tamam koha e demaskimit të klikës së Titos nga Informbyroja. Stalini dhe Bashkimi Sovjetik e shpëtuan për të dytën herë popullin shqiptar.

Byroja Informative bëri të dështojnë veprimet komplotiste të klikës së Titos jo vetëm në Shqipëri, por edhe në vendet e tjera të demokracisë popullore. Renegati dhe agjenti i imperializmit, Titua dhe banda e tij, duke vepruar nën maskën e komunistëve, u përpoqën të shkëpusnin vendet e demokracisë popullore të Ballkanit dhe të Evropës Qendrore nga miqësia dhe aleanca e luftës me Bashkimin Sovjetik, të shkatërronin partitë komuniste dhe punëtoresh të vëndeve tona dhe t'i shndërronin shtetet tona në rezervë të imperializmit anglo-amerikan.

Kush ishte ai që nuk i dinte dhe nuk i pa në veprim këto plane armiqësore të imperializmit dhe të shërbëtorit të tij besnik Tito? Të gjithë i dinin, të gjithë i mësuan dhe të gjithë njëzëri aprovuan vendimet e drejta të Byrosë Informative, të gjithë aprovuan, pa përjashtim, rezolutat e Byrosë Informative, të cilat pa përjashtim ishin dhe mbetën të gjitha të drejta, sipas pikëpamjes sonë.

Ata që s'deshën t'i shihnin, e t'i kuptonin këto veprime të kësaj bande kriminelësh provuan për të dytën herë me kundërrivolucionin në Hungari dhe me komplotet e parreshtura në Shqipëri se ujku qimen ndërrohet, por prapë ujku mbetet, se Titua dhe banda e tij mund të bëjnë dredhira, mund të vënë maska, por prapë trathëtarë, kriminelë dhe agjentë të imperializmit, vrasës të komunistëve heroikë internacionalistë jugosllavë mbeten, veprimet dhe kështu do të jenë, deri sa të zhduken.

Vendimet e marra kundër grupit renegat të Titos nga Informbyroja Partia e Punës e Shqipërisë nuk i konsideron të marra personalisht nga shoku Stalin, por nga të gjitha partitë që bënin pjesë në Byronë Informative. Por jo vetëm prej këtyre partive, pjesëtare të Byrosë Informative, por edhe nga partitë komuniste dhe punëtoresh që s'bënin pjesë në Informbyro. Si një çështje që u përkiste të gjitha partive komuniste dhe punëtoresh, ajo i përkiste, pra, edhe Partisë së Punës të Shqipërisë, e cila, duke pasë marrë e studjuar letrën drejtuar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Jugosllave nga Stalini dhe Molotovi, ishte treguar plotësisht solidare me këtë letër dhe me vendimet e Informbyrosë.

Pse, pra, «kthesa» që u bë nga ana e shokut Hrushov dhe e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik më 1955 ndaj revizionistëve jugosllavë nuk u bë çështje e një konsultimi të rregullt me partitë e tjera komuniste e punëtoresh, por u konceptua e u zbatua në mënyrë aq të shpejtë dhe të njëanshme? Kjo ishte një çështje që na përkiste të tërëve. Revizionistët jugosllavë o ishin vënë në luftë kundër marksizëm-leninizmit dhe partive komuniste e punëtoresh të botës, o nuk ishin vënë; o ata kishin gabuar, ose kishim gabuar ne kundrejt tyre dhe jo vetëm Stalini. Këtë gjë s'mund ta zgjidhte dhe s'lejohej ta zgjidhte vetëm me dëshirën e tij shoku Hrushov. Por ky në fakt kështu bëri dhe kthesën

në marrëdhënjet me revizionistët jugosllavë e lidhte me vajtjen e tij në Beograd. Partisë së Punës të Shqipërisë kjo i ra si bombë e papritur dhe ajo e kundërshtoi menjëherë kategorikisht. Para nisjes së shokut Hrushov për në Beograd, në maj të vitit 1955, Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë i drejtoi një letër Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, ku i shfaqte kundërshtimin e Partisë sonë për vajtjen e tij në Beograd, duke theksuar se çështja jugosllave nuk mund të zgjidhej në mënyrë të njëanshme, por duhej të mblidhej Byroja Informative, ku kërkonim të merrte pjesë si e ftuar edhe Partia e Punës e Shqipërisë. Atje të vendosej kjo çështje, pasi të diskutohej gjatë dhe drejt.

Sigurisht në formë ne s'kishim të drejtë të vendosnim nëse duhej të vinte shoku Hrushov në Beograd ose jo dhe për këtë ne u tërhoqëm, por në esencë dhe që çështja jugosllave nuk duhej zgjidhur kështu në këmbë ne kishim të drejtë dhe koha këtë e vërtetoi.

U hodh parulla e «mbishtresave», u hoq me të shpejtë rezolucioni i dytë i Byrosë Informative, u hap «epoka e pajtimit» me «shokët jugosllavë», u rishikuan e u rehabilituan komplotistët, «shokët jugosllavë» andej, «shokët jugosllavë» këtej dhe «shokët jugosllavë» na dolën të larë, u ngrehën si gjela, trumbetuan se «çështja e tyre e drejtë» triumfoi, se «kriminelin Stalin» i kishte kurdisur të gjitha këto dhe u krijua situata që ai që nuk ecte në këtë rrugë të re, ishte «stalinist» dhe duhej likuiduar.

Partia jonë nuk e pranoi një rrugë të tillë pajtuese dhe oportuniste. Ajo qëndroi në pozitë e drejta ideologjike marksiste-leniniste, në pozitë e luftës ideologjike dhe politike me revizionistët jugosllavë. Partia e Punës e Shqipërisë qëndroi e patundur në pikëpamjet e veta se grupi titist ishte tradhëtar, renegat, trockist, diversionist dhe agjenturë e amerikanëve, se Partia e Punës e Shqipërisë nuk kishte gabuar ndaj tij.

Partia e Punës e Shqipërisë qëndroi e patundur në pikëpamjen se shoku Stalin nuk kishte gabuar në këtë çështje, se revizionistët me vijën e tyre tradhëtare ishin përpjekur të skllavëronin Shqipërinë, të shkatërronin Partinë e Punës të Shqipërisë dhe me kurdisjen nga ata të një sërë komplotesh ndërkombëtare me imperialistët anglo-amerikanë kërkonin ta fusnin Shqipërinë në konflikte ndërkombëtare.

Partia e Punës e Shqipërisë ishte, nga ana tjetër, dakord që me Republikën Federative Popullore të Jugosllavisë të vendoste marrëdhënje shtetërore të fqinjësisë së mirë, marrëdhënje tregëtare dhe kulturele, në rast se respektoheshin normat e bashkekzistencës paqësore në mes të shteteve me regjime të ndryshme, pse për Partinë e Punës të Shqipërisë Jugosllavia titiste s'ka qenë, s'është dhe s'do të jetë kurrë një vend socialist, deri sa të ketë në krye grupin renegat dhe agjent të imperializmit.

Asnjë tentativë e hapët ose e maskuar nuk e përuli Partinë e

Punës të Shqipërisë nga këto qëndrime të drejta. Më kot u lodh Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, nëpërmjet shokut Suslov, të na bindte ne që në raportin e Kongresit tonë III që u mbajt në maj 1956, të zhdukim çështjen e Koçi Xoxes, që do të thoshte të mohonim luftën dhe qëndrimet tona parimore.

Në Shqipëri titistëve u hasi sharra në gozhdë, ose, si thotë Titua, «Shqipëria ju bë ferrë në këmbë» dhe natyrisht grupi tradhëtar titist e vazhdoi luftën kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe mendonte se na demaskonte duke na cilësuar «stalinistë».

Grupi i Beogradit s'na luftoi vetëm me propagandë, por ai vazhdoi spiunazhin, diversionin, komplotet, dërgimin e bandave të armatosura në vendin tonë dhe vepronte më fort se para vitit 1948. Këto janë të faktuara. Por tragjedia qëndron këtu, që Partia e Punës e Shqipërisë, nga një anë, ishte në mbrojtje kundër sulmeve të ashpra dhe të paprera të revizionistëve jugosllavë, nga ana tjetër, qëndrimi i patundur, parimor, marksist-leninist i Partisë sonë ishte në kundërshtim me qëndrimet pajtuese që mbaheshin ndaj revizionistëve jugosllavë nga ana e udhëheqësve sovjetikë dhe të disa partive të tjera komuniste e punëtore.

Atëhere me të madhe thuhej e shkruhej se «Jugosllavia është një vend socialist dhe ky është një fakt», se «komunistët jugosllavë kanë një eksperiencë të madhe dhe merita të mëdha», se «eksperiencia jugosllave është e denjë për interesimin më të madh dhe për ta studjuar me vëmendje», se «periudha e grindjeve dhe e keqkuptimeve nuk ishte shkaktuar nga Jugosllavia dhe se i qe bërë asaj një padrejtësi e madhe» etj., etj. Këto qëndrime, natyrisht, i dhanë zemër klikës së Titos, e cila kujtoi se çdo gjë e fitoi, vetëm se i kishte ngelur një «ferrë në këmbë», të cilën mendonte ta izolonte e pastaj ta likuidonte. Por jo vetëm nuk mundi ta izolojë e ca më pak ta likuidojë Partinë tonë, por përkundrazi koha vërtetoi se pikëpamjet e Partisë sonë, ishin të drejta.

Kundërshtimet Partisë sonë, për këtë qëndrim, janë bërë shumë presione. Udhëheqja shqiptare konsiderohej si «gjaknxehtë», «kokëfortë», se «i ekzagjeroi» çështjet me Jugosllavinë, se i nxiste pa të drejtë jugosllavët etj. Në radhë të parë në këtë drejtim Partia jonë është sulmuar nga shoku Hrushov.

Më sipër unë përmenda shkurtimisht ç'bënë revizionistët jugosllavë kundër Partisë dhe vendit tonë në kohën e luftës, pas luftës, pas 1948-s, por do të ndalem pak edhe para kundërrevolucionit në Hungari, që është vepra e agjentëve jugosllavë. Grupi tradhëtar i Beogradit filloi organizimin e kundërrevolucionit edhe në Shqipëri. Sikur Partia jonë të kish bërë gabimin e futjes në «vallen e pajtimit» me revizionistët jugosllavë, siç predikohej pas vitit 1955, atëhere demokracinë popullore të Shqipërisë do ta kish

marrë lumi. Ne, shqiptarët, nuk do të ishim sot këtu në këtë sallë, po do të luftonim ende nëpër male.

Partia dhe populli, në një unitet të çeliktë, qëndronin shumë vigjilente dhe zbuluan e demaskuan spiunët e Titos në Komitetin tonë Qendror, që punonin në bashkëpunim me Legatën Jugosllave në Tiranë. Titua u dërgoi lajm këtyre tradhëtarëve, duke u thënë se qenë ngutur, se duhej të kishin pritur udhëzimet e tij. Këta spiunë e tradhëtarë i dërguan letër edhe shokut Hrushov që të ndërhynte kundër Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë. Këto janë të faktuara me dokumenta. Qëllimi i Titos ishte që kundërrevolucionin në Shqipëri të koordinonte me atë në Hungari.

Pas Kongresit XX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik do të mbahej Kongresi ynë III. Agjentura jugosllave mendoi se kish ardhur çasti ta rrëzonte udhëheqjen «kokëfortë dhe staliniste shqiptare» dhe organizoi komplotin, i cili u zbulua dhe u dërmua në konferencën e Partisë në Tiranë, në prill 1956. Komplotistët muarën dënimin e rreptë të merituar.

Agjentët e tjerë të rrezikshëm të Titos në Shqipëri, Dali Ndreu dhe Liri Gega morën urdhër nga Titua të arratiseshin në Jugosllavi se «ishin në rrezik» dhe se veprimet kundër Partisë sonë «duheshin organizuar nga territori jugosllav». Partia ishte plotësisht në dijeni të veprimtarisë dhe të urdhërit sekret të Titos. Ajo ishte vigjilente dhe i kapi tradhëtarët mu në kufi, kur tentonin të arratiseshin. Tradhëtarët shkuan në gjyq dhe u pushkatuan. E gjithë agjentura jugosllave që pregatiste kundërrevolucionin në Shqipëri u zbulua dhe u asgjësua. Për çudi, shoku Hrushov doli përpara nesh në mbrojtje të këtyre tradhëtarëve dhe agjentëve jugosllavë: ai na akuzoi ne se gjoja kishim pushkatuar agjentin jugosllave, tradhëtarin Liri Gega, «kur ajo ishte me barrë, gjë që nuk ndodhte as në kohë të carit dhe kjo kishte bërë figurë të keqe në opinionin botëror». Këto ishin shpifje të jugosllavëve, te të cilët shoku Hrushov kishte besim më shumë se te ne. Natyrisht ne i hodhëm poshtë këto insinuata të shokut Hrushov.

Por s'mbaroi me kaq qëndrimi jo i drejtë, joparimor dhe jomiqësor i shokut Hrushov ndaj Partisë sonë dhe udhëheqjes së saj. Agjenti tjetër jugosllav dhe tradhëtar i Partisë së Punës të Shqipërisë e i popullit shqiptar, Panajot Plaku, u arratis në Jugosllavi, u vu në shërbim të jugosllavëve. Ai organizonte emisio-net armiqësore të radiostacionit të ashtuquajtur «Shqipëria socialiste». Ky tradhëtar i shkroi letër banditit Tito dhe shokut Hrushov dhe i kërkonte këtij të fundit që me autoritetin e tij ta likuidonte udhëheqjen e Shqipërisë, me Enver Hoxhën në krye, për arsye se ne qenkemi «antimarksistë», «stalinistë». Shoku Hrushov jo vetëm që s'u indinjua nga letra e këtij tradhëtar, por ishte i mendimit që ai mund të kthehej përsëri në Shqipëri, me

kusht që ne të mos i bënim asgjë, ose ai mund të vente të gjente strehim politik në Bashkimin Sovjetik. Neve sikur na ranë muret e Kremlinit mbi krye, pse s'mund të imagjinonim kurrë që Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik të arrinte deri atje sa të përkrahte agjentët e Titos dhe tradhëtarët e Partisë sonë, kundër Partisë dhe popullit tonë.

Por kulmi i kundërshtimeve tona parimore për çështjen jugosllave me shokun Hrushov u arrit, kur përpara këmbënguljes sonë parimore, për demaskimin e agjenturës titiste të Beogradit ai u revoltua aq shumë, sa që gjatë bisedimeve zyrtare midis dy delegacioneve tona, në prill 1957, i inatosur, na tha, «Presim bisedimet, nuk mund të merremi vesh me ju. Ju kërkoni të na çoni në rrugën e Stalinit».

Ne u revoltuam përpara një qëndrimi të tillë jomiqësor të shokut Hrushov, i cili kërkonte të priste bisedimet, që do të thoshë të acaronte marrëdhënjet me Partinë dhe shtetin shqiptar për çështjen e tradhëtarëve të marksizëm-leninizmit, grupit të Titos. Ne s'mund të ishim kurrësi dakord për këtë çështje, por ne, që akuzohemi për gjaknxehtësi, u treguam gjakftohtë, pse ishim të bindur se kishim ne të drejtë dhe jo shoku Hrushov, se vija që ndiqnim ne ishte e drejtë dhe jo ajo e shokut Hrushov, se vija jonë do të vërtetohej përsëri në jetë, siç u vërtetua shumë herë.

Kundërrevolucioni në Hungari është kryesisht vepra e titistëve, sipas mendimit tonë. Imperialistët amerikanë kishin të Titua dhe te renegatët e Beogradit, në radhë të parë, armën më të mirë për të shkallmuar demokracinë popullore në Hungari.

Pas vajtjes së shokut Hrushov në Beograd, më 1955, veprimtaria minuese e Titos u la pas dore. Organizimi i kundërrevolucionit në Hungari nuk plasi papritur e pakujtuar, ai u pregatit, mund të themi, fare hapët dhe sheshit dhe do të jetë e papranueshme të na bindë ndokush se ky kundërrevolucion u organizua në fshehtësinë më të madhe. Kundërrevolucioni u pregatit nga agjentura e bandës së Titos në bashkëpunim me tradhëtarin Imre Nagi, në bashkëpunim me fashistët hungarezë dhe të gjithë këta vepronin hapët nën drejtimin e amerikanëve.

Titistët, që ishin kryesorët, kishin në plan që Hungaria të shkëputej nga kampi ynë i socializmit, të shndërrohej në një Jugosllavi të dytë, të lidhej me aleancë me NATO-n, nëpërmjet Jugosllavisë, Greqisë dhe Turqisë, të merrte ndihma nga Amerika dhe të vazhdonte luftën, tok me Jugosllavinë, nën drejtimin e imperializmit, kundër kampit të socializmit.

Haptas punonin kundërrevolucionarët në Hungari. Por si nuk ra në sy veprimtaria e tyre? Ne nuk mund të kuptojmë si është e mundur që në një demokraci popullore motër si Hungaria, ku në fuqi ishte partia, e cila kishte në dorën e saj armët e dikta-

turës, ku ishte edhe Ushtria Sovjetike, të vepronin kaq lirisht, siç vepruan, Titua dhe bandat hortiste.

Ne mendojmë se qëndrimet e shokut Hrushov dhe të shokëve të tjerë sovjetikë ndaj Hungarisë nuk kanë qenë të qarta, pse pikëpamjet e tyre shumë të gabuara që kishin ata për bandën e Beogradit nuk i linin t'i shikonin drejt këto çështje.

Shokët sovjetikë kishin besim te Imre Nagi, njeriu i Titos. Këtë ne nuk e themi kot dhe pa baza. Para se të bëhej kundërrevolucioni dhe kur në klubin «Petefi» po ziente kazani, unë kalova nga Moska dhe në bisedë me shokun Susllov i thashë çka pashë në Budapest duke kaluar, i thashë gjithashtu se revizionisti Imre Nagi po ngrë krye dhe po organizon kundërrevolucionin në klubin «Petefi». Shoku Susllov ma kundërshtoi kategorikisht pikëpamjen time dhe për të më provuar mua se Imre Nagi është njeri i mirë më nxori nga sirtari «autokritikën e freskët të Imre Nagit». Megjithatë i thashë shokut Susllov se Imre Nagi është tradhëtar.

Neve na çudit dhe bëjmë pyetjen legjitime: pse shoku Hrushov dhe shokët sovjetikë shumë herë shkuan në Brioni për të biseduar me renegatin Tito për çështjen e Hungarisë? Në qoftë se shokët sovjetikë kishin dijeni se titistët po pregatishin kundërrevolucionin në një vend të kampit tonë, a u lejohet udhëheqësve të Bashkimit Sovjetik të venë të bisedojnë me një armik, që organizon komplete dhe kundërrevolucione në vendet socialiste?

Është e drejtë që si Parti komuniste, si shtet i demokracisë popullore, si anëtar i Traktatit të Varshavës dhe pjesëtar i kampit të socializmit të kërkojmë nga shoku Hrushov dhe shokët sovjetikë, të na thonë pse gjithë këto mbledhje me Titon në Brioni në vitin 1956, me këtë tradhëtar të marksizëm-leninizmit dhe asnjë mbledhje me vendet tona, asnjë mbledhje të pjesëmarrësve të Traktatit të Varshavës? Kur do të mblidhet ky Traktat i Varshavës, në mos atëhere kur një nga vendet tona është në rrezik?

Me ndërhy, apo mos me ndërhy me armë në Hungari ne mendojmë se nuk është vetëm në kompetencën e një personi; deri sa kemi krijuar Traktatin e Varshavës, duhet të vendosim bashkërisht, pse atëhere është bajate të flasim për aleancë, për kolegjalitet, për bashkëpunim në mes partive. Kundërrevolucioni hungarez i kushtoi gjak kampit tonë, i kushtoi gjak Hungarisë dhe Bashkimit Sovjetik.

Si u lejua të derdhej ky gjak dhe s'u muarën masat që më parë? Ne jemi të mendimit se asnjë masë nuk mund të merrej më parë, derisa te organizatori i kundërrevolucionit hungarez, trathëtar i Tito, tregohej besim nga shoku Hrushov dhe shokët sovjetikë i nënvleftësonin kaq keq mbledhjet e rregullta të domosdoshme të miqve, të aleatëve të tyre, sa vendimet e veta të njëanshme për

çështjet që na përkisnin të gjithëve i quanin si të vetmet të drejta dhe as peshonin fare punën dhe vendimet kolegjiale.

Partia e Punës e Shqipërisë nuk është aspak e qartë për këtë çështje si janë zhvilluar dhe si janë vendosur gjërat. Në një kohë kur titistët bisedojnë në Brioni me shokët sovjetikë, nga një anë, dhe, nga ana tjetër, organizojnë në ethe kundërrevolucionin në Hungari dhe në Shqipëri, shokët sovjetikë as marrin mundimin më të vogël të vënë në korrent udhëheqjen tonë se ç'po ngjet, se ç'masa mendohet të merren prej tyre, të paktën formalisht, si aleatë që jemi. Por këtu s'është çështje formale. Shokët sovjetikë e dinë fare mirë ç'mendonte banda e Beogradit për Shqipërinë dhe ç'qëllime kishte. Me të vërtetë ky qëndrim i shokëve sovjetikë jo vetëm që është i dënueshëm, por edhe i pakuptueshëm.

Hungaria ishte një mësim i madh për ne, për çka u bë, për çka u luajt në skenë e në prapaskenë. Ne besonim se ishte më se e mjaftë pas kundërrevolucionit hungarez tradhëtia e Titos dhe e bandës së tij. Ne dimë se shumë dokumenta mbahen në sirtare dhe nuk hidhen në dritë, dokumenta që demaskojnë veprimtarinë barbare të grupit të Titos në çështjen hungareze. Pse ngjet kjo nuk e kuptojmë. Çfarë interesash fshihen prapa këtyre dokumentave, që nuk hidhen në dritë, por ruhen fort në sirtare? U kërkuan dhe u zbuluan dokumentat më të vogla për të dënuar pas vdekjes shokun Stalin, ndërsa dokumentat për të demaskuar këtë tradhëtar të poshtër, siç është Titua, po mbahen në sirtare.

Por edhe pas kundërrevolucionit hungarez lufta politike dhe ideologjike kundër bandës titiste, në vend që të shkonte kreshendo, ashtu siç e lyp marksizëm-leninizmi, shkoj duke u shuar, shkoj drejt ripajtimit, drejt buzëqeshjeve, drejt kontakteve, drejt zbutjes, gati drejt puthjes. Në fakt titistët, nga ky qëndrim oportunist, e kapërcyen edhe këtë hendek.

Partia e Punës e Shqipërisë ishte në kundërshtim me vijën që ndiqte shoku Hrushov dhe shokët e tjerë ndaj revizionistëve jugosllavë. Lufta e Partisë sonë kundër revizionistëve vazhdoi edhe më me forcë. Shumë miq dhe shokë, në radhë të parë shokët sovjetikë dhe shokët bullgarë, në pamundësi të sulmonin vijën tonë të drejt, na tallnin, buzëqeshnin dhe në kontaktet miqësore me titistët kudo izoloni njerëzit tanë.

Ne shpresonim se pas Kongresit VII titist edhe qorrat, pa le marksistët, do të shihnin me kë kishin të bënin dhe çfarë duhej të bënin. Mjerisht kjo s'ngjau kështu. Nuk shkoi shumë kohë dhe pas Kongresit VII titist demaskimi i revizionizmit u zbut. Revistat teorike sovjetike flisnin për çfarëdo revizionizmi, edhe për revizionizmin në Honolulu, por për revizionizmin jugosllav flisnin pak. Kësaj i thonë mos shikoni ujkun që kemi përpara, por kërkoni gjurmët. Dolën parullat «Të mos flasim më për Titon dhe grupin e tij, se u rritet mendja», «Mos flasim më për Titon dhe grupin e tij, se

i bëjmë dëm popullit jugosllav», «Mos flasim për renegatët titistë, se Titua i përdor fjalët tona për të mobilizuar popullin jugosllav kundër kampit tonë» etj. Mjaft parti i adoptuan këto parulla, kurse Partia jonë jo, dhe ne mendojmë se vepruam drejt.

Situata u krijua e tillë që shtypi i vendeve miq pranonte artikuj nga njerëzit shqiptarë, por vetëm pa përmendur emrin e revizionistëve jugosllavë. Kudo në vendet e demokracisë popullore të Evropës, me përjashtim të shokëve çekoslovakë, të cilët i kanë gjykuar në përgjithësi drejt veprimet tona, ambasadorët tanë tërthorazi u izoluan, pse diplomatëve të vendeve miq u pëlqente muhabeti me diplomatët titistë, kurse tanët i urrenin dhe s'donin as me sy t'i shikonin.

Dhe çështja arriti deri atje, sa shoku Hrushov kondicionoi ardhjen e tij në Shqipëri, në maj të 1959-s, në krye të delegacionit të Partisë dhe të Qeverisë Sovjetike, me çështjen jugosllave. Fjala e parë e shokut Hrushov, në fillimin e bisedimeve në Tiranë, ishte të lajmëronte të gjithë mbledhjen se ai nuk do të fliste kundër revizionistëve jugosllavë, gjë për të cilën as që e detyronte kush, dhe me një thënjë të tillë donte të tregonte hapët mospajtimin e tij në këtë çështje me Partinë e Punës të Shqipërisë.

Ne e respektuam dëshirën e mikut, deri sa qëndroi në Shqipëri, pavarësisht nga shtypi titist, i cili u gëzua pa masë dhe s'mungoi të thoshte se Hrushovi ua mbylli gojën shqiptarëve. Kjo në fakt i përgjegjej realitetit, por shoku Hrushov ishte shumë larg të na mbushte mendjen për këtë çështje, dhe titistët e mësuajnë fare qartë se, pas ikjes së mikut nga vendi ynë, Partia e Punës e Shqipërisë s'ishte më e lidhur me konditat që na vuri miku dhe vazhdoi rrugën e vet marksiste-leniniste.

Shoku Hrushov, në bisedimet që ka bërë me Vukmanoviç Tempon, në mes të të tjerave, i ka barazuar qëndrimet tona, nga pikëpamja e tonit, si të njëjlojta me ato të jugosllavëve dhe nuk ka qenë dakord me tonin e shqiptarëve. Ne e konsiderojmë të gabueshme dhe të dënueshme thënjën e shokut Hrushov Vukmanoviç Tempos, armik i marksizmit, i kampit të socializmit dhe i Shqipërisë. Ne themi «ajo mushkë ato dru do» dhe ne nga ana jonë nuk jemi dakord me tonin pajtues të shokut Hrushov ndaj revizionistëve. Populli thotë se përpara armikut ngrihet toni, përpara së dashurës del mjaltë nga goja.

Disa shokë që mendojnë gabim pretendojnë se ne mbajmë këto qëndrime ndaj titistëve nga që gjoja dashkemi të mbajmë flamurin e luftës kundër revizionizmit ose ngaqë e shohim këtë problem ngushtë, nga pikëpamja thjesht nacionale, prandaj qenkemi futur, në mos në «rrugën shoviniste», të paktën në atë të «nacionalizmit të ngushtë». Partia e Punës e Shqipërisë çështjen e revizionizmit jugosllav e ka parë dhe e sheh nën prizmin e marksizëm-leninizmit, e ka parë, e sheh dhe e lufton si rrezikun kryesor për lëvizjen ko-

muniste ndërkombëtare, si rrezik për unitetin e kampit socialist.

Por ne, duke qenë internacionalistë, jemi njëkohësisht edhe komunistë të një vendi të caktuar, të Shqipërisë. Ne, komunistët shqiptarë, nuk do të quheshim komunistë, në qoftë se nuk do të mbronim me konsekuencë dhe me vendosmëri lirinë e atdheut tonë të shtrenjtë nga komplotet dhe sulmet diversioniste të klikës revizioniste të Titos, të cilat synojnë invadimin e Shqipërisë dhe që tashmë njihen mirë nga të gjithë. A mundet dhe a është e lejueshme që ne, komunistët shqiptarë, ta lëmë vendin tonë që të bëhet gjahu i Titos, i amerikanëve, i grekëve, apo i italianëve? Jo, kurrë!

Disa të tjerë na këshillojnë të mos flasim kundër jugosllavëve; ata thonë «Pse keni frikë? Ju ju mbron Bashkimi Sovjetik». Ne u kemi thënë dhe u themi këtyre shokëve se s'kemi frikë as nga trockistët jugosllavë, as nga kurrkush. Ne e kemi thënë dhe e themi se Bashkimi Sovjetik na ka mbrojtur, na mbron dhe do të na mbrojë, por ne jemi marksistë-leninistë, luftën kundër revizionistëve dhe imperialistëve për asnjë çast nuk duhet ta dobësojmë, deri sa t'i zhdukim. Se që të të mbrojë Bashkimi Sovjetik, duhet më parë të mbrohesh vetë.

Jugosllavët na akuzojnë se gjoja ne jemi «shovinistë, ndërhyjmë në punët e tyre të brendshme dhe kërkojmë rektifikimin e kufive shqiptaro-jugosllavë». Mjaft nga miqtë tanë mendojnë dhe lënë të kuptohet se ne, komunistët shqiptarë, jemi në këto ujëra. Ne u themi miqve që mendojnë kështu se gabohen rëndë. Ne s'jemi shovinistë, ne as kemi kërkuar dhe as kërkojmë rektifikim kufish. Por ajo që ne kërkojmë dhe do të kërkojmë vazhdimisht nga titistët dhe për të cilën do t'i demaskojmë ata deri në fund është të heqin dorë nga krimi i gjenocidit kundër minoritetit shqiptar të Kosovës e të Metohisë, të heqin dorë nga terrori i bardhë kundër shqiptarëve të Kosovës, të heqin dorë nga dëbimi i shqiptarëve nga tokat e tyre dhe dërgimi në masë i shqiptarëve në Turqi; ne kërkojmë që minoritetit shqiptar në Jugosllavi t'i njihen të drejtat, në bazë të kushtetutës së Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë. Shoviniste është kjo kërkesë apo marksiste?

Këto janë pozitat tona në këtë çështje. Por në rast se titistët flasin për bashkekzistencën, për paqen, për marrëdhënje të fqinjësisë së mirë dhe nga ana tjetër organizojnë komplete, organizojnë ushtri mercenarësh dhe fashistësh në Jugosllavi për të sulmuar kufitë tanë dhe për të copëtuar së toku me Greqinë monarko-fashiste Shqipërinë tonë socialiste, atëherë të jeni të bindur se jo vetëm populli shqiptar i Shqipërisë së re do të ngrihet me armë në dorë, por me armë në dorë do të ngrihen edhe njëmilion shqiptarë që jetojnë nën robërinë e Titos, për t'i ndalur dorën kriminelit. Dhe kjo është marksiste dhe kështu do të bëhet, po të ngjasë gjë-

kafshë. Partia e Punës e Shqipërisë nuk lejon kërkend të luajë ose të bëjë politikë me të drejtat e popullit shqiptar.

Ne nuk ndërhyjmë në punët e brendshme të të tjerëve, por kur si rezultat i zbutjes së luftës kundër revizionistëve jugosllavë arrin puna që në një vend mik si Bullgaria të shtypet harta e Ballkanit, duke përfshirë Shqipërinë brenda kufive të Jugosllavisë Federative, nuk mund të rrijmë pa folur. Na thuhet se kjo ndodhi për gabimin teknik të një nëpunësi, po pse këto nuk ndodhën më parë?

Por ky s'është një rast i izoluar. Në një miting në Sremska Mitrovica, banditi Rankoviç e sulmoi si zakonisht Shqipërinë dhe e quajti atë «një skëterrë, ku mbretëron teli me gjëmba dhe çizmja e kufitarit» dhe se demokracia e neofashistëve italianë është më e përparuar nga ajo jona.

Fjalët e Rankoviçit s'do të kishin asnjë rëndësi për ne, por këto fjalë i dëgjuan me serenitetin më të madh, pa bërë as protestën më të vogël ambasadori sovjetik dhe ambasadori bullgar në Beograd, që asistonin në këtë miting. Ne protestuam shoqërisht për këtë pranë komiteteve qendrore të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe të Partisë Komuniste Bullgare.

Shoku Zhivkov, në letërpërgjigjen që i drejton Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, ka guximin ta hedhë poshtë protestën tonë dhe ta quajë fjalimin e banditit Rankoviç si pozitiv. Ne nuk mund të imagjinonim kurrë që Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Bullgare të quajë si pozitiv fjalimin e një banditi si Rankoviçi, që fyen kaq rëndë Shqipërinë socialiste duke e cilësuar si skëterrë. Ne jo vetëm e hedhim poshtë me përbuzje këtë fyerje të palejueshme të Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Bullgare, por jemi plotësisht të bindur se do të revoltohej pa masë Partia Komuniste Bullgare dhe populli heroik bullgar, po ta merrte vesh një gjë të tillë. Në qoftë se lejojmë gabime të tilla të rënda ndaj njëri-tjetrit, atëherë punët nuk do të shkojnë mirë.

Ne nuk mundet të jemi kurrsesi dakord me shokun Hrushov, dhe këtë protestë ja bëmë atij në kohën e duhur, për bisedimet që ai pati me Sofokli Venizellosin në lidhje me minoritetin grek në Shqipëri. Shoku Hrushov e di se kufitë e Shqipërisë janë të paprekshëm dhe të shenjtë; kush i prek ato është agresor. Populli shqiptar do të derdhë gjak po t'ja prekë kush kufitë. Shoku Hrushov gaboi rëndë kur i tha Venizellosit se ai pa në Korçë grekët dhe shqiptarët që punonin si vëllezër. Në Korçë s'ka fije minoriteti grek, por ka lakmi shekullore të grekëve për krahinën e Korçës, si për gjithë Shqipërinë. Një minoritet shumë të vogël grek ka në Gjirokastër. Shoku Hrushov e di se ata kanë të gjitha të drejtat, kanë gjuhën greke, kishat, shkollat greke dhe veç kë-

tyre po ato të drejta që kanë edhe të gjithë nënshtetasit e tjerë shqiptarë.

Rivendikimet e grekëve, midis të cilëve edhe të Sofokli Venizellosit, birit të Elefter Venizellosit, vrasësit të shqiptarëve, dje-gësit të krahinave shqiptare të Jugut, shovinistit më të tërbuar grek dhe babait të megalidhesë greke, të copëtimit të Shqipërisë dhe të aneksimit të saj nën parullën e autonomisë, janë të njohura fare mirë. Shoku Hrushov e njuh fare mirë qëndrimin e Partisë së Punës të Shqipërisë, të Qeverisë Shqiptare dhe të popullit shqiptar për këtë çështje. Atëhere të mos i përgjigjesh siç e meriton, t'i lësh shpresa e iluzione dhe t'i thuash se do t'u transmetoj shokëve shqiptarë dëshirat e një agjenti anglez, të një shovinisti, të një armiku të komunizmit dhe të Shqipërisë, kjo është e papranueshme nga ne dhe është e dënueshme.

Ne ja dhamë përgjigjen Sofokli Venizellosit, shoku Hrushov, dhe me anën e shtypit besojmë se ke marrë dijeni. Ne s'jemi në kundërshtim të bëni politikë me Sofokli Venizellosin, por me kufitë dhe të drejtat tona duhet të mos bëni politikë, pse ne as kemi lejuar, as do të lejojmë. Dhe për këtë nuk jemi nacionalistë, por internacionalistë.

Dikush mund t'i gjykojë këto që them unë si gjëra pa vend, si deklarata që s'janë në lartësinë e mbledhjes. Nuk do të ishte rëndë për mua të ndërtoja një fjalim gjoja me ton teorik, të thoshja fjalë dhe citate të përgjithshme, t'ju bëja një referat të përgjithshëm, t'ju bëja qejfin dhe të shkoja radhën. Por Partisë së Punës të Shqipërisë i duket se s'është rasti i tillë. Këto që thashë dikujt mund t'i duken si sulme, por këto janë kritika që kanë ndjekur rrugën e tyre normale, që janë bërë më parë kur duhej dhe ku duhej, brenda normave leniniste, por tani që gabimet po trashen, do të jetë gabim të heshtësh, se qëndrimet, veprat, praktika, vërtetojnë, pasurojnë dhe krijojnë teorinë.

Sa shpejt u organizua Konferenca e Bukureshtit dhe sa shpejt u dënua Partia Komuniste e Kinës për «dogmatizëm»! Por pse vallë s'është organizuar shpejt edhe një konferencë për të dënuar revizionizmin?

Por revizionizmi a mos vallë është demaskuar krejtësisht, siç pretendojnë shokët sovjetikë? Në asnjë mënyrë jo. Revizionizmi ka qenë dhe është rrezik kryesor, revizionizmi jugosllav nuk është likuiduar dhe, kështu si po sillemi ndaj tij, atij i lihet fushë e gjerë veprimi në të gjitha format.

Por vallë në partitë e tjera nuk ka shfaqje shqetësuese të revizionizmit modern? Kush thotë jo, mbyll sytë përpara këtij rreziku dhe një mëngjez do të na ngjasin të papritura. Ne jemi marksistë, ta analizojmë punën tonë ashtu siç na mësonte dhe si vepronte Lenini. Ai s'kishte frikë nga gabimet, ai i shikonte në sy

dhe i korrigjonte gabimet. Kështu u kalit Partia Bolshevike, kështu janë kalitur edhe partitë tona.

Ç'po ngjet në gjirin e partive tona? Ç'po ngjet në kampin tonë që pas Kongresit XX? Shoku Suslov mund të jetë shumë optimist, siç u shpreh ai në komisionin e tetorit, duke akuzuar delegacionin e Partisë së Punës të Shqipërisë, shokun Hysni Kapo, për pesimizëm në vështrim të ngjarjeve. Ne, komunistët shqiptarë, nuk kemi qenë pesimistë as në kohët më të errëta të historisë së Partisë dhe të popullit tonë dhe as do të jemi kurrë, por realistë do të jemi kurdoherë.

Shumë fjalë thuhën për unitetin tonë. Ky është i domosdoshëm dhe duhet të luftojmë ta forcojmë, ta kalitim. Por fakt është që ne për shumë çështje të rëndësishme parimore nuk kemi unitet.

Partia e Punës e Shqipërisë mendon se duhet të rishikohen çështjet në dritën e analizës marksiste-leniniste dhe të ndreqen ku janë gabimet. Le të marrim çështjen e kritikës ndaj Stalinit dhe veprës së tij. Partia jonë, si parti marksiste-leniniste, është plotësisht e ndërgjegjshme se kulti i individit është një shfaqje e huaj dhe e dëmshme për partitë dhe për vetë lëvizjen komuniste. Partitë marksiste jo vetëm nuk duhet të lejojnë zhvillimin e kultit të individit, i cili frenon aktivitetin e masave, mohon rolin e tyre, është në kundërshtim me zhvillimin e vetë jetës së partisë dhe të ligjeve që e rregullojnë atë, por duhet të luftojnë me të gjitha forcat për ta shkukur nga rrënjët, kur ky nis e shfaqet ose është shfaqur në një vend. Në këtë prizëm ne jemi plotësisht dakord që duhej kritikuar kulti i individit të Stalinit si shfaqje e dëmshme në jetën e partisë. Por, sipas mendimit tonë, Kongresi XX dhe veçanërisht raporti sekret i shokut Hrushov çështjen e shokut Stalin nuk e shtroi drejt dhe në mënyrë objektive marksiste-leniniste.

U dënua rëndë dhe pa të drejtë Stalini për këtë çështje nga shoku Hrushov dhe nga Kongresi XX. Shoku Stalin dhe veprimtaria e tij nuk i përket vetëm Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe popullit sovjetik, por na përket të gjithëve. Ashtu sikundër shoku Hrushov e shtroi çështjen në Bukuresht, se mosmarrëveshjet nuk janë në mes të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe të Partisë Komuniste të Kinës, por janë në mes të Partisë Komuniste të Kinës dhe komunizmit ndërkombëtar, ashtu sikundër i pëlqen të thotë se vendimet e Kongresit XX dhe XXI u adoptuan nga të gjitha partitë komuniste dhe punëtore të botës, ashtu duhet të jetë zemërgjerë dhe konsekuent për gjykimin e veprimeve të Stalinit që të adoptoheshin me plot ndërgjegje nga partitë komuniste dhe punëtore të botës.

S'mund të ketë as dy masa, as dy pesha për këto çështje. Atëhere pse u dënua shoku Stalin në Kongresin XX pa u kon-

sultuar më parë edhe me partitë e tjera komuniste dhe punëtorë të botës? Pse përpara partive komuniste dhe punëtorë të botës, papritur e pakujtuar, u hodh «anathema» kundër Stalinit dhe shumë parti motra këtë gjë e muarën vesh kur imperializmi shtypi raportin e fshehtë të shokut Hrushov me okë nëpër tregje?

Botës komuniste dhe botës përparimtare ju imponua dënimi i shokut Stalin nga shoku Hrushov. Çfarë të bënin partitë tona në këtë situatë, kur papritmas, duke përdorur autoritetin e madh të Bashkimit Sovjetik, ju imponohej në blok një çështje e tillë?

Partia e Punës e Shqipërisë ka qenë në dilemë të madhe. Ajo s'ishte e bindur dhe s'do të jetë kurrë e bindur për çështjen e dënimit të shokut Stalin në atë mënyrë dhe në ato forma siç u bë nga shoku Hrushov. Partia jonë adoptoi formulimet e Kongresit XX në përgjithësi për këtë çështje, por megjithatë nuk u qëndroi caqeve të kufizuara nga ky kongres, ajo nuk ju përul shantazheve dhe frikësimeve që i bëheshin nga jashtë vendit.

Partia e Punës e Shqipërisë tregohej realiste në çështjen e Stalinit, tregohej e drejtë dhe mirënjohëse ndaj këtij marksisti të lavdishëm, që sa që gjallë ai nuk doli asnjë «trim» nga ne ta kritikonte, por kur vdiq shumë baltë u hodh mbi të dhe u krijua e është krijuar një situatë e padurueshme që një epokë e tërë e lavdishme e Bashkimit Sovjetik, që kur u mëkëmb shteti i parë socialist në botë, u forcua Bashkimi Sovjetik, u mposhtën me sukses komplotet imperialiste, u dërmuan trockistët, buharinistët, kulakët si klasë, triumfoi ngritja e industrisë së rëndë, triumfoi kolektivizimi, me një fjalë Bashkimi Sovjetik u bë një fuqi kolosale që ndërtoi me sukses socializmin e që në Luftën e dytë botërore, luftoi me heroizëm legjendar dhe mposhti fashizmin, çliroi popujt tanë, u krijua kampi i fuqishëm i socializmit etj, etj, që gjithë kjo epokë pra e lavdishme e Bashkimit Sovjetik të mbetet pa kokë, pa udhëheqje.

Partia e Punës e Shqipërisë mendon se s'është e drejtë, normale dhe marksiste që për të gjithë këtë epokë të shuhet emri dhe vepra e madhe e Stalinit, siç po bëhet. Veprën e mirë dhe të pavdekshme të Stalinit duhet ta mbrojmë të tërë, kush nuk e mbron ai është oportunist dhe frikacak.

Shoku Stalin, si person dhe si udhëheqës i Partisë Komuniste Bolshevike, është njëkohësisht udhëheqësi më i shquar i komunizmit ndërkombëtar pas vdekjes së Leninit, që influençoi në mënyrë shumë pozitive dhe me autoritet të madh në konsolidimin dhe në zhvillimin e fitoreve të komunizmit në të gjithë botën. Gjithë veprat teorike të shokut Stalin janë një dëshmi e zjarrtë e besnikërisë së tij ndaj mësuesit gjenial, Leninit të madh dhe leninizmit.

Stalini luftoi për të drejtat e klasës punëtorë dhe të punonjësve në të gjithë botën, ai luftoi me konsekuencë të madhe deri

në fund për lirinë e popujve të vendeve tona të demokracisë popullore.

Duke e shikuar vetëm nga këto anë, Stalini i përket gjithë botës komuniste dhe jo vetëm komunistëve sovjetikë, u përket gjithë punonjësve të botës dhe jo vetëm punonjësve sovjetikë.

Sikur shoku Hrushov dhe shokët sovjetikë ta kishin shikuar këtë çështje në këtë frymë, do të ishin shmangur gabimet e mëdha që u bënë. Por ata e shikuan çështjen e Stalinit shumë thjesht dhe vetëm në prizmin e brendshëm të Bashkimit Sovjetik. Por, sipas mendimit të Partisë së Punës të Shqipërisë, edhe në këtë prizëm ata e shikuan në mënyrë të njëanshme, panë vetëm gabimet e tij, lanë gati krejt mënjanë veprimtarinë e tij të madhe, kontributin e tij të madh në forcimin e Bashkimit Sovjetik, në kalitjen e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, në ngritjen e ekonomisë së Bashkimit Sovjetik, të industrisë, të bujqësisë kolkoziane, në drejtimin e popullit sovjetik në fitoren e madhe mbi fashizmin gjerman.

A ka pasur gabime Stalini? Sigurisht ka pasur. Është e pashmangshme që në një periudhë kaq të gjatë, mbushur me heroizma, me përpjekje, me luftra, me fitore, të mos kishte edhe gabime, jo vetëm personale të Josif Stalinit, por edhe të udhëheqjes si organ kolektiv. Cila është ajo parti dhe cili është ai udhëheqës që e quan veten se u ka shpëtuar gabimeve në punën e vet? Kur bëhen kritika për udhëheqjen e sotme sovjetike, dhe shokët e udhëheqjes sovjetike na këshillojnë të shikojmë përpara, ata thonë ta lëmë mënjanë polemikën, por kur që puna për Stalinin, ata jo vetëm që nuk shkuan përpara, por u kthyen shumë, shumë prapa, për të gërmuar vetëm anët e dobëta të punës së Stalinit.

Kulti i individit të Stalinit duhej kapërcyer patjetër. Por a mund të thuhet, siç u tha, se Stalini është artizani vetë i këtij kulti të individit? Kulti i individit duhej kapërcyer patjetër, por a ishte nevoja dhe a ishte e drejtë që të arrihej deri atje, sa që kush përmendte emrin e Stalinit të tregohej menjëherë me gisht, kush përdorte një citat të Stalinit të shikohej me sy të shtrembër? Me shpejtësi dhe me zell disa i thyen statujat e Stalinit, ndërruan emrat e qyteteve që i kishin pagëzuar me emrin e tij. Po pse të shkojmë më tej? Në Bukuresht shoku Hrushov, duke ju drejtuar shokëve kinezë, u tha: «Po kapeni prej kalit të ngor-dhur», «Po të doni, ejani merrni edhe kockat e tij». Këto gjëra thuheshin në adresë të Stalinit.

Partia e Punës e Shqipërisë deklaroi solemnisht se është kundër këtyre veprimeve dhe këtyre gjykimeve mbi veprën dhe personin e J. V. Stalinit.

Po pse u vunë këto çështje, shokë sovjetikë, në këtë mënyrë dhe në këto forma të shtrembëra, kurse kishte mundësi edhe gabimet e Stalinit, edhe ato të udhëheqjes, të viheshin në dukje

si duhej, të ndreqeshin këto gabime, por të mos krijohet ajo tronditje e madhe që u krijua në zemrat e komunistëve të të gjithë botës, që vetëm ndjenja e disiplinës dhe autoriteti i Bashkimit Sovjetik i frenoi të buçisnin?

Shoku Mikojan na ka thënë se ne s'guxonim ta kritikonim shokun Stalin, sa ishte gjallë, se na priste kokën. Ne jemi të sigurt se shoku Hrushov kokën s'na e pret po ta kritikojmë drejt.

Pas Kongresit XX ndodhën ngjarjet që dihen në Poloni, kundërrevolucionari ndodhi në Hungari, sulme filluan të bëhen kundër sistemit sovjetik, tronditje ngjanë në shumë parti komuniste dhe punëtorë të botës dhe me në fund kjo që po ngjet.

Bëjmë pyetjen, përse ndodhën këto gjëra në gjirin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare, në gjirin e kampit tonë pas Kongresit XX? Apo mos këto ngjasin pse udhëheqja e Partisë së Punës të Shqipërisë është sektare, dogmatike dhe pesimiste?

Ne duhet të na shqetësojë jashtëzakonisht një gjë e tillë dhe duhet t'i gjejmë burimin sëmundjes e ta shërojmë. Sigurisht sëmundja nuk shërohet as duke i fërkuar krahët renegatit Tito, as duke shënuar në deklaratë se revizionizmi modern është shpartalluar përfundimisht, siç pretendojnë shokët sovjetikë.

Autoriteti i leninizmit ka qenë dhe është vendimtar. Ai duhet të vendoset në atë mënyrë që të spastrojë kudo dhe në mënyrë radikale pikëpamjet e gabuara. Tjetër rrugë s'ka për ne, komunistët. Në qoftë se mund dhe duhet të thuhet drejt gjërat, ashtu siç janë, duhet të bëhet tani sa s'është vonë, në këtë konferencë. Komunistët, mendojmë ne, duhet të flenë me ndërgegje të qetë, të forcojnë unitetin marksist, por pa ruajtur rezerva, hatëre, mëri. Komunisti ç'ka në zemër ta thotë haptas dhe çështjet të gjyko-hen drejt.

Mund të ketë njerëz që të mos u pëlqejë çka thotë Partia jonë e vogël, mund të izolohet Partia jonë e vogël, mund t'i bëhen presione ekonomike vendit tonë, për t'i vërtetuar popullit tonë se udhëheqja e saj gjoja nuk bën, mund të sulmohet dhe po sulmohet Partia jonë, Mihail Suslovi e barazon Partinë e Punës të Shqipërisë me partitë borgjeze dhe udhëheqësit e saj me Kerenskin. Por kjo s'na frikëson. Jemi mësuar. Rankoviçi s'ka thënë më shumë për Partinë e Punës të Shqipërisë, Titua na ka quajtur Gebelsë, por prapë ne jemi leninistë dhe ata janë trocistë, tradhëtarë, shërbëtorë dhe agjentë të imperializmit.

Dëshiroj të theksoj se Partia e Punës e Shqipërisë dhe populli shqiptar e ka treguar me vepra sa e do, sa e respekton, sa besnike i qëndron Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe kur Partia e Punës e Shqipërisë kritikon veprimet e gabuara të disa udhëheqësve sovjetikë, kjo nuk do të thotë se ka ndryshuar pikëpamja dhe qëndrimi ynë. Ne, shqiptarët, kemi kurajon marksiste t'i kritikojmë këta shokë, jo pse i

urrejmë, por se i duam dhe pse duam më shumë e mbi çdo gjë Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe popujt sovjetikë.

Kështu e duam ne Bashkimin Sovjetik, Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe udhëheqjen sovjetike. Me ashpërsinë tonë marksiste ne u themi atyre çdo gjë në mënyrë shoqërore, ne u hapim zemrën singerisht, ua themi hapët çfarë mendojmë dhe hipokritë as kemi qenë dhe as do të jemi.

Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik do të na dojë, me gjithë ashpërsinë tonë që tregojmë, pavarësisht se mundet edhe të gabojmë, por për një gjë Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik dhe partitë komuniste dhe punëtorë të botës nuk do të na dënojnë, për singeritetin tonë dhe që prapa krahëve nuk llomotitim ose që të 100 flamureve nuk jemi.

Në fund dëshiroja të flisja pak mbi projektdeklaratën që na është paraqitur nga komisioni i redaktimit. Delegacioni ynë u njoh me këtë projekt dhe e studjoi atë me vëmendje. Në projektin e ri që na është paraqitur janë bërë mjaft ndryshime, në krahasim me variantin e parë të paraqitur nga delegacioni sovjetik, i cili u muar si bazë për punën e komisionit të redaktimit. Me ndryshimet që u bënë, projekti i ri është përmirësuar mjaft, janë forcuar shumë ide të rëndësishme, janë formuluar më drejt mjaft teza, u hoqën në shumicën dërmuese aluzionet kundër Partisë Komuniste të Kinës.

Delegacioni i Partisë sonë në mbledhjen e komisionit të redaktimit bëri shumë vërejtje, të cilat pjesërisht u pranuan. Megjithëse për disa çështje të rëndësishme e parimore delegacioni ynë nuk ishte i mendimit që të mbeteshin në projekt, ai dha pëlqimin që ky dokument t'i paraqitej kësaj mbledhjeje, duke ruajtur të drejtën që të shfaqë mendimin e tij edhe një herë për të gjitha ato gjëra për të cilat ai nuk ishte dakord. Para së gjithash ne mendojmë që ato pesë çështje që kanë mbetur të pakoordinuara duhet të zgjidhen, me qëllim që të nxjerrim një dokument të aprovuar nga të gjithë me unanimitet.

Ne mendojmë se është e nevojshme të dalë qartë në deklaratë ideja e Leninit, e shprehur kohët e fundit nga shoku Moris Torez, si dhe nga shoku Suslov në fjalimin e tij të mbledhjes së komisionit të redaktimit, se garanci absolute për ndalimin e luftës mund të ketë vetëm atëhere kur socializmi të ketë fituar në të gjithë botën ose të paktën edhe në një sërë vendesh të tjera të mëdha imperialiste. Gjithashtu duhet të hiqet paragrafi që flet për veprimtari fraksioniste e grupazhi në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, pasi kjo, siç e kemi shpjeguar edhe në mbledhjen e komisionit, nuk i shërben forcimit të unitetit, përkundrazi e minon atë. Ne jemi gjithashtu për heqjen e fjalëve ku flitet mbi kapërcimin e pasojave të dëmshme të kultit të individit, ose pas

tyre të shtohen fjalët «që kishte vend në një sërë partish», gjë që i përgjigjet më mirë realitetit.

Për këto çështje dhe për vërejtjet e tjera që ne kemi për projektdeklaratën unë nuk dua t'i ha kohën mbledhjes. Vërejtjet tona konkrete delegacioni ynë do t'i bëjë kur të shqyrtohet vetë projekti i deklaratës.

Do të bëjmë mirë dhe do të jetë shpëtimtare që në këtë konferencë t'i shohim me guxim në sy gabimet dhe të shërojmë plagët ku janë e ku s'janë, por që ka rrezik të majisen e të bëhen të rrezikshme. Ne nuk e quajmë fyerje kur shokët na kritikojnë me të drejtë dhe me fakte, por nuk do të pranojmë kursesi që të na quajnë pa fakte «dogmatikë», «sektarë», «nacionalistë të ngushtë», vetëm sepse ne luftojmë me këmbëngulje kundër revizionizmit modern e veçanërisht kundër revizionizmit jugosllav. Në qoftë se ndokush luftën tonë kundër revizionizmit e quan dogmatizëm ose sektarizëm, ne i themi atij: hiq syzat revizioniste dhe do të shikosh më qartë.

Partia e Punës e Shqipërisë mendon se kjo konferencë do të mbetet historike, pse do të jetë një konferencë në traditën e konferencave leniniste që ka organizuar Partia Bolshevike për të demaskuar dhe shfarosur nga rrënjët pikëpamjet e shtrembëra, për të forcuar dhe çelnikosur mbi bazën e marksizëm-leninizmit unitetin e lëvizjes sonë komuniste e punëtore ndërkombëtare. Partia jonë e Punës do të luftojë edhe në të ardhshmen me vendosmëri për të çelnikosur unitetin tonë, lidhjet vëllazërore, vepimin e përbashkët midis partive komuniste e punëtore, sepse kjo është garancia e fitores së çështjes së paqes dhe të socializmit. Uniteti i kampit socialist, me Bashkimin Sovjetik në krye, uniteti i lëvizjes komuniste dhe punëtore ndërkombëtare, me Partinë e lavdishme Komuniste të Bashkimit Sovjetik në qendër, është gjëja më e shenjtë, të cilën Partia jonë do ta ruajë si sytë e ballit dhe do ta forcojë përditë e më shumë.

**Botohet sipas origjinalit
që ndodhet në Arkivin
Qendror të Partisë**

Nr. 131

**LETËR E KQ TË PPSH DREJTUAR KOMITETIT QENDROR TË
PARTISË KOMUNISTE TË BASHKIMIT SOVJETIK LIDHUR
ME RIFILLIMIN E BASHKËBISEDIMEVE MIDIS
PËRFAQËSUESVE TË PKBS DHE PPSH.**

MOSKË

21 nëntor 1960

Muarëm letrën e datës 14 nëntor 1960 të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik drejtuar delegacionit të Partisë së Punës të Shqipërisë që merr pjesë në Mbledhjen e partive komuniste e punëtore në Moskë, me anën e së cilës ju propozoni që të rifillojnë bashkëbisedimet midis përfaqësuesve të partive tona, të cilat u ndërprejnë më 12 nëntor të këtij viti.

Në lidhje me letrën tuaj të mësipërme, Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë na ka autorizuar t'u përgjigjemi sa më poshtë:

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë ka qenë dhe është kurdoherë i mendimit se rruga më e drejtë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të lindura midis dy partive tona është rruga e bashkëbisedimeve, në bazë të parimeve marksiste-leniniste, të barazisë dhe të respektit reciprok.

Më datën 9 nëntor të këtij viti, ju na propozuat që Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, shoku Enver Hoxha, të takohej me Sekretarin e Parë të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, shokun Hrushov, për bashkëbisedime në lidhje me mosmarrëveshjet e lindura midis dy partive tona. Shoku Enver Hoxha e priti me kënaqësi këtë ftesë dhe u bë gati që të vinte në takim me shokun Hrushov. Por fare pak kohë para se të nisej për takim shoku Enver Hoxha, delegacionit tonë, duke lexuar letrën e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik drejtuar me datën 5 nëntor të këtij viti Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës, i ra në sy se, në atë letër, Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik e injoron ekzistencën e Republikës Popu-

llore të Shqipërisë si vend socialist dhe denigron Partinë e Punës të Shqipërisë. Këto konsideracione Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik nuk ja kishte thënë drejtpërdrejt Partisë sonë, më parë se t'ja bënte të njohura zyrtarisht gjithë lëvizjes komuniste ndërkombëtare, siç bëri me letrën e datës 5 nëntor të këtij viti drejtuar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës. Për këtë veprim fyes dhe të palejueshëm të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik ndaj Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Partisë së Punës të Shqipërisë, shoku Enver Hoxha, me të drejtë, e ndryshoi vendimin për t'u takuar me shokun Hrushov, duke refuzuar takimin në minutën e fundit.

Megjithatë, delegacioni i Partisë së Punës të Shqipërisë në Mbledhjen e partive komuniste e punëtore që mbahet tani në Moskë pranoi të bashkëbisedonte me udhëheqësit e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik të nesërmen, më datën 10 nëntor të këtij viti. Kështu, më 10 nëntor të këtij viti u bë takimi midis delegacionit tonë me përbërje të plotë dhe përfaqësuesve të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik shokëve Mikojan, Kozllov, Susllov, Pospellov dhe Antropov. Bashkëbisedimet vazhduan edhe më datën 11 nëntor midis delegacionit tonë, nga njëra anë, dhe shokëve Mikojan e Kozllov, nga ana tjetër. Fatkeqësisht, gjatë këtyre bashkëbisedimeve nuk u arrit asnjë rezultat, në lidhje me mosmarrëveshjet midis dy partive tona. Në këto bashkëbisedime u konstatua se të dy palët qëndrojnë secila pa lëvizur nga pozitat e veta: ne konsiderojmë se burimi i mosmarrëveshjeve qëndron në veprimet e gabuara të udhëheqjes së Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, kurse ju konsideroni që burimi i mosmarrëveshjeve qëndron në qëndrimin gjoja të gabuar të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë. Por në takimin e datës 11 nëntor ne ramë dakord me propozimin e shokëve Mikojan e Kozllov për t'u takuar me shokun Hrushov të nesërmen.

Më datën 12 nëntor, për hir të përmirësimit të marrëdhënjëve midis dy partive tona dhe të miqësisë midis dy vendeve tona, me qëllim që të gjendej rruga e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të lindura midis nesh, delegacioni ynë shkoi në Kremlin për t'u takuar me shokun Hrushov, ku ndodheshin edhe shokët Mikojan, Kozllov e Antropov. Gjatë bisedimeve në këtë takim, përsëri të dyja palët mbetën secila në qëndrimet e veta. Por N. S. Hrushovi papritur filloi të sulmonte në mënyrë fyese, të palejueshme, personalisht Sekretarin e Parë të Komitetit Qendror të Partisë sonë, shokun Enver Hoxha, derisa e krahasoi me Makmilanin. Në atë rast, delegacioni ynë i kërkoi N. S. Hrushovit ta merrte mbrapsht këtë dhe, meqenëse ai refuzoi, në mënyrë fyese, që ta tërhiqte këtë fyerje të rëndë ndaj Partisë sonë, delegacioni ynë, në shenjë proteste, u largua pa përfunduar bashkëbisedimet.

Kështu, pra, faji për ndërprerjen e bashkëbisedimeve nuk na bie neve, por përfaqësuesve të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, të cilët fyen rëndë udhëheqjen e Partisë sonë.

Megjithatë, Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë është i mendimit dhe konsideron se duhet të zhvillohen bashkëbisedime midis përfaqësuesve të dy partive e qeverive tona, me qëllim që të zhduken mosmarrëveshjet, me qëllim që të ecim përpara, për forcimin e miqësisë midis popujve tanë dhe partive tona. Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë pranon propozimin tuaj që bëni me anën e letrës së datës 14 nëntor të këtij viti për të rifilluar bashkëbisedimet. Nga ana jonë, si përfaqësues të Partisë dhe të qeverisë sonë në këtë bashkëbisedim do të jenë shokët Mehmet Shehu dhe Hysni Kapo. Ne propozojmë që përfaqësuesit tanë dhe përfaqësuesit tuaj të takohen gjatë kohës që zhvillon punimet Mbledhja e partive komuniste e punëtore në Moskë, kur ta shihni ju të përshtatshme.

Ne kemi besim se, me vullnet të mirë, mosmarrëveshjet tona mund të eliminohen dhe miqësia e dashuria midis popujve dhe partive tona do të forcohen edhe më tej.

*Me përshëndetje komuniste
Delegacioni i PPSH në Mbledhjen e partive
komuniste e punëtore*

**Botohet sipas origjinalit
që ndodhet në Arkivin
Qendror të Partisë**

PLENUMI XXI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 19-20 dhjetor 1960

KOMUNIKATË

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

Më 19-20 dhjetor 1960 u mbledh Plenumi i Komitetit Qendror nën kryesinë e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të PPSH, shokut Enver Hoxha.

Plenumi dëgjoi raportin e mbajtur nga shoku Enver Hoxha në emër të delegacionit të PPSH që mori pjesë në punimet e Mbledhjes së përfaqësuesve të partive komuniste dhe punëtorë që u mbajt gjatë muajit nëntor 1960 në Moskë.

1) Plenumi diskutoi dhe aprovoi njëzëri raportin e shokut Enver Hoxha si dhe gjithë veprimtarinë e delegacionit të PPSH gjatë punimeve të Mbledhjes së përfaqësuesve të partive komuniste e punëtorë dhe mori rezolutën përkatëse.

2) Plenumi aprovoi njëzëri Deklaratën dhe Thirrjen e Mbledhjes së Moskës drejtuar popujve të gjithë botës.

3) Plenumi i Komitetit Qendror vendosi gjithashtu që Kongresi IV i Partisë së Punës të Shqipërisë të mbahet më 13 shkurt 1961.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Nr. 132

NGA REZOLUTA

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË MBI MBLEDHJEN E PËRFAQËSUESVE TË 81 PARTIVE KOMUNISTE E PUNËTORE NË MOSKË NË NËNTOR 1960.

20 dhjetor 1960

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH, i mbledhur më datën 19-20 dhjetor 1960, dëgjoi dhe diskutoi raportin e mbajtur nga Sekretari i Parë i Komitetit Qendror, shoku Enver Hoxha, që krye-

soi delegacionin e Partisë së Punës të Shqipërisë në Mbledhjen e përfaqësuesve të 81 partive komuniste e punëtorë në Moskë.

Plenumi aprovoi njëzëri veprimtarinë e delegacionit të Partisë sonë që mori pjesë në Mbledhjen e Moskës si dhe Deklaratën dhe Thirrjen drejtuar nga ajo mbledhje popujve të botës.

Plenumi i KQ të PPSH thekson se Deklarata e 81 partive komuniste e punëtorë është një dokument programatik për lëvizjen komuniste ndërkombëtare ku, në bazën e mësimëve të pavdekshme të marksizëm-leninizmit dhe të eksperiencës kolektive të të gjitha partive komuniste e punëtorë, përcaktohen pozitat parimore për çështjet më të rëndësishme aktuale dhe detyrat e luftës së tyre të mëtejshme për paqen, pavarësinë kombëtare, demokracinë dhe socializmin.

... Partitë komuniste dhe punëtorë e ruajnë unitetin e tyre si gjënë më të shtrenjtë dhe e forcojnë atë çdo ditë mbi parimet e marksizëm-leninizmit dhe të internacionalizmit proletar. Në bazën e unitetit të lëvizjes komuniste ndërkombëtare qëndron uniteti i partive komuniste e punëtorë të vendeve socialiste, uniteti i kampit socialist... Plenumi e konsideron Deklaratën e 81 partive si dokumentin bazë për forcimin e mëtejshëm të unitetit të partive komuniste e punëtorë të të gjitha vendeve dhe të kampit socialist. Partia e Punës e Shqipërisë, edhe në të ardhshmen, do të vërë të gjitha forcat e saj për ta bërë unitetin tonë të pathyeshëm.

Mbledhja e 81 partive dënoi gjithashtu formën jugosllave të oportunizmit ndërkombëtar, që është bërë shprehje e koncentruar e «teorive» të revizionistëve të sotëm. Në Deklaratë tregohet fytyra e vërtetë e revizionistëve jugosllavë si tradhëtarë të marksizëm-leninizmit, që bëjnë një punë minuese kundër kampit socialist dhe lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Plenumi i KQ të Partisë e konsideron si shumë të rëndësishëm lidhur me këtë çështje konkluzionin që përmban Deklarata për nevojën e demaskimit të mëtejshëm të udhëheqësve të revizionistëve jugosllavë, duke e quajtur këtë si një detyrë të domosdoshme edhe për të ardhshmen për çdo parti marksiste-leniniste.

Plenumi i KQ të PPSH porositi të gjitha organizatat e Partisë që t'i studjojnë me vëmendje të madhe dokumentat historike të Mbledhjes së partive komuniste e punëtorë që u mbajt në Moskë, në nëntor të vitit 1960, Deklaratën dhe Thirrjen drejtuar gjithë popujve, t'i propagandojnë ato gjerësisht në masat gjatë fushatës për përgatitjen e Kongresit IV të Partisë dhe të mbështeten në to për të gjithë punën e tyre.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Botohet sipas gazetës
«Zëri i Popullit», Nr.
305, datë 21 dhjetor 1960

**LETËR E KQ TË PPSH DREJTUAR GJITHË ORGANIZATAVE
TË PARTISË MBI ZHVILLIMIN E MBLLEDHJES SË MOSKËS
TË VITIT 1960 TË 81 PARTIVE KOMUNISTE E PUNËTORE
DHE MBI QËNDRIMIN E PPSH NË LUFTËN KUNDËR
REVIZIONIZMIT MODERN**

31 dhjetor 1960

Shokë,

Duke shikuar me vëmendje rrugën e bërë gjatë këtyre vjetëve që na ndajnë nga Kongresi III i Partisë, nuk mund të mos krenohemi me të drejtë për punën madhështore të bërë nga populli ynë trim e punëtor, i udhëhequr me urtësi dhe zotësi nga Partia e tij marksiste-leniniste, nga Komiteti i saj Qendror me udhëheqësin e sprovuar dhe të dashur shokun Enver Hoxha në krye për ndërtimin e socializmit në vendin tonë.

Së shpejti do të mbledhet Kongresi IV i Partisë, i cili do të bëjë bilancin e fitoreve të shkëlqyera të korrura në këto vjet pune dhe luftime të palodhur dhe do të përcaktojë detyrat madhështore për periudhën e ardhshme për planin e tretë pesëvjeçar të zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës në Republikën Popullore të Shqipërisë. Sukseset e shkëlqyera që korrëm, duke arritur 1 vit para afatit nivelin e prodhimit industrial të parashikuar në planin e dytë pesëvjeçar, duke plotësuar një vit para afatit detyrën shumë të rëndësishme që shtroi Kongresi III i Partisë për transformimin socialist të fshatit, duke realizuar me sukses të gjitha detyrat e pesëvjeçarit edhe në fushën e ngritjes së nivelit të jetesës materiale dhe kulturele të masave punonjëse, përbëjnë një bazë shumë të shëndoshë për ecjen me ritme më të shpejta përpara në rrugën e ndërtimit të socializmit.

Baza ekonomike e socializmit tashmë është ndërtuar në vendin tonë. Sektori socialist i ekonomisë sundon sot në mënyrë absolute në të gjitha fushat e ekonomisë së vendit tonë; lufta midis socializmit dhe kapitalizmit në ekonominë e vendit tonë u fitua plotësisht nga ana e socializmit; klasat shfrytëzuese si klasa e me to bashkë edhe shfrytëzimi i njeriut prej njeriut janë zhdukur...

Në këto vjet që na ndajnë nga Kongresi III i Partisë ndryshime të rëndësishme, në dobi të socializmit, janë bërë gjithashtu edhe në situatën ndërkombëtare.

Para së gjithash, është rritur në mënyrë të vrullshme fuqia dhe influenca ndërkombëtare e sistemit socialist botëror. Fuqia e socializmit ja ka kaluar fuqisë së imperializmit... Të gjitha këto suksese shënojnë triumfin e marksizëm-leninizmit dhe u tregojnë masave punonjëse të mbarë botës, që ende vuajnë nën kthetrat e kapitalizmit, rrugën që duhet të ndjekin për të siguruar një jetë të lumtur e në paqe.

Së dyti, në situatën ndërkombëtare, gjatë kësaj periudhe, është vënë re një proces aktiv i shthurjes së sistemit kolonial, nën goditjet e luftës nacional-çlirimtare të popujve të shtypur. Që nga mbarimi i Luftës së dytë botërore dhe deri më sot rreth 40 shtete të reja, të pavarura, kanë lindur në Azi dhe në Afrikë. Fitorja e revolucionit në Kubë i dha një nxitje gjithashtu edhe luftës për çlirimin kombëtar në Amerikën Latine. Këto suksese tregojnë se shkatërrimi i plotë i kolonializmit është i pashmangshëm. Shembja e sistemit të skllavërisë koloniale, pas krijimit të sistemit botëror të socializmit, shënon një ngjarje të rëndësishme historike botërore.

Më në fund, në situatën ndërkombëtare të kësaj periudhe është vënë re një rënje dhe shthurje e mëtejshme e sistemit botëror kapitalist. Kontradiktat e thella, që e brejnë nga brenda sistemin kapitalist, kanë marrë sot formën më të ashpër. Asnjëherë deri më sot konflikti midis forcave prodhuese dhe marrëdhënjeve në prodhim në botën kapitaliste, konflikt ky që zgjidhet me revolucionin proletar, nuk ka qenë kaq i thellë. Kapitalizmi, më tepër se kurdoherë, po pengon përdorimin e realizimeve të shkencës dhe të teknikës moderne në interes të përparimit shoqëror. Krizat ekonomike të superprodhimit pasojnë njëra-tjetrën. Dhe në vendin më të zhvilluar kapitalist, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duket fare qartë kalbëzimi i sistemit kapitalist. Është bërë një fenomen i përhershëm shfrytëzimi jo i plotë i forcave prodhuese, papunësia mjaft e madhe kronike, grabitja e vendeve të tjera të Azisë, e sidomos të Amerikës Latine, militarizimi i shëmtuar i ekonomisë etj. Të gjitha këto tregojnë se edhe vendi më i pasur kapitalist po kalbet, po dekompozohet, se imperializmi amerikan është bërë shfrytëzuesi më i madh ndërkombëtar.

Duke dashur të gjejmë rrugëdalje nga kjo situatë, imperialistët, me imperializmin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në krye, mundohen, nga njëra anë, të mbysin në gjak çdo lëvizje përparimtare e çlirimtare, e në këtë drejtim imperializmi amerikan është bërë kështjella kryesore e reaksionit botëror,

xhandar ndërkombëtar, armiku më i madh i gjithë popujve të botës, dhe nga ana tjetër, po përgatiten me ethe për një luftë të tretë botërore, kundër vendeve të kampit socialist, për vendosjen e sundimit botëror nga ana e imperializmit amerikan. Krijimi i bloqeve ushtarake në shumë rajone të botës, krijimi i bazave ushtarake amerikane përreth vendeve të kampit socialist, gara e shfrenuar e armatimeve, përgatitja me zell e shpejtësi e vatrave të sulmit në Gjermaninë Perëndimore e në Japoni tregojnë qartë qëllimet agresive, luftëdashëse, të imperializmit në përgjithësi e në mënyrë të veçantë të imperializmit amerikan. Dhe në qoftë se deri tani imperialistët nuk kanë shpërthyer një luftë të tretë botërore, kjo jo për dëshirën e tyre, por pse forcat e socializmit e të paqes ua kanë ndaluar dorën...

Bilanci i forcave në arenën ndërkombëtare anon nga ana jonë. Forcat e socializmit dhe të paqes ua kalojnë forcave të imperializmit dhe të luftës.

Pra, nga njëra anë, zhvillimi i situatës ndërkombëtare dhe, nga ana tjetër, sukseset ekonomike të vendit tonë, e veçanërisht perspektivat që hap para nesh plani i tretë pesëvjeçar, i cili do ta vërë Shqipërinë në rrugën e transformimit nga një vend agraro-industrial në një vend industrialo-agrar, na bëjnë që ta shikojmë me optimizëm të ardhshmen.

Por, në të njëjtën kohë, ne nuk do t'ja lejojmë kurrë vetes të dehemi nga sukseset e të biem në gjumë, pse përballë nesh qëndrojnë armiq të egër e gjaksorë, qëndrojnë imperialistët dhe shërbëtorët e tyre revizionistët jugosllavë dhe gjithë revizionistët modernë, monarko-fashistët grekë e reaksioni italian, të cilët janë gati të shfrytëzojnë çdo dobësi ose mungesë vigjilence nga ana jonë. Prandaj, ashtu si dhe deri sot, edhe në të ardhshmen ne do të ndërtojmë socializmin duke mbajtur në njërin dorë kazmën e në tjetrën pushkën.

Kuptimi i drejtë nga çdo komunist i situatës ndërkombëtare dhe përgjithësisht i ngjarjeve të ndryshme politike, ka rëndësi të madhe, sepse ato tregojnë, nga njëra anë, se situata zhvillohet në dobi të socializmit, në dobinë tonë, pra nxisin optimizmin në masat, të cilat mobilizohen më mirë për zbatimin e detyrave konkrete që shtron përpara tyre Partia, dhe, nga ana tjetër, ato na bëjnë që të jemi kurdoherë vigjilentë e të kujdesshëm, na kujtojnë që të hapim sytë për të qenë kurdoherë të gatshëm ndaj çdo veprimtarie agresive të armiqve tanë.

Në këtë situatë ndërkombëtare u mblodh Konferenca e Moskës e 81 partive komuniste e punëtore të botës. Qëllimi i Konferencës së Moskës, e cila filloi me 10 nëntor dhe mbaroi me 1 dhjetor 1960, sikurse dihet, ishte të analizonte situatën ndërkombëtare dhe të nxirrte detyrat që dalin përpara gjithë lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Kjo gjë kishte rëndësi të madhe.

duke marrë parasysh se, siç dihet, në gjirin e lëvizjes komuniste kanë lindur mosmarrëveshje të thella ideologjike e politike, që kanë të bëjnë me taktikën dhe strategjinë e lëvizjes komuniste, me zbatimin e drejtë të marksizëm-leninizmit, disa parime të të cilit janë shkelur nga disa parti dhe në radhë të parë nga udhëheqja e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, me shokun N. Hrushov në krye.

Konferenca e Moskës i bëri një analizë konkrete, marksiste-leniniste, gjendjes së sotme ndërkombëtare, raportit të forcave në botë dhe aprovoi njëzëri Deklaratën e Moskës të 81 partive komuniste e punëtore. Deklarata e 81 partive komuniste e punëtore ka një rëndësi shumë të madhe, sepse ajo përbën programin bazë për çdo parti komuniste në luftën për paqen, për demokracinë, pavarësinë kombëtare dhe socializmin. Ajo përcakton në këtë drejtim detyrat konkrete të çdo partie marksiste. Partia jonë e Punës e aprovoi plotësisht deklaratën dhe do ta ketë atë program pune në të ardhshmen, jo vetëm pse përmbajtja e saj është marksiste-leniniste, por edhe se përmbajtja e saj puqet plotësisht me vijën e Partisë sonë, është një pasqyrë ku ne shohim fare qartë se sa e drejtë e marksiste-leniniste ka qenë dhe është në të gjitha çështjet vija e Partisë sonë heroike të Punës.

Deklarata që u aprovua në Moskë ka rëndësi të madhe për unitetin e lëvizjes komuniste e punëtore, për unitetin e kampit socialist. Ajo përbën një bazë reale, konkrete për forcimin e mëtejshëm të këtij uniteti. Kjo ka rëndësi shumë të madhe, veçanërisht në qoftë se kemi parasysh se në lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare ekzistojnë mosmarrëveshje të thella me karakter ideologjik e politik. Këto mosmarrëveshje, të cilat në fillim u shfaqën si mosmarrëveshje midis Partisë Komuniste të Kinës dhe Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, por që më vonë u bënë midis partive të ndryshme në gjirin e gjithë lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare, janë në fakt mosmarrëveshje midis partive që mbrojnë me vendosmëri e konsekuencë marksizëm-leninizmin dhe partive që shtrembërojnë ideologjinë tonë fitimtare, janë mosmarrëveshje midis partive që i kanë qëndruar besnike dhe kanë zbatuar me përpikmëri Deklaratën e Moskës të vitit 1957 dhe partive që e kanë shkelur këtë Deklaratë dhe parimet e saja.

Ku konsistojnë mosmarrëveshjet parimore në lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare?

1. — *Mbi përcaktimin e karakterit të epokës sonë*: Në Deklaratën e Moskës thuhet se përmbajtja themelore e epokës sonë është kalimi nga kapitalizmi në socializëm. Kjo do të thotë se epoka jonë karakterizohet nga epërsia e forcave të socializmit mbi ato të imperializmit, nga epërsia e forcave të paqes mbi ato

të luftës, nga epërsia e forcave të demokracisë mbi forcat e reaktionit, nga epërsia e forcave të lëvizjes nacional-çlirimtare mbi forcat e kolonialistëve; pra epoka jonë është epoka e revolucioneve, e shembjes së imperializmit, e triumfit të socializmit dhe të komunizmit. Këtë pikëpamje ka Partia Komuniste e Kinës, këtë vijë e pikëpamje ka patur dhe ka Partia jonë e Punës. Duke u nisur nga këto konkluzione, Partia jonë ka theksuar gjithnjë se raporti i forcave në botë ka ndryshuar në dobi të socializmit, por në të njëjtën kohë Partia jonë ka theksuar se nuk duhen nënvleftësuar forcat e reaksionit imperialist, forcat e armiqve, sepse derri, megjithëse i plagosur, përsëri dërr mbetet, bile është gati nga dëshpërimi të hidhet në çdo aventurë. Prandaj Partia ka kërkuar kurdoherë të demaskohet imperializmi dhe veçanërisht imperializmi amerikan, të forcohet vigjilenca ndaj intrigave të imperializmit, i cili nuk ka ndryshuar natyrën, por mbetet agresiv siç ka qenë (populli thotë: ujku qimen ndërron, por kurrë zakonin), se vetëm me përpjekje të përbashkëta të popujve duhet ta bëjmë zap imperializmin që të mos shpërthejë një luftë të re etj. Armiku kryesor është imperializmi amerikan. Kjo ka qenë kurdoherë vija e drejtë marksiste-leniniste e Partisë sonë. Këtë ka lindur parulla jonë: «në njërin dorë kazmën e në tjetrën pushkën».

Mirëpo kohët e fundit shokët e udhëheqjes sovjetike në disa fjalime dhe në shtypin e tyre filluan të nxjerrin disa konkluzione të reja, që janë në kundërshtim me Deklaratën e Moskës. Disa herë forcat e imperializmit nënvleftësohen, duke u paraqitur çështja sikur ato bëjnë ç't'u themi ne. Por jeta tregon se nuk është kështu. Shembulli i ngjarjeve në Kongo, në Algjeri, në Laos vërteton se imperializmi vepron kundër vullnetit tonë. Kur nënvleftësohen forcat e armikut patjetër mbytet vigjilenca e popujve, vihen popujt në gjumë, dhe kjo është shumë e rrezikshme. Kur mendohet se imperialistët bëjnë ashtu siç duam ne, kjo do të thotë se imperializmi ka ndryshuar natyrën e tij, nuk është më agresiv dhe i egër, shtypës dhe xhandar ndërkomëtar. Puna arriti deri atje sa në disa fjalime të disa udhëheqësve sovjetikë dhe në shtypin e disa vendeve të tjera të demokracisë popullore të Evropës thuhej se Ajzenhaueri është për paqen, se një pjesë e borgjezisë reaksionare preferon më tepër socializmin se sa luftën etj. Kështu, për shembull, në fjalimin e tij me rastin e kthimit nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, më 29 shtator 1959, shoku Hrushov tha: «Nga kjo tribunë e lartë, përpara moskovitëve, përpara të gjithë popullit, përpara qeverisë dhe partisë sonë, unë dua të them se Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës D. Ajzenhauer u tregua një burrë shteti i urtë në vlerësimin e gjendjes ndërkomëtare, tregoi burrëri dhe vullnet të fortë... Ai është një njeri që gëzon mirëbesimin absolut të popullit të tij... Mua m'u krijua

përshtypja se ai dëshiron sinqerisht likuidimin e gjendjes së «luftës së ftohtë», krijimin e marrëdhënjeve normale midis vendeve tona, përkrahjen e përmirësimit të marrëdhënjeve midis të gjitha vendeve». Pikërisht këto koncepte bënë që në një gazetë bullgare të nxirret Ajzenhaueri duke marrë në dorëzim tufa lulesh, si luftëtar për paqen. Natyrisht, këto nuk janë pikëpamje të drejta marksiste. Prandaj për të justifikuar pikëpamjen e tyre shokët sovjetikë e disa të tjerë filluan të flasin se tani nuk jemi si 50 vjet më parë, pra se mësimet e Leninit nuk vlejné për ditët tona, se leninizmi është «vjetëruar» etj. Duket sheshit se këto pikëpamje janë të gabuara, prandaj në kundërshtim me to ishte Partia Komuniste e Kinës, Partia jonë e Punës dhe disa parti të tjera. Në Deklaratën e aprovuar tani në Moskë, si rezultat i luftës së vendosur të partive tona që qëndronin në pozita të drejta marksiste, jepet përcaktimi i drejtë i karakterit të epokës, i karakterit të imperializmit dhe caktohen detyrat luftarake të partive komuniste.

2. — *Mbi çështjen e luftës dhe të paqes.* Edhe në këto çështje ka mosmarrëveshje të mëdha. Si shtrohen këto çështje nga ana marksiste?

E para, marksizmi me fjalën luftë njeh 4 lloje luftrash: luftrat botërore, luftrat lokale e agresive, që vijnë si rezultat i agresionit imperialist, luftrat nacional-çlirimtare të popujve të shtypur kundër shtypësve dhe luftrat revolucionare të klasave të shtypura kundër shfrytëzimit kapitalist. Komunistët janë kundër dy luftrave të para, por ata pranojnë dhe mbështesin dy llojet e luftrave të fundit.

E dyta, burimi i luftrave është sistemi kapitalist dhe veçanërisht imperializmi, sistemi i shfrytëzimit nacional dhe social.

E treta, në konditat e sotme, kur raporti i forcave ka ndryshuar në dobi të socializmit, kur forcat e paqes kanë epërsi mbi forcat e luftës, simbas mësimëve të marksizëm-leninizmit, ka mundësi që të shmanget lufta botërore si dhe luftrat lokale agresive që shkakton imperializmi. Këtu e ka burimin lufta për paqen. Por luftrat nacional-çlirimtare dhe luftrat revolucionare nuk mund dhe nuk duhet të shmangen; ato duhen përkrahur, sepse dobësojnë imperializmin dhe çlirojnë popujt nga sundimi nacional dhe social.

Duke u nisur nga këto mësimet të marksizëm-leninizmit dhe duke u qëndruar atyre gjithmonë besnike, Partia jonë ka ndjekur me konsekuencë këtë vijë të drejtë; gjithnjë ka demaskuar imperializmin dhe veçanërisht imperializmin amerikan si luftënxitës, si armikun më të rrezikshëm të popujve, ka përkrahur luftën e drejtë çlirimtare të popujve të shtypur, ka luftuar me vendosmëri për mbrojtjen e paqes. Por, duke luftuar për mbrojtjen e paqes, Partia jonë i ka shpjeguar kurdoherë popullit se ekziston edhe mundësia e luftës, e rrezikut të saj, prandaj ka kërkuar for-

efmin e vigjilencës dhe të fuqisë mbrojtëse të vendit tonë, me qëllim që të jemi të gatshëm për çdo eventualitet. Pra, ne gjithnjë kemi vepruar duke patur parasysh dy mundësitë: edhe mundësinë e shmangjes së luftës, edhe mundësinë e shpërthimit të saj nga imperialistët. Populli ynë, në sajë të punës së Partisë, është pregtatur për të dyja mundësitë. Kjo është rruga e drejtë leniniste, sepse duke bërë të qartë mundësinë e ndalimit të luftës, forcohet besimi i popujve në të ardhshmen, merr hov lëvizja për paqen, kurse duke folur edhe për mundësinë e shpërthimit të luftës, forcohet vigjilenca dhe gatishmëria luftarake e popujve për të mos u gjendur kurrë në befasi.

Se sa e drejtë ka qenë dhe është kjo vijë e Partisë sonë, si dhe e Partisë Komuniste të Kinës, e partive të vendeve të tjera që ndjekin po këtë rrugë, e tregon Deklarata që u aprovua në Moskë nga 81 partitë komuniste e punëtoresh, ku çështja e luftës dhe e paqes, çështja e dy mundësive (ajo e shmangjes së luftës dhe ajo e shpërthimit të saj) paraqiten pikërisht ashtu siç i ka kuptuar dhe i kupton Partia jonë.

Mirëpo kohët e fundit lidhur me këto probleme jetike për njerëzimin lindën mosmarrëveshje me shokët udhëheqës sovjetikë dhe të disa vendeve të tjera, të cilët filluan t'i shtrembërojnë mësimet marksiste për problemet e luftës dhe të paqes. Veçanërisht këto mosmarrëveshje u dukën më qartë në kohën e vizitës së shokut Hrushov në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në disa fjalime të tij dhe në shtyp theksohej se në kohën e sotme ka mundësi të ndalohet çdo luftë, pa bërë dallim midis luftimeve që shpërthen imperializmi dhe luftimeve të drejta që bëjnë popujt e shtypur dhe klasat e shtypura. Këtë rrjedh gabimi tjetër, që lufta nacional-çlirimtare e popujve të shtypur nuk është mbështetur e ndihmuar sa duhet. Shembull konkret është Algjeria, ku ka 6 vjet që vazhdon lufta e këtij populli heroik. Nga ana tjetër, në propagandën sovjetike dhe të disa vendeve filloi të flitej vetëm për mundësinë e shmangjes së luftës, kurse për rrezikun e shpërthimit të saj as nuk bëhej zë. Bile filloi të mos flitej për imperializmin amerikan dhe të mos demaskohej rreziku i tij. Për të siguruar paqen shpresat më të mëdha u varën te personalitetet, te mbledhja e të mëdhenjve, te «politikanët e veçantë» dhe «arësytet e qëllimet e mira» të krerëve të imperializmit, me Ajzenhauerin në krye, dhe jo te lufta e popujve, te bashkimi dhe aksioni konkret i forcave të paqes, siç theksonte Deklarata e Moskës e vitit 1957. Për rrjedhim, lëvizja për paqe filloi të bjerë, organizatat ndërkombëtare po dobësoheshin. Doli parulla e çarmatimit të plotë. A është e mundur që kapitalistët e imperialistët të hedhin të gjitha armët, të çarmatosen plotësisht? Lenini thotë se vetëm kur të triumfojë socializmi në të gjithë botën, pra kur nuk do të ketë klasa, mund të arrihet çarmatimi i plotë, mund të prishen krejtësisht

armët. A nuk krijohet kështu përshtypja e gënjeshtërt se imperializmi nuk është më agresiv, se ai ka ndryshuar natyrën? A nuk vihet në gjumë kështu vigjilenca e popujve? A nuk është ky largim nga mësimet e marksizëm-leninizmit?

Kundër këtyre pikëpamjeve ka qenë dhe është Partia Komuniste e Kinës, Partia jonë e Punës e disa parti të tjera, që me vendosmëri mbrojnë pastërtinë e marksizëm-leninizmit. Pikërisht për këtë arsye ne na akuzojnë se gjoja jemi për luftën, se gjoja jemi kundër politikës së bashkekzistencës, se gjoja nuk e kuptojmë situatën e krijuar në botë etj. Por aprovimi i Deklaratës së Moskës nga 81 parti komuniste e punëtoresh, ku në fakt shprehet pikëpamja jonë, tregoi se ne e kuptojmë shumë drejt situatën, se vija e Partisë sonë ka qenë dhe është plotësisht e drejtë, marksiste-leniniste.

3. — *Mbi problemin e bashkekzistencës paqesore.* Politika e bashkekzistencës paqesore është përpunuar nga Lenini i madh dhe përbën bazën mbi të cilën mbështeten marrëdhënjet e shteteve socialiste me shtetet kapitaliste. Partia jonë, gjatë gjithë veprimtarisë së saj, ka ndjekur me konsekuencë një politikë të jashtme paqesore dhe në marrëdhënje me shtetet kapitaliste ka zbatuar parimet e bashkekzistencës paqesore. Partia jonë, në të njëjtën kohë, duke luftuar kundër çdo kuptimi oportunist të këtij parimi leninist, ka theksuar gjithnjë se politika e bashkekzistencës paqesore nuk shtrihet në marrëdhënjet midis klasave të ndryshme brenda vendeve kapitaliste, se ajo nuk shtrihet në marrëdhënjet midis popujve të shtypur e kolonialë dhe shtypësve të tyre imperialistë e kolonialistë. Përkundrazi, lufta e klasave në vendet kapitaliste, si dhe lufta çlirimtare në vendet e shtypura e koloniale, duhet të zhvillohen më me forcë për të dobësuar pozitat e kapitalizmit e të imperializmit, për të detyruar shtetet imperialiste që të pranojnë bashkekzistencën paqesore me vendet socialiste. Nga ana tjetër lufta për bashkekzistencën paqesore nuk duhet të përjashtojë, por përkundrazi duhet të nënkuptojë zhvillimin e pandërprerë të luftës ideologjike e politike kundër imperializmit dhe shërbëtorëve të tij. Kjo do të thotë se nuk ka e nuk mund të ketë bashkekzistencë ideologjike e politike as me imperializmin, as me revizionizmin, as me çdo shërbëtor tjetër të imperializmit. Ndryshe largohemi nga mësimet leniniste.

Këto pikëpamje të drejta leniniste kanë mbrojtur e kanë zbatuar Partia e Punës e Shqipërisë, Partia Komuniste e Kinës dhe disa parti të tjera. Por shokët e udhëheqjes sovjetike dhe ata të disa vendeve të tjera, veçanërisht shokët bullgarë e rumunë, e kuptojnë dhe e zbatojnë ndryshe parimin leninist të bashkekzistencës paqesore. Ata e quajnë këtë parim si «vijën e përgjithshme të politikës së jashtme të vendeve socialiste», sikur «politika e bashkekzistencës paqesore përbën gjithë përmbajtjen

e politikës së jashtme të vendeve socialiste». Natyrisht, kjo nuk është e drejtë, sepse politika e jashtme e vendeve socialiste përbëhet nga tri aspekte kryesore: *e para*, në marrëdhënjet midis vendeve socialiste si bazë është parimi i bashkëpunimit vëllazëror, parimi i ndihmës dhe i përkrahjes reciproke internacionaliste njëri-tjetrit dhe jo parimi i bashkekzistencës paqesore; *e dyta*, në marrëdhënjet me popujt e shtypur e kolonialë, si bazë është politika e mbështetjes dhe e përkrahjes së luftës revolucionare antiimperialiste dhe antikoloniale të këtyre popujve, dhe jo vetëm parimi i bashkekzistencës paqesore; *e treta*, në marrëdhënjet me vendet me sisteme të ndryshme shoqërore si bazë është politika leniniste e bashkekzistencës paqesore. Në qoftë se nuk kuptohet kështu, por parimi i bashkekzistencës paqesore zbatohet edhe në dy rastet e para, kjo dëmton edhe bashkëpunimin vëllazëror midis vendeve socialiste, edhe luftën çlirimtare të popujve, së cilës nuk do t'i sigurohet përkrahja e nevojshme.

Nga këto koncepte të gabuara rrjedhin edhe konceptet e tjera, simbas të cilave në disa raste politika e bashkekzistencës paqesore që ndjekin vendet socialiste me vendet kapitaliste është shtrirë edhe në marrëdhënjet midis klasave, në luftën e klasave. Kështu, për shembull, komunistët francezë, apo ata indianë, kur Ajzenhaueri vajti për vizitë në vendet e tyre, e përshëndetën atë «si lajmëtar të paqes», ose kërkuan që edhe komunistët të merrnin pjesë në ceremonitë zyrtare të përshëndetjes së tij etj. Ose në një artikull të botuar në «Problemet e paqes dhe të socializmit», shoku Zhivkov i Bullgarisë shtron çështjen se «bashkekzistenca paqesore është rruga e triumfit të socializmit në shkallë botërore». Shtruarja e problemit në një mënyrë të tillë është e gabuar. Kështu lihet mënjanë mësimi i Leninit mbi luftën e klasave, mbi revolucionin socialist si forma më e lartë e luftës së klasave. Çdo gjë mbështetet te bashkekzistenca paqesore. Duket sikur socializmi do të vijë vetë, atë do t'ua sjellë si dhuratë popujve politika e bashkekzistencës paqesore që ndjekin vendet socialiste.

Po kështu mund të thuhet edhe përsa i përket luftës ideologjike dhe politike. Për hir të bashkekzistencës paqesore, nga frika se mos dëmtohet ajo, u pushua gati fare, për një kohë, lufta për demaskimin e imperializmit amerikan. Në disa fjalime të udhëheqësve sovjetikë filluan lavdërimet për krerët e imperializmit, De Goli u quajt «krenaria e popullit francez» etj. Për luftën politike kundër imperializmit, për demaskimin e tij, filloi të flitet se nuk duhet acaruar puna, duhet kujdes, se kështu e do politika e bashkekzistencës etj. Tipike është gati shuarja e plotë e luftës ideologjike e politike kundër revizionizmit jugosllav, me pretekstin se Jugosllavia, në disa çështje të politikës së jashtme, mbështet propozimet sovjetike. Kuptimi oportunist i bashkekzistencës paqesore e shpuri N. Hrushovin deri atje sa ai bisedoi

me shovinistin grek, Sofokli Venizellosin, për çështjen e minoritetit grek në Shqipëri. Sofokli Venizellosi i shtroi Hrushovit çështjen që minoritetit grek në Shqipëri t'i njihet e drejta e autonomisë. Ky shovinist i tërbuar, djali i Elefter Venizellosit, vrasësit të shqiptarëve, djegësit të krahinave shqiptare të Jugut, frymëzuesit të megaliidhesë greke dhe të copëtimit të Shqipërisë, nën parullën e autonomisë, kërkoi të përsërisë të kaluarën. Dhe Hrushovi, në vend që t'i mbyllë gojën këtij armiku të popullit shqiptar dhe t'i tregojë vendin, si pa gjë të keqe i thotë se kur ishte në Shqipëri pa në Korçë se grekët rronin mirë dhe se çështjen e autonomisë do t'ua transmetonte udhëheqësve shqiptarë. A është ky qëndrim marksist? A është ky qëndrim internacionalist dhe miqësor? E ku i pa grekët Hrushovi në Korçë, ku nuk ka as fije minoriteti?

Komiteti Qendror i Partisë sonë, kur mori vesh për këtë bisedim të Hrushovit me Venizellosin, protestoi me vendosmëri pranë Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, qysh në muajin korrik 1960. Ne theksuam se kufitë e Shqipërisë janë të paprekshëm dhe të shenjtë, kush i prek ata është agresor dhe derdhet gjak. Për kufitë tanë, për të drejtat e popullit shqiptar, ne nuk kemi lejuar dhe nuk lejojmë askend që të diskutojë, qoftë edhe për hir të politikës së bashkekzistencës paqesore. Këto fjalë ne i thamë edhe në Moskë, në Konferencën e 81 partive komuniste e punëtoare.

Në Deklaratën e Moskës, që u aprovua tani së fundi në Moskë, theksohet se politika e bashkekzistencës paqesore zbatohet nga shtetet socialiste në marrëdhënjet e tyre me vendet me sisteme të ndryshme shoqërore, se bashkekzistenca paqesore nuk nënkupton zhdukjen e luftës së klasave, përkundrazi lufta e klasave duhet të rritet, lufta politike dhe ideologjike për demaskimin e imperializmit duhet të forcohet. Pra edhe për këtë çështje të madhe shihen qartë pikëpamjet e Partisë sonë se vija e saj ka qenë dhe është plotësisht e drejtë dhe e bazuar në mësimet e marksizëm-leninizmit.

4. — *Mbi rrugët e kalimit nga kapitalizmi në socializëm.* Klasikët e marksizëm-leninizmit mësojnë se kalimi nga kapitalizmi në socializëm është një proces revolucionar, si rezultat i të cilit duhet të shkatërrohet maqina e vjetër shtetërore e borgjezisë dhe të ndërtohet shteti i diktaturës së proletariatit. Ky proces, marrja e pushtetit nga proletariati, sipas mësimëve të klasikëve të marksizmit, bëhet në rrugë paqesore, dhe në rrugë jopaqesore, me dhunë. Kjo gjë nuk varet nga proletariati, por nga borgjezia, nga shkalla e kundërshtimit të saj; nëse ajo e lëshon pushtetin pa luftë, revolucionin kryhet pa gjak, nëse kundërshton me armë, atëherë revolucionin kryhet me gjak e dhunë. Eksperienca historike e deritanishme tregon se asnjë klasë sunduese nuk e ka lëshuar

pushtetin vullnetarisht, përkundrazi, për mbrojtjen e tij ajo ka përdorur kurdoherë armët.

Duke qenë kështu, Partia jonë ka qenë gjithnjë e mendimit se partitë komuniste e punëtore, që nuk kanë ardhur ende në fuqi, duhet të përgatiten njëkohësisht për të dyja rrugët, për të dyja mundësitë, pra si për marrjen e pushtetit pa gjak, ashtu edhe për marrjen e tij me dhunë. Bile për rrugën e dytë duhet të përgatiten seriozisht. Këtë tregon edhe eksperiencia e Partisë sonë. Po të jesh i përgatitur mirë për rrugën jopaqesore, krijohen më tepër mundësi për vetë rrugën paqesore.

Mirëpo kohët e fundit, e veçanërisht pas Kongresit XX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, ku rruga paqesore u paraqit si një mundësi shumë reale në kohën e sotme, në lëvizjen komuniste ndërkombëtare disa parti, si për shembull Partia Komuniste Italiane, e shtrojnë çështjen sikur ka vetëm një mundësi: të merret pushteti me rrugë paqesore. Këtë tezë hapur e mbështetin edhe udhëheqësit sovjetikë. Ata thonë se në konditat e bashkëzistencës paqesore krijohen më shumë mundësi për rrugën paqesore të revolucionit socialist. Por ku ndodhi kjo? Në cilin vend konkretisht? Të flasësh sot në mënyrë kaq absolute për mundësinë e rrugës paqesore është shumë gabim. Dihet se sot në të gjitha vendet kapitaliste, bile edhe në ato të sapoçliruara, si Egjipti, Iraku, India, Indonezia etj., po rriten e forcohen gjithnjë e më shumë aparatet burokratiko-ushtarake të borgjezisë, forcat e reaksionit po bëhen gjithnjë e më agresive kundër komunistëve, të cilët po burgosen e po nxirren jashtë ligjit etj.

Pra mosmarrëveshjet për këtë problem kanë lindur me interpretimin reformist-oportunist të rrugës paqesore për në socializëm. Deklarata e aprovuar tani së fundi e shtron drejt këtë problem, duke theksuar të dyja rrugët, të dyja mundësitë, por duke theksuar, ashtu siç e ka menduar gjithnjë Partia jonë, se eksperiencia historike tregon se asnjë klasë nuk është larguar kurrë vullnetarisht nga skena e historisë.

5. — *Mbi revizionizmin e dogmatizmin.* Siç dihet, në Deklaratën e Moskës të vitit 1957 theksohet se partitë komuniste duhet të luftojnë kundër revizionizmit, si rreziku kryesor në kohën e sotme në lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare, si dhe kundër dogmatizmit e sektarizmit. Partia jonë e ka zbatuar me vendosmëri e konsekuencë këtë konkluzion të drejtë të Deklaratës së Moskës. Revizionizmi apo oportunizmi i djathtë është një fenomen ndërkombëtar; ai ka rrënjë të thella shoqërore dhe është një pasqyrim i ideologjisë borgjeze. Në epokën tonë, kur partitë komuniste e punëtore zhvillojnë politikën e aleancave të shumta me klasa e shtresa të ndryshme të popullsisë dhe me parti të ndryshme, kur vendet socialiste luftojnë për sigurimin e bashkëzistencës paqesore dhe kur borgjezia imperialiste nuk është

në gjendje hapur të sulmojë forcat e socializmit dhe të lëvizjes punëtore, apo të lëvizjes nacional-çlirimtare e revolucionare, oportunizmi i djathtë, pra revizionizmi, mbetet gjithnjë rrezik kryesor. Shembull tipik i rrezikshmërisë së tij është revizionizmi jugosllav, i cili sundon në një shtet. Pikërisht, e nisur nga këto konsiderata marksiste, Partia jonë ka luftuar dhe vazhdon të luftojë me vendosmëri e guxim kundër revizionizmit në përgjithësi e revizionizmit jugosllav në veçanti. Këtë rrugë ka ndjekur edhe Partia Komuniste e Kinës dhe disa parti të tjera, të cilat kanë zbatuar kështu me besnikëri Deklaratën e vitit 1957.

Por veçanërisht këto vitet e fundit, në disa fjalime të disa udhëheqësve sovjetikë, në shtypin sovjetik dhe në disa parti të tjera konkluzionet e drejta të Deklaratës së 1957-s u lanë pas dore dhe vendin e tyre filluan ta zënë koncepte të gabuara. Filloi të flitet se gjoja «revizionizmi është shkatërruar ideologjikisht» dhe se «është izoluar nga lëvizja komuniste e punëtore», se «nuk duhet të flitet shumë kundër Titos e klikës së tij, se u rritet mendja, u rritet vlera në sytë e imperializmit» etj., etj. Bile nuk munguan edhe fjalët e mira për revizionistët jugosllavë. Kështu në korrik 1957 Hrushovi theksonte: «Vërtet shokët tanë jugosllavë i shqiptojnë disi keq fjalët «kampi socialist», por Jugosllavia është një vend socialist dhe ky është një fakt». Ose udhëheqësi i partisë polake, Gomulka, më 1957 afirmonte se «periudha e grindjeve dhe e keqkuptimeve nuk ishte shkaktuar nga Jugosllavia dhe se asaj i qe bërë një padrejtësi e madhe». Kurse udhëheqësit e Partisë Komuniste Italiane shkruanin se «eksperiencia jugosllave është e denjë për ta studjuar me vëmendje dhe për të treguar një interesim më të madh për të».

Duke patur këto konsiderata antimarksiste, udhëheqësit sovjetikë dhe ata bullgarë kaluan edhe në gabime konkrete. Kështu, p.sh., në një miting në Sremska Mitrovica, ku banditi Rankoviç sulmoi si zakonisht Shqipërinë dhe e quajti atë «një skëterrë, ku mbretëron teli me gjemba dhe çizmja e kufitarit» dhe se demokracia e neofashistëve italianë qenka më e përparuar nga ajo e jona, asistoni si ambasadori sovjetik ashtu edhe ai bullgar dhe që të dy nuk bënë as protestën më të vogël. Komiteti Qendror i Partisë sonë menjëherë protestoi si pranë Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, ashtu edhe pranë Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bullgarisë. Ne u çuditëm kur si përgjigje na u tha se nuk kishim të drejtë të protestonim, sepse fjalimi i banditit Rankoviç konsiderohej si fjalim pozitiv.

Ja dhe një fakt tjetër. Si rezultat i zbutjes së luftës kundër revizionistëve jugosllavë puna arriti deri atje sa në një vend socialist si Bullgaria u shtyp dhe u shpërnda në të gjithë botën një hartë e Ballkanit, në të cilën Shqipëria ishte përfshirë brenda kufive të Jugosllavisë. Komiteti Qendror i Partisë sonë protestoi

edhe për këtë çështje pranë Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bullgarisë. Në përgjigje Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bullgarisë, Zhivkovi, na thosh se ky është një gabim, të cilin e paska bërë një njeri jo i mirë dhe që paska gruan jugosllave. Eja pastaj e lufto kundër revizionizmit jugosllav.

Natyrisht me pikëpamje të tilla as udhëheqësit sovjetikë, as ata bullgarë nuk e quajnë revizionizmin si rrezik kryesor, prandaj as nuk luftojnë kundër tij. Përkundrazi ata më të rrezikshëm nxorën dogmatizmin e sektarizmin. Veçanërisht kohët e fundit, pas Mbledhjes së Bukureshtit, në shtypin sovjetik dhe të disa vendeve socialiste filloi një fushatë e madhe kundër dogmatizmit, kurse revizionizmi e veçanërisht revizionizmi jugosllav u harrua fare. Me revizionistët e Beogradit filluan lajkat dhe prirjet për t'u pajtuar e për t'u afruar gjithnjë e më shumë. Shokët bullgarë i hapën kufitë dhe filluan të organizojnë takime masive (me dhjetëra mijëra persona) në kufi midis popullsisë bullgare e jugosllave. Duke luftuar gjoja kundër dogmatizmit, në fakt shigjetat filluan të drejtohen kundër Partisë Komuniste të Kinës dhe Partisë së Punës të Shqipërisë, të cilat akuzoheshin si gjoja «dogmatike». E përse? Sepse në të gjitha çështjet për të cilat folëm më sipër ne mbronim me vendosmëri Deklaratën e Moskës dhe pastërtinë e marksizëm-leninizmit.

Duke luftuar kundër revizionizmit, si rrezik kryesor, Partia jonë ka luftuar edhe kundër dogmatizmit. Dogmatizmi e sektarizmi shfaqen kur partia është e shkëputur nga masat, nga populli, nga jeta e përditshme, kur partia nuk merr parasysh konditat e veçanta të vendit, veçoritë e tij, por zbaton mësimet e marksizëm-leninizmit kallëp, ashtu si janë shkruar në libra, kur partia kopjon automatikisht eksperiencën e të tjerëve etj. Duke vepruar si parti marksiste, duke mos rënë në dogmatizëm, Partia jonë është parti e popullit punonjës të vendit tonë, ajo është e lidhur si mishi me kockën me popullin tonë, pulsi i Partisë rreh një me pulsën e popullit, mendja e popullit është mendja e Partisë, jeta e popullit është jeta e Partisë, vendimet e Partisë shprehin dëshirat e popullit. Nuk ka të ne asnjë vendim të rëndësishëm partie që më parë të mos jetë diskutuar nga populli: merrni direktivat për planin e tretë pesëvjeçar, merrni tezat mbi riorganizimin e shkollës e shumë e shumë çështje të tjera.

Pikërisht sepse dogmatizmi është i huaj për ne, Partia jonë, me sukses, me forma origjinale e në përshtatje me konditat e veçanta të vendit tonë, ka udhëhequr luftën për çlirim dhe luftën për ndërtimin e socializmit, duke arritur që brenda 16 vjetëve të rritë 25 herë prodhimin e përgjithshëm industrial. Asnjë vend tjetër socialist nuk ka qenë në konditat tona: gjysmë-feudal, me ekonomi të prapambetur, me 80 për qind të popullsisë analfabete,

e rrethuar gjeografikisht nga armiq të tërbuar etj. Vetëm aftësia dhe urtësia e Partisë, zbatimi krijues i marksizëm-leninizmit nga Partia jonë, nga Komiteti i saj Qendror, me themeluesin e udhëheqësin e dashur të Partisë e të popullit tonë shokun Enver Hoxha në krye, mund të zgjidhte aq drejt gjithë ato probleme të koklavitura që janë zgjidhur deri tani. Këtë gjë e kanë pranuar edhe vetë udhëheqësit sovjetikë, të cilët në deklaratën e përbashkët të të dy qeverive e partive tona, në prill 1957, shkruanin: «Delegacioni i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik vuri në dukje rëndësinë e madhe të eksperiencës së Partisë së Punës të Shqipërisë në çështjen e krijimit të frontit të gjerë popullor antifashist e nacional-çlirimtar në vitet e Luftës së dytë botërore, si dhe në realizimin me sukses të detyrave të revolucionit demokratik popullor dhe të ndërtimit të socializmit në kushte specifike të një vendi të tillë të prapambetur dhe gjysmëfeudal siç ishte më parë Shqipëria».

Pra edhe në këtë çështje të madhe parimore, siç është çështja e luftës kundër revizionizmit si rrezik kryesor, si dhe kundër dogmatizmit, jeta tregoi se kush ka vepruar drejt, se kush ka mbrojtur mësimet e pavdekshme të Leninit. Ne përshëndesim Deklaratën e aprovuar tani së fundi në Moskë, e cila jo vetëm ritheksoi se rreziku kryesor mbetet revizionizmi, por në mënyrë të plotë e fare qartë tregoi fytyrën e vërtetë të revizionistëve jugosllavë si tradhëtarë të marksizëm-leninizmit, demaskoi veprimtarinë e tyre minuese e armiqësore dhe caktoi për të gjitha partitë komuniste e punëtore të botës detyrën e demaskimit të mëtejshëm të kësaj bande renegatësh. Deklarata provon se sa drejt e sa qartë e ka parë këtë çështje Partia jonë, e cila, e bindur në mësimet e marksizëm-leninizmit, kurrë ndonjëherë nuk hoqi dorë, por me konsekuencë ka luftuar dhe do të luftojë deri sa të shpartallohet plotësisht banda tradhëtare e Beogradit.

Këto ishin, të dashur shokë, çështjet kryesore, rreth të cilave ka mosmarrëveshje në gjirin e lëvizjes komuniste e punëtore.

Lidhur me këto çështje, lidhur me qëndrimin e saj të drejtë marksist-leninist dhe luftën e vendosur për mbrojtjen e pikëpamjeve të Deklaratës së Moskës të vitit 1957, udhëheqësit sovjetikë dhe ata të disa vendeve të tjera deshën ta dënojnë në Mbledhjen e Bukureshtit Partinë heroike të Kinës, deshën ta akuzojnë atë si fraksioniste, ta nxirrnin nga gjiri i kampit socialist. «Faji» i vetëm i Partisë Komuniste të Kinës është, se ajo nuk ishte dakord me shkelësit e Deklaratës së Moskës, ajo nuk ishte dakord me pikëpamjet e gabuara të shokëve sovjetikë mbi çështjet për të cilat foli me guxim, në mënyrë të qartë e të drejtë në artikujt e broshurës «Rroftë leninizmi», mbrojti pikëpamjen e drejtë marksiste-leniniste dhe Deklaratën e Moskës dhe u tha ndal shkelësve të saj.

Tani, që ju kini të qartë çështjet, për të cilat ekzistojnë mos-

marrëveshjet, mund të kuptoni edhe më mirë se sa prapaskenë e rrezikshme antimarksiste ishte Mbledhja e Bukureshtit, se sa i drejtë e parimor ishte qëndrimi i Partisë sonë në atë mbledhje.

Partia jonë nuk ishte dakord jo vetëm me metodën antimarksiste të organizimit të Mbledhjes së Bukureshtit dhe të zhvillimit të saj, siç ju është shpjeguar në letrën e Komitetit Qendror mbi këtë çështje, por as edhe me përmbajtjen e «akuzave» që i drejtoheshin Partisë Komuniste të Kinës, sepse në fakt «akuzat» kundër Partisë Komuniste të Kinës ishin edhe akuza kundër Partisë sonë, ishin akuza kundër atyre që mbronin marksizmin dhe Deklaratën e Moskës. Prandaj, me shumë të drejtë, Partia jonë në Mbledhjen e Bukureshtit mbajti qëndrimin heroik që dihet, mbrojti me guxim marksizëm-leninizmin, mbrojti Partinë Komuniste të Kinës dhe u gjend në kundërshtim me udhëheqjen e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Se sa drejt veproi Partia jonë në Mbledhjen e Bukureshtit, se sa të drejtë pati Partia jonë, e cila e vlerësoi Bukureshtin si një njollë në lëvizjen komuniste, këtë e vërtetoi më së miri edhe Konferenca e Moskës dhe dokumentat që aprovoi ajo. Asnjë përfaqësues i asnjë partie nuk pati guximin të mbrojë Mbledhjen e Bukureshtit, t'u përgjigjej kritikave tona dhe të shokëve kinezë për punën antimarksiste e fraksioniste që u bë atje. Jo vetëm kaq, por askush nuk pati guximin që të propozonte të vihej ndonjë fjalë e mirë për Mbledhjen e Bukureshtit në Deklaratën që u aprovua dhe që përbëhet nga 52 faqe. Përkundrazi në Deklaratë, kur flitet për nevojën e mbledhjeve të përfaqësuesve të partive komuniste e punëtoresh, merren si shembull mbledhjet e 1957-s dhe kjo e fundit e Moskës. Mbledhjes së Bukureshtit nuk i duket as nami, as nishani. Qëndrimi i Partisë sonë në Mbledhjen e Bukureshtit ka një rëndësi shumë të madhe: ne ngritëm zërin në mbrojtje të marksizëm-leninizmit, ne u ndalëm dorën organizatorëve të prapaskenës antimarksiste të Bukureshtit, të cilët synonin të qëronin hesapet me Partinë Komuniste të Kinës dhe me Partinë tonë, që i pengonin për zbatimin e vijës së tyre oportuniste. Ne hapur, me guxim e vendosmëri thamë fjalën tonë, ashtu siç mëson leninizmi. Marksizëm-leninizmin e mbrojnë jo vetëm partitë e mëdha, por edhe të voglat, ashtu si dhe gabime bëjnë edhe partitë e mëdha e jo vetëm të voglat. Prandaj ne thamë se edhe shokët sovjetikë mund të gabojnë, pra mund dhe duhet të kritikohen me kurajo marksiste.

Mund të lindë pyetja: si është e mundur që udhëheqësit sovjetikë dhe ata të partive të tjera, që kanë një eksperiencë aq të madhe, bënë një gabim të tillë organizativ siç ishte Mbledhja e Bukureshtit, që nuk i lejohet ta bëjë as edhe një udhëheqësi të një organizate bazë? Përgjigjja është e thjeshtë: Derisa udhëheqësit sovjetikë kishin pikëpamje të gabuara në një seri çështjesh parimore, si ato që përmendëm më sipër, derisa ata u futën në një

qorrsoak të tillë, që ishte në kundërshtim me mësimet e marksizëm-leninizmit dhe që binte erë oportuniste, ata gabime të këtij lloji do të bënin patjetër edhe në veprimtarinë praktike, qoftë kjo politike, qoftë organizative, qoftë në marrëdhënjet midis partive e vendeve socialiste. Po shkele parimet ideologjike patjetër do të shkelësh edhe rregullat organizative etj. Dhe në fakt udhëheqësit sovjetikë, përveç gabimit të madh të Mbledhjes së Bukureshtit, kanë bërë edhe gabime të tjera. Nga konceptet e tyre të gabuara ata në lidhje me konfliktin kufitar kino-indian morën anën e Indisë borgjeze dhe akuzuan Kinën socialiste; ata pas Mbledhjes së Bukureshtit hoqën gjithë specialistët sovjetikë nga Kina dhe ndërprejnë furnizimet e maqinerive të porositura më parë nga kinezët në Bashkimin Sovjetik, gjë që në fakt do të thotë të sabotosh ndërtimin e socializmit në Kinë; në lidhje me vendin tonë filluan ndërhyrjet në punët tona të brendshme, me qëllim që të përçanin Partinë, pra të rrëzonin udhëheqjen e saj, filluan presionet ekonomike e politike etj., për të cilat do të flasim më me hollësi më poshtë.

Këtej ne duhet të nxjerrim mësimin: të ruajmë me besnikëri parimet e marksizëm-leninizmit, parimet ideologjike e politike, të cilat përbëjnë vijën themelore të Partisë sonë, sepse vetëm kështu mund të jemi të garantuar nga gabimet parimore. Po u shkelën parimet ideologjike, gabimet e mëdha në praktikë, në çdo drejtim, janë të pashmangshme.

Por me udhëheqësit sovjetikë Partia jonë nuk ka qenë e një mendjeje edhe për një sërë çështjesh të tjera, për të cilat, në kohën e duhur, Partia jonë ka vënë në dijeni udhëheqjen sovjetike, kurse në Konferencën e Moskës foli hapur edhe përpara përfaqësuesve të 81 partive komuniste e punëtoresh motra. Kështu për shembull:

1. — Partia jonë nuk ka qenë e një mendjeje me udhëheqjen sovjetike përse i përket mënyrës dhe masës së kritikës kundër kultit të Stalinit, siç u bë ajo në Kongresin XX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Ne nuk e kemi quajtur dhe as e quajmë të drejtë faktin që kjo kritikë ra si bombë në gjithë lëvizjen komuniste, pa u bërë më parë për këtë qëllim asnjë konsultim midis partive komuniste e punëtoresh motra. Ne mendojmë se një gjë e tillë duhej bërë, sepse Stalini nuk ishte vetëm udhëheqës i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, por ai ishte udhëheqës i lëvizjes komuniste dhe punëtoresh ndërkombëtare, ai ishte personaliteti më me autoritet, emri i të cilit frymëzonte punonjësit e gjithë botës. Nga ana tjetër ne nuk kemi qenë dhe nuk jemi dakord edhe me faktin se në Kongresin XX për Stalinin u frynë pa masë «gabimet», kurse nuk u përmendën fare anët pozitive të veprimtarisë së tij. Stalini, siç e ka deklaruar gjithnjë Partia jonë, mbetet një nga figurat më të shquara të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, teoricien i madh marksist-leninist.

Siç dihet lidhur me këtë problem Partia jonë ka ndjekur kurdoherë vijën e saj, ka folur dhe do të flasë për Stalinin ashtu siç e meriton ai, si figurë e madhe e komunizmit ndërkombëtar, si klasik i marksizëm-leninizmit, si vazhdues besnik i veprës së Leninit. Dhe jeta tregon se ne veprojmë drejt.

2. — Partia jonë nuk ka qenë e një mendjeje me udhëheqësit sovjetikë në lidhje me qëndrimin e tyre ndaj revizionizmit jugosllav. Kjo fillon qysh nga maji i vitit 1955, kur shokët Hrushov e Bullganin vajtën në Beograd për përmirësimin e marrëdhënjeve me udhëheqësit revizionistë jugosllavë. Para së gjithash ne s'kemi qenë dakord, dhe për këtë kemi vënë në dijeni që atëhere Komitetin Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, që udhëheqja sovjetike, në mënyrë të njëanshme, pa pyetur Informbyronë dhe partitë e tjera komuniste motra, të rehabilitojë klikën e Titos. Sepse në fakt në vitin 1948 dënimi i revizionistëve jugosllavë u bë jo vetëm nga Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik, por nga Informbyroja, ku bënë pjesë 8 parti komuniste, dhe pastaj u aprovua nga të gjitha partitë komuniste dhe punëtorë të botës. Prandaj edhe çështja e rehabilitimit ose jo të tyre duhej të vendosej nga një mbledhje e shumë partive. Pastaj Partia jonë asnjëherë s'ka qenë dakord me taktikën që ndiqnin udhëheqësit sovjetikë ndaj Titos dhe klikës së tij, e cila përkëdhelej, ftohej në mbledhje partie, deklarohesh se punon për socializmin, konsultohesh me të etj. Kur Partia jonë i shtronte këto çështje i thuhej se «ishte gjaknxehëse», «se i shihte gjërat nën prizmin e ngushtë nacional», se «duke luftuar shumë revizionizmin i rritet atij vlera përpara imperializmit amerikan» etj. Është e qartë se Partia jonë, duke luftuar me konsekuencë kundër revizionizmit jugosllav, kishte plotësisht të drejtë, ajo mbronte marksizëm-leninizmin, zbatonte me besnikëri Deklaratën e Moskës, kurse udhëheqësit sovjetikë shkisin në këtë çështje në oportunizëm. Bile kjo tendencë vihet re edhe tani, pas aprovimit të deklaratës, kur revizionizmi jugosllav dënohet me rreptësi. Udhëheqësit sovjetikë, gjoja nën parullën e afrimit në vijën shtetërore, po forcojnë lidhjet me revizionistët jugosllavë, duke hequr dorë, në fakt, nga lufta kundër tyre. Natyrisht Partia jonë nuk është dakord me një taktikë të tillë.

Çdo komunist shqiptar e ka të qartë rrezikshmërinë e revizionistëve jugosllavë, të cilët, në drejtim të vendit tonë, kanë treguar sheshit fytyrën e tyre të vërtetë, tiparet karakteristike për të gjithë revizionistët e kallëpeve të ndryshme. Revizionistët jugosllavë kanë përdorur metoda të shumëllojshme kundër vendit e popullit tonë. Le t'i kujtojmë ato:

Revizionistët jugosllavë, qysh herët, pa u demaskuar ende si armiq e tradhëtarë të marksizëm-leninizmit, duke përfituar nga miqësia dhe marrëdhënjet e ngushta vëllazërore që lidhnin po-

pujt tanë, u përpoqën të përçanin Partinë, të prishnin unitetin e saj, ta nënshtonin atë. Revizionistët për t'ja arritur këtij qëllimi aktivizuan tradhëtarët e Partisë, si Koçi Xoxen me shokë, vunë në lëvizje agjenturën e tyre, duke përfshirë edhe përfaqësuesit e tyre zyrtarë, akuzuan udhëheqjen e Partisë sonë se gjoja po nxiste «frymën antijugosllave» dhe në të njëjtën kohë filluan të sabotojnë ekonominë tonë, duke vendosur edhe bllokadën, me qëllim që të pengonin lidhjen e vendit tonë me vendet socialiste. Vetëm qëndrimi heroik i Partisë dhe i popullit tonë, lufta e vendosur e tyre, vigjilenca e mprehtë revolucionare dhe uniteti i çeliktë i Partisë dhe i popullit tonë bëri që të dështojnë të gjitha planet e revizionistëve. Por ata u egërsuan edhe më shumë. Të gjithë i dinë provokacionet ushtarake, shantazhet dhe aktet e diversionit, propagandën dhe çdo gjë tjetër që kanë bërë dhe bëjnë vazhdimisht kundër vendit tonë këta armiq të socializmit dhe të paqes. Gjithë komunistët dhe qytetarët tanë i kanë parasysh metodat që kanë përdorur dhe përdorin kundër Partisë dhe vendit tonë revizionistët, prandaj gjithnjë e kanë quajtur dhe e quajnë luftën për demaskimin e revizionizmit dhe veçanërisht revizionizmit jugosllav si një çështje të rëndësishme. Deklarata e Moskës që u aprovua në nëntor vërteton se Partia jonë ka plotësisht të drejtë dhe qëndron plotësisht në pozita marksiste edhe në këtë çështje.

3. — Partia jonë ka patur pikëpamje të kundërta me ato të udhëheqësve sovjetikë përse i përket vlerësimit të ngjarjeve të Hungarisë dhe demaskimit të organizatorëve të kundërrevolucionit. Pikëpamja e Partisë sonë ka qenë dhe është se forcat e socializmit u treguan shumë toleruese dhe liberale, duke i lënë shesh të lirë veprimtarisë së kundërrevolucionarëve. Veçanërisht revizionistëve jugosllavë, të cilët ishin nga nxitësit dhe organizatorët kryesorë të kundërrevolucionit, ju dha mundësia që të vepronin lirisht kundër pushtetit popullor dhe socializmit. Më në fund, sipas pikëpamjes sonë, edhe pas shtypjes së kundërrevolucionit nuk u demaskuan plotësisht dhe me forcë shkaktarët e kundërrevolucionit, ndërsa revizionistët jugosllavë, të cilët bile u bënë strehues të Imre Nagit, as nuk u cilësuan si komplotistë dhe armiq të socializmit në Hungari. Dihet se, pas dështimit të kundërrevolucionit hungarez, në vend që lufta për demaskimin e revizionistëve jugosllavë të aktivizohej dhe këtyre tradhëtarëve t'u pritej rruga e organizimit të veprimtarisë së mëtejshme minuese kundër vendeve të tjera socialiste, filloi përsëri politika e zbutjes, e përkëdheljes, ajo e fshehjes së fakteve demaskuese që kishin dalë me rastin e kundërrevolucionit në Hungari. Sipas mendimit tonë, udhëheqësit sovjetikë nuk e shohin drejt këtë problem, sepse ata kanë pikëpamje të shtrembëra për vetë esencën e revizionizmit jugosllav. Ata, siç duket, nuk janë të ndër-

gjegjshëm për rrezikshmërinë e revizionistëve jugosllavë: vlerësojnë e u besojnë më shumë disa frazave dhe fjalimeve demagogjike të udhëheqësve revizionistë, veçanërisht lidhur me çështjet e paqes etj. dhe nuk shohin krimet e tyre, armiqësinë e tyre.

4. — Më në fund Partia jonë ka patur kundërshtime me udhëheqësit sovjetikë edhe për mjaft çështje të tjera që kanë të bëjnë me kuptimin e drejtë leninist të marrëdhënjeve midis partive motra, të cilat janë të barabarta dhe të pavarura nga njëra-tjetra. Shokët sovjetikë, duke lënë mënjanë këto parime, në disa raste kanë ndërhyrë padrejtësisht në punët e brendshme të Partisë sonë dhe e keqja në këtë drejtim është fakti se udhëheqësit sovjetikë, duke ju besuar më shumë shpifjeve të revizionistëve jugosllavë dhe tradhëtarëve të Partisë sonë, janë përpjekur të marrin nën mbrojtje armiq të Partisë e të popullit tonë. Kështu vetë N. Hrushovi ka ndërhyrë pranë udhëheqjes së Partisë sonë, sigurisht i nxitur dhe nga shpifjet e revizionistëve jugosllavë, që ne të mos pushkatonim tradhëtarin Liri Gega, të mos dënonim armikun e Partisë Tuk Jakovën dhe të rishikonim mundësinë e pranimit në Shqipëri, por pa i bërë gjë, të tradhëtarit Panajot Plaku. Natyrisht, këto ndërhyrje janë hedhur poshtë me të drejtë nga ana e Komitetit Qëndror të Partisë sonë.

Siç shihet, nga këto që thamë deri tani, në çështjet themelore të politikës së jashtme, të taktikës dhe të strategjisë së lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare, Partia jonë e Punës ka ndjekur kurdoherë një vijë të drejtë marksiste-leniniste, vijë e cila puqej plotësisht me parimet e Deklaratës së Moskës dhe që ka qenë në kundërshtim në shumë drejtime me vijën që ka ndjekur këto vitet e fundit udhëheqja sovjetike.

Komiteti Qendror i Partisë sonë, duke ndjekur me vendosmëri e konsekuencë vijën e sipërme, duke ruajtur të paprekshme parimet marksiste-leniniste, deri në Konferencën e Moskës të vitit 1960 nuk i shfaqti publikisht kundërshtimet e tij. Përse e bëri këtë Komiteti Qendror? Përse nuk i ka thënë më parë, në ndonjë mbledhje tjetër ndërkombëtare, këto kundërshtime?

E para, sepse pas Kongresit XX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik (në vitin 1956), siç dihet, të gjitha sulmet e armiqve imperialistë dhe revizionistë ishin përqëndruar për të përçarë unitetin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Të gjithë e kanë parasysh se atëhere u bë kritika e kultit të individit, ndodhën ngjarjet e Polonisë dhe të Hungarisë, në shumë parti filloi aktivizimi i elementëve revizionistë si në Itali, Francë, Amerikë, Angli, Danimarkë etj. Gjithë propaganda e reaksionit fliste për të ashtuquajturën «krizë» të komunizmit. Revizionistët jugosllavë u bënë shumë aktivë. Ata edhe te ne organizuan komplotin në konferencën e Partisë në qytetin e Tiranës etj. Në kë-

të kohë, në këto kondita, çështja kryesore ishte ruajtja e unitetit të kampit socialist, prandaj për hir të tij ne duhej të përmbaheshim, të zbatonim me konsekuencë e vendosmëri vijën marksiste-leniniste, duke evituar kritikën e hapëta në drejtim të udhëheqjes sovjetike. Në atë kohë çdo kritikë kundrejt udhëheqjes sovjetike mund të ndihmonte vetëm elementët revizionistë.

E dyta, sepse pas Kongresit XX dhe ngjarjeve në Poloni e Hungari reaksioni dhe revizionistët filluan një fushatë të madhe antisovjetike. Të gjitha përpjekjet bëheshin për të ulur autoritetin e Bashkimit Sovjetik dhe të partisë së tij të lavdishme. Të gjithëve u kujtohet se atëhere reaksioni vinte në dyshim vetë sistemin sovjetik, bile Toliati i Italisë foli kundër sistemit sovjetik dhe hodhi parullën e policentrizmit, që në fakt mohonte rolin e Bashkimit Sovjetik dhe të Partisë së tij Komuniste si qendër e lëvizjes komuniste. Në këto kondita, detyra internacionaliste kërkonte që të mbrohej me të gjitha forcat Bashkimi Sovjetik dhe Partia Komuniste e Leninit, kërkohesh që të mbrohej autoriteti dhe prestigji i tyre, të mos i jepej asnjë armë reaksionit dhe të ndihmohej udhëheqja sovjetike, me anë të kritikave shoqërore, që të vihej në rrugë të drejtë. Kështu veproi edhe Partia jonë. Ajo e mbrojti publikisht Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, vetë Bashkimin Sovjetik, por në të njëjtën kohë disa vërejtje kritike, veçanërisht lidhur me qëndrimin ndaj revizionizmit jugosllav, me ngjarjet hungareze apo me ndërhyrjet në punët tona të brendshme, sipas rastit, që nga 1955 e më vonë, ua këni vënë në dukje udhëheqësve sovjetikë.

E treta, në fillim gabimet e udhëheqjes sovjetike nuk ishin aq të qarta sa u bënë kohët e fundit, veçanërisht gabimet lidhur me qëndrimin ndaj imperializmit etj. Tani këto gabime jo vetëm u thelluan, por ato po e dëmtojnë seriozisht çështjen e komunizmit, prandaj edhe duhet të demaskohen.

Komiteti Qendror i Partisë mendon se ky qëndrim i Partisë sonë është një qëndrim i drejtë, internacionalist, marksist-leninist. Të veprohej ndryshe në atë kohë do të thoshte të bëje lojën e armikut, të dëmtoje çështjen e përgjithshme të socializmit dhe të klasës punëtore ndërkombëtare.

Vështirësitë e asaj kohe kaluan; ato u kapërcyen me sukses. Por udhëheqësit sovjetikë vazhduan më thellë në gabimet e tyre. Puna arriti deri atje sa jo vetëm po përkëdhelej Titua dhe banda e tij, por filloi të mbulohej me lajka e fjalë të mira edhe Ajzenhaueri. Kurse në të njëjtën kohë, kundër Partisë Komuniste të Kinës, e cila mbronte me guxim marksizëm-leninizmin dhe u shpreh kundër pikëpamieve të shokëve sovjetikë, u organizua menjëherë Mbledhja e Bukureshtit, kjo prapaskenë antimarksiste, e cila kishte për qëllim të dënonte Partinë Komuniste

të Kinës. Në një situatë të tillë nuk duhej heshtur. Përkundrazi duhej të mbrohej me guxim marksizëm-leninizmi. Këtë bëri Partia jonë në Mbledhjen e Bukureshtit dhe u gjend në kundërshtim me të gjitha partitë komuniste dhe punëtore të botës, këtë bëri ajo edhe në Konferencën e Moskës, por këtë herë nuk u gjend e vetmuar; drejtësia dhe heroizmi i saj u kurorëzuan me sukses.

Në Konferencën e Moskës, përpara përfaqësuesve të 81 partive, delegacioni i Partisë sonë foli hapur për gabimet e udhëheqësve sovjetikë dhe të shokut Hrushov në veçanti, jo vetëm për çështjet për të cilat folëm deri tani, për çështjet që kanë lidhje me situatën ndërkombëtare dhe taktikën e strategjinë e lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare, por edhe për disa veprime antimarksiste dhe shumë të dëmshme që kanë bërë kundër Partisë e vendit tonë, pas Mbledhjes së Bukureshtit, udhëheqësit sovjetikë.

Fill pas Mbledhjes së Bukureshtit kundër Partisë dhe vendit tonë, kundër udhëheqjes së Partisë sonë, nga ana e shokëve sovjetikë filloi një sulm i papritur, joparimor, një ndërhyrje brutale dhe një presion i gjithanshëm, politik dhe ekonomik. Shkaku ishte se udhëheqjes sovjetike nuk i pëlqeu qëndrimi ynë i drejtë e parimor në Mbledhjen e Bukureshtit. Por burimi i vërtetë i presioneve të udhëheqjes sovjetike dhe i veprimeve të saj kundër Partisë dhe vendit tonë ka lidhje me kontradiktat parimore që ekzistojnë midis dy partive tona; ka lidhje me Kongresin XX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, me të cilin ne nuk kemi qenë dakord, si përsa i përket kritikës së Stalinit, si për trajtimin e çështjes së rrugës paqësore për në socializëm; ka lidhje me politikën oportuniste të udhëheqësve sovjetikë ndaj imperializmit amerikan dhe revizionizmit jugosllav, me të cilët ne kemi qenë kurdoherë në kundërshtim etj. Pra presionet politike dhe ekonomike, veprimet e gabuara të udhëheqësve sovjetikë kundër vendit e Partisë sonë, të cilat nuk i shërbejnë socializmit, por armiqve të tij, gëzojnë vetëm revizionistët dhe imperialistët, e kanë burimin te mosmarrëveshjet parimore që kanë ekzistuar dhe ekzistojnë midis Partisë sonë dhe udhëheqjes sovjetike, e kanë burimin te gabimet parimore të udhëheqjes sovjetike, sepse, siç e thamë më parë, vetëm ai që gabon në parime, vetëm ai që shkel principet themelore të marksizëm-leninizmit mund t'i lejojë vetes veprime të tilla, siç janë presionet politike apo ekonomike, dhe të synojë të përçajë një parti motër marksiste-leniniste e të likuadojë udhëheqjen e saj.

Cilat janë presionet dhe veprimet antimarksiste, që udhëheqja sovjetike ka bërë kundër Partisë e vendit tonë?

Sulmin kundër Partisë sonë e filloi qysh në Mbledhjen e Bukureshtit N. Hrushovi, i cili lidhur me qëndrimin tonë në atë mbledhje foli hapur kundër Partisë sonë. Pas tij veprimet kun-

dër nesh u vazhduan në Moskë, ku nga udhëheqësit sovjetikë përpunoheshin me zell shokët e Byrosë Politike që rastësisht kalonin andej. Qëllimi ishte që të përçanin udhëheqjen e Partisë sonë, që të nxitnin shokët tanë kundër udhëheqjes dhe vijës së Partisë. Atyre u shtrohej çështja se «udhëheqja e Partisë së Punës të Shqipërisë tradhëtoi miqësinë me Bashkimin Sovjetik» se «vija që ndjek udhëheqja e Partisë karakterizohet nga zik-zake», se «Shqipëria duhet të zgjedhë: ose të shkojë me 200 milionët (d.m.th. me Bashkimin Sovjetik), ose me 650 milionët (d.m.th. me Kinën)» dhe më në fund kërcënonin se «Shqipëria do të jetë në rrezik në qoftë se nuk lidhet me Bashkimin Sovjetik, sepse ajo do të jetë e izoluar» etj.

Si rezultat i kësaj pune përçarëse Liri Belishova, ish-anëtare e Byrosë Politike, që ishte karrieriste dhe e predispozuar për të shkarë në oportunizëm, kapitulloi përpara shantazheve dhe frikësimeve të udhëheqësve sovjetikë, ra në kurthin e lajkave dhe të përkëdheljeve të tyre dhe u vu në opozicion të hapët me vijën e Partisë. Siç dihet plenumi i Komitetit Qendror e përjashtoi atë nga radhët e veta.

Një punë të tillë përçarëse kundër Partisë sonë filluan të bëjnë në Shqipëri edhe disa punonjës të Ambasadës Sovjetike me ambasadorin sovjetik në krye. Ata, duke përfituar nga dashuria e madhe që ka çdo shqiptar për Bashkimin Sovjetik, si edhe nga lidhjet e ngushta, respekti i madh që çdo njeri ka te ne për njerëzit sovjetikë, filluan të flasin me kuadro të Partisë në Tiranë dhe në rrethe kundër vijës së Partisë sonë dhe udhëheqjes së saj, të krijojnë panik dhe konfuzion në radhët e Partisë, të ndanin udhëheqjen nga Partia. Kështu punonjësit e ambasadës u përpoqën të mblidhnin informata poshtë e përjetë për zhvillimin e punimeve të Plenumit të korrikut 1960; organizuan takime dhe biseda me kuadro që kishin mbaruar studimet në Bashkimin Sovjetik, duke menduar se ata ishin kontigjente të përshtatshme për punën e tyre të sëmurë, por u hasi sharra në gozhdë. Ata shkuan aq larg në veprimtarinë e tyre antimarksiste, sa u bënë pyetjen gjeneralëve tanë se «kujt do t'i qëndronte besnike ushtria». Duket sheshit se ky provokacion kishte për qëllim të nxiste ushtrinë kundër Partisë dhe udhëheqjes së saj. Por ambasadori sovjetik mori përgjigjen e merituar nga gjeneralët tanë: ushtria do t'i qëndrojë besnike popullit, interesave të atdheut dhe të kampit të socializmit, ajo është nën urdhërat e Partisë dhe sipas direktivave të saj do të luftojë kundër çdo armiku që do të synojë të prekë interesat e atdheut, të popullit, të Partisë dhe të kampit të socializmit.

Megjithkëtë, punonjësit e Ambasadës Sovjetike, me ambasadorin në krye, arritën që me anë të këtyre metodave të palejueshme e antimarksiste të nxirrnin nga rruga e Partisë ish-kryetarin

e Komisionit të Revizionimit të Partisë, Koço Tashkon. Ai, dy javë më parë, ishte shprehur dakord me vijën e qëndrimit të Partisë në Bukuresht, kurse pas dy javësh, pas takimeve me ambasadorin sovjetik, u deklarua kundër vijës së Partisë dhe udhëheqjes së saj. Dihet se plenumi i Komitetit Qendror e përjashtoi atë si nga Komisioni i Revizionimit, ashtu edhe nga Partia.

Të gjitha këto veprime antimarksiste synonin që të përçanin Partinë, të prishnin unitetin e saj, të ngjallnin konfuzion e pakënaqësi, të ndanin udhëheqjen e Partisë nga Partia dhe ta likuidonin atë, meqenëse ajo ish bërë pengesë për realizimin e qëllimeve të shtrembëra të udhëheqjes sovjetike.

Por udhëheqësit sovjetikë nuk u ndalën me kaq. Ata kaluan edhe në presione të hapura politike dhe ekonomike. Kështu N. Hrushovi, në tetor të këtij viti, në një bisedë u tha shokëve kinezë se «ne (sovjetikët) do ta trajtojmë Shqipërinë ashtu si Jugosllavinë», domethënë se me Shqipërinë do të mbahen të njëjtat marrëdhënie ekonomike e politike si me Jugosllavinë e Titos. Dhe në fakt kështu filluan të veprojnë udhëheqësit sovjetikë me vendin tonë, pas Mbledhjes së Bukureshtit. Kështu, për shembull, kur ne i kërkuam Qeverisë Sovjetike që ta blinim bukën me shkëmbim mallrash, sepse nga thatësira popullin e kërcënonte uria, qeveria sovjetike jo vetëm që na u përgjegj me vonesë (pas një muaji e gjysmë), por na njoftoi se mund të na shiste me shkëmbim mallrash veçse një të pestën e bukës që kërkonim, kurse pjesën tjetër duhej ta paguanim me floririn e bankës sonë dhe me valutë të lirë (me dollarë). Është e qartë se një qëndrim i tillë ishte presion i hapur, ishte me të vërtetë një qëndrim jomiqësor, jomarksist e jointernationalist. Dhe populli ynë do të vuante urie, do të mbetej pa bukë, në qoftë se nuk do të gjendej ndihma e shpejtë internacionaliste e Partisë Komuniste të Kinës, e cila meniherë i dha qeverisë sonë jo vetëm sasinë e domosdoshme të bukës, por edhe rezervat e nevojshme.

Presione të tilla ekonomike e politike udhëheqësit sovjetikë bëjnë edhe tani, sidomos duke zgjatur pa shkak bisedimet ekonomike etj.

Qëllimi i këtyre veprimeve antimarksiste, i presioneve ekonomike e politike është i qartë. Udhëheqja sovjetike, me Hrushovin në krye, synonte ose të përkulte Partinë tonë dhe të na detyronte të hiqnim dorë nga rruga e drejtë marksiste-leniniste, të hiqnim dorë nga pozitën parimore që ka zënë Partia jonë, ose, si rezultat i vështirësive që do të krijoheshin, sipas mendimit të udhëheqësve sovjetikë, të ndodhte ndonjë përçarje në Parti, të lindnin pakënaqësitë e mosbesimi në radhët e Partisë e të popullit dhe si rrugëdalje të likuidoheshin udhëheqja e Partisë për të

ardhur në krye të saj «shpëtimtarët», që do të ishin besnikë të vijës së gabuar të udhëheqjes sovjetike.

Por hesapet janë bërë pa hanxhinë, prandaj këto qëllime dështuan dhe kurdoherë do të dështojnë me turp. Këtyre qëllimeve të ulëta udhëheqësit sovjetikë nuk ua arritën dot, sepse Partia jonë është një Parti e fortë, e kalitur, një Parti marksiste-leniniste, sepse një unitet i çeliktë dhe i pathyeshëm lidh Partinë me popullin, Partinë me Komitetin Qendror të saj dhe me Byronë Politike. Partia jonë duhet të nxjerrë një mësim: *Edhe në të ardhmen të forcojë edhe më shumë unitetin e çeliktë të Partisë me masat e gjëra të popullit, unitetin e Partisë me Komitetin e saj Qendror dhe Byronë Politike. Uniteti ynë është garancia e pathyeshme për të gjitha fitoret tona.*

Veprimet që përmendëm më sipër dhe qëndrimi antimarksist që mbajtën udhëheqësit sovjetikë ndaj Partisë e vendit tonë, pas Mbledhjes së Bukureshtit, na forcoi edhe më shumë bindjen se Partia jonë ishte në pozita të drejta marksiste-leniniste, se pozita e saj në të gjitha çështjet themelore ishte parimore, prandaj ajo duhej mbrojtur me vendosmëri dhe duhej kundërshtuar çdo presion.

Duke patur parasysh sa më sipër Partia jonë u pregatit seriozisht për Konferencën e Moskës. Komiteti Qendror e porosi delegacionin e tij, të kryesuar nga shoku Enver Hoxha, që në Konferencën e Moskës, hapur dhe sinqerisht, me kurajon marksiste-leniniste, të shtronte pikëpamjen parimore të Partisë sonë për të gjitha çështjet ku ka mosmarrëveshje, të njoftonte mbledhjen për veprimet antimarksiste të udhëheqësve sovjetikë pas Bukureshtit kundrejt Partisë sonë dhe t'i kritikonte ata ashpër, me qëllim që veprime të tilla të mos përsëriteshin më në të ardhmen.

Delegacioni ynë e zbatoi plotësisht këtë direktivë të Komitetit Qendror. Në një fjalim të gjatë, delegacioni ynë shtroi pikëpamjen e Partisë sonë lidhur me problemet kryesore të situatës dhe të lëvizjes komuniste, mbrojti me vendosmëri Deklaratën e Moskës të vitit 1957 dhe pastërtinë e mësimëve marksiste-leniniste, mbrojti Partinë Komuniste të Kinës dhe pozitën e saj të drejtë, kritikoi ashpër, por në frymë shoqërore shokët e udhëheqjes sovjetike, si për pikëpamjet dhe veprimet e tyre të gabuara, si edhe për ndërhyrjet në punët e brendshme të Partisë sonë, duke u ndalur veçanërisht në presionet politike e ekonomike që na u bënë pas Mbledhjes së Bukureshtit.

A veprimi drejt Komitetit Qendror kur vendosi që këto çështje, hapur, t'i shtrojë në Konferencën e Moskës? Ne mendojmë se veprimi shumë drejt.

E para: sepse duke kritikuar hapur, me zemër të pastër e pa prapamendime, në një mbledhje partie të komunizmit ndërkom-bëtar, siç ishte Konferenca e Moskës, gabimet dhe shtrembërimet

që vihen re lidhur me disa çështje themelore të taktikës e të strategjisë së lëvizjes komuniste, ne udhëhiqeshim nga qëllime të drejta. Pavarësisht se kush i kishte këto gabime, ne me kritikën tonë synimim që të ndreqeshin ato, që të mos u lihej vend shfaqjeve oportuniste; ne synimim që të forcohej dhe të çelnikosej edhe më shumë lëvizja komuniste ndërkombëtare dhe uniteti e kompaktësia e saj. Po të mos e bënim një gjë të tillë, ne nuk duhej t'i thoshim vetes komunistë. Partia jonë na ka edukuar ne, anëtarët e saj, që të jemi kurdoherë të drejtë dhe të guximshëm për të mbrojtur pastërtinë e marksizëm-leninizmit.

E dyta: se duke kritikuar me zemër të hapur dhe në mënyrë parimore disa veprime të padrejta, siç janë presionet ekonomike e politike, në marrëdhënjet midis Partisë sonë dhe udhëheqjes sovjetike, ne synimim që të zhduken këto mosmarrëveshje, që të mos përsëriten më këto veprime dhe si rrjedhim të forcohen edhe më shumë marrëdhënjet miqësore dhe lidhjet e unitetit midis Partisë sonë, Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, midis Shqipërisë e Bashkimit Sovjetik, të forcohej uniteti i kampit socialist.

Partia na ka mësuar se kritika e autokritika janë armë të fuqishme, të cilat ndihmojnë në zhdukjen e të metave dhe të gabimeve dhe e çojnë çështjen tonë përpara. Ne nuk do të ishim komunistë të mirë, në qoftë se për një arësye apo tjetër do të tregoheshim frikacakë dhe nuk do ta thoshim hapur fjalën tonë.

Raporti i delegacionit tonë, pavarësisht se disa njerëzve, e në radhë të parë udhëheqësve sovjetikë, nuk u pëlqeu, ishte një kontribut i madh për përfundimin me sukses të Konferencës së Moskës. Partia jonë u tregua e guximshme, parimore, luftëtare e vendosur e mbrojtjes së pastërtisë së marksizëm-leninizmit, luftëtare e ruajtjes dhe e forcimit të unitetit të lëvizjes sonë komuniste. Si rrjedhim, personaliteti i Partisë sonë u rrit edhe më shumë, dashuria dhe respekti për guximin e saj dhe për qëndrimin parimor u shtua pa masë. *Prandaj plenumi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë e aprovoi njëzëri e plotësisht aktivitetin e delegacionit të Partisë sonë në Moskë dhe e konsideroi qëndrimin e tij të vendosur e parimor, fjalimin dhe gjithë punën e zhvilluar prej tij, gjatë Mbledhjes së Moskës, si shumë pozitive dhe të dobishme.*

Konferenca e Moskës e 81 partive komuniste e punëtore është një nga mbledhjet më të rëndësishme të lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Ajo kishte për qëllim që të diskutonte çështjet kryesore që preokupojnë sot gjithë lëvizjen tonë dhe të përcaktonte vijën e përbashkët për të ardhmen. Për të realizuar këtë detyrë, në radhë të parë, duhet të diskutoheshin kontradiktat ekzistuese mbi çështjet parimore. Por në këtë drejtim udhëheqësit sovjetikë kishin planin e tyre. Ata jashtë mbledhjes u përpoqën që të bëjnë fajtorë Partinë Komuniste të Kinës dhe Partinë tonë

të Punës, kurse në mbledhje u përpoqën që të mos i zbulonin kontradiktat, që të mos diskutoheshin për to, meqenëse ata e dinin se nga një diskutim i tillë do të dilte qartë se udhëheqësit sovjetikë e kishin shkelur Deklaratën e Moskës, se vetë ata kishin bërë gabime të mëdha dhe pra ata do të kritikoheshin nga përfaqësuesit e partive marksiste-leniniste. Në përputhje me këtë taktikë vepruan në fillim të mbledhjes udhëheqësit sovjetikë.

Kështu, dy ditë përpara fillimit të konferencës, pra më 8 nëntor, ata u dorëzuan gjithë pjesëmarrësve të konferencës një letër prej 125 faqesh që Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik i kishte dërguar më 5 nëntor Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës. Në këtë letër të gjatë plot shpifje e falsifikime Partia Komuniste e Kinës akuzohej si fraksioniste, si përçarëse e lëvizjes komuniste, si dogmatike e deviatore. Sipas asaj letre dilte se për çështjet që diskutoheshin fajtorë ishte Partia Komuniste e Kinës dhe jo Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik, se Partia Komuniste e Kinës ishte kundër bashkekzistencës paqësore dhe partizane e luftës etj, etj. Këtë letër shokët sovjetikë e punuan në mbledhje të veçanta, përpara se të fillonte konferenca, me delegacionet e partive të ndryshme. Është e qartë se, ashtu si në Mbledhjen e Bukureshtit, shokët sovjetikë u përpoqën të bindnin përfaqësuesit e partive të ndryshme se gjoja shokët kinezë ishin në rrugë të shtrembër dhe të siguronin përkrahjen e tyre kundër Partisë Komuniste të Kinës. Natyrisht, një përpunim i tillë i delegacioneve, një shfrytëzim i tillë i pozitës së privilegjuar që patën shokët sovjetikë, duke qenë se mbledhja bëhej në shtëpinë e tyre, nuk është i drejtë, ai është antimarksist. Por kjo punë tregon nga ana tjetër edhe dobësinë e pozitave të shokëve sovjetikë, edhe fajësinë e tyre, sepse ai që është në pozita të drejta, ai që është i pafajshëm nuk ka nevojë me metoda të shtrembëra të bëjë aleatë e përkrahës pas kurrizit të të tjerëve. Në fakt shokët kinezë, të cilët ishin në pozita të drejta marksiste-leniniste, nuk bënë asnjë punë përgatitore me delegacionet. Ata pikëpamjet e tyre i thanë hapur në konferencë, me argumente bindëse, sipas mësimëve të marksizëm-leninizmit, pa qenë nevoja të bënin aleatë qosheve.

Udhëheqësit sovjetikë, pasi bënë këtë punë përgatitore dhe mbasi krijuan në disa parti opinionin kundër Partisë Komuniste të Kinës, në fillim i dhanë konferencës edhe orientimin që donin, dmth diskutime të përgjithshme, pa folur hapur për kontradiktat që ekzistonin, pa kurrfarë kritike dhe autokritike. Shembullin e dha vetë Hrushovi, i cili foli i pari në konferencë. Ai foli më shumë se 3 orë, por asnjë herë nuk përmendi me emër Partinë Komuniste të Kinës, bëri thirrje formale për unitet dhe la të kuptohej se udhëheqja sovjetike nuk ka asnjë gabim dhe se fajtorë janë të tjerët. Cilët? Me letrën prej 125 faqesh e kishte shpjeguar jashtë mbledhjes: këta ishin «kinezët».

Pas Hrushovit folën me radhë edhe 18 delegatë të partive të ndryshme, të cilët ndoqën të njëjtën taktikë; diskutim të përgjithshëm, lëvdata për fjalimin e Hrushovit, thumba kundër Partisë Komuniste të Kinës etj. Në të njëjtën kohë sovjetikët filluan punën edhe me delegacionet e atyre partive që qëndronin në pozita të drejta marksiste-leniniste dhe që patjetër do të flisnin në konferencë hapur për mosmarrëveshjet dhe do të kritikonin udhëheqjen sovjetike. Një punë të tillë udhëheqësit sovjetikë e bënë edhe me delegacionin tonë. Ata u takuan me ne dy-tri herë, me qëllim që të na «bindnin» për të mos shtruar në konferencë, përpara përfaqësuesve të 81 partive motra, çështjet për të cilat ne nuk ishim të një mendjeje me shokët sovjetikë dhe veçanërisht veprimet e tyre antimarksiste kundër Partisë e vendit tonë pas Mbledhjes së Bukureshtit. Por delegacioni ynë nuk u lëkund nga pozitat e tij.

Punimet e Konferencës së Moskës morën një rrugë tjetër vetëm pas fjalimit të delegacionit kinez dhe pas fjalimit të delegacionit tonë. Fjalimet tona ishin parimore, të bazuara në marksizëm-leninizmin, fjalime që analizonin mirë jo vetëm situatën, por edhe të metat e gabimet, kishin kritikë të hapur kundrejt shokëve sovjetikë dhe atyre të disa vendeve të tjera në lidhje me pikëpamjet e veprimet e tyre të gabuara e antimarksiste. Nga fjalimet tona doli qartë përpara pjesëmarrësve të konferencës së shokët sovjetikë kanë shkëlur Deklaratën e Moskës të vitit 1957 dhe janë larguar në disa çështje themelore nga pozitat e marksizëm-leninizmit. Nga ana tjetër doli qartë se Partia Komuniste e Kinës, kundër së cilës ishin bërë akuza të shumta në Mbledhjen e Bukureshtit dhe pas saj, ka qenë kurdoherë në pozita të drejta dhe ka mbrojtur me besnikëri marksizëm-leninizmin.

Pas fjalimeve të delegacionit kinez dhe të atij të delegacionit tonë, Konferenca e Moskës u gjallërua dhe diskutimet u bënë më interesante. Çdo parti u detyrua të mbajë qëndrim për çështjet parimore. Nga diskutimet u pa qartë se në pozitat e marksizëm-leninizmit qëndrojnë fort edhe shumë parti të tjera. Në qoftë se në Mbledhjen e Bukureshtit, hapur mbajtën qëndrim kundër veprimeve të padrejta të udhëheqësve sovjetikë vetëm Partia Komuniste e Kinës dhe Partia e Punës e Shqipërisë, në Konferencën e Moskës në këto pozita ishin edhe shumë parti të tjera si Partia e Koresë, ajo e Vietnamit, e Indonezisë, e Japonisë, e Birmanisë etj. etj.

Duhet thënë se Partia jonë, me qëndrimin e saj të drejtë e parimor, më parë në Mbledhjen e Bukureshtit dhe pastaj në Konferencën e Moskës, ka fituar simpatinë dhe respektin e shumë partive motra. Asaj i është rritur autoriteti dhe personaliteti politik. Në Konferencën e Moskës e përkrahën Partinë tonë shumë parti. Në mënyrë të veçantë një përkrahje të madhe e të vendo-

sur i dha delegacioni i Partisë Komuniste të Kinës. Shokët kinezë në fjalimet e tyre në konferencë, e çmuan shumë qëndrimin heroik të Partisë sonë, qëndrimin marksist-leninist të saj dhe e mbrojtën atë nga sulmet e fyerjet që ju bënë nga delegacionet e disa partive. Në fjalimin e tyre në Konferencën e Moskës shokët kinezë theksuan: «Këtu nuk mund të mos vëmë gjithashtu në dukje se pozita që ka zënë këto kohët e fundit Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik kundrejt Partisë së Punës të Shqipërisë ka ngjallur tek ne një shqetësim të madh. . . Këto kohët e fundit udhëheqësit e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik kanë sulmuar më se një herë para shokëve kinezë Partinë e Punës të Shqipërisë, duke deklaruar se ata do të mbajnë kundrejt Partisë marksiste-leniniste të Punës të Shqipërisë dhe kundrejt Republikës Popullore të Shqipërisë po atë qëndrim që mbajnë kundrejt Jugosllavisë, se ata duan të dënojnë Partinë e Punës të Shqipërisë, duke i ndërprerë çdo lloj ndihme, për arësytën e thjeshtë se shokët shqiptarë mbrojtën pikëpamjet e tyre për një radhë çështjesh, sidomos në Mbledhjen e Bukureshtit, dhe se pas kësaj mbledhjeje nuk shkuan pas shokëve sovjetikë në veprimet që drejtoheshin kundër Partisë Komuniste të Kinës. . . Ne shpresojmë se shokët sovjetikë do të mendohen me qetësi për faktin se nga udhëhiqen ata, duke mbajtur një qëndrim të tillë kundrejt Partisë së Punës të Shqipërisë, nga parimet e internacionalizmit proletar, apo nga parimet patriarkale që janë të palejueshme në radhët e komunistëve? . . . Nuk ka dyshim se akte të tilla janë absolutisht të papajtuësme me interesat e kampit socialist dhe të lëvizjes komuniste ndërkombëtare. . . Delegacioni i Partisë Komuniste të Kinës mendon se çështjet që paraqiti shoku Enver Hoxha në lidhje me marrëdhënjet midis partive dhe shteteve të Bashkimit Sovjetik dhe të Shqipërisë janë serioze dhe meritojnë vemendje serioze e studim nga ana e shokëve» etj. etj. Partinë tonë e përkrahën edhe delegacioni i Koresë, i Vietnamit, i Indonezisë, i Birmanisë, i Malajës, i Ceilonit etj.

Kurse shokët sovjetikë, si dhe delegacionet e partive polake, bullgare, rumune, italiane, çeke etj., të cilëve nuk u pëlqyen as fjalimi i delegacionit kinez, as fjalimi ynë, në fjalimet e tyre sulmuan ashpër si Partinë Komuniste të Kinës, ashtu edhe Partinë tonë. Duke mos qenë në gjendje që të përdorin asnjë argument serioz për të rrëzuar tezën dhe faktet tona, duke mos qenë në gjendje që të mbrohen me fakte dhe duke mos dashur që të bëjnë autokritikë për gabimet që kanë bërë, ata përdorën më shumë fjalë të përgjithshme dhe fyerje kundër nesh. Natyrisht kjo tregonte se sa të dobëta janë pozitat e tyre. Ndërsa ne ishim parimorë dhe flisnim me fakte, ata përdornin shpifje dhe fyerje. Kjo gjë u ra në sy të gjitha delegacioneve. Shumë delegacione, veçanërisht nga Amerika Latine, nga vendet skandinave apo nga ven-

det afrikane etj., filluan të lëkundën dhe të mbajnë një qëndrim të matur, që në shumë çështje puqet me qëndrimin tonë kundër pikëpamjeve të udhëheqësve sovjetikë. Kjo gjë si do ta shohim edhe më poshtë, u shpreh edhe në përfundimin e konferencës.

Në Konferencën e Moskës delegacioni kinez, ai i Partisë sonë dhe i disa partive të tjera bënë një luftë të drejtë parimore e të vendosur, në mënyrë që deklarata të përpunohej simbas mësimëve marksiste-leniniste, që çështjet që do të përmbante ajo të për-caktoheshin drejt, në frymë revolucionare dhe jo oportuniste. Përkundrazi, udhëheqësit sovjetikë dhe shokë të disa delegacioneve të tjera u përpoqën që në deklaratë të futin pikëpamjet e tyre. Veç kësaj, ata deri në ditën e fundit të konferencës bënë të gjitha përpjekjet që në deklaratë të futeshin disa teza, të cilat ishin të papranueshme dhe shumë të rrezikshme, me anën e të cilave ne e shokët kinezë akuzoheshim për fraksionizëm, si «komunistë nacionalë» etj. Por, si rezultat i luftës së delegacioneve tona, ata u detyruan të tërhiqen. Bile projekti i tyre i paraqitur thuajse u ndryshua krejtësisht. Nga 36 faqe ai u bë 52 faqe. Tezat e ndryshme u forcuan dhe përgjithësisht deklarata ju dha një frymë revolucionare, duke e pastruar nga fryma oportuniste që kishte projekti i paraqitur nga sovjetikët. Tehu kryesor i deklaratës është drejtuar kundër imperializmit, e në radhë të parë kundër imperializmit amerikan, si dhe kundër revizionizmit, e veçanërisht kundër revizionizmit jugosllav.

Duke lexuar me kujdes Deklaratën çdo komunist mund të konstatojë se në të janë pasqyruar drejt parimet themelore të marksizëm-leninizmit. . .

Duke studjuar me kujdes Deklaratën e aprovuar mund të thuhet me siguri se ajo është një vërtetim konkret i vijës së drejtë parimore që ka ndjekur vazhdimisht Partia jonë heroike. Merrni çështjen e demaskimit të imperializmit amerikan, apo çështjen e luftës dhe të paqes, apo përcaktimin e rrezikut të revizionizmit, si rrezik kryesor, dhe të revizionistëve jugosllavë si renegatë e tradhëtarë të marksizmit e të socializmit, si sabotatorë të ndërtimit të socializmit dhe armiq të kampit tonë. Në asnjë dokument të lëvizjes komuniste ndërkombëtare nuk u është bërë një demaskim i tillë revizionistëve jugosllavë, siç bëhet në Deklaratën e Moskës⁵². Merrni kapitullin që flet në lidhje me vendet socialiste, me zbatimin e mësimëve themelore të marksizëm-leninizmit për ndërtimin e shoqërisë socialiste dhe çdo njeri do të shohë se sa drejt ka vepruar Partia jonë, sa e urtë është treguar ajo në zbatimin krijues të marksizmit në konditat e vendit tonë.

Kështu mund të thuhet edhe për shumë çështje të tjera të deklaratës. Është e qartë për të gjithë se *për të gjitha çështjet parimore, mbi të cilat ka patur mosmarrëveshje në lëvizjen komuniste, pozita e Partisë sonë ka qenë dhe mbetet pozitë e drejtë,*

marksiste-leniniste. Këtë e vërteton Deklarata e aprovuar nga përfaqësuesit e 81 partive komuniste e punëtore.

Fakti që Deklarata u aprovua njëzëri është një gjë pozitive. Uniteti i lëvizjes komuniste dhe ai i kampit socialist, duke patur si bazë parimet e deklaratës që u aprovua, ka mundësi reale që të forcohet e të zhvillohet më tej. Udhëheqësit sovjetikë, në qoftë se duan, mund të vijnë në rrugë të drejtë. Ata duhet të zbatojnë Deklaratën, t'u përmbahen parimeve të saja. Vetëm mbi këtë bazë, pa lëshuar aspak nga parimet, mund të forcohet uniteti ynë.

Lind pyetja: I zhduku Konferenca e Moskës mosmarrëveshjet parimore që ekzistonin midis Partisë Komuniste të Kinës dhe Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, mosmarrëveshjet që ekzistonin në lëvizjen komuniste ndërkombëtare? Me aprovimin njëzëri të Deklaratës çështjeve që ishin në diskutim ju dha një interpretim i drejtë, marksist-leninist. Logjikisht tani mund të thuhet se të gjitha partitë, pra edhe Partia Komuniste e Kinës apo ajo e Bashkimit Sovjetik, ashtu si edhe Partia jonë apo çdo parti tjetër, tani e tutje duhet të kenë një pikëpamje, një interpretim të vetëm. Në këtë kuptim, në qoftë se në të ardhshmen çdo parti do të zbatojë me besnikëri Deklaratën e Moskës, atëhere do të ketë unitet të plotë mendimi e veprimi dhe nuk do të ketë mosmarrëveshje parimore për këtë çështje. Por puna është si do të zbatohet Deklarata, a do t'i qëndrojnë të gjithë besnikë asaj? Sepse edhe më parë ishte Deklarata e Moskës e vitit 1957, por ajo u shkel, në radhë të parë nga udhëheqësit sovjetikë. Nga ana jonë ne mund të themi se Partia e Punës e Shqipërisë, ashtu si deri tani, siç ka zbatuar me vendosmëri deklaratën e vitit 1957 dhe siç ka luftuar për respektimin e parimeve të saj nga të gjithë, do të zbatojë dhe do të luftojë për respektimin e saj me të gjitha forcat, duke ditur se kështu u qëndron besnike marksizëm-leninizmit, interesave të lëvizjes komuniste dhe të kampit të socializmit, interesave të popullit dhe të atdheut tonë. Ne urojmë që Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik dhe të gjitha partitë e tjera të respektojnë e të zbatojnë me besnikëri Deklaratën e aprovuar. Kjo do t'i shërbejë forcimit e çelnikosjes së unitetit të komunistëve dhe të kampit socialist.

Ekzistenca e mosmarrëveshjeve, veçanërisht midis Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste të Kinës, e dëmton shumë unitetin tonë. . . Në Mbledhjen e Bukureshtit në qershor 1960 dhe pas saj, në fjalime e vendime të disa partive, si dhe në shtypin sovjetik dhe atë të disa vendeve socialiste është thënë se mund të bëjmë edhe pa Kinën, se Kinën mund ta përjashtojmë nga kampi etj. Del pra se këto pikëpamje kanë qenë të gabuara e antimarksiste, gjë që në fakt u hodhën poshtë edhe nga vetë ata që i kishin thënë. Këtu edhe një herë duket qartë se sa me urtësi e sa drejt veproi Partia jonë në Mbledhjen e Buku-

reshtit, ku nuk u bashkua me prapaskenën antimarksiste për të «dënuar» Partinë Komuniste të Kinës.

Me shumë të drejtë komunistëve mund t'u lindë pyetja tjetër: Po mosmarrëveshjet që kanë ekzistuar midis Partisë sonë dhe udhëheqësve sovjetikë a u zgjidhën? Marrëdhënjet tona me Bashkimin Sovjetik dhe me Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik a u rregulluan? Kjo pyetje është e drejtë të bëhet, sepse kjo çështje i preokupon të gjithë.

Ne ua thamë udhëheqësve sovjetikë në Konferencën e Moskës hapur pikëpamjet tona, ne i kritikua ata për qëndrimet jo të drejta kundrejt Partisë e vendit tonë, ne kërkua që t'u jepej fund këtyre shfaqjeve negative, si presioneve politike e ekonomike, dhe që mbi baza të drejta e shoqërore, sipas mësimëve të marksizëm-leninizmit të forcojmë miqësinë tonë. Por në Konferencën e Moskës, përpara përfaqësuesve të partive motra, shokët sovjetikë nuk i aprovuan kritikën tona, përkundrazi ata dhe disa delegacione të tjera sulmuan padrejtësisht Partinë tonë, duke na quajtur si shpifës, sikur ne kërkonim të diskreditojm Bashkimin Sovjetik e udhëheqësit e tij etj.

Natyrisht Konferenca e Moskës nuk ishte mbledhur për t'u marrë konkretisht me mosmarrëveshjet që ka midis Partisë sonë e udhëheqjes sovjetike dhe aq më pak për t'i zgjidhur ato. Mosmarrëveshjet do të zgjidhen nga dy partitë tona. Tani shokët e udhëheqjes sovjetike i dinë mendimet dhe pikëpamjet tona, kritikën ne ua bëmë hapur dhe shoqërisht, pra në qoftë se ata ndryshojnë qëndrimin e tyre, në qoftë se zbatojnë parimet e Deklaratës së Moskës dhe heqin dorë nga pikëpamjet e veprimet antimarksiste ndaj Partisë sonë, mosmarrëveshjet tona do të zduken. Partia e Punës e Shqipërisë, duke mos hequr dorë nga parimet e marksizëm-leninizmit, duke ruajtur me besnikëri e fanatizëm pastërtinë e tij, është e gatshme mbi bazën e primeve që përcaktoi Konferenca e Moskës për marrëdhënjet midis partive motra, mbi bazën e marksizëm-leninizmit dhe të mosndërrhyrjes në punët e brendshme të njëri-tjetrit, të përmirësojë marrëdhënjet me Bashkimin Sovjetik dhe me Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik.

Por ne duhet të jemi të përgatitur edhe për mundësinë tjetër. Shokët e udhëheqjes sovjetike mund të vazhdojnë qëndrimin e shtrembër e antimarksist kundër Partisë e vendit tonë edhe në të ardhshmen: ata mund të përpiqen të na nxjerrin vështirësi të reja, si në çështjet politike, ashtu edhe në ato ekonomike. Konkretisht ata mund të përpiqen të shpifin kundër Partisë sonë, duke e akuzuar atë sikur gjoja mban qëndrim antisovjetik etj. Qëllimi i tyre do të jetë që të përçajnë Partinë, të shkatërrojnë unitetin e saj. Nga ana tjetër, ata mund të kufizojnë ndihmat ekonomike, me qëllim që të pengojnë zhvillimin socialist të vendit, të bëjnë që të dështojë plani i tretë pesëvjeçar dhe si rrjedhim të turpërohet

Partia jonë në sytë e masave popullore, të bëhen këto të pakënaqura dhe kështu të shkatërrohet uniteti ynë.

A mund t'jua arrijnë këtyre qëllimeve, me këto metoda anti-parti e antimarksiste, udhëheqësit sovjetikë? Ne me bindje të plotë përgjigjemi jo. Ata në asnjë mënyrë dhe kurrë nuk mund të përuhin Partinë e popullin tonë, nuk mund të përçajnë unitetin tonë të çeliktë, nuk mund të ndalojnë ndërtimin e socializmit në vendin tonë. Në qoftë se udhëheqësit sovjetikë i hyjnë një pune të tillë, kjo jo vetëm do të tregojë edhe një herë se ata po vazhdojnë rrugën e gabuar e antimarksiste, por do të vërtetojë edhe një gjë: se udhëheqësit sovjetikë nuk e njohin Partinë tonë heroike, e cila ka lindur në luftë, është rritur në përlëshje me armiqtë e vështirësitë, është kalitur në beteja kundër fashistëve italianë e gjermanë, kundër revizionistëve jugosllavë, kundër të gjitha plehërave oportuniste e revizioniste që janë shfaqur edhe në radhët tona dhe ka dalë kurdoherë fitimtare; se nuk e njohin popullin tonë të lavdishëm, i cili është i vogël në numër, por ka zemër të madhe, i cili gjatë gjithë historisë së tij mijëvjeçare nuk e ka përkulur kurrë kokën, përpara asnjë kërcënimi, por kurdoherë ballëhapët, me guxim, ka ecur përpara, ka triumfuar mbi armiqtë dhe gjithnjë ka dalë faqebardhë; se nuk e njohin dhe nuk kanë besim në marksizëm-leninizmin, i cili nuk njih as të madh as të vogël, por që i mbush zemrat e njerëzve me zjarr e barut, që i bën njerëzit çelik dhe të pamposhtur ndaj çdo armiku apo deviatori, ndaj çdo shkelësi të ideve tona ngadhjimtare.

Nuk mund të kenë sukses udhëheqësit sovjetikë, duke e akuzuar Partinë tonë si antisovjetike. Gjithë bota e di se Partia jonë ka qenë, është dhe do të jetë luftëtare e patrembur e miqësisë me Bashkimin Sovjetik; se Partia jonë ka rrënjësuar thellë në zemrat e çdo shqiptari një dashuri të flaktë për popujt sovjetikë, të cilën asgjë nuk mund ta shuajë, bile as qëndrimet negative dhe jomiqësore të udhëheqësve sovjetikë ndaj vendit e Partisë sonë; se popujt sovjetikë dhe Partia e tyre e lavdishme Komuniste kanë patur, kanë dhe do të kenë kurdoherë në popullin dhe Partinë tonë një mik me besë, në ditë gëzimi e hidhërimi, i cili do të jetë gati për të mbrojtur atdheun e Leninit, miqësinë tonë të shtrenjtë, të farkëtuar me gjak, të kalitur me punën e përditshme të Partisë sonë heroike. Populli shqiptar dhe Partia e Punës e Shqipërisë e kanë shprehur dashurinë për Bashkimin Sovjetik e Partinë e tij Komuniste edhe në ditët më të këqia, edhe në ditët e Luftës patriotike, kur fashizmi gjendej para Moskës e Leningradit; ne e kemi treguar dashurinë tonë edhe atëhere kur pas vdekjes së Stalinit, apo në kohën e ngjarjeve të Polonisë e të Hungarisë, filloi fushata e egër antisovjetike, kur në disa vende socialiste vriteshin ushtarët sovjetikë, kur nga disa udhëheqës komunistë thuheshin njëmij të këqia kundër sistemit sovjetik dhe atdheut të Leninit...

Udhëheqësit sovjetikë nuk do të kenë sukses as në fushën e presioneve ekonomike. Natyrisht presionet ekonomike do të krijojnë disa vështirësi, por ato nuk do të ndalojnë ecjen tonë përpara. Në radhë të parë, sepse për çdo sukses garanci kryesore e vendimtare nuk janë ndihmat, por populli ynë, aftësia e tij krijuese, vendosmëria e tij. Ne nuk mohojmë, përkundrazi e vëmë gjithnjë në dukje e me mirënjohje se edhe deri tani kemi patur ndihmë të çmuar vëllazërore nga Bashkimi Sovjetik, nga Kina e vendet e tjera socialiste. Por pa punën vetmohuese dhe të talentuar të popullit tonë heroik, pa udhëheqjen e urtë të Partisë sonë nuk do të mund të realizoheshin fitoret që ka arritur vendi ynë. Por veç kësaj plani ynë i tretë pesëvjeçar është i garantuar nga pikëpamja e ndihmave ekonomike, sepse kreditë e nevojshme janë dhënë nga të gjitha vendet, ato janë firmuar⁵³. Anulimi i tyre do të ngarkonte me përgjegjësi shkaktarin, qoftë kjo dhe udhëheqja sovjetike. Por edhe sikur udhëheqësit sovjetikë të shkëlin kontratat e firmosura, prapë ne themi me siguri se plani i tretë pesëvjeçar nuk do të pengohet; ai do të realizohet njëjloj, sepse miqtë e shokët nuk na mungojnë, e në radhë të parë shokët kinezë.

Shokë,

Ne duhet të jemi realistë. Kështu si paraqiten marrëdhënjet me udhëheqjen sovjetike, në rast se kjo nuk do të ndryshojë qëndrimin e saj ndaj nesh, pavarësisht nga gatishmëria që tregojnë vendet socialiste e sidomos Republika Popullore e Kinës për të ndihmuar Partinë e popullit tonë, prapëseprapë disa vështirësi politike, sidomos po të kemi parasysh se vendi ynë është i rrethuar gjeografikisht nga armiqtë, do t'i kemi, prandaj duhet një luftë e vendosur. Në këto kushte, përpara Partisë dhe popullit tonë dalin detyra shumë të rëndësishme, të cilat çdo komunist duhet t'i zbatojë me përpikmëri. Cilat janë këto detyra?

E para: Detyra kryesore, si gjithnjë, është forcimi i mëtejshëm dhe çelnikosja e unitetit të radhëve të Partisë sonë, e unitetit të mendimit dhe veprimit të të gjithë komunistëve, të të gjitha organizatave të Partisë, të gjithë Partisë me Komitetin Qendror të saj. Kjo çështje ka rëndësi shumë të madhe, veçanërisht në këto çaste, sepse gjithë veprimtaria e armiqve tanë do të ketë si synim të lëkundë unitetin e Partisë. Uniteti i radhëve tona është garancia absolute për të gjitha fitoret. Ky unitet do të forcohet edhe më shumë, në qoftë se organizatat e Partisë do të luftojnë me vendosmëri kundër pikëpamjeve të huaja që mund të depërtojnë në elementë të ndryshëm, kundër grindjeve dhe tarafeve, të cilat objektivisht dobësojnë unitetin dhe u shërbejnë armiqve të Partisë, kundër elementëve frikacakë, të lëkundshëm dhe oportunistë, të cilët mund të shfaqin dyshime në vijën e drejtë të Partisë sonë.

Ashtu si deri tani, edhe në të ardhshmen Partia duhet të ruajë edhe më shumë konspiracionin për çështjet e Partisë e të shtetit dhe të respektojë me rreptësi porositë e vazhdueshme për forcimin e udhëheqjes kolegjiale etj. Forcimi i këtyre normave të Partisë, lufta e mëtejshme në këtë drejtim është gjithashtu një faktor i rëndësishëm për ta forcuar edhe më tepër unitetin e çeliktë të Partisë sonë.

Ne duhet të forcojmë edhe më shumë jetën e brendshme të Partisë. Zhvillimi më i mirë, në nivel më të lartë i mbledhjeve të Partisë, lufta për vënjen në jetë të të gjitha vendimeve që merren, aktivizimi i gjithë komunistëve, luajtja e rolit pararojë nga çdo komunist, forcimi i kritikës, i autokritikës dhe i disiplinës janë detyra me rëndësi të madhe për Partinë.

Duhet të forcohet roli drejtues, organizues dhe mobilizues i organizatave të Partisë, të forcohet kontrolli dhe drejtimi i tyre në të gjitha hallkat. Asgjë me rëndësi nuk mund të zgjidhet e të realizohet pa dorën dhe drejtimin e Partisë. Në këtë kuptim çdo komunist dhe organizatat në tërësi të kuptojnë përgjegjësinë e tyre.

Partia jonë duhet të forcojë njëkohësisht unitetin e saj me masat e gjëra të popullit, shtruarjen dhe zgjidhjen e çështjeve të ndryshme me masat e popullit. Çdo komunist duhet të jetojë në mes të popullit dhe në radhët e tij, me punën e tij shembullore, me aftësinë e tij të lozë rolin e udhëheqësit. Forca e pathyeshme e Partisë sonë është te lidhjet e ngushta dhe të përditshme me masat e gjëra të punëtorëve, të fshatarëve, të inteligjencës. Në këtë drejtim organizatat e Partisë, ashtu si deri tani, duhet t'i kushtojnë shumë kujdes punës me organizatat e masave, punës së organizatave të rinisë, të Bashkimeve Profesionale, të Frontit, të gruas etj., të cilat e lidhin Partinë me masat e gjëra. Në mënyrë të veçantë Partia duhet të merret me rininë dhe intelektualët.

E dyta: Organizatat e Partisë duhet të forcojnë punën politike dhe ideologjike me komunistët dhe me punonjësit. Të gjithë komunistët duhet t'i kushtojnë më shumë kujdes studimit të teorisë marksiste-leniniste. Veçanërisht tani ky problem merr një rëndësi të veçantë. Duhet të punohet e të shpjegohet mirë në masa dhe në Parti përmbajtja e Deklaratës dhe e Thirrjes që aprovoi Konferenca e Moskës. Qëllimi është që, duke shpjeguar mirë këto dokumenta, të dalë qartë se pikëpamjet që shprehen në to, çështjet që trajtohen, puqen plotësisht, pra vërtetojnë krejtësisht vijën e drejtë që ka ndjekur gjithnjë Partia jonë e Punës. Përmbajtja e këtyre dokumentave duhet të jetë një program pune për Partinë tonë. Prandaj ne, jo vetëm do të luftojmë për zbatimin e tyre në praktikë, por do të luftojmë edhe kundër kujtëdo që do të përpiqet të shtrembërojë tezat e atyre dokumentave. Simbas vendimit të Komitetit Qendror këto dokumenta duhet të punohen në

format e arësimit në Parti, me leksione e biseda me masat etj.

E treta: Gjatë punës politike me masat, Partia duhet të vazhdojë si më parë të forcojë punën për popullarizimin e Bashkimit Sovjetik, për forcimin e miqësisë dhe të dashurisë sonë për popujt sovjetikë, për Partinë e tyre Komuniste. Mosmarrëveshjet që kemi ne me udhëheqësit sovjetikë nuk duhet të ndryshojnë vijën e përgjithshme të Partisë sonë në lidhje me qëndrimin si ndaj Bashkimit Sovjetik, ashtu edhe ndaj vendeve të demokracisë popullore. Qëndrimi dhe vija e Partisë sonë në këtë drejtim mbeten të paprekura, mbeten ato që kanë qenë. Kjo ka rëndësi të madhe të kuptohet mirë, sepse elementët armiq dhe revizionistët do të përpiqen ta çorientojnë Partinë dhe popullin, me qëllim që të na fusin në qorrrokak. Prandaj në agjitacionin e propagandën tonë popullarizimit të sukseseve të Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të tjera socialiste duhet t'i kushtojmë kujdes ashtu si edhe forcimit të miqësisë e të dashurisë ndaj popujve të tyre. Me njerëzit sovjetikë, apo ata të vendeve të demokracisë popullore, duhet të mbahet qëndrim korrekt dhe i matur, i ngrohtë e i përzemërt, si edhe më parë. Natyrisht, në qoftë se ndokush do të përpiqet të shpifë kundër Partisë sonë, apo udhëheqjes së saj, çdo komunist e çdo qytetar e ka për detyrë të mbrojë Partinë e tij dhe t'u tregojë vendin shpifësve, cilëtdo qofshin ata.

E katërta: Duke forcuar punën politike dhe ideologjike në Parti, organizatat e Partisë dhe çdo komunist e kanë për detyrë të rrisin edhe më shumë vigjilencën revolucionare, si në radhët e Partisë, ashtu edhe në popull. Është fare e qartë se në këto situata armiqtë, dhe në radhë të parë revizionistët jugosllavë, do të përpiqen të punojnë për të mbjellë dyshime, për të vjellë helm kundër Partisë dhe vijës së saj, me qëllim që të ngjallin pakënaqësi, të demobilizojnë masat, të mbjellin panik e frikë etj. Partia jonë duhet të hapë sytë, t'i demaskojë këto veprime e manevra, si dhe parullat e tyre të ndryshme, të rrisë vigjilencën, në mënyrë që asnjë intrigë të mos ketë sukses. Organizatat e Partisë kanë një eksperiencë të madhe në këtë drejtim, por tani duhet edhe më shumë zgjuarësi dhe kundërveprim i shpejtë. Edhe në të ardhshmen duhet t'i kushtohet kujdes forcimit të Ushtrisë sonë Popullore, organeve të sigurimit të shtetit dhe atyre të kufirit.

E pesta: Detyra më themelore, me të cilën janë të lidhura të tjerat, është ajo e mobilizimit të të gjithë Partisë, të komunistëve dhe të gjithë punonjësve për të realizuar me sukses detyrat ekonomike në të gjitha fushat: në industri, në bujqësi, në arësim e kulturë, në ndërtim, komunikacion etj. Duhet të kemi parasysh, shokë, se armiqtë kurdoherë llogarisin në vështirësitë që mund të na lindin në këtë fushë. E thamë edhe më parë se ne duhet të jemi të pregatitur edhe për presione të reja eventuale ekono-

mike që mund të na bëjnë udhëheqësit sovjetikë. Çfarë kërkohet nga komunistët dhe nga çdo punonjës i vendit tonë?

a) Në radhë të parë që secili të dyfishojë forcat, të dyfishojë entuziazmin dhe vullnetin në punë, të dyfishojë zotësitë e dije-nitë e tij. Çdo punonjës, dhe në radhë të parë çdo komunist, jo vetëm duhet të realizojë plotësisht planin e shtetit, si sasi e si cilësi, por duhet ta tejkalojë atë. Kjo duhet bërë çështje nderi, çështje e patriotizmit socialist, në këtë shprehet besnikëria ndaj Partisë, ndaj vijës së saj të drejtë, në këtë shprehet vendosmëria për të mbrojtur marksizëm-leninizmin, për të dërmuar revizionizmin dhe çdo armik të Partisë sonë heroike.

b) Çdo ndërmarrje apo kooperativë bujqësore, çdo drejtues e teknik të shfrytëzohet në mënyrë racionale maqineritë dhe rezervat e brendshme, të vrasë mendjen, të nxisë shpikjet e racionalizimet, të inkurajojë iniciativën e masave, në mënyrë që me mjetet që ka të shtojë prodhimin, të përmirësojë cilësinë e tij. Të ngjallet në masat një entuziazëm dhe emulacion i madh, një emulacion patriotik i bazuar në dashurinë për popullin e Partinë tonë heroike, për qëndrimin e vijën e saj burrërore, të drejtë e marksiste-leniniste. Të kursehen sa më shumë mjetet e maqineritë, sidomos ato që vijnë nga importi, dhe të bëhen përpjekje që sa më pak të kërkohen për t'u importuar në të ardhshmen. Kjo do të jetë një shprehje tjetër e besnikërisë ndaj popullit e Partisë, e vendosmërisë për të shkuar përpara, pavarësisht nga çdo vështirësi që do të kemi.

Partia jonë ndodhet në prak të Kongresit IV të saj që do të mbahet me 13 shkurt 1961. Organizatat e Partisë duhet të mobilizojnë punonjësit që në kongres të vijnë me plane të realizuara e të tejkaluara. Kjo do të jetë dhurata më e mirë, aprovimi më konkret i vijës dhe i qëndrimit të Partisë sonë, shprehje e besnikërisë ndaj marksizëm-leninizmit.

Komiteti Qendror është i bindur se e gjithë Partia, ashtu si gjithnjë, si një trup i vetëm do të mobilizojë tërë popullin dhe do ta udhëheqë atë në punën e madhe ndërtimtare për plotësimin me sukses të të gjitha detyrave. Dikur, më 1941, kur u themelua Partia, më pak se 200 komunistë shqiptarë, të frymëzuar nga idetë e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit, ngritën në këmbë gjithë popullin tonë, e udhëhoqën atë në luftë dhe e nxorën fitimtar; sot jo më pak se 200, por mbi 50.000 komunistë janë në gjendje të shembin male, të ndalojnë lumenj, të ndryshojnë faqen e gjithë atdheut tonë të dashur. Komiteti Qendror ka besim të patundur se Partia jonë, populli ynë, duke u qëndruar besnikë për jetë mësimëve të marksizëm-leninizmit, do të kapërcejnë çdo pengesë e vështirësi dhe do të dalin kurdoherë fitimtarë. Ne jemi në rrugë të drejtë, ne luftojmë për një çështje fisnike, prandaj asgjë nuk mund të ndalë marshimin tonë përpara drejt socializmit dhe komunizmit.

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë porosit gjithë Partinë që çështjet për të cilat u fol në këtë letër janë çështje partie, prandaj ato nuk duhet të dalin jashtë, nuk duhet të bëhen objekt bisedimi me njerëz të ndryshëm, sepse kështu mund t'i sillt dem çështjes së Partisë. Pëshpëritjet dhe muhabetet e tepërta kurdoherë e dëmtojnë punën tonë.

KOMITETI QENDROR I PARTISË SË PUNËS
TË SHQIPËRISË

Botohet sipas origjinalit
që ndodhet në Arkivin
Qendror të Partisë

Nr. 133

LETËR E KQ TË PPSH DREJTUAR KOMITETIT QENDROR TË
PARTISË KOMUNISTE TË BASHKIMIT SOVJETIK. ME ANËN
E SË CILËS KRITIKOHEN PËRDPJEKJET E UDHËHEQJES
SOVJETIKE PËR TË SABOTUAR MARRËVESHJET
EKONOMIKE MIDIS RP TË SHQIPËRISË DHE BRSS
PËR PERIU DHËN 1961-1965

M O S K E

14 janar 1961

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë, me anën e një note të Ambasadës Sovjetike në Tiranë, në datën 6 janar 1961, mori njoftim për përgjigjen e Qeverisë së Bashkimit Sovjetik lidhur me përfundimin e marrëveshjes së kleringut midis Republikës Popullore të Shqipërisë dhe BRSS për periudhën 1961-1965 dhe nënshkrimin e marrëveshjes mbi kredinë e akorduar Republikës Popullore të Shqipërisë nga Bashkimi Sovjetik për mekanizimin e bujqësisë. Me anën e kësaj përgjigjeje, Qeveria Sovjetike, duke mos konsideruar të pranueshëm propozimin e Qeverisë Shqiptare për të dërguar për këtë qëllim në Moskë zëvendëskryetarin e Këshillit të Ministrave dhe kandidatin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, Koço Theodosin, «ripohon edhe një herë që çështjet ekonomike, të cilat, sikundër dihet, lidhen drejtpërdrejt me normalizimin e marrëdhënjeve, mund të diskutohen në kushtet e krijuara vetëm në nivelin më të lartë të partive dhe qeverive».

Një qëndrim i tillë nga ana e Qeverisë Sovjetike ne nuk na duket i kuptueshëm dhe në pajtim me vetë çështjen në shqyrtim dhe aq më pak në pajtim me karakterin e marrëdhënjeve midis vendeve pjesëtare të kampit socialist.

Bashkimi Sovjetik e ka ndihmuar vazhdimisht dhe pa kursyer popullin shqiptar dhe Republikën Popullore të Shqipërisë në përpjekjet për të zhdukur sa më shpejt prapambetjen shekullore dhe për të ndërtuar me sukses socializmin. Partia e Punës e Shqipërisë, qeveria jonë si dhe gjithë populli shqiptar e kanë

çmuar kurdoherë shumë dhe me mirënjohje këtë ndihmë të madhe, e kanë konsideruar atë dhe e konsiderojnë gjithnjë si një shprehje të internacionalizmit proletar, si një ndihmë që i jep shoku-shokut dhe vëllai vëllait.

Në këtë frymë Komiteti Qendror dhe qeveria jonë ju drejtuan Komitetit Qendror të Partisë Komuniste dhe Qeverisë së Bashkimit Sovjetik për kreditë e reja për realizimin me sukses të planit të tretë pesëvjeçar 1961-1965 të zhvillimit të ekonomisë popullore të Shqipërisë.

Sikundër dihet, në bazë të bisedimeve të zhvilluara në Moskë lidhur me këtë çështje në dhjetor 1958 midis përfaqësuesve të partive dhe qeverive të të dy vendeve në nivelin më të lartë, Bashkimi Sovjetik i akordoi Republikës Popullore të Shqipërisë një kredi prej 300 milion rublash për periudhën 1959-1965 dhe marrëveshja përkatëse, së bashku me listat mbi veprat që do të zgjerohen ose do të ndërtohen në Shqipëri me ndihmën e Bashkimit Sovjetik, në bazë të kësaj kredie, u nënshkrua në Tiranë më 3 korrik 1959. Po kështu, në përgjigje të kërkesës së Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, datë 30 prill 1960, për një kredi të veçantë prej 300 milion rublash për mekanikë bujqësorë dhe plehëra kimike, Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik pranoi t'i akordojë Republikës Popullore të Shqipërisë për këtë qëllim një kredi prej 70 milion rublash dhe më 25 korrik 1960 Qeveria Sovjetike i paraqiti Qeverisë Shqiptare projekt marrëveshjen përkatëse për nënshkrim. Përsa u përket shkëmbimeve në bazë kleringu midis dy vendeve, për periudhën 1961-1965, qysh me 3 prill 1959 është nënshkruar Protokolli përkatës nga kryetarët respektivë të Komisionit të Planit të Shtetit të Republikës Popullore të Shqipërisë dhe të BRSS, Koço Theodhosi dhe A. Kosigin, pas bisedimeve të zhvilluara për këtë qëllim nga të dy delegacionet qeveritare të kryesuara prej tyre.

Në këto kushte, duke i konsideruar të gjitha këto çështje të vendosura në nivelin më të lartë të partive dhe të qeverive të të dy vendeve dhe të përfunduara në rregull, Qeveria Shqiptare propozoi që marrëveshja mbi kleringun 1961-1965 dhe ajo e paraqitur nga Qeveria Sovjetike mbi kredinë për mekanizimin e bujqësisë të nënshkruar nga zëvendëskryetari i Këshillit të Ministrave dhe kryetar i Komisionit të Planit të Shtetit të Republikës Popullore të Shqipërisë, Koço Theodhosi. Është e qartë se nuk kishte mbetur asnjë çështje pa rregulluar, përveç disa ndryshimeve objektive të kërkuara nga Qeveria Shqiptare me notën e Ambasadës Shqiptare në Moskë me 28 tetor 1960 dhe që mund të zgjidheshin fare lehtë nga të dy delegacionet.

Këtu është rasti të përmendet se pak muaj më parë vetë Qeveria Sovjetike i konsideronte çështjet në të njëjtën mënyrë

dhe u deklarua e gatshme të dërgonte në Shqipëri për nënshkrimin e këtyre marrëveshjeve ministrin e tregëtisë së jashtme të Bashkimit Sovjetik, N. Patoliçev. Kur nga pala sovjetike na u njoftua se ministri i tregëtisë së jashtme të Bashkimit Sovjetik, N. Patoliçevi, nuk mund të vinte dot në Shqipëri për arsye shëndetësore, nga ana jonë u bënë përçapjet e nevojshme që të vinte në Moskë një delegacion shqiptar, i kryesuar nga zëvendëskryetari i Këshillit të Ministrave dhe kryetar i Komisionit të Planit të Shtetit, Koço Theodhosi.

Sikundër shihet, çdo gjë është shumë e qartë dhe propozimi i Qeverisë Shqiptare për të dërguar shokun Koço Theodhosi në Moskë për qëllimin e mësipërm është plotësisht me vend dhe i rregullt. Në këto rrethana, ne me të drejtë na çudit qëndrimi i marrë nga Qeveria Sovjetike tani së fundi për këto çështje dhe nuk mund të kuptojmë se nga ç'baza niset ajo që në mënyrë të njëanshme të kërkojë rishikimin e çështjeve të lartpërmendura, të diskutuara dhe të vendosura në nivelin më të lartë të partive dhe qeverive të të dy vendeve dhe të rregulluara përfundimisht. Në përgjigjen e saj të 6 janarit 1961 Qeveria Sovjetike bën edhe aluzione dyshimi mbi marrëdhënjet midis dy shteteve tona dhe flet për normalizimin e tyre.

Lidhur me këtë qëndrim të Qeverisë Sovjetike, ne e shohim me vend t'ju shprehim hapët mendimin tonë se ky qëndrim i Qeverisë së Bashkimit Sovjetik parimisht nuk është i drejtë dhe praktikisht nuk pajtohet me gjendjen reale të fakteve dhe të çështjes në shqyrtim. Qeveria Sovjetike, duke përzjerë marrëdhënjet shtetërore me ato midis partive, pa të drejtë dhe në mënyrë të papranueshme në marrëdhënjet midis vendeve tona socialiste, kërkon t'i imponojë vullnetin e saj Partisë së Punës të Shqipërisë për të dërguar përfaqësuesin kryesor të Partisë për t'i biseduar këto çështje.

Pikëpamja jonë është se çështjet e ngritura nga Qeveria Sovjetike kanë karakter të shtrembër dhe mund të konsiderohen me të drejtë si presione ekonomike që i bëhen shtetit tonë dhe Partisë së Punës të Shqipërisë, në prakun e Kongresit IV të saj, për t'i nxjerrë vështirësi ekonomike e të tjera. Ne mendojmë se marrëdhënjet midis dy shteteve tona duhet të jenë krejt normale dhe Qeveria Sovjetike, duke vënë në dyshim karakterin e tyre të vërtetë, bën një vlerësim shumë të gabuar dhe të njëanshëm, me të cilin ne nuk mund të pajtohemi.

Ne duam të theksojmë se Partia e Punës e Shqipërisë dhe Qeveria Shqiptare e kanë konsideruar dhe do ta konsiderojnë kurdoherë kënaqësi takimin e delegacioneve të dy partive e qeverive tona të nivelit më të lartë dhe të çdo niveli tjetër... por në kondita të tilla si e paraqet çështjen Qeveria Sovjetike, Komiteti

Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë nuk e gjen të arësyeshme dhe as me vend që të dërgojë një delegacion të nivelit të lartë, e para për arësye se, siç u tha më lart, çështjet për të cilat bëhet fjalë janë shqyrtuar dhe vendosur përfundimisht nga të dyja palët, në marrëveshje të plotë midis tyre dhe në nivelin më të lartë, dhe e dyta për arësye se Qeveria Sovjetike i ngre këto çështje në mënyrë jo të drejtë, në kundërshtim me frymën e marrëdhënjeve midis vendeve socialiste, pra të papranueshme nga ana jonë.

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë shpreson se Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik do të marrë masa që edhe në të ardhshmen marrëdhënjet midis të dy vendeve tona të vazhdojnë në rrugën e drejtë të marrëdhënjeve miqësore që kanë ekzistuar prej një kohe të gjatë, marrëdhënje këto që i kanë lidhur ngushtë të dy vendet dhe popujt tanë. Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë shpreson se Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik do të marrë masat që gjen më të përshtatshme, në mënyrë që delegacioni i caktuar nga Qeveria Shqiptare, me shokun Koço Theodhosi në krye, të vijë sa më parë në Moskë dhe të nënshkruajë me përfaqësuesit e Qeverisë Sovjetike akordet që kanë lidhje me marrëveshjet e përfunduara më parë.

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë dëshiron t'i vërë në dukje Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik se, në qoftë se do të ecet në atë rrugë si i shtron çështjet Qeveria Sovjetike, në lidhje me marrëdhënjet midis dy vendeve tona, duke u mundur të krijojë vështirësi për ndërtimin socialist në Shqipëri, ajo është rrugë pa krye. Natyrisht, Qeveria Sovjetike do të mbante përgjegjësinë për rrjedhimet që do të kishin këto veprime në marrëdhënjet shqiptaro-sovjetike, veprime që janë të papajtueshme me praktikën e deritashme të marrëdhënjeve midis partive marksiste dhe vendeve socialiste. Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë ka besim te Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik dhe te Komiteti i saj Qendror se do të mënjanohen pengesat artificiale që i vihen Partisë së Punës të Shqipërisë dhe një vendi mik dhe aleat, pjesëtar i kampit socialist, një partie marksiste dhe një vendi të vogël socialist që luftojnë pa u tundur, në kushtet e rrethimit gjeografik armiqësor, kundër imperialistëve dhe armiqve të marksizëm-leninizmit, revizionistëve jugosllavë, për mbrojtjen jo vetëm të interesave të popullit shqiptar, por edhe të interesave të të gjithë kampit socialist...

Ne shpresojmë se Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik do t'i shqyrtojë me vëmendje këto çështje të rëndësishme dhe do të na japë përgjigje brenda një kohe të afërt,

me qëllim që marrëveshjet në fjalë të nënshkruhen sa më shpejt që të jetë e mundur.

Me përshëndetje komuniste.

ME POROSI TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH
SEKRETARI I PARË I KQ TË PPSH

ENVER HOXHA

Botohet sipas origjinalit
që ndodhet në Arkivin
Qendror të Partisë

LETËR E KQ TË PPSH DREJTUAR KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SOCIALISTE TË BASHKUAR GJERMANE, ME ANËN E SË CILËS PROTESTOHET PËR AKUZAT E NGRITURA NË FJALIMIN E SEKRETARIT TË PARË TË KQ TË PS TË BASHKUAR GJERMANE, VALTER ULBRIHT KUNDËR PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

BERLIN

14 janar 1961

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë mësoi me keqardhje përmes organit të Komitetit Qendror të Partisë Socialiste të Bashkuar Gjermane «Neues Deutschland», numër 349, datë 18 dhjetor 1960, se Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të Partisë Socialiste të Bashkuar Gjermane, shoku Valter Ulbriht, në referatin e mbajtur në Plenumin XI të Komitetit Qendror mbi rezultatet e Mbledhjes së partive komuniste e punëtore në Moskë, shtrembëroi qëndrimin që mbajti delegacioni i Partisë së Punës të Shqipërisë në Mbledhjen e Moskës, në nëntor 1960. Në «Neues Deutschland» thuhet:

«Në lidhjen e partive komuniste dhe punëtore doli me një koncept dogmatik e sektar, në mënyrë të veçantë, përfaqësuesi i Partisë së Punës të Shqipërisë».

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë i hedh poshtë me vendosmëri akuzat pa baza të ngritura në fjalimin e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të Partisë Socialiste të Bashkuar Gjermane, shokut Valter Ulbriht, kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe udhëheqjes së saj. Dihet se qëndrimi i Partisë së Punës të Shqipërisë dhe i delegacionit të saj në Mbledhjen e përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore në Moskë, në nëntorin e vitit 1960, ishte qëndrim i drejtë, marksist-leninist. Delegacioni i Partisë së Punës të Shqipërisë parashtroi me kurajo dhe drejt pikëpamjen e Partisë së tij, duke zbatuar të gjitha rregullat dhe praktikën që ndiqet në mbledhje të tilla të partive komuniste dhe punëtore motra.

Ne na çudit fakti që shoku Valter Ulbriht, megjithëse i kishte të gjitha mundësitë që në Mbledhjen e Moskës të shfaqte pikëpamjen e tij ndaj qëndrimit të Partisë së Punës të Shqipërisë që paraqiti delegacioni i saj, ai atje nuk tha asgjë, ndërsa preferoi të zgjedhë një rrugë të dëmshme për të bërë akuza pa asnjë bazë kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe udhëheqjes së saj, akuza të cilat u publikuan në shtypin e Republikës Demokratike Gjermane, d.m.th. ndoqi rrugën e publikimit, duke u dhënë kështu mundësi reaksionit ndërkombëtar dhe revizionizmit jugosllav t'i shfrytëzojnë këto për qëllimet e tyre antisocialiste, antimarksiste dhe antishqiptare.

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë nuk është kundër marrjes në diskutim brenda në parti të çështjeve ose qëndrimeve të një partie tjetër, kur gjykohet se duhen diskutuar; por kur çështjet që diskutohen brenda në parti përmes shtypit bëhen çështje publike, atëhere duhet të zbulohen edhe shkaqet e vërteta që i shtyjnë autorët e tyre të mbajnë një qëndrim të tillë. Siç dihet, Deklarata e Moskës thekson: «Kur kësaj ose asaj partie i lindin pyetje që kanë të bëjnë me veprimtarinë e një partie tjetër motër, atëhere udhëheqja e saj i drejtohet udhëheqjes së partisë përkatëse; në rast nevojë bëhen takime dhe konsultime». Ne dëshirojmë të vëmë në dukje se Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të Partisë Socialiste të Bashkuar, shoku Valter Ulbriht, jo vetëm që ka shtrembëruar qëndrimin e delegacionit të Partisë së Punës të Shqipërisë në Konferencën e Moskës, porse, duke vepruar në atë mënyrë, ne mendojmë se nuk i është përmbajtur Deklaratës së Moskës të vitit 1960.

Ne na vjen shumë keq që shoku Valter Ulbriht pa të drejtë gjeti të sulmojë botërisht një parti motër, të barabartë e të pavarur për qëndrimin e drejtë e marksist-leninist që mbajti në Konferencën e Moskës dhe që në konditat e rrethimit kapitalist e revizionist ka përballuar dhe përballon vështirësi jo të vogla për ruajtjen e pavarësisë së vendit dhe të ndërtimit socialist të tij, për mbrojtjen me konsekuencë të marksizëm-leninizmit, të unitetit të kampit socialist dhe të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare.

Dihet botërisht se Partia e Punës e Shqipërisë, e udhëhequr nga ndjenjat internacionaliste dhe nga mësimet e marksizëm-leninizmit në gjithë veprimtarinë e saj, ka mbrojtur kurdoherë në mënyrë të vendosur Republikën Demokratike Gjermane dhe interesat e saj nga kërcënimet e imperializmit dhe të armiqve të tjerë të Republikës Demokratike Gjermane, ashtu sikurse ka vepruar edhe Partia Socialiste e Bashkuar Gjermane ndaj Republikës Popullore të Shqipërisë, por fatkeqësisht Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të Partisë Socialiste të Bashkuar Gjermane, shoku Valter Ulbriht, duke sulmuar pa të drejtë Partinë e Punës të Shqipërisë,

u dha rast imperialistëve, revizionistëve jugosllavë dhe emigrationit reaksionar shqiptar jashtë shtetit të shpërthejnë sulme të reja, në mënyrë të shfrenuar, me anën e radios, të shtypit dhe të mjeteve të tjera të propagandës dhe të shtojnë veprimet diversioniste kundër Republikës Popullore të Shqipërisë, si edhe kundër Partisë së Punës të Shqipërisë, duke dëmtuar kështu interesat e Shqipërisë socialiste e të popullit shqiptar edhe të kampit të socializmit. Ne ju sigurojmë juve, të dashur shokë, se Partia e Punës e Shqipërisë do t'i përballojë me sukses të gjitha sulmet e poshtra të armiqve tanë, se ajo mbron një çështje të drejtë, por shoku Valter Ulbriht mban një përgjegjësi të madhe për çka bëri kundër Partisë së Punës të Shqipërisë.

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë shpreh keqardhjen e tij të thellë për këtë fakt dhe, në interes të ruajtjes së unitetit të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare dhe të kampit socialist, kërkon që t'u jepet fund qëndrimeve të tilla dhe marrëdhënjet midis partive motra të mbahen kurdoherë në frymën e Deklaratës së Moskës.

Përhëndetje revolucionare.

KOMITETI QENDROR I PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

**Botohet sipas origjinalit
që ndodhet në Arkivin
Qendror të Partisë**

Nr. 135

PLENUMI XXII I KQ TË PPSH

Tiranë, 6 shkurt 1961

KOMUNIKATË

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

Më 6 shkurt 1961 u mbledh Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH, nën kryesinë e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të PPSH, shokut Enver Hoxha, për të shqyrtuar raportet që do t'i paraqiten Kongresit IV të Partisë dhe përgatitjet për kongresin.

Plenumi aprovoi njëzëri raportin «Mbi aktivitetin e Komitetit Qendror të PPSH», që do të mbahet nga Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Enver Hoxha, si dhe raportin «Mbi projekt-direktivat e planit të tretë pesëvjeçar 1961-1965 të zhvillimit të ekonomisë e të kulturës të RP të Shqipërisë», që do të mbahet nga anëtari i Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH dhe Kryetar i Këshillit të Ministrave të RPSH, shoku Mehmet Shehu.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

**Botohet sipas gazetës
«Zëri i Popullit» Nr. 32,
datë 7 shkurt 1961**

KONGRESI IV I PPSH

Tiranë, 13-20 shkurt 1961

Kongresi IV i PPSH i zhvilloi punimet e tij në Tiranë. Në të merrnin pjesë 754 delegatë me votë deliberative dhe 54 delegatë me votë konsultative që përfaqësonin 50.802 anëtarë dhe 2.857 kandidatë për anëtarë partie.

Kongresi punoi me këtë rend dite:

1) Raport mbi aktivitetin e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë. Referoi Sekretari i Parë i Komitetit Qendror shoku Enver Hoxha. 2) Raport mbi aktivitetin e Komisionit Qendror të Revizionimit të Partisë së Punës të Shqipërisë. Referoi anëtari i Komisionit Qendror të Revizionimit shoku Llazi Stratobërdha. 3) Raport mbi direktivat e Kongresit IV të Partisë së Punës të Shqipërisë për planin e tretë pesëvjeçar të zhvillimit ekonomik e kultural të Republikës Popullore të Shqipërisë. Referoi anëtari i Byrosë Politike dhe Kryetari i Këshillit të Ministrave shoku Mehmet Shehu. 4) Zgjedhja e organeve qendrore të Partisë.

Kongresi i bëri një analizë të thellë shkencore, marksiste-leniniste, veprimtarisë së Partisë që nga Kongresi III. Ai bëri bilancin e rezultateve të arritura në fushën politike, ekonomike e kulture dhe përcaktoi drejt rrugët e zhvillimit për të ardhshmen.

Kongresi mori vendime të rëndësishme që i hapën vendit tonë perspektiva të mëdha. Ai hyri në histori si kongresi që çeli një etapë të re në zhvillimin e vendit, etapën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste dhe që përgatiti Partinë për një sulm të përgjithshëm ideologjik kundër revizionizmit modern. Kongresi aprovoi direktivat e planit të tretë pesëvjeçar të zhvillimit ekonomik e kultural të vendit. Në të njëjtën kohë mori vendim mbi disa ndryshime në Statutin e Partisë në përshtatje me kushtet e zhvillimit të vendit dhe të Partisë. Kongresi zajodhi organet udhëheqëse të Partisë: Komitetin Qendror të PPSH prej 53 anëtarësh dhe 29 kandidatësh dhe Komisionin Qendror të Revizionimit prej 9 anëtarësh.

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH, i zqjedhur nga Kongresi IV, në mbledhjen e tij më 20 shkurt 1961 zgjodhi Byronë

Politike të përbërë nga 11 anëtarë e 4 kandidatë dhe Sekretariatit e Komitetit Qendror të përbërë nga 5 sekretarë. Sekretar i parë i Komitetit Qendror të PPSH u zgjodh shoku Enver Hoxha.

Nr. 136

VENDIM

I KONGRESIT IV TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË PËR APROVIMIN E RAPORTIT «MBI VEPRIMTARIËN E KOMITETIT QENDROR TË PPSH»

16 shkurt 1961

Kongresi IV i Partisë së Punës të Shqipërisë, pasi dëgjoji dhe diskutoi raportin e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të PPSH, shokut Enver Hoxha, Mbi veprimtarinë e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë,

Vendosi

Të aprovohet plotësisht raporti, vija politike dhe veprimtaria praktike e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Botohet sipas librit
Kongresi IV i PPSH
Tiranë, 1961

Nr. 137

VENDIM

I KONGRESIT IV TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË PËR APROVIMIN E RAPORTIT TË KOMISIONIT QENDROR TË REVIZIONIMIT TË PPSH

16 shkurt 1961

Kongresi IV i Partisë së Punës të Shqipërisë vendosi të aprovohet raporti i Komisionit Qendror të Revizionimit të PPSH.

Botohet sipas librit
Kongresi IV i PPSH
Tiranë, 1961

VENDIM**I KONGRESIT IV TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË
PËR RAPORTIN «MBI DIREKTIVAT E PLANIT TË TRETË
PESEVJEÇAR TË ZHVILLIMIT EKONOMIK E KULTURAL TË
REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË»**

19 shkurt 1961

Kongresi IV i PPSH, pasi dëgjoi raportin «Mbi direktivat e planit të tretë pesëvjeçar të zhvillimit ekonomik e kultural të Republikës Popullore të Shqipërisë», mbajtur nga shoku Mehmet Shehu, anëtar i Byrosë Politike dhe Kryetar i Këshillit të Ministrave të RP të Shqipërisë, dhe pasi diskutoi rreth tij, e aprovoi atë plotësisht dhe vendosi:

Të merren për bazë direktivat e Kongresit IV të PPSH për planin e tretë pesëvjeçar të zhvillimit ekonomik e kultural të Republikës Popullore të Shqipërisë në vjetët 1961-1965.

**Botohet sipas librit
Kongresi IV i PPSH
Tiranë 1961**

VENDIM**I KONGRESIT IV TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË
«MBI DISA NDRYSHIME NË STATUTIN E PARTISË SË PUNËS
TË SHQIPËRISË»**

20 shkurt 1961

Kongresi IV i Partisë së Punës të Shqipërisë vendosi:

Të aprovojë ndryshimet e propozuara nga Komiteti Qendror i Partisë për Statutin e Partisë së Punës të Shqipërisë.

**Botohet sipas librit
Kongresi IV i PPSH
Tiranë 1961**

REZOLUCION**I KONGRESIT IV TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË
PËR RAPORTIN MBI VEPRIMTARINË E KOMITETIT
QENDROR TË PPSH**

(APROVUAR NJËZËRI MË 20 SHKURT 1961)

20 shkurt 1961

Kongresi IV i Partisë së Punës të Shqipërisë, i mbledhur nga 13 deri më 20 shkurt 1961, pasi dëgjoi dhe diskutoi raportin mbi veprimtarinë e Komitetit Qendror të PPSH mbajtur nga Sekretari i Parë i Komitetit Qendror, shoku Enver Hoxha, *aprovoi njëzëri plotësisht vijën e përgjithshme dhe veprimtarinë praktike të Komitetit Qendror, si dhe konkluzionet, propozimet dhe detyrat që vihen në raport.*

Kongresi vëren me kënaqësi se vija e përgjithshme politike, ekonomike dhe organizative e Partisë ka qenë e drejtë, se Partia jonë i ka qëndruar kurdoherë besnike marksizëm-leninizmit dhe se në vendin tonë po ndërtohet me sukses socializmi.

Realizimi në përgjithësi para afatit i planit të dytë pesëvjeçar, sukseset në industrializimin e mëtejshëm socialist të vendit, kolektivizimi i bujqësisë, forcimi i gjithanshëm i Partisë, forcimi i gjendjes së brendshme dhe i pozitës ndërkombëtare të vendit tonë e kanë bërë periudhën midis Kongresit III dhe Kongresit IV të Partisë një nga më të rëndësishmet për fitoren e socializmit në Shqipëri. Kongresi vëren se me punën e popullit tonë heroik, të udhëhequr nga Partia jonë, besnike deri në fund e marksizëm-leninizmit, dhe me ndihmën e gjithanshme internacionaliste të Bashkimit Sovjetik, në radhë të parë, të Republikës Popullore të Kinës dhe të vendeve të tjera socialiste atdheu ynë është bërë sot më i fuqishëm, janë shtuar pasuritë e tij, është përmirësuar jeta e popullit.

Duke bërë bilancin e punës së Partisë për këtë periudhë, në një kohë kur kanë ndodhur ndryshime të mëdha, si brenda vendit ashtu edhe në fushën ndërkombëtare, kur në Shqipëri është ndërtuar baza ekonomike e socializmit dhe tani vendi ynë po hyn në një etapë të re, në etapën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste, ku rolin kryesor do ta luajë ndërtimi i mëtejshëm i bazës materialo-teknike të socializmit, kur në fushën ndërkombëtare forcat e paqes e të socializmit ua kanë kaluar forcave të luftës dhe të reaksionit imperialist, Kongresi shpreh kënaqësinë për këto fitore të mëdha të popullit tonë dhe të socializmit në tërësi.

Në këto kushte Kongresi IV i Partisë ka një rëndësi të veçantë për Partinë dhe për popullin tonë. Vendimet e tij për ndërtimin e mëtejshëm të socializmit, për sigurimin e paqes, për forcimin e unitetit të kampit socialist e të lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe për ruajtjen e pastërtisë së marksizëm-leninizmit përcaktojnë rrugën në të cilën do ecë Partia jonë në të ardhshmen.

— I —

Karakteristika kryesore në zhvillimin e gjendjes ndërkombëtare sot është ndryshimi i raportit të forcave në dobi të socializmit e të paqes dhe në dëm të imperializmit e të luftës. Në arenën botërore duket përherë e më shumë epërsia e forcave të socializmit mbi ato të imperializmit, epërsia e forcave të paqes mbi ato të luftës. Në Deklaratën e Moskës të vitit 1960 përcaktohet drejt se epoka jonë është epoka e luftës midis dy sistemeve shoqërore të kundërta, e revolucioneve socialiste dhe nacional-çlirimtare, e shembjes së imperializmit dhe e zhdukjes së sistemit kolonial, e triumfit të socializmit dhe të komunizmit, se përmbajtja themelore e epokës sonë është kalimi nga kapitalizmi në socializëm, kurse tipari i saj dallues është se sistemi socialist botëror po bëhet faktori vendimtar i zhvillimit të shoqërisë njerëzore.

Socializmi, që nga Revolucioni i madh socialist i Tetorit, ka korrur fitore më rëndësi historike botërore. Bashkimi Sovjetik është bërë një shtet i fuqishëm në botë... Gjithashtu Republika Popullore e Kinës është bërë një shtet i fuqishëm socialist. Të gjitha vendet e tjera të kampit socialist kanë arritur suksese të mëdha... Kampi socialist, që përfshin në gjirin e tij 12 shtete socialiste, është bërë kështjella e pamposhtur e socializmit, mburoja e sigurt e paqes dhe mbështetja e popujve të të gjithë botës në luftën e tyre për paqe, pavarësi kombëtare, demokraci dhe socializëm.

Por ndërsa sistemi socialist botëror është në ngritje dhe tregon çdo ditë e më shumë epërsinë e tij, sistemi kapitalist botëror është në rënje dhe tregon çdo ditë e më shumë paaftësinë për të zgjidhur problemet shoqërore të kohës dhe karakterin e tij reaksionar. Për kapitalizmin po bien këmbanat e vdekjes. Nën goditjen e luftës nacional-çlirimtare të vendeve të shtypura po shkatërrohet sistemi kolonial i imperializmit, nga i cili janë shkëputur deri tani rreth 1 miliard e 250 milion njerëz, dhe kanë lindur një numër i madh shtetesh të reja të pavarura në Azi, në Afrikë dhe në Amerikën Latine. Si rezultat i krijimit të sistemit socialist botëror, i shkatërrimit të sistemit kolonial dhe i ashpërsimit të të gjitha kontradiktave që e brejnë nga brenda sistemin kapitalist, të kontradiktave klasore e kombëtare të brendshme

e të jashtme, është thelluar kriza e përgjithshme e imperializmit. Imperializmi amerikan është bërë sot shfrytëzuesi më i madh ndërkombëtar, kështjella kryesore e reaksionit botëror, armiku më i egër i të gjithë popujve.

Ekzistenca dhe lufta e dy sistemeve botërore të kundërta përcakton edhe ekzistencën e dy vijave të kundërta në politikën ndërkombëtare.

Nga një anë është vija e politikës paqësore konsekuente që ndjekin Bashkimi Sovjetik, Kina Popullore dhe vendet e tjera të kampit socialist, e cila gjen çdo ditë e më shumë përkrahjen e popujve të botës. Kjo është politika e sigurimit të paqes, politika e bashkekzistencës paqësore midis shteteve me sisteme të ndryshme shoqërore, e mbështetjes dhe e përkrahjes së luftës nacional-çlirimtare antiimperialiste e antikoloniale të popujve të robëruar, e forcimit të bashkëpunimit vëllazëror dhe të ndihmës reciproke midis vendeve socialiste.

Bashkekzistenca paqësore është parimi leninist mbi të cilin vendet socialiste i bazojnë marrëdhënjet e tyre me vendet kapitaliste në kushtet e ndarjes së botës në dy kampe. Por të ndjekësh politikën e bashkekzistencës paqësore nuk do të thotë të heqësh dorë nga lufta politike e ideologjike, nga lufta e klasave dhe lufta e popujve të shtypur kundër shtypësve imperialistë. Përkundrazi, lufta për arritjen e bashkekzistencës paqësore kalon nëpërmjet luftës aktive të vendeve të kampit socialist dhe vendeve të tjera paqedashëse për zgjidhjen e problemeve ndërkombëtare, luftës nacional-çlirimtare të popujve të shtypur, luftës klasore të proletariatit dhe luftës për paqe. Popujt duhet t'ua imponojnë atë imperialistëve, të cilët nuk heqin dorë vullnetarisht nga «lufta e ftohtë», nga bloqet ushtarake, nga gara e armatimeve, nga ndërhyrja në punët e brendshme të vendeve të tjera, nga shkelja e pavarësisë dhe e sovranitetit të popujve.

Vendet e kampit socialist ndjekin në mënyrë të vendosur politikën e ruajtjes së paqes, sepse paqia u përgjigjet interesave jetike të të gjithë popujve dhe se vendeve tona ajo u duhet për ndërtimin e socializmit. Duke luftuar për sigurimin e paqes, ne nisemi nga fakti se në kushtet e sotme, kur forcat e socializmit ua kalojnë forcave të imperializmit, lufta nuk është fatalisht e pashmangshme, ajo mund të ndalohet nga popujt. Por në të njëjtën kohë nuk duhet harruar se derisa ekziston imperializmi, ekziston edhe rreziku i luftës, se imperializmi nuk ka ndryshuar natyrë, ai është agresiv dhe armik i popujve, prandaj popujt duhet t'i lidhin atij këmbë e duar, duhet t'ua imponojnë imperialistëve paqen.

Nga ana tjetër është politika agresive e përgatitjes së luftës që ndiekin me këmbëngulje fuqitë imperialiste, dhe në radhë të parë Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ato sabotojnë çdo ini-

ciativë të vendeve socialiste për zgjidhjen e çështjeve ndërkom-bëtare me anë bisedimesh, vazhdojnë garën e armatimeve, ndër-hyrjen në vendet e tjera, kërcënojnë botën me një luftë të re. Me përkrahjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës u ringjall edhe një herë militarizmi gjerman në zemër të Evropës. Paktet agresive të NATO-s, SEATO-s janë kthyer në vegla të pregatitjes së luftës kundër Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të tjera socialiste. Imperialistët amerikanë janë bërë xhandarë ndërkom-bëtarë në luftën kundër lëvizjes nacional-çlirimtare të popujve të shtypur, siç po ngjet në Algjeri, Kongo, Laos, etj., si dhe kundër luftrave klasore të proletariatit. Rreth 300 baza ushta-rake janë ngritur nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës në toka të huaja, të cilat drejtohen kundër Bashkimit Sovjetik, Republi-kës Popullore të Kinës dhe vendeve të tjera socialiste. Ato kanë pushtuar ishullin kinez të Tajvanit dhe pengojnë pjesëmarrjen e Republikës Popullore të Kinës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Të gjitha këto tregojnë qartë se fuqitë imperialiste, me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në krye, ecin drejt luftës. Kjo politikë, që u përgjigjet interesave të monopoleve të mëdha, u shpreh hapur edhe një herë nga presidenti i ri i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kenedi, i cili, me mesazhin e tij para Kongresit, tregoi se do të ndjekë kursin e politikës së paraardhë-sit të tij — Ajzenhauerit. Detyra e popujve është që të mos i lejojnë imperialistët ta hedhin botën në një luftë të re botërore, të jenë vigjilentë dhe të luftojnë që sot, sa nuk është vonë, për sigurimin e paqes.

Kongresi vëren me kënaqësi se në këtë gjendje të nderë dhe të ndërlikuar ndërkombëtare, në këtë luftë për mbrojtjen e paqes që ka përfshirë gjithë popujt dhe forcat paqëdashëse të botës, Partia jonë ka zbatuar me sukses vijën e saj të drejtë marksiste-leniniste në fushën e politikës së jashtme, ka ndjekur në mënyrë konsekuente politikën e sigurimit të paqes dhe të lar-gimit të rrezikut të luftës.

Republika Popullore e Shqipërisë, si vend socialist, si pjesë-tare e kampit socialist dhe e Traktatit të Varshavës, ka marrë pjesë aktivisht dhe ka dhënë kontributin e saj të çmueshëm për ruajtjen dhe forcimin e mëtejshëm të unitetit të kampit socialist, për demaskimin dhe kundërshtimin e planeve të politikës agre-sive të imperialistëve, me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në krye, dhe ka luftuar me vendosmëri kundër të gjithë armiqtë të paqes e të socializmit, imperialistëve dhe shërbëtorëve të tyre, revizionistëve jugosllavë, për zhdukjen e «luftës së ftohtë» dhe për të ndaluar që ajo të kthehet në një luftë të nxehtë bërtham-ore, e cila do t'i sillte njerëzimit shumë vuajtje e mjerime.

Miqësia me Bashkimin Sovjetik ka qenë guri themeltar i politikës sonë të jashtme. Ajo është farkëtuar nga Partia jonë

heroike në zjarrin e luftës për liri, socializëm dhe paqe, ajo mbështetet në parimet e marksizëm-leninizmit dhe të interna-cionalizmit proletar... Te populli sovjetik dhe te Partia Komu-niste e Bashkimit Sovjetik populli ynë ka mikun e tij të shtrenj-të, ashtu si edhe populli sovjetik ka te populli ynë dhe te Partia e Punës e Shqipërisë një mik besnik. Miqësia dhe bashkëpunimi vëllazëror me Republikën Popullore të Kinës, gjithashtu, janë forcuar shumë dhe shkojnë duke u forcuar për ditë në luftën e përbashkët për socializmin dhe paqen. Ne jemi krenarë që kemi në Republikën Popullore të Kinës dhe në popullin kinez një mik të tillë të shtrenjtë. Me të gjitha vendet e tjera të kampit socialist populli ynë ka forcuar dhe do të forcojë përherë e më shumë miqësinë dhe bashkëpunimin e tij vëllazëror.

Duke zbatuar me vendosmëri këtë politikë të jashtme paqes-ore, është forcuar pozita ndërkombëtare e vendit tonë, janë zgjeruar marrëdhënjet me vendet e tjera dhe vendi ynë luan sot një rol aktiv në fushën ndërkombëtare. Kongresi vëren se të gji-tha këto janë dëshmi e gjallë e vijës së drejtë marksiste-leniniste të ndjekur nga Partia jonë në politikën e jashtme.

Republika Popullore e Shqipërisë është bërë sot një faktor paqeje dhe përparimi në zonën e Ballkanit dhe të Adriatikut, pengesë për planet agresive të imperializmit amerikan në këtë pjesë të botës. Ajo ka demaskuar me forcë fytyrën e vërtetë të revizionistëve jugosllavë, si armiq të socializmit dhe të paqes në Ballkan, ka zbuluar planet e tyre agresive, pjesëmarrjen në bloq-et ushtarake të imperialistëve me anën e Paktit të Ballkanit dhe ka treguar se janë pikërisht revizionistët e Beogradit, me aleatët e tyre shovinistët e Athinës, që, duke zbatuar porositë e imperialistëve amerikanë, e pengojnë paqen në Ballkan.

Në luftën për sigurimin e paqes Republika Popullore e Shqi-përisë ka vendosur marrëdhënje diplomatike me një serë vendesh të Evropës, të Azisë, të Afrikës dhe të Amerikës. Partia dhe qeveria jonë kanë qenë dhe janë kurdoherë për marrëdhënje normale mbi bazën e respektimit reciprok, të barazisë e të mos-ndërhyrjes në punët e brendshme me të gjitha vendet që dëshë-rojnë të kenë marrëdhënje të tilla me ne. Gjithashtu, vendi ynë do të vazhdojë të japë të gjithë kontributin e tij në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, si dhe në organizatat e tjera ndërkomb-ëtare në të cilat bën pjesë.

Kongresi IV i Partisë e porosit Komitetin Qendror që edhe në të ardhshmen të vazhdojë të ndjekë me vendosmëri politikën e jashtme të miqësisë dhe të bashkëpunimit vëllazëror me Bash-kimin Sovjetik, Kinën Popullore dhe vendet e tjera të kampit socialist, politikën e bashkekzistencës paqesore me vendet që ka-në sistem shoqëror të ndryshëm nga sistemi ynë socialist dhe politikën e mbështetjes e të përkrahjes së luftës nacional-çlirim-

tare e antiimperialiste të popujve të shtypur ose të porsaçliruar. Duke ndjekur politikën e paqes për ndalimin e luftës, Partia, qeveria dhe gjithë populli ynë duhet të ndjekin kurdoherë me vigjilencë intrigat e imperialistëve dhe të shërbëtorëve të tyre revizionistë, t'i demaskojnë ata dhe të marrin të gjitha masat e duhura për të forcuar fuqinë mbrojtëse të atdheut tonë.

— II —

Kongresi IV i Partisë së Punës të Shqipërisë vërejti se gjatë këtyre 16 vjetëve pas çlirimit vendi ynë ka korrur fitore të mëdha historike në rrugën e ndërtimit të socializmit.

E udhëhequr në tërë veprimtarinë e saj nga shkenca ngadh-njimtare marksiste-leniniste, Partia jonë ndërmori një varg masash shumë të rëndësishme, të cilat sollën transformime me përmbajtje të thellë revolucionare ekonomiko-shoqërore. Shtetëzimi i industrisë, i transportit, i bankës, i tregëtisë së jashtme dhe të brendshme me shumicë çuan në vendosjen e pronës shoqërore mbi mjetet kryesore të prodhimit e të qarkullimit, krijuan mundësitë e para ekonomike për fillimin e ndërtimit të socializmit.

Përfundoi transformimi socialist i bujqësisë, duke u zgjidhur kështu me sukses një nga çështjet më të ndërlikuara të periudhës kalimtare nga kapitalizmi në socializëm. Fshatarësia jonë, me besim të patundur te Partia, hyri përfundimisht në rrugën e kolektivizimit dhe ecën me vendosmëri në këtë rrugë, e bindur plotësisht për epërsinë e saj ndaj ekonomisë së vogël individuale. Ky është një shembull tjetër i shkëlqyer i zbatimit në praktikë të planit leninist të kooperimit.

Kështu në vendin tonë është zhdukur në përgjithësi ekonomia shumëformëshe dhe në vend të saj është krijuar një sistem i vetëm socialist i ekonomisë.

Në këtë mënyrë baza ekonomike e socializmit është krijuar si në qytet ashtu dhe në fshat... Ekonomia kapitaliste, klasat shfrytëzuese dhe shfrytëzimi i njeriut prej njeriut janë zhdukur... Me këtë fitore të madhe historike vendi ynë po ecën me hapa më të shpejta në ndërtimin e bazës materialo-teknike të socializmit.

Mbi bazën e shëndoshë të marrëdhënjeve të reja socialiste në prodhim është bërë zhvillimi i vrullshëm i forcave prodhuese, është zhdukur papunësia, po ngrihen vazhdimisht mirëqenja materiale dhe niveli kultural i masave punonjëse, ka ndryshuar në mënyrë rrënjësore struktura e klasave të shoqërisë sonë.

Tipari më karakteristik dhe themelor i strukturës së klasave të vendit tonë në etapën e sotme është ekzistenca e dy klasave mike, e klasës punëtore dhe e fshatarësisë kooperativiste, ale-

anca e tyre, nën udhëheqjen e klasës punëtore, dhe forcimi mbi këtë bazë i unitetit moralo-politik të popullit tonë.

Transformime të thella revolucionare janë bërë edhe në fushën e ideologjisë, të arësimit dhe të kulturës. Është krijuar inteligjencia e re popullore. Një punë e madhe është bërë për edukimin e punonjësve me frymën e ndërgjegjes së lartë socialist ndaj punës dhe pronës së përbashkët, për ngritjen e nivelit arësimesor e kultural të popullit, për përparimin e shkencës e të teknikës dhe për përgatitjen e kuadrit.

Partisë sonë ju desh të ndërmerre industrializimin socialist të vendit në rrethanat e prapambetjes së theksuar tekniko-ekonomike që trashëguam nga e kaluara. Kjo ka qenë një luftë e vështirë e plot pengesa, por e domosdoshme. Një luftë të vendosur dhe konsekuente ka bërë Partia jonë kundër veprimtarisë armiqësore të imperialistëve dhe të shërbëtorëve të tyre, revizionistëve jugosllavë, të cilët kanë bërë çmos që ta shkëpusin Partinë nga rruga e saj e drejtë marksiste-leniniste, të pengojnë ndërtimin e socializmit në Shqipëri dhe të zhdukin pavarësinë e popullit shqiptar. Por ata në të gjitha përpjekjet e tyre kanë pësuar disfatë. Suksesi i vijës së drejtë ekonomike të ndjekur nga Partia jonë sot është më i qartë se kurrë.

Në arritjen e këtyre fitoreve të mëdha një vend shumë të rëndësishëm historik zë plani i dytë pesëvjeçar. Kongresi IV i Partisë së Punës të Shqipërisë vëren me kënaqësi se detyra kryesore e planit të dytë pesëvjeçar, e caktuar në Kongresin III, në përgjithësi u plotësua para afatit.

Volumi i përgjithshëm industrial u plotësua në 4 vjet e 9 muaj, nga i cili prodhimi i industrisë minerale në 4 vjet e 6 muaj. Në vitin 1960 volumi i prodhimit të përgjithshëm industrial u rrit 118 për qind në krahasim me vitin 1955, kundrejt 92 për qind që ishte detyra e caktuar nga Kongresi, me një ritëm mesatar vjetor prej 16,9 për qind. Në vitin 1960, në krahasim me vitin 1938, prodhimi i përgjithshëm industrial u rrit 25 herë.

Një rol të rëndësishëm në zhvillimin e ekonomisë sonë gjatë planit të dytë pesëvjeçar kanë luajtur vendimet e Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë që u mbajt në shkurt të vitit 1958. Mobilizimi i masave punonjëse, rritja e iniciativës së tyre për zbulimin dhe shfrytëzimin e rezervave të brendshme bënë të mundur rishikimin drejt rritjes së shifrave që çuan në realizimin dhe tejkalimin e detyrave të pesëvjeçarit të dytë.

Fitoret e mëdha historike që janë arritur deri sot kanë krijuar mundësitë që vendi ynë të vazhdojë me ritme më të shpejta ndërtimin e socializmit.

Pesëvjeçari i tretë do të shënojë një hap të rëndësishëm përpara në ndërtimin e bazës materialo-teknike të socializmit. Vendi

ynë do të ecë më shpejt në rrugën e transformimit nga një vend bujqësor-industrial, në një vend industrial-bujqësor, prodhimi bujqësor do të rritet me hapa më të mëdha dhe, si rrjedhim, do të ngrihet më shumë niveli material dhe kultural i masave punonjëse.

Vendi ynë i ka të gjitha mundësitë për ta bërë realitet këtë objektiv të Kongresit IV të Partisë së Punës të Shqipërisë. Udhëheqja e drejtë marksiste-leniniste e Partisë dhe uniteti i saj me popullin, plotësimi me sukses i planeve ekonomike të shtetit, ndërtimi i bazës ekonomike të socializmit, zhvillimi i pandërprerë i forcave prodhuese, pasuritë e vendit tonë, ndërgjegjja në punë dhe emulacioni socialist që ka shpërthyer në gjirin e klasës sonë heroike punëtore, të fshatarësisë punonjëse dhe të inteligjencies popullore janë garanci e shëndoshë se detyrat që caktoi ky kongres do të realizohen para afatit.

Në vitin 1965 pesha specifike e prodhimit industrial, kundrejt volumit të përgjithshëm të prodhimit industrial-bujqësor, do të arrijë 54 për qind.

Kongresi IV i Partisë së Punës së Shqipërisë e quan të domosdoshëm zhvillimin e mëtejshëm të industrializimit socialist të vendit, duke i dhënë epërsi zhvillimit me ritme më të shpejta industrisë së rëndë, si hallka vendimtare për ndërtimin e bazës materialo-teknike të socializmit. Një zhvillim të madh duhet të marrin industria minerale dhe ajo e përpunimit, me qëllim që të shfrytëzohen më mirë pasuritë e vendit, mineralet e dobishme, burimet e lëndëve djegëse dhe hidroenergjitike, pasuritë pyjore, lëndët e para bujqësore etj. Këtij qëllimi duhet t'i shërbejë ngri-tja për herë të parë në vendin tonë e degëve të reja të industrisë së rëndë, siç janë industria kimike për prodhimin e plehërave azotike dhe fosfatike, si dhe metalurgjia e ferro-kromit dhe elektrometalurgjia e bakrit.

Kongresi vuri detyrën që në pesëvjeçarën e tretë t'i jepet epërsi prodhimit të mjeteve të prodhimit, si kusht i domosdoshëm për transformimin e vendit tonë në një vend të industrializuar. Në këtë mënyrë prodhimi i mjeteve të prodhimit (grupi «A») do të rritet 54 për qind, ndërsa prodhimi i mallrave të konsumit të gjerë (grupi «B») 50 për qind.

Kujdes i posaçëm duhet treguar për industrinë e nxjerrjes dhe të përpunimit të naftës, e cila ka një perspektivë të madhe për vendin tonë. Të merren masa të efektshme për të vënë në doli të ekonomisë vendburime të reja nafte dhe gazi si dhe të intensifikohen punimet për nxjerrjen e saj nga shtresat në shfrytëzim. Zhvillim të vrullshëm gjatë pesëvjeçarit të tretë duhet të marrë prodhimi i të gjitha degëve të industrisë minerale. Të rritet shumë nxjerrja e qymyrgurit, e kromit, e bakrit dhe e hekur-nikelit si nëpërmjet shfrytëzimit më të mirë të vendburimeve

ekzistuese, ashtu edhe me anën e vënjes në shfrytëzim të minierave të reja.

Realizimi i këtyre detyrave mjaft të mëdha kërkon përmirësimin e punës në projektimin dhe në përgatitjen për shfrytëzim të minierave, ngritjen e shkallës së mekanizimit dhe të rendimentit të punës, zbatimin e sistemit të përparuar të shfrytëzimit me tregues të lartë teknikë dhe ekonomikë.

Për të përballuar ritmet e shpejta të zhvillimit të industrisë së naftës, të minierave, nevojat e veprave të fuqishme industriale dhe të metalurgjisë me ngjyra, të industrisë kimike që do të ngrihen në vendin tonë, Kongresi IV i Partisë e quan si detyrë të ngutshme dhe të domosdoshme zgjerimin dhe intensifikimin e punimeve gjeologjike. Kujdes i posaçëm duhet t'u kushtohet kërkimeve komplekse për gjetjen e vendburimeve të reja, në radhë të parë për naftën, bitumin dhe gazin natyror, qymyrgurin, kromin, hekur-nikelin dhe bakrin. Të zhvillohen punime kërkimi në shkallë të gjerë për zbulimin e lëndës së parë për materiale ndërtimi dhe minerale të tjera të dobishme.

Të merren masa për të përmirësuar shërbimin gjeologjik, për të rritur efektivitetin e punimeve gjeologjike, për zbulimin dhe ngritjen në kategori të rezervave industriale me sa më pak shpenzime. Puna e sektorit të gjeologjisë të vlerësohet jo vetëm me volumin e punimeve të kryera, por edhe me sasinë dhe cilësinë e rezervave të mineraleve të dobishme që vihen në shërbim të ekonomisë.

Kongresi shpreh bindjen se naftëtarët, minatorët dhe gjeologët tanë do të shumëfishojnë përpjekjet për të nxjerrë nga nëntoka jonë sa më shumë naftë, gaz dhe minerale të dobishme, për t'i vënë ato në shërbim të ekonomisë sonë popullore, për të mirën dhe begatinë e atdheut tonë të dashur socialist.

Të pajiset me kapacitete të reja prodhuese industria elektrike dhe të shfrytëzohen këto në mënyrë sa më racionale, me qëllim që të përballohen pa ndërprerje nevojat e konsumatorëve kryesorë.

Të zhvillohet me ritme edhe më të larta industria mekanike për prodhimin e pjesëve të këmbimit, duke shfrytëzuar më në thellësi bazat ekzistuese, si edhe të vihen në shfrytëzim kapacitete të reja.

Për të plotësuar në kohë dhe me cilësi planin madhështor të ndërtimeve, Kongresi e quan të domosdoshme t'i jepet një hov i madh zhvillimit të industrisë së materialeve të ndërtimit, me qëllim që ajo të jetë në gjendje të përballojë jo vetëm ritmet e larta të ndërtimeve të këtij pesëvjeçari, por edhe për të ardhmen. Kujdes i posaçëm t'u kushtohet industrisë së lëndës së dru-

rit dhe shfrytëzimit racional të pasurive pyjore për plotësimin e nevojave të ekonomisë.

Me qëllim që të plotësohen kërkesat gjithnjë në rritje të popullsisë me mallra të konsumit të gjerë, Kongresi IV i Partisë e quan të nevojshme që, krahas rritjes së prodhimit të mjeteve të prodhimit, të zhvillohet më tej prodhimi i mallrave të konsumit. Zbatimi i kësaj detyre të arrihet nëpërmjet shfrytëzimit sa më të mirë dhe zgjerimit të kapaciteteve prodhuese, si dhe nëpërmjet sigurimit të lëndës së parë. Zhvillim të mëtejshëm të marrin gjithashtu industria lokale dhe artizanati i kooperuar, si ndihmës të industrisë kombëtare në plotësimin e nevojave të popullsisë.

Realizimi i këtyre detyrave të mëdha që i shtrohen industrisë socialiste kërkon përmirësimin e mëtejshëm të metodës së drejtimit nga organizatat e Partisë. Ato duhet të zbatojnë drejt parimin leninist të kombinimit të punës organizative dhe politike me detyrat e planit.

Zhvillimi me ritme të shpejta i industrializimit socialist, rikonstruksioni i një numri të madh ndërmarrjesh dhe pajisja e tyre me teknikë të re, si dhe zhvillimi i vrullshëm i të gjitha degëve të ekonomisë popullore shtrojnë si një çështje të ngutshme detyrën për përgatitjen e kuadrove të aftë, të nevojshëm për vënjen në shfrytëzim të veprave të reja dhe për përvetësimin sa më të plotë të kapaciteteve prodhuese të projektuara.

Organet e Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë të marrin masat më të efektshme për të ngritur punën e tyre në nivelin e detyrave të reja ekonomike dhe për të shpejtuar kalimin e industrisë, si edhe të degëve të tjera të ekonomisë popullore, nga realizimi i planit kryesisht në sasi në realizimin e tij me doemos edhe në treguesit cilësorë. Të përmirësohet rrënjësisht cilësia e prodhimit dhe e ndërtimit, të ngrihet në një shkallë më të lartë kontrolli nga organet qendrore dhe ndërmarrjet, si dhe të gjallërohet vetëkontrolli shoqëror në të gjitha fazat e procesit teknologjik. Të futet teknika e përparuar dhe të përmirësohet vazhdimisht teknologjia e prodhimit. Të zgjerohet mekanizimi i proceseve të vështira të punës në radhë të parë, dhe i atyre që kërkojnë shumë punëtorë, siç janë industria e minierave, e lëndës së drurit, e ndërtimit, në bujqësi etj.

Njëkohësisht të vazhdojë puna për zbulimin dhe shfrytëzimin e rezervave të brendshme të prodhimit, për rritjen e rendimentit të punës, uljen e kostos, përmirësimin e cilësisë dhe shtimin e zgjerimin e asortimentit të prodhimit. Të merren masa për shfrytëzimin në gjerësi e thellësi të kapaciteteve të prodhimit dhe të sigurohet furnizimi i pandërprerë i ndërmarrjeve dhe i reparteve me lëndë të parë si kusht i domosdoshëm për siguri-

min e ngarkesës së maqinerisë për realizimin ritmik të planit dhe për shfrytëzimin e kohës së punës.

Të përnapen gjerësisht normat teknike të punës dhe të përmirësohen normat eksperimentale-statistikore, për t'i vendosur ato në baza më të drejta. Të përmirësohet sistemi i pagave, me qëllim që të bëhet një mjet edhe më i fortë nxitës për rritjen e prodhimit, për shtimin e aftësive teknike të punëtorëve dhe për përdorimin me kursim të materialeve.

Organizatat e Partisë dhe organet ekonomike shtetërore luftën për realizimin e detyrave të planit ta lidhin ngushtë me luftën për vendosjen e një regjimi të rreptë kursimi në të gjitha degët e ekonomisë popullore, si dhe në fushat e tjera të veprimtarisë shtetërore dhe shoqërore. Të vazhdojë puna për edukimin e punonjësve me qëndrimin e ndërgjegjshëm ndaj punës dhe pronës së përbashkët dhe me ndjenjën e regjimit të kursimit, me qëllim që të sigurohen burime suplementare, materiale e financiare, për riprodhimin e zgjeruar socialist. Organet e planifikimit, dikasteret, të gjitha ndërmarrjet dhe organizatat ekonomike të jenë shumë të rrepta në planifikimin e shpenzimeve, në mënyrë që leku i popullit të përdoret me nikoqirllëkun më të madh.

Të përkrahen dhe të përhapen iniciativat e mira në punë, si edhe eksperiencia e përparuar e punonjësve të pararojës, të organizohet më mirë emulacioni socialist, ku të përfshihen masat më të gjera të punonjësve. Këto përbëjnë një kusht të domosdoshëm për të realizuar detyrat e mëdha që shtrun plani i tretë pesëvjeçar.

Rritja e ndërtimeve 60 për qind gjatë pesëvjeçarit të tretë kërkon që në këtë sektor të bëhet një përmirësim i mëtejshëm i punës. Kujdes i posaçëm u duhet kushtuar studimeve tekniko-ekonomike dhe projektimit të veprave që do të ndërtohen për të përcaktuar leverdishmërinë dhe efektivitetin e investimeve. Të kalohet më me guxim në tipizimin e projekteve, standardizimin e pjesëve të ndërtimit dhe industrializimin e ndërtimit, që janë metoda më e mirë për shpejtimin e ritmeve dhe për përmirësimin e cilësisë së punimeve. Shkurtimi i afateve të ndërtimit, mbajtja e ritmeve pak a shumë të barabarta në të gjitha stinat, vënja me kohë në shfrytëzim e veprave, përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë dhe ulja e kostos të konsiderohen ndër detyrat kryesore të punonjësve të këtij sektori për të vënë në jetë parullën e Partisë «të ndërtojmë më shpejt, më mirë dhe më lirë».

Kongresi vëren me kënaqësi se kolektivizimi i bujqësisë u realizua me sukses një vit para afatit. Me përjashtim të zonave me karakter të theksuar malor, në të gjitha fshatrat e republikës janë ngritur kooperativa bujqësore, të cilat përfshijnë 85 për qind të tokës - arë që zotëron fshatarësia dhe më se 71 për qind

të ekonomive bujqësore. Kjo është një nga fitoret më të shkëlqyera të Partisë e të popullit tonë, që tregon edhe një herë unitetin e pathyeshëm të Partisë me popullin, pjekurinë politike të fshatarit tonë, i cili e përqafton me bindje dhe vendosmëri kolektivizimin, si rrugën e vetme të drejtë për të dalë një herë e përgjithmonë nga prapambetja dhe për të ndërtuar jetën e re socialiste në fshat. Kjo është një dëshmi tjetër e qartë që vërteton drejtësinë e vijës së Partisë sonë dhe të tezave të V. I. Leninit për transformimin socialist të fshatit.

Përfundimi me sukses i kolektivizimit të bujqësisë, zgjerimi dhe forcimi i gjithanshëm i SMT-ve, si dhe kryerja e veprave të mëdha të tharjes e të kullimit, krahas kujdesit të posaçëm që ka treguar Partia për zhvillimin e bujqësisë, bënë që gjatë pesëvjeçarit të dytë, vlera e prodhimit të përgjithshëm bujqësor, në krahasim me pesëvjeçarin e parë, të rritet 25,5 për qind. Të gjitha këto përbëjnë një mbështetje të fortë dhe një bazë reale për plotësimin me sukses të detyrave më të mëdha që shtrohen në pesëvjeçarin e tretë.

Kongresi thekson se detyra kryesore e bujqësisë sonë në pesëvjeçarin e tretë mbetet rritja e prodhimit të drithërave. Krahas me këtë, duhet të shtohen edhe prodhimet e tjera bujqësore e blegtorale, për të siguruar një furnizim të kënaqshëm të popullit dhe për të plotësuar nevojat e industrisë me lëndë të parë, si dhe për të shtuar eksportimin e tyre. Rruga kryesore për zhvillimin e bujqësisë sonë duhet të jetë rritja e vazhdueshme e rendimenteve pa ndërprerë punën për hapjen e tokave të reja.

Problemin e drithërave Partia e Punës e Shqipërisë e ka konsideruar gjithnjë hallkën kryesore jo vetëm për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë dhe të blegtorisë, konditë për furnizimin më të mirë të masave punonjëse, por edhe pikëmbështetje për zhvillimin e të gjitha degëve të ekonomisë popullore. Praktika ka vërtetuar se «lufta për bukë është lufta për socializëm», prandaj edhe në të ardhshmen prodhimit të drithërave të bukës duhet t'i kushtohet kujdes i veçantë.

Kongresi IV i Partisë u bën thirrje gjithë organizatave të Partisë në kooperativa, në NBSH, në SMT, organeve të Partisë, të pushtetit, të bujqësisë dhe të grumbullimit, tërë punonjësve të bujqësisë, që të mobilizojnë të gjitha forcat për realizimin e detyrave që shtron pesëvjeçari i tretë për shtimin e drithërave. Lufta për shtimin e prodhimit të drithit duhet përqëndruar në të dy drejtimet: në mbjelljen e sa më shumë sipërfaqeve me drithë dhe në rritjen e rendimenteve për çdo ha të mbjellë me drithë. Të luftohet me këmbëngulje për t'i mbjellë drithërat në kohë dhe në kondita të mira agroteknike. Të bëhet rregull që për këto kultura të caktohen medoemos tokat që sigurojnë rendimentet e planifikuara për çdo skuadër, brigadë e kooperativë

Të mos lejohet në asnjë mënyrë pakësimi i sipërfaqeve të planifikuara për drithërat e bukës. Të shfrytëzohen gjithë mundësitë për të marrë çdo vit prodhime nga bimët e arave prej sipërfaqeve të përgatitura për mbjelljen e kulturave drunore. Në zona bujqësore që kanë kondita të përshtatshme, të synohet për të marrë dy prodhime në vit drithëra buke nga e njëjta sipërfaqe. Mundësitë dhe rezervat më të mëdha për shtimin e prodhimit të drithit gjatë këtij pesëvjeçari, si dhe në të ardhshmen, janë në rritjen e rendimentit. Prandaj në këtë drejtim duhet të përqëndrohet vëmendja kryesore e të gjithë organizatave të Partisë në fshat dhe e punonjësve të bujqësisë.

Janë krijuar kushte të mira për një bujqësi intensive. Prandaj gjatë pesëvjeçarit të tretë të zhvillohet një luftë e gjithanshme për kullimin e tokave, që të shpejtohen mbjelljet dhe bima të rritet në kushte të mira, për punimin e thellë, për zgjerimin e gjithanshëm të sipërfaqes së vaditshme dhe për shfrytëzimin e mirë të ujit, për përdorimin e plotë të plehërave organike dhe për ngritjen e nivelit të përgjithshëm agroteknik. Një punë e veçantë, këmbëngulëse dhe e organizuar mirë të bëhet për të marrë 2-3 prodhime në vit nga e njëjta sipërfaqe jo vetëm nga tokat e vaditura, por nga e gjithë sipërfaqja nën kulturë, sidomos të zonave fushore. Për këto duhen nxitur dhe përkrahur me të gjitha mjetet iniciativat e mira të punonjësve të bujqësisë. T'i jepet një rëndësi e veçantë studimit dhe përhapjes së eksperiencës së përparuar të punonjësve të dalluar.

Të tregohet më shumë kujdes për ngritjen e cilësisë, veçanërisht të duhanit e të pambukut, si dhe për zhvillimin e kulturës së perimeve pranë qendrave të mëdha të banimit, në radhë të parë të perimeve të hershme dhe të vonshme për eksport. Të zgjerohen bloqet me pemë frutore, ullinj e vreshta në tokat e papërshtatshme për kulturat e arave dhe që sot janë të zëna me prodhime të panevojshme.

Për realizimin e detyrave të pesëvjeçarit të tretë në lëmin e blegtorisë, vëmendja kryesore të përqëndrohet në rritjen e produktivitetit të kafshëve, duke shfrytëzuar të gjitha rezervat për zhvillimin e bazës ushqimore. T'u kushtohet një kujdes i veçantë ushqimeve të gjelbëra. Njëkohësisht, të bëhet një punë e gjithanshme për shtimin e numrit të blegtorisë në kooperativat bujqësore, sidomos të gjedhëve, derrave, shpendëve dhe bletëve. Të tregohet më shumë kujdes për zbatimin e të gjitha masave zooveterinare.

Hallka kryesore për realizimin e detyrave të pesëvjeçarit të tretë në fshat është forcimi ekonomiko-organizativ i kooperativave bujqësore. Organizatat e Partisë, organet shtetërore dhe ato të bujqësisë t'u japin kooperativave bujqësore një ndihmë të gjithanshme dhe të kualifikuar për zbatimin e statutit, për

organizimin dhe shpërblimin e drejtë të punës, për sigurimin e pjesëmarrjes së gjerë të të gjithë anëtarëve në punë. Të futen gradualisht format më të përsosura të punës e të drejtimit në kooperativat, duke siguruar një lidhje të ngushtë të shpërblimit me rezultatet e punës, të vendoset dhënja e paradhënjeve më të shpeshta dhe të rregullta etj.

Të vazhdojë puna për zmadhimin gradual dhe vullnetar të kooperativave të vogla, në radhë të parë në zonat fushore. Në kooperativat bujqësore e sidomos në ato më të mëdhatë të dërgohet pjesa kryesore e specialistëve që mbarojnë institutet dhe teknikumet bujqësore si dhe kuadro të tjerë të aftë drejtues. Një kujdes më i madh të tregohet për forcimin ekonomik të kooperativave në zonat malore.

Kongresi shtron përpara të gjitha organizatave të Partisë në fshat, kooperativistëve, punonjësve të NBSH-ve, të SMT-ve, të ndërmarrjeve pyjore, atyre të shfrytëzimit të ujërave, të grumbullimit etj. detyrën që të mobilizojnë të gjitha forcat për realizimin me sukses të planit të tretë pesëvjeçar.

Rritja e prodhimit të përgjithshëm industrial e bujqësor, fitorja e kolektivizimit në fshat, zhvillimi i të gjithë sektorëve të tjerë të ekonomisë popullore kanë sjellë ngritjen e nivelit material e kultural të popullit. Të ardhurat kombëtare në vitin 1960 u rritën 48 për qind kundrejt vitit 1955. Paga reale e punëtorëve dhe e nëpunësve në vitin 1959, kundrejt vitit 1955, u rrit 29 për qind. Gjithashtu, janë shtuar edhe të ardhurat e fshatarësisë. Gjatë pesëvjeçarit të dytë u bënë disa herë zbritje të çmimeve të shitjes me pakicë, sistemi i triskëtimit u hoq plotësisht para afatit të caktuar nga Kongresi III i Partisë dhe u shtua qarkullimi i mallrave. Është rritur fondi i banesave.

Kongresi IV i Partisë porositi që në pesëvjeçarin e tretë të merren masa të rëndësishme për ngritjen e mëtejshme të mirëqenjes materiale dhe të nivelit kultural të masave punonjëse. Në pesëvjeçarin e tretë të ardhurat kombëtare të rriten 56 për qind, paga reale e punëtorëve dhe e nëpunësve të rritet 30 për qind dhe të ardhurat e fshatarësisë 35 për qind. Orari i punës për minatorët e nëntokës të shkurohet nga 8 në 7 orë, pa prekur pagën e tyre bazë. Të përmirësohet furnizimi dhe shërbimi i popullit me mallra të konsumit të gjerë, të ngrihet kultura tregëtare. Detyra të rëndësishme shtrohen edhe për zhvillimin e mëtejshëm të tregëtisë së jashtme. Organizatat e Partisë, organet shtetërore dhe të ekonomisë duhet t'i kushtojnë një kujdes të posaçëm shtimit të mallrave për eksport, si dhe zëvendësimit të vazhdueshëm të mallrave të importit. Të merren të gjitha masat që mallrat tona të zënë vendin e merituar në tregjet ndërkombëtare. Të zhvillohet turizmi.

Gjatë pesëvjeçarit të tretë të zgjerohen shumë shërbimet

komunale, të rritet fondi i banesave. Kujdes i veçantë t'i kushtohet mirëmbajtjes së banesave, zbukurimit, gjelbërimit dhe pastërtisë së qyteteve.

Partia ka treguar vazhdimisht një kujdes të veçantë për ruajtjen dhe forcimin e shëndetit të popullit. Zgjerimi i masave higjienoprofilaktike, përmirësimi i shërbimit në institucionet e mjekimit, rritja e numrit të kuadrove mjekësore, kualifikimi dhe edukimi i tyre me frymën e humanizmit dhe të ndërgjegjes së lartë socialiste përbëjnë detyrat kryesore të pesëvjeçarit të tretë në sektorin e shëndetësisë. T'i kushtohet kujdes zhvillimit masiv të kulturës fizike dhe sporteve.

Kongresi vë re se suksese të mëdha janë arritur në kryerjen e revolucionit kultural, në zhvillimin e arësimit dhe të shkencës, të kulturës, të letërsisë dhe të arteve. Në çdo pesë banorë të vendit tonë njëri mëson në shkollë. Në arësimin 7-vjeçar përfshihen mbi 70 për qind të fëmijëve të moshave përkatëse. Është zgjeruar shumë arësimi i mesëm, i përgjithshëm dhe profesional, si dhe arësimi i të rriturve pa ndërprerje nga puna. Për të parën herë në historinë e vendit tonë u krijua Universiteti shtetëror i Tiranës. Një ngjarje me rëndësi në lëmin e arësimit që diskutimi i përgjithshëm popullor për riorganizimin e shkollës. Nën kujdesin e Partisë është bërë një punë e madhe për të nxjerrë në dritë traditat e shquara patriotike-kulturale të popullit tonë. Është vënë në rrugë të drejtë organizimi i punës dhe i jetës shkencore në vendin tonë. Suksese të mëdha janë arritur edhe në lëmin e letërsisë dhe të arteve. Ato janë bërë mjete të fuqishme në edukimin ideologjik dhe estetik të masave. Kultura po bëhet çdo ditë e më shumë e masave. Një lëvizje e gjerë e amatorëve të artit ka shpërthyer në të gjithë vendin.

Plani i tretë pesëvjeçar shtron një sërë detyrash për ta çuar më përpara çështjen e revolucionit kultural. Në lëmin e arësimit popullor detyra kryesore është lidhja më e ngushtë e të mësuarit me punën prodhuese. Në të njëjtën kohë duhet të sigurohet një përparim më i mirë i nxënësve dhe i studentëve në mësim, të zgjerohet rrjeti shkollor i të gjitha kategorive dhe të realizohet gradualisht kalimi nga arësimi i përgjithshëm i detyrueshëm shtatëvjeçar në atë tetëvjeçar. Për të zgjidhur këto detyra Kongresi porositi të punohet me kujdes për përgatitjen e kuadrit mësimor, për përmirësimin e drejtimit të punës në shkollat dhe për ta bërë arësimin problem të të gjithë shoqërisë. Një kujdes i veçantë të tregohet për arësimin në fshat.

Ndërtimi i bazës materialo-teknike të socializmit kërkon, përveç kulturës, njohjen e gjerë e të thellë të teknikës në çdo degë. Prandaj çështja e aftësisimit të kuadrove nga ana tekniko-profesionale dhe ajo e përvetësisimit të teknikës në përgjithësi dhe sipas

specialitetit në veçanti të mbahen vazhdimisht parasysh nga organet e Partisë, ato shtetërore dhe organizatat e masave.

Puna për të zgjeruar bazën e zhvillimit të shkencave në vendin tonë kërkon një kujdes të veçantë. Krahas zhvillimit të shkencave humanitare e bujqësore, të zhvillohen me ritme më të shpejta shkencat natyrore e teknike dhe të bëhet studimi i burimeve natyrore të vendit tonë. Për të zbatuar këto detyra duhet të pregatitet një kolektiv i gjerë punonjësish shkencorë.

Puna kulturalo-artistike duhet të ngrihet në një nivel më të lartë dhe të përfshijë në sferën e veprimtarisë së saj masat e gjera të punonjësve të qytetit, e sidomos të fshatit. Të zhvillohet një lëvizje e gjerë popullore kulturalo-artistike me pjesëmarrjen e vetë masave. Letërsia, dhe përgjithësisht arti ynë i realizmit socialist duhet të lidhen edhe më ngushtë me jetën e popullit dhe të militojnë me të gjitha forcat për edukimin komunist të punonjësve.

— III —

Faktori vendimtar i të gjitha sukseseve që kemi korrur deri më sot, si dhe i atyre që do të korrin në të ardhmen, është udhëheqja e drejtë marksiste-leniniste e Partisë sonë të Punës. Kongresi vëren me kënaqësi se Partia jonë është rritur e forcuar si numër dhe sidomos si cilësi, janë ngritur aftësitë e saj drejtuese dhe organizuese. Karakteristika dalluese e Partisë së Punës të Shqipërisë është uniteti i çeliktë i radhëve të saj rreth Komitetit Qendror, si dhe lidhja e saj e pazgjidhshme me masat e gjera të popullit. Kurdoherë, dhe posaçërisht në çastet më të rëndësishme të historisë së Partisë, është shfaqur me të gjithë forcën e vet uniteti ideologjik, politik dhe organizativ i të gjithë Partisë sonë, gatishmëria dhe vendosmëria e anëtarëve të saj, si dhe e masave punonjëse të vendit tonë, për të zbatuar pa lëkundje vijën e drejtë marksiste-leniniste të Partisë sonë. Te uniteti i çeliktë i radhëve të saj, te lidhjet e pazgjidhshme të saj me popullin, te besnikëria e patundur ndaj mësimëve të pavdekshme të marksizëm-leninizmit qëndrojnë burimi dhe garancia e forcës dhe e pathyeshmërisë së Partisë sonë.

Kongresi IV i Partisë së Punës të Shqipërisë vëren se Komiteti Qendror i Partisë e ka udhëhequr drejt dhe me zotësi punën për forcimin e Partisë, për rritjen e rolit të saj organizues dhe drejtues.

Në bazë të orientimit që dha Kongresi III, është përmirësuar në mënyrë të dukshme përbërja shoqërore e Partisë. Sot punëtorët dhe anëtarët e kooperativave bujqësore zënë më tepër se gjysmën e gjithë efektivit të Partisë. Kjo mbetet një detyrë krye-

sore edhe për të ardhshmen. Gjithë Partia duhet të punojë me kujdes për forcimin e mëtejshëm të përbërjes së saj, si nëpërmjet një pune më të shëndoshë në lidhje me pranimet e reja në Parti dhe nëpërmjet një shpërndarjeje edhe më të mirë të forcave të Partisë, ashtu edhe nëpërmjet edukimit dhe kalitjes së mëtejshme të komunistëve. Duke u nisur nga kushtet e krijuara, Kongresi IV i Partisë jep këtë orientim të përgjithshëm për pranimet në Parti: shumicën dërmuese të të pranuarve në Parti ta përbëjnë njerëzit e prodhimit (të qytetit dhe të fshatit), ndër ta vendin e parë ta zënë punëtorët, kryesisht punëtorët e industrisë, të minierave e të transportit dhe pastaj anëtarët e kooperativave bujqësore. Ndaj nëpunësve dhe shtresave të tjera të ketë kërkesa më të larta. Burimi i pashtershëm për shtimin e radhëve të Partisë duhet të konsiderohet, si kurdoherë, organizata e Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë. Të punohet më mirë për të shtuar radhët e Partisë me gra.

Lidhur me ndryshimet rrënjësore të bëra në vendin tonë në strukturën e klasave, si rrjedhim i ndërtimit të bazës ekonomike të socializmit, kongresi vendosi të heqë kërkesat e diferencuara sipas përbërjes shoqërore për pranimet e reja në Parti dhe të aprovojë një rregull unik për të gjithë. Çdo njeri që kërkon të pranohet në Parti duhet të paraqesë rekomandimin e tre anëtarëve të Partisë, të cilët të kenë stazh partie prej jo më pak se tre vjetësh dhe ta njohin të rekomanduarin në punë të përbashkët të paktën një vit.

Në saje të punës së mirë të bërë deri tani, është siguruar një shtrirje e organizatave bazë dhe një shpërndarje e tillë e forcave të Partisë, që u përgjigjen plotësisht detyrave që kemi përpara. Roli i organizatave bazë të Partisë, gjithashtu, është rritur mjaft në krahasim me të kaluarën. Por Kongresi thekson se detyra kryesore në çështjet e organizatave të Partisë sot është rritja e rolit drejtues dhe ngritja e nivelit të punës së organizatave bazë të Partisë. Në mënyrë të veçantë të tërhiqet vëmendja e gjithë organeve dhe organizatave të Partisë në përmirësimin edhe më shumë të punës së organizatave bazë, sidomos për drejtimin më të mirë të prodhimit, duke forcuar kontrollin e tyre mbi veprimtarinë e administratës së ndërmarrjeve. Një vëmendje të veçantë kërkon edhe puna për gjallërimin edhe më të madh të jetës së brendshme të organizatave bazë, duke siguruar një pjesëmarrje sa më aktive të të gjithë komunistëve në zgjidhjen e të tëra çështjeve që preokupojnë Partinë, si dhe duke zhvilluar gjithnjë e më shumë kritikën dhe autokritikën e shëndoshë dhe parimore.

Periodha midis kongreseve III dhe IV të Partisë ka qenë periudha e një rritjeje të dukshme në cilësi të punës së plenumeve dhe të byrove të komiteteve të Partisë, si dhe të aparateve të tyre. Por detyrat e reja, dhe veçanërisht drejtimi më i mirë i

ekonomisë, kërkon përmirësimin e mëtejshëm të metodës së punës nga komitetet e Partisë. Kongresi shtroi detyrën që të rritet kujdesi kolektiv i organeve drejtuese të Partisë për zgjidhjen e mirë dhe me kohë të çështjeve kryesore që ka çdo sektor dhe njëkohësisht të rritet përgjegjësia personale e çdo organi dhe e çdo kuadri për detyrat konkrete dhe praktike që u janë ngarkuar. Organet drejtuese të Partisë dhe aparatet e tyre duhet të braktisin shfaqjet e punës burokratike dhe të forcojnë lidhjet e tyre me organizatat bazë, me komunistët dhe me masat. Për këtë qëllim të forcohen edhe më shumë drejtimi dhe roli i sekretarëve të komiteteve të Partisë për zonat e caktuara, duke mbajtur gjithashtu në nivelin e duhur edhe përgjegjësinë si pjesëtarë të udhëheqjes kolegjiale, si dhe të ngrihet edhe më shumë niveli i punës së instruktorëve të komiteteve të Partisë. Të përmirësohet puna për kontrollin e zbatimit të vendimeve.

Një nga hallkat kryesore për zbatimin e të gjitha detyrave që i shtrohen Partisë është zgjidhja e problemit të kuadrit. Për këtë arsye duhet të rrisim edhe më shumë kujdesin për përgatitjen, përparimin dhe vendosjen e kuadrove. Duhet të bëhet rregull për çdo organizatë dhe organ partie që, sa herë shqyrtojnë probleme të sektorëve të ndryshëm, të shikojnë në radhë të parë si janë gjendja dhe përgatitja e kuadrove dhe ç'duhet të bëhet për këtë. Edukimi komunist i kuadrove mbetet edhe për të ardhshmen një nga detyrat më të rëndësishme. Një rol të madh për këtë, si edhe deri tani, duhet të luajë Shkolla e Partisë «V. I. Lenin», e cila duhet të ngrejë edhe më shumë nivelin e dhënjes së mësimit. Të ndiqet me shumë kujdes nga të gjitha organizatat e Partisë çështja e vazhdimit të rregullt të shkollave dhe të kurseve dhe sidomos të shkollave të natës e me korrespondencë. Duke punuar me durim për përparimin e kuadrove të vjetër, të punohet njëkohësisht me shumë kujdes për të ngritur me kurajo kuadro të rinj, besnikë ndaj çështjes së popullit dhe të Partisë, veçanërisht nga radhët e klasës punëtore. Praktika, jeta, lufta për zbatimin e vijës dhe të detyrave të Partisë të konsiderohet, ashtu si dhe deri më sot, një shkollë e madhe për përgatitjen dhe kalitjen e kuadrove të rinj të dalë nga prodhimi.

Duke zbatuar detyrat që shtroi Kongresi III i Partisë, organizatat e masave — Bashkimet Profesionale të Shqipërisë, Bashkimi i Rinisë së Punës të Shqipërisë, Bashkimi i Grave të Shqipërisë, Fronti Demokratik i Shqipërisë etj. — kanë përmirësuar mjaft punën e tyre dhe kanë ndihmuar për një lidhje edhe më të ngushtë të Partisë me masat. Një luftë e vazhdueshme është bërë kundër shfaqjeve të formalizmit dhe të burokratizmit në punë, gjë që ka ndihmuar për një veprimtari më të gjallë e më konkrete me njerëzit. Por kongresi thekson se puna me masat, forcimi i vazhdueshëm i lidhjeve të ngushta me to përbëjnë një detyrë

të përhershme e shumë të rëndësishme të Partisë. Prandaj edhe në të ardhshmen duhet të rrisim rolin e organizatave të masave si «rripa transmisioni» për të çuar rregullisht në masat vijën e Partisë dhe për të sjellë në Parti zërin e masave, vërejtjet dhe sugjerimet e tyre. Gjithashtu duhet forcuar edhe më shumë puna për edukimin e masave. Duke marrë parasysh nivelin dhe kërkesat e ndryshme të çdo shtrese të popullsisë, si dhe problemet dhe detyrat konkrete që qëndrojnë para tyre, duhet që edhe puna edukative të bëhet e diferencuar. Të punohet më me kujdes për gjallërimin e jetës së brendshme të organizatave të masave, dhe sidomos për shtimin e numrit të aktivistëve dhe për edukimin e tyre të vazhdueshëm.

Forcimi i mëtejshëm i pushtetit popullor është kusht i domosdoshëm për realizimin me sukses të të gjitha detyrave. Kujdes i posaçëm duhet t'i kushtohet rritjes së rolit drejtues të të gjitha instancave të zgjedhura të pushtetit lokal. Të aktivizohen më mirë komisionet dhe masa e gjerë e këshilltarëve dhe të tërhiqen gjithnjë e më shumë masat punonjëse në problemet e pushtetit. Brenda kompetencave që u jep ligji, të rritet iniciativa e të gjitha organeve të pushtetit lokal. Në mënyrë të veçantë të ndihmohen për të kryer si duhet funksionet e tyre këshillat popullore të fshatrave dhe të lokaliteteve.

Të gjitha organet e pushtetit popullor duhet të tregojnë kujdes të madh e të vazhdueshëm për zbatimin e drejtë e të përpiktë të ligjeve tona. Organet e drejtësisë e të kontrollit, ashtu si edhe deri tani, duhet të mbikqyrin me kujdes dhe të kërkojnë, pa lëshimin më të vogël, respektimin e plotë të ligjshmërisë së socialiste.

Ushtria jonë trime, organet e palodhura të sigurimit e të policisë dhe rojet vigjilente të kufirit, nën udhëheqjen e Partisë, janë forcuar e modernizuar dhe kanë kryer kurdoherë me nder detyrat që u janë ngarkuar. Ato janë plotësisht të afta për të mbrojtur Republikën Popullore të Shqipërisë, gjithë fitoret e popullit tonë. Edhe në të ardhshmen duhet të rritet kujdesi i Partisë për të forcuar organet e diktaturës, për të forcuar dhe modernizuar forcat tona të armatosura, për të rritur vigjilencën dhe aftësitë profesionale të organeve të punëve të brendshme (sigurim, polici, kufi) si dhe për të forcuar gjithnjë e më shumë lidhjet e këtyre organeve me popullin.

Zgjidhja me sukses e detyrave të ndërtimit socialist dhe kushtet e reja të ashpërsimit të luftës kundër ideologjisë borgjeze, si dhe të luftës kundër revizionizmit të sotëm, kërkojnë forcimin e mëtejshëm të punës ideologjike të Partisë, ngritjen e saj në një nivel më të lartë.

Kongresi vëren me kënaqësi se Partia jonë i ka kushtuar kujdes të madh edukimit marksist-leninist të komunistëve dhe

të masave dhe punën ideologjike e ka quajtur gjithnjë si një nga sektorët më të rëndësishëm të veprimtarisë së saj.

Në periudhën që na ndan nga Kongresi III edhe në këtë fushë janë arritur një sërë suksesesh. Në luftën për ndërtimin e socializmit, në luftën kundër imperializmit dhe revizionizmit të sotëm, në mënyrë të veçantë kundër revizionizmit jugosllav, në luftën për ruajtjen e pastërtisë së marksizëm-leninizmit është bërë kalitja ideologjike e Partisë dhe është ngritur niveli politik i komunistëve dhe i masave. Rezultate të mira janë arritur në rrjetin e arësimit të Partisë dhe në edukimin politik të rinisë e të intelektualëve. Janë shtuar botimet e letërsisë politike.

Gjatë këtyre viteve është bërë një punë e mirë për realizimin e detyrave të caktuara në Kongresin III të Partisë për lidhjen më të ngushtë të punës ideologjike me jetën, me praktikën, me ndërtimin socialist. Ky është parimi më i lartë i punës ideologjike të Partisë, sepse pikërisht në lidhje me jetën, me veprimtarinë praktike për transformimin e botës qëndron pathyeshmëria e marksizëm-leninizmit si një teori revolucionare, gjithmonë e gjallë e krijuese. Por kongresi thekson se lidhja e teorisë me praktikën nuk do të thotë aspak të nënçmohet teorinë, sepse shkëputja e praktikës nga teoria është po aq e dëmshme, sa edhe shkëputja e teorisë nga praktika.

Kongresi porositi që të gjitha mjetet dhe format e punës ideologjike të Partisë, propaganda, agjitacioni, shtypi dhe aktiviteti kultural duhet të përqëndrojnë të gjitha forcat për t'i njohur punonjësit me detyrat e mëdha të planit të tretë pesëvjeçar, me perspektivat e shkëlqyera që hapen përpara vendit tonë dhe t'i mobilizojnë ato për të arritur përfundime sa më të mëdha në ndërtimin e socializmit.

Lufta për formimin dhe forcimin e qëndrimit socialist ndaj punës, për forcimin dhe zhvillimin e pronës shoqërore, si bazë materiale e rendit tonë socialist, për edukimin me ndërgjegjen socialiste, si dhe lufta kundër paragjykimëve fetare, besimeve të kota e zakoneve prapanike, për formimin e një botëkuptimi të drejtë shkencor materialist, duhet të zënë një vend të dorës së parë në të gjithë punën ideologjike të Partisë, posaçërisht në fshat.

Kongresi vë në dukje se në kushtet e sotme një rëndësi të veçantë merr lufta në frontin ideologjik për mbrojtjen e pastërtisë së marksizëm-leninizmit, për sqarimin e drejtë dhe të thellë të problemeve të zhvillimit të sotëm botëror, për propagandimin e parimeve themelore të marksizëm-leninizmit dhe të vijës së drejtë që ka ndjekur e ndjek Partia e Punës e Shqipërisë lidhur me këto probleme.

Për t'i kuptuar dhe për t'i shpjeguar drejt fenomenet shoqërore dhe ndryshimet që janë bërë e bëhen sot në botë, metoda e

vetme shkencore është dialektika materialiste. Vetëm duke u nisur nga studimi i thellë objektiv i gjendjes reale që ekziston sot në botë dhe nga analiza klasore e raportit të forcave mund të arrihet në përfundime të drejta, të përcaktohen drejt strategjia dhe taktika e Partisë dhe të mënjanohe gabime në politikë. Prandaj një detyrë kryesore për komunistët, dhe në radhë të parë për kuadrot, është studimi i materializmit dialektik e historik.

Lufta kundër revizionizmit, si rrezik kryesor në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, dhe veçanërisht kundër revizionistëve jugosllavë, që kanë tradhëtuar marksizëm-leninizmin, mbetet një detyrë kryesore e punës ideologjike të Partisë. Revizionistët përpiqen ta shpallin marksizëm-leninizmin «të vjetëruar», ata përpiqen të hedhin poshtë tezat kryesore të tij, si teorinë mbi revolucionin socialist e diktaturën e proletarietit, teorinë mbi imperializmin, si dhe tezat mbi luftën e paqen, mbi ndërtimin e socializmit e të komunizmit, mbi shtetin socialist etj. Fjala është për t'i hequr marksizëm-leninizmit thelbin revolucionar dhe për ta shndërruar atë në një doktrinë të padëmshme për borgjezinë. *Kongresi porositi që lufta kundër revizionizmit të vazhdojë dhe të ngrihet në një nivel edhe më të lartë, deri në shkatërrimin e tij të plotë ideologjik dhe politik.* Duke luftuar me vendosmëri kundër revizionizmit si rrezik kryesor, Partia duhet të luftojë edhe kundër çdo shfaqjeje të dogmatizmit e të sektarizmit.

Kongresi IV i Partisë vë në dukje se problemet më të rëndësishme të kohës janë analizuar me hollësi dhe kanë gjetur një pasqyrim të drejtë marksist-leninist në Deklaratën e përfaqësuesve të 81 partive komuniste e punëtore të Mbledhjes së Moskës në nëntor të vitit 1960. Deklarata përshkohet nga një frymë revolucionare, atje ka gjetur shprehje të plotë vija e drejtë e Partisë sonë. Për të gjitha këto Kongresi IV i Partisë aprovon plotësisht veprimtarinë e delegacionit të PPSH, të kryesuar nga shoku Enver Hoxha, në Mbledhjen e Moskës të 1 nëntorit 1960, si dhe dokumentat e saj historike. Kongresi e quan Deklaratën si një dokument programatik për gjithë lëvizjen komuniste ndërkombëtare dhe si bazë për unitetin e mëtejshëm të saj. Partia jonë, ashtu siç ka zbatuar Deklaratën e vitit 1957, do të zbatojë me besnikëri edhe Deklaratën e vitit 1960 dhe do të luftojë për zbatimin e saj. *Për këto arsye sqarimi i drejtë dhe i thellë i problemeve dhe i detyrave kryesore të lëvizjes komuniste ndërkombëtare që përmbahen në Deklaratën e vitit 1960 përbën një nga drejtimit kryesore të punës ideologjike të Partisë.*

Partia jonë ka luftuar kurdoherë me vendosmëri dhe ka dhënë kontributin e saj për forcimin e unitetit të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare dhe të kampit socialist. Ajo i ka edukuar anëtarët e saj me frymën e internacionalizmit proletar, të miqësisë vëllazërore me popujt e Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve

të tjera të kampit socialist, të solidaritetit me luftën e klasave punëtore, të partive komuniste dhe të popujve të vendeve të tjera. Kjo mbetet një detyrë e rëndësishme e propagandës së Partisë edhe për të ardhshmen.

Partia jonë e Punës ka kaluar një rrugë të vështirë, por në të njëjtën kohë heroike, gjatë së cilës ajo është rritur, është forcuar dhe është kalitur si një parti marksiste-leniniste. Në këtë luftë të vështirë dhe të ashpër, e ndriçuar nga mësimet e marksizëm-leninizmit dhe e edukuar me besnikëri ndaj tij, Partia jonë ka përpunuar kurdoherë një vijë të drejtë, ka fituar pjekurinë të orientohet në çdo situatë dhe ka treguar guxim dhe vendosmëri në luftën për ruajtjen e pastërtisë së marksizëm-leninizmit. Me këtë shpjegohet pse Partia jonë ka patur dhe ka një vijë të drejtë. *Prandaj Kongresi IV i Partisë porositi që çdo komunist e punonjës i vendit tonë të njohë mirë historinë e Partisë. Këtë duhet ta mbajë vazhdimisht parasysht propagandë e Partisë.*

Kongresi shpreh bindjen e plotë se Partia e Punës e Shqipërisë, e kalitur në luftëra të ashpra me armiqtë, e udhëhequr nga idetë e pavdekshme të marksizëm-leninizmit, e dalë nga gjiri i popullit tonë të vuajtur dhe e mbështetur fort në popullin, duke u qëndruar besnike marksizëm-leninizmit, interesave të popullit e të socializmit, internacionalizmit proletar dhe me unitet të pashyeshëm me lëvizjen komuniste ndërkombëtare, do ta udhëheqë popullin tonë drejt fitores së plotë të socializmit dhe të komunizmit. Nuk ka forcë në botë që të mund të largojë atë nga kjo rrugë.

Botohet sipas librit
«Kongresi IV i PPSH
Tiranë, 1961

Nr. 141

DIREKTIVAT E KONGRESIT IV TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË MBI PLANIN E TRETË PESËVJEÇAR TË ZHVILLIMIT EKONOMIK E KULTURAL TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË GJATË VJETËVE 1961-1965 (APROVUAR NJËZËRI MË 20 SHKURT 1961)

20 shkurt 1961

MBI PLOTËSIMIN E DETYRAVE KRYESORE TË PLANIT TË DYTË PESËVJEÇAR (1956-1960)

Gjatë periudhës midis kongreseve III dhe IV të Partisë së Punës të Shqipërisë vendi ynë ka ecur me sukses përpara në rrugën e ndërtimit të socializmit. Nën udhëheqjen e drejtë marksis-

te-leniniste të Partisë, me punën vetëmohuese të klasës punëtore, të fshatarësisë punonjëse dhe të inteligjencies popullore, me ndihmën bujare dhe të gjithanshme të Bashkimit Sovjetik në radhë të parë, të Republikës popullore të Kinës dhe të vendeve të tjera të kampit të socializmit, detyrat kryesore të caktuara nga Kongresi III i Partisë në përgjithësi janë plotësuar dhe tejkaluar.

Përparime të rëndësishme u arritën në zhvillimin e industrisë, dhe sidomos të industrisë minerale. Volumi i prodhimit të përgjithshëm industrial, i caktuar nga Kongresi III i Partisë për të pesë vjetët të marrur së bashku, u plotësua në 4 vjet e 9 muaj, i industrisë minerale në 4 vjet e 6 muaj, ndërsa niveli i prodhimit të përgjithshëm industrial i caktuar për vitin 1960 u arrit një vit para afatit.

Në vitin 1960 prodhimi i përgjithshëm industrial u rrit 118 për qind më shumë se në vitin 1955, kundrejt 92 për qind që caktonte Kongresi III i Partisë, me një ritëm mesatar vjetor prej 16.9 për qind, nga 14 për qind që ishte detyra e Kongresit. Në vitin 1960, në rreth 15 ditë u prodhua aq sa gjatë gjithë vitit 1938. Prodhimi i mjeteve të prodhimit u rrit 129 për qind, kundrejt 99 për qind që ishte parashikuar nga kongresi, me një ritëm mesatar vjetor prej 18 për qind, nga 14,8 për qind që ishte detyra. Prodhimi i mallrave të konsumit u rrit 111 për qind, kundrejt 88 për qind që parashikonte kongresi, me një ritëm mesatar vjetor prej 16 për qind, nga 13,5 për qind që ishte detyra.

Në bujqësi gjatë pesëvjeçarit të dytë u arrit një fitore me rëndësi historike: detyra e caktuar nga Kongresi III i PPSH për kolektivizimin e bujqësisë u plotësua një vit para afatit. Fshatarësia jonë patriotike dhe punëtore, me besim të madh dhe entuziazëm, hyri në rrugën e kolektivizimit, duke zbatuar kështu një nga porositë më të rëndësishme të Kongresit III të PPSH. Me përjashtrim të zonave të theksuara malore, në të gjitha fshatrat e zonave të tjera u ngritën kooperativat bujqësore, ku hynë në masë jo vetëm fshatarët e varfër, por edhe fshatarët e mesëm. Janë zgjeruar dhe forcuar fermat shtetërore. Si rrjedhim, në vitin 1960 bujqësia socialiste përfshinte mbi 86 për qind të tokës së punuar (arë) dhe mbi 80 për qind të prodhimit të përgjithshëm bujqësor dhe blegtoral.

Me kolektivizimin e bujqësisë në vendin tonë u ndërtua baza ekonomike e socializmit në fshat dhe, bashkë me këtë, bujqësisë sonë ju hapën perspektiva të sigurta për zhvillimin e mëtejshëm të saj.

Vitet 1959 dhe 1960 nuk kanë qenë aspak të favorshme për bujqësinë: lagështia shumë e madhe në vjeshtë dhe në pranverë, si dhe thatësira shumë e gjatë e verës, i dëmtuan rëndë të gjitha kulturat bujqësore dhe veçanërisht drithërat. Megjithkëtë, si rrjedhim i kolektivizimit të bujqësisë, i zgjerimit të mekanizimit, i

bonifikimeve dhe i mobilizimit të masave punonjëse të fshatit vlera e prodhimit të përgjithshëm bujqësor të pesëvjeçarit të dytë ishte 25,5 për qind më shumë se ajo e pesëvjeçarit të parë. Gjatë pesëvjeçarit të dytë u hapën 71.000 ha toka të reja dhe sipërfaqja nën kulturë u rrit 12,8 për qind në krahasim me vitin 1955, ose 57 për qind më shumë se në vitin 1938. Është përmirësuar mjaft struktura e sipërfaqeve të mbjella dhe bujqësia ka hyrë në rrugën e përparimit.

Volumi i përgjithshëm i punimeve të mekanizuara në pesëvjeçarin e dytë u rrit mbi 5,5 herë kundrejt vitit 1955, duke tejkaluar detyrën e kongresit 84,5 për qind, ndërsa parku i traktorëve u rrit 2,8 herë. Nga punimet e mëdha të tharjes dhe të vadi-tjes, që kanë vazhduar gjatë këtij pesëvjeçari, një pjesë e të cilave përfundon këtë vit, përfitohen 17.000 ha tokë e re, u përmirësuan 43.000 ha dhe aftësia vaditëse u rrit 46 për qind kundrejt vitit 1955.

Gjatë pesëvjeçarit të dytë është bërë një punë e madhe për shtimin e numrit të blegtorisë, për përmirësimin e racës dhe forcimin e bazës ushqimore, sidomos në bujqësinë kooperativiste. Në vitin 1960 u prodhuan më shumë se në vitin 1955: qumësht 41 për qind, vezë 60 për qind, dhe lesh dhensh 47 për qind. Gjatë viteve të fundit janë zhvilluar me ritme më të shpejta frutikultura dhe vreshtat, duke plotësuar, në përgjithësi, detyrën e caktuar nga Kongresi III i PPSH. Shumë kodra dhe toka të tjera, dikur të mbuluara me shkurre ose të lëna djerr, sot janë kthyer në pemëtore dhe vreshta. Është treguar një kujdes më i mirë për zhvillimin dhe shfrytëzimin e pyjeve.

Gjatë pesëvjeçarit të dytë u grumbulluan më shumë se në pesëvjeçarin e parë: drithëra buke 31 për qind, mish 19 për qind, lesh 24 për qind, qumësht 199 për qind, pambuk 83 për qind, duhan 184 për qind etj. Në këtë mënyrë, nëpërmjet shtimit të grumbullimit është përmirësuar furnizimi i popullit, i industrisë me lëndë të parë dhe janë shtuar artikujt për eksport.

Detyrat që caktonte pesëvjeçari i dytë për transportin në përgjithësi u tejkaluan: në transportin automobilistik të mallrave të Ministrisë së Komunikacionit 4 për qind më shumë, në transportin hekurudhor të mallrave 31 për qind më shumë dhe në transportin detar, të brendshëm dhe të jashtëm mbi katër herë.

Gjatë këtij pesëvjeçari janë zhvilluar me ritme të mëdha investimet dhe ndërtimet. Detyrat e caktuara nga Kongresi III i Partisë për të pesë vjetët së bashku u plotësuan: për investimet 147 për qind dhe për ndërtimet 136 për qind. Investimet e pesëvjeçarit të dytë janë 86 për qind dhe ndërtimet 58 për qind më shumë se në pesëvjeçarin e parë. Gjatë këtij pesëvjeçari u vunë në shfrytëzim mbi 250 vepra të rëndësishme për ekonominë dhe kulturën popullore, nga të cilat më kryesoret janë:

a) Në industrinë e naftës dhe në minierat — fusha e re për prodhimin e naftës në Marinzë, miniera e qymyrgurit në Alarup, minierat e hekur-nikelit në Pishkash dhe Cervenakë, miniera e bakrit në Kurbnesh, minierat e kromit në Tropojë dhe Martanesh, uzinat e përpunimit të naftës në Qytetin Stalin dhe në Cërrik me vajgursjellës, Patos-Qyteti Stalin-Cërrik, fabrika e pa-surimit të bakrit në Kurbnesh etj.

b) Në industrinë elektrike — Hidrocentrali «Karl Marks», centralet elektrike termike në Qytetin Stalin dhe Cërrik, linjat e tensionit të lartë me gjatësi prej rreth 400 km., që lidhin qendrat kryesore industriale të vendit: Ulzë, Tiranë, Cërrik, Qyteti Stalin, Marinzë, Memaliaj, Durrës, Kurbnesh, Lushnjë, Selenicë, Vlorë dhe Rubik.

c) Në industrinë e materialeve të ndërtimit — zgjerimi i Fabrikës së çimentos «V. I. Lenin» në Vlorë, fabrikat për prodhimin e materialeve të parafabrikuara të ndërtimit në Tiranë, Durrës e Korçë, fabrikat e reja të tullave në Lushnjë, Vlorë, Shkodër dhe Elbasan, zgjerimi i fabrikave të tullave në Tiranë, Durrës, Korçë etj.

ç) Në industrinë e lehtë — Fabrika e kadifesë dhe ajo e qelqit në Tiranë, zgjerimi i fabrikave të përpunimit të lëkurëve në Korçë, Shkodër, Vlorë dhe Gjirokastër, zgjerimi i Fabrikës së këpucëve në Tiranë, i Fabrikës së gomës në Durrës, i trikotazhit në Korçë dhe i fabrikave të tisazhit dhe të përpunimit të mëndafshit në Shkodër.

d) Në industrinë ushqimore — Fabrika e konservave të peshkut e perimeve «Ernest Telman» në Vlorë, Fabrika e birrës në Tiranë, fabrikat e përpunimit të frutave dhe të perimeve në Shkodër, Elbasan, Korçë, Peshkopi, Lezhë, Kavajë, Berat, Ballsh, Këlcyrë, fabrikat e përpunimit të rrushit në Milot, Librazh, Skrapar, Këlcyrë, Ballsh, zgjerimi i Fabrikës së sheqerit «8 Nëntori» në Maliq, Fabrika e alkoolit në Maliq, Fabrika e nishestesë në Shijak, zgjerimi i fabrikave të cigareve në Shkodër, Durrës dhe Gjirokastër, uzinat e fermentimit të duhanit në Elbasan, Durrës dhe Gjirokastër, frigoriferët në Tiranë, Korçë etj.

dh) Në bujqësi përfundoi tharja dhe vaditja e fushave të Zadrimes dhe të Mursisë, u kryen punime të mëdha për tharjen dhe vaditjen e fushave të Myzeqesë, Vurgut, Thumanës dhe Roskovecit, të cilat përfundojnë në vitin 1961. Punime të rëndësishme u bënë gjithashtu në ndërmarrjet shtetërore «Perlat Rexhepi» në Shkodër, «Gjergj Dimitrov» në Tiranë dhe «29 Nëntori» në Lushnjë, për krijimin e bloqeve të mëdha të vreshtave. Investime të mëdha u kryen edhe për rritjen e numrit dhe për përmirësimin e racës së lopëve. Parku i traktorëve nga 1.260 u rrit në 4.480 traktorë (të kthyer në 15 kuaj fuqi), u zgjerua baza e riparimit të tyre, u ngritën 4 SMT të reja etj.

e) Në komunikacion, u hapën rreth 290 km. rrugë dhe u asfaltuan rreth 190 km. rrugë të tjera kombëtare; u përfundua aerodromi në Rinas; u rrit parku i kamionave dhe baza e ndreqjes së tyre. Për të parën herë u krijua flota detare tregëtare për lundrime të gjata, e cila po lidh vendin tonë me botën e jashtme.

ë) Për arësimin dhe kulturën u ndërtuan 33 shkolla shtatëvjeçare, 28 shkolla të mesme, 6 konvikte me 1.100 vende, 31 kopshte dhe shtëpi fëmijësh me 3.300 vende, Teatri i Shkodrës, 10 kinema, 4 shtëpi kulture dhe stadiumet në Tiranë, Korçë, Vlorë etj.

f) Për shëndetësinë u ndërtuan spitali i pediatriisë në Tiranë, spitalet në Elbasan, Lushnjë e Skrapar, sanatoriumet në Shkodër e Tiranë, si dhe u ndërtuan ose u zgjeruan çerdhe fëmijësh me 6.000 vende etj.

g) Për komunalen u ndërtuan 11.733 apartamente, ujësjellësit e Durrësit, Beratit, Fierit, Lushnjës, Qytetit Stalin etj.

Gjithashtu u ndërtuan vepra të tjera të rëndësishme, si shtëpi pushimi me 1.000 vende, 3 hotele të mëdha turistike etj.

Klasa jonë punëtore dhe gjithë masat e tjera punonjëse kanë punuar me vull dhe entuziazëm për plotësimin e detyrave të mëdha të caktuara nga Kongresi III i PPSH. Një hov të madh mori emulacioni socialist gjatë fushatës për nder të 15-vjetorit të çlirimit të atdheut, dhe sidomos pas shpalljes për thirrjen e Kongresit IV të PPSH. Emulacioni socialist ka përfshirë të gjitha masat e gjera punonjëse në qytet dhe në fshat për plotësimin e detyrave të planit para afatit. Në këtë valë të emulacionit socialist lindën për herë të parë brigadat e 15-vjetorit të çlirimit, të cilat sot luftojnë për të merituar titullin «Brigadë e punës socialiste».

Mobilizimi më i madh i masave punonjëse dhe përmirësimi i drejtimit të ekonomisë për shfrytëzimin më të plotë të aftësive prodhuese, vënja në shfrytëzim dhe përvetësimi i teknikës së re, kanë sjellë përfundime të kënaqshme në rritjen e rendimentit të punës dhe në uljen e kostos. Në prodhimin e përgjithshëm industrial rendimenti i punës u rrit 57 për qind, në ndërtim - montim 44 për qind dhe në transport 90 për qind.

Mbi bazën e rritjes së prodhimeve industriale dhe bujqësore, të rritjes së rendimentit të punës dhe të uljes së kostos, u sigurua rritja e mëtejshme e mirëqenjes materiale dhe e nivelit kulturor të masave punonjëse. Gjatë pesëvjeçarit të dytë të ardhurat kombëtare u rritën 48 për qind. Detyra e kongresit për pagën reale të punëtorëve dhe nëpunësve u tejkalua. U rritën gjithashtu të ardhurat e fshatarësisë, megjithëse prodhimet bujqësore gjatë dy viteve të fundit u dëmtuan rëndë. Gjatë pesëvjeçarit të dytë u hoq, para afatit, sistemi i triskëtimit në furnizimin e popullit; u bënë 6 ulje të çmimeve të shitjes me pakicë të mallrave të kon-

sumit të gjerë për një shumë prej 7 miliard e 200 milion lekësh. Në të njëjtën kohë u rritën çmimet e blerjes nga shteti të prodhimeve bujqësore e blegtorale. U rritën rrogat e ulëta dhe u shtuan pensionet. Të gjitha këto masa rritën fuqinë blerëse të popullatës. Volumi i qarkullimit të mallrave në vitin 1960 arriti në 194 për qind kundrejt vitit 1955, nga 162 për qind që ishte detyra e kongresit.

Gjatë pesëvjeçarit të dytë u zgjerua rrjeti dhe baza materiale e tregëtisë, u rritën rezervat e mallrave, u përmirësua shërbimi i popullit, u ngrit kultura tregëtare dhe në përgjithësi u përmirësua puna e punonjësve të tregëtisë.

Përparime të dukshme gjatë pesëvjeçarit të dytë u bënë në të gjithë jetën arësimore dhe kulturele të vendit, si edhe në ruajtjen e shëndetit të popullit. Në lëmin e arësimit dhe të kulturës u vu në jetë ëndrra e rilindasve tanë, u hap i pari universitet shtetëror me gjashtë fakultete. Tani në vendin tonë (duke përfshirë edhe institutet e larta pedagogjike 2-vjeçare) dhe jashtë shtetit përgatiten rreth 1000 kadro të lartë në vit. U zgjerua rrjeti i shkollave, sidomos i shkollave 7-vjeçare, u zgjerua rrjeti i institucioneve parashkollore. Numri i nxënësve dhe i studentëve brenda dhe jashtë shtetit u rrit nga 211.000 në vitin 1955, në 313.000 në vitin 1960. Sot në vendin tonë një në çdo 5 vetë mëson në shkollë, ndërsa në vitin 1938 mësonte një në çdo 18 vetë. Përfundime të mira u arritën në përgatitjen e kuadrove të rinj si edhe në rritjen e aftësisë së punëtorëve, duke tejkaluar detyrat e caktuara nga Kongresi III i Partisë. Përparime të mëdha u bënë për mbrojtjen e shëndetit të popullit. Shtrirja e rrjetit të institucioneve të mjekimit në të gjitha anët e vendit tonë, rritja e numrit të mjekëve dhe e personelit tjetër mjekësor, dhënja falas e barërave për fëmijët nën një vjeç si dhe lehtësitë e mëdha për mjekimin e punonjësve bënë të mundur kufizimin e përhapjes së sëmundjeve ngjitëse dhe dhënjen e ndihmës së shpejtë. Si rrjedhim i këtij kujdesi, shtesa natyrore e popullsisë ka qenë rreth 32 për mijë. Në vitin 1960 popullsia e RPSH, sipas të dhënave paraprake, arriti në 1 milion e 625 mijë vetë.

Rëndësi e madhe i është dhënë ndërtimit të banesave për punonjësit e qytetit dhe të qendrave të punës. Nga 670 mijë m² që parashikonin detyrat e Kongresit III, u ndërtuan gjithsej 776 mijë m², ose 15,8 për qind më shumë, pa përmendur këtu ndërtimet e shumta që bënë vetë punonjësit në qytet dhe në fshat, duke përfutur nga ndihma që u dha atyre shteti me kredi, në kushte shumë lehtësuese.

Transformimet e thella revolucionare ekonomik-shoqërore që u kryen në mënyrë të ndërgjegjshme nga Partia jonë që në vitet e para të çlirimit të vendit, si shtetëzimi i industrisë, i transportit, i bankës, i tregëtisë së jashtme dhe i asaj të brendshme me shumicë, çuan në vendosjen e pronës shoqërore mbi mjetet kryesore të prodhimit e të qarkullimit dhe krijuan mundësitë e para ekonomike për fillimin e ndërtimit të shoqërisë së re socialiste.

Detyra e caktuar nga Kongresi III i Partisë për kolektivizimin e bujqësisë u realizua një vit para afatit. Fshatarësia jonë patriotike përqafoi rrugën e kolektivizimit dhe vullnetarisht ecën me vendosmëri në këtë rrugë, e bindur plotësisht për epërsinë e saj ndaj ekonomisë së vogël individuale.

Kjo ishte një fitore tjetër e shkëlqyer e politikës ekonomike të Partisë, e cila bazohet gjithnjë në shkencën ngadhnjimore të marksizëm-leninizmit, një dëshmi e qartë e zbatimit në jetë të planit leninist të kooperimit.

Në këtë mënyrë brenda një periudhe relativisht të shkurtër, në vendin tonë u zgjidh me sukses detyra më e ndërlikuar e periudhës kalimtare për në socializëm.

Me këto fitore me rëndësi të madhe historike, në përgjithësi në ekonominë popullore të vendit tonë u vendosën marrëdhënje të reja socialiste në prodhim, u krijuan sistemi i fuqishëm i ekonomisë socialiste. Në vitin 1960 në ekonominë socialiste u krijuan rreth 90 për qind të të ardhurave kombëtare. Po në këtë vit pesha specifike e ekonomisë socialiste në prodhimin e përgjithshëm industrial ishte 99 për qind, në prodhimin e përgjithshëm bujqësor mbi 80 për qind, në tregëtinë me pakicë rreth 90 për qind.

Kështu në vendin tonë është zhdukur në përgjithësi ekonomia shumëformëshe dhe në vend të saj është krijuar një sistem i vetëm socialist i ekonomisë. Në këtë mënyrë baza ekonomike e socializmit është krijuar si në qytet ashtu dhe në fshat. . . Ekonomia kapitaliste, klasat shfrytëzuese dhe shfrytëzimi i njeriut prej njeriut janë zhdukur. . . Me këtë fitore të madhe historike vendi ynë futet në një etapë të re, në etapën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste, ku rolin kryesor do ta luaj ndërtimi i bazës materialo-teknike të socializmit.

Vendosja e marrëdhënjëve të reja socialiste në prodhim ndryshoi në mënyrë rrënjësore strukturën e vjetër të klasave të shoqërisë sonë.

Tipari më karakteristik themelor i strukturës së klasave të vendit tonë në etapën e sotme është ekzistenca e dy klasave mike, e klasës punëtore dhe e fshatarësisë kooperativiste, aleanca e tyre nën udhëheqjen e klasës punëtore dhe forcimi mbi këtë bazë i unitetit moralo-politik të të gjithë punonjësve.

Fitoret e mëdha që u arritën në ndërtimin socialist të vendit e kanë burimin në vijën e drejtë marksiste-leniniste që ka zbatuar kurdoherë Partia jonë e Punës dhe Komiteti i saj Qendror, në patriotizmin e zjarrtë të masave punonjëse, në vrullin revolucionar të tyre, në forcimin e lidhjeve të Partisë me masat e gjëra punonjëse, në vendosmërinë e tyre për ndërtimin me sukses të socializmit. Ndihma. . . e vendeve të kampit socialist ka qenë dhe mbetet një faktor me rëndësi për ndërtimin socialist të vendit tonë. Në periudhën midis dy kongreseve, Komiteti Qendror i Partisë, në plenumet e tij, ka shqyrtuar një numër problemesh të rëndësishme ekonomike.

Plenumi i Komitetit Qendror, që u mbajt në shkurt të vitit 1958, duke analizuar kushtet e reja që u krijuan në zhvillimin e ekonomisë si rrjedhim i plotësimit me sukses të planeve, i zbulimit të rezervave të brendshme, e gjeti plotësisht të mundshme rritjen e detyrave të planit të dytë pesëvjeçar.

Vendimet e rëndësishme të Plenumit të shkurtit 1958 të Komitetit Qendror gjetën një përkrahje të madhe në masat punonjëse të vendit tonë, të cilat u mobilizuan me të gjitha forcat për plotësimin e tyre. Kështu, detyrat e rritura të planit të dytë pesëvjeçar u plotësuan në këtë mënyrë: volumi i prodhimit të përgjithshëm industrial rreth 100 për qind, nga i cili industria e kromit 101 për qind e hekur-nikelit 148 për qind, industria elektrike 110 për qind, industria e drurit 102 për qind, industria e lehtë 100 për qind, industria lokale 106 për qind, kooperativat e artizanatit 103 për qind etj. ndërsa nuk i plotësuan tërësisht detyrat e rritura industria e naftës, industria ushqimore, ajo e qelq-qeramikës etj.

Detyrat e rritura të pesëvjeçarit të dytë u plotësuan gjithashtu në investimet rreth 100 për qind, në ndërtimet 104 për qind, në transportin automobilistik të mallrave të Ministrisë së Komunikacionit në ton/km 104 për qind, në transportin hekurudhor të mallrave në ton/km 119 për qind dhe në qarkullimin e mallrave të tregëtisë së brendshme 97 për qind.

Përfundimet, në përgjithësi të kënaqshme, që u arritën në plotësimin e detyrave të rritura të planit të dytë pesëvjeçar, tregojnë edhe një herë drejtësinë e politikës ekonomike të Partisë për shpejtimin e ritmeve të ndërtimit socialist të vendit.

Me përjashtim të prodhimit bujqësor, i cili u dëmtua rëndë nga kushtet e këqia atmosferike, sidomos në këta dy vjetët e fundit, vendimet e rëndësishme të Plenumit të Komitetit Qendror të shkurtit 1958 bënë të mundur plotësimin para afatit të planit të dytë pesëvjeçar të vendosur në Kongresin III të PPSH.

Detyrat themelore të planit të tretë pesëvjeçar (1961-1965). Pesëvjeçari i tretë do të shënojë një hap të rëndësishëm për-

para në ndërtimin e bazës materialo-teknike të socializmit; vendi ynë do të ecë më shpejt në rrugën e transformimit nga një vend agraro-industrial në një vend industrialo-agrar, prodhimi bujqësor do të rritet me hapa më të mëdha dhe, si rrjedhim, do të ngrihet më shumë niveli material dhe kultural i masave punonjëse.

Partia e Punës e Shqipërisë e quan si detyrë të rëndësishme zhvillimin e mëtejshëm të industrializimit socialist të vendit, duke i dhënë epërsi zhvillimit të industrisë së rëndë, e në veçanti industrisë nxjerrëse e të përpunimit të mineraleve të dobishme, si hallka kryesore për zhvillimin e degëve të tjera të ekonomisë popullore.

Të bëhen investime të rëndësishme për krijimin e degëve të reja të industrisë, për të krijuar bazën e industrisë së rëndë të përpunimit dhe të pasurimit të mineraleve, të prodhimit të plehërave kimike, të materialeve të ndërtimit e të tjera.

Të sigurohet rritja e rezervave industriale të lëndëve djegëse kryesore si dhe të mineraleve të dobishme, në radhë të parë për naftën, gazin, qymyrgurin, mineralin e kromit, bakrin, hekurnikelin, etj.

Të zgjerohet baza energjitike për sigurimin e zhvillimit në perspektivë të industrisë dhe të të gjitha degëve të tjera të ekonomisë popullore. Të zhvillohen industria mekanike dhe industria e materialeve të ndërtimit, me qëllim që të plotësohen nevojat e vendit.

Të zhvillohet më tej prodhimi i mallrave të konsumit, duke ngritur vepra të reja industriale dhe duke shfrytëzuar në mënyrë më të plotë aftësitë prodhuese të sotme.

Pesëvjeçari i tretë duhet të karakterizohet nga një zhvillim me hapa më të mëdha të prodhimit bujqësor. Drithërat, yndyrnat, mishi, bulmetrat, perimet e patatet e të tjera janë prodhimet kryesore për ushqimin e popullit. Prandaj, për sigurimin e tyre në vend, duhet të përqëndrohen të gjitha forcat e fshatarësisë, të organeve të pushtetit e të Partisë, si dhe të organizatave të masave. Industria jonë ushqimore dhe ajo e lehtë në përgjithësi varen nga prodhimi bujqësor, prandaj çështja e sigurimit të lëndës së parë për industrinë duhet të përbëjë një detyrë të veçantë për organet e bujqësisë në qendër dhe në rrethe, të pushtetit dhe të Partisë. Bujqësia duhet të bëhet burim i rëndësishëm për rritjen e vazhdueshme të eksportit, duke shfrytëzuar kushtet e veçanta klimatike të vendit tonë.

Detyrat e mëdha që i shtrohen bujqësisë sonë kërkojnë punë të vazhdueshme dhe këmbëngulëse, në radhë të parë nga fshatarësia kooperativiste dhe nga organet e bujqësisë të çdo hallke, kërkojnë shfrytëzimin e plotë të çdo pëllëmbë tokë dhe zgjerimin e vazhdueshëm të sipërfaqeve nën kulturë, kërkojnë zbatim

min e përpiktë të agroteknikës së përparuar të vendit tonë dhe të vendeve të tjera përshtatur kushteve tona, kërkojnë që të rriten rendimentet e bimëve dhe të pemëve frutore e vreshtave, kërkojnë që të zhvillohet si numër dhe si racë blegtoaria; të gjitha këto janë kushte të domosdoshme për një bujqësi të përparuar dhe për shtimin e prodhimeve të frutikuturës dhe të blegtorisë.

Këto do të arrihen me një drejtim më të mirë nga organet qendrore të bujqësisë, me një punë të gjithanshme të Partisë dhe të pushtetit për forcimin e mëtejshëm organizativo-ekonomik të kooperativave bujqësore dhe me plotësimin e bazës materialo-teknike të përshtatshme për këtë rritje të prodhimit bujqësor.

Partia e Punës e Shqipërisë, duke u nisur nga zhvillimi i mëtejshëm i forcave prodhuese të vendit, quan detyrë të rëndësishme përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes materiale të masave punonjëse të vendit tonë, duke e rritur më tej pagën reale të punëtorëve dhe nëpunësve, të ardhurat reale të fshatarësisë dhe duke shtuar në përpjesëtime më të mëdha ndërtimin e banesave.

Të futen gjerësisht në të gjitha degët e ekonomisë popullore përfundimet e teknikës së re dhe të shkencës, të sigurohet një përgatitje sistematike e kadrove dhe e specialistëve për t'ju përgjigjur nevojave dhe nivelit të teknikës dhe mbi këto baza të arrihet ngritja e mëtejshme e rendimentit të punës, ulja e kostos dhe përmirësimi i cilësisë së prodhimeve dhe të ndërtimeve.

Gjatë pesëvjeçarit të tretë të sigurohet një përparim i mëtejshëm në zhvillimin ideo-politik, arësimor dhe kultural të popullit, duke përhapur gjerësisht mësimet e marksizëm-leninizmit, duke zgjeruar dhe duke forcuar shkollën dhe institucionet e ndryshme arësimore-kulturale, duke riorganizuar sistemin e arësimit në vendin tonë, për lidhjen e ngushtë të shkollës me jetën.

Mbi bazën e zhvillimit të mëtejshëm të forcave prodhuese, të rritet dhe të forcohet klasa punëtore, të forcohet edhe më shumë aleanca e saj me fshatarësinë punonjëse, si dhe baza ekonomike, politike dhe organizative e pushtetit tonë popullor.

Të forcohen lidhjet e Partisë me masat, të përmirësohet metoda e drejtimit të ekonomisë nga ana e organeve të Partisë, organeve shtetërore dhe ekonomike, të ngrihet niveli tekniko-profesional i kadrove në lartësinë e detyrave që shtrohen.

Kongresi IV i Partisë së Punës të Shqipërisë, duke marrë parasysh edhe rezultatet e propozimeve dhe të vërejtjeve që masat punonjëse bënë me rastin e diskutimit popullor të projekt-direktivave, cakton këto direktiva për zhvillimin ekonomik dhe kultural të Republikës Popullore të Shqipërisë gjatë pesëvjeçarit të tretë (1961-1965).

I. — ZHVILLIMI I INDUSTRIË

1) Volumi i përgjithshëm i prodhimit industrial në bazë të çmimeve të vitit 1960 të rritet 52 për qind, me një ritëm mesatar vjetor prej 8,7 për qind. Në vitin 1965 pesha specifike e prodhimit industrial, kundrejt volumit të përgjithshëm të prodhimit industrial dhe bujqësor, të arrijë 54 për qind.

Detyrë e dorës së parë në industri të jetë rritja e mëtejshme e prodhimit industrial në ato degë që paraqesin kushte ekonomike më të përshtatshme. Të zhvillohet industria minerale dhe ajo e përpunimit, për të shfrytëzuar sa më mirë pasuritë e vendit, siç janë mineralet e dobishme, burimet e lëndëve djegëse dhe hidroenergjitike, pasuritë pyjore, lëndët e para bujqësore e të tjera.

Prodhimi i mjeteve të prodhimit (Grupi «A») gjatë pesëvjeçarit të tretë të rritet rreth 54 për qind, me një peshë specifike prej 50,4 për qind kundrejt prodhimit të përgjithshëm industrial. Të sigurohet rritja e mëtejshme e nxjerrjes së naftës dhe e mineraleve të dobishme. Të fillojë krijimi i degëve të reja të industrisë së rëndë, siç janë industria kimike për prodhimin e plehërave azotike dhe fosfatike, metalurgjia e fero-kromit dhe elektrometalurgjia e bakrit. Të zgjerohet edhe më tej baza energjitike, e domosdoshme për zhvillimin në perspektivë të industrisë dhe të degëve të tjera të ekonomisë popullore. Të sigurohet gjithashtu një zhvillim më i mirë i industrisë mekanike, i materialeve të ndërtimit, i lëndës së drurit etj.

Prodhimi i mallrave të konsumit të gjerë (grupi «B») të rritet jo më pak se 50 për qind, duke zhvilluar më tej industrinë e lehtë dhe ushqimore.

2) Prodhimi i mallrave kryesore industriale në vitin 1965 të arrijë:

*Në përqindje:
viti 1960 = 100*

Nafta brut	151
Benzina.	128
Gazoili.	154
Qymyrguri.	145
Mineral kromi	118
Mineral hekur-nikeli	188
Bakër blisteri	201
Energjia elektrike	184
Pjesët e këmbimit	221
Lënda e drurit e sharruar	106
Lënda e drurit e stazhionuar	177
Kompensatua	125
Rimesua.	248

Mobiljet dhe orenditë	147
Çimentua.	316
Tullat.	166
Tjegullat.	118
Prodhimet e qelqit	207
Pëlhurët e pambukta	109
Pëlhurët e leshta	201
Trikotazhet	193
Këpucët e sandalet	194
Sheqeri	129
Orizi i pastruar	209
Makaronat.	119
Verërat	331
Vaji i ullirit	141
Yndyrnat industriale	158
Gjalpi.	137
Djathërat.	210
Birra.	167
Peshku i njomë	192
Cigaret dhe duhani kaush	178
Sapuni.	148

3) Zgjerimi i kërkimeve dhe i zbulimeve gjeologjike për të siguruar edhe më tej bazën e industrisë minerale të vendit tonë të quhet një nga detyrat më të rëndësishme të ekonomisë. Të vazhdojnë me ritme më të shpejta kërkimet për zbulimin e vendburimeve të reja të mineraleve të dobishme dhe për rritjen më të shpejtë të rezervave industriale, në mënyrë që të sigurohet baza e lëndës së parë për zhvillimin perspektiv të industrisë së nxjerrjes dhe të përpunimit në vend të mineraleve kryesore.

T'u kushtohet kujdes i veçantë kërkimeve komplekse, sidomos për gjetjen e vendburimeve të reja me perspektivë, në radhë të parë për naftën, bitumin dhe gazin natyror, qymyrgurin, kromin, hekur-nikelin, bakrin, squfurin. Njëkohësisht të vazhdojnë kërkimet gjeologjike në shkallë të gjerë për zbulimin e lëndës së parë për materiale ndërtimi dhe minerale të reja të dobishme.

Punimet komplekse gjeofizike të zënë vendin kryesor në tërësinë e punimeve gjeologo-kërkuese dhe të sigurojnë vendosjen sa më të studjuar të shpimeve të thella të zbulimit të naftës. Të pregatiten në përputhje me rregullat gjeologjike dhe të jepen për shpim-kërkim të thellë jo më pak se 10 struktura të reja; të pregatiten njëkohësisht edhe strukturat rezervë. Të zbulohen dy vendburime të reja nafte, nga të cilat njëri të vihet në shfrytëzim në vitin 1963. Volumi i shpim-kërkimeve të thella që do të kryhet gjatë pesëvjeçarit të tretë të arrijë në 350 mijë ml. Një pjesë e këtij metrazhi të përdoret për shpimin e puseve strukturale kërkuese.

Punimet gjeologo-zbuluese për qymyrgurin të përqëndrohen në zonën e Tiranës. Ndërkaq, të vazhdojnë punimet gjeologo-kërkuese për gjetjen e vendburimeve të tjera, sidomos për qymyrgurin me më pak sqfur dhe të koksifikueshëm. Brenda vitit 1961 të jepen të dhënat për projektimin e minierës së Mëzezit në Tiranë.

Brenda vitit 1962 të sigurohen rezervat e nevojshme për fabrikat e pasurimit të mineraleve të varfëra të kromit në zonat Bulqizë, Martanesh dhe Kukës. Të studjohet mundësia e zbulimit të mineralit të kromit edhe në zonat ku nuk ka shenja në sipërfaqe. Rëndësi e veçantë t'i kushtohet zbulimit të rezervave të mineralit me përmbajtje mbi 40 për qind Cr_2O_3 në zonën e Bulqizë-Martaneshit, ku edhe të përqëndrohet pjesa më e madhe e punimeve.

Të vazhdojnë me ritme të mëdha punimet e kërkimit dhe të zbulimit për mineralin e hekur-nikelit, që të sigurohen rezervat industriale për një afat të gjatë për ngritjen në të ardhmen të metalurgjisë së zezë, si edhe për eksport.

Të përfundojë në vitin 1961 zbulimi i vendburimit të mineralit të bakrit në Spaç. Punimet për kërkimet dhe zbulimet e mineralit të bakrit të përqëndrohen në radhë të parë në zonën e Mirditës dhe në Kukës, sidomos për gjetjen e mineraleve të pasura.

4) Prodhimi i industrisë së naftës në vitin 1965 të jetë rreth 36 për qind më shumë se në vitin 1960. Të përpunohet në vend 38 për qind më shumë naftë se në vitin 1960. Të parashikohet shpimi i puseve të shfrytëzimit në sasinë e domosdoshme për nxjerrjen e naftës së nevojshme për përpunim në vend dhe për eksport. Shpejtësia e shpimit të sondave në pusët e shfrytëzimit të rritet jo më pak se 22 për qind dhe në pusët e kërkimit jo më pak se 20 për qind. Gjatë pesëvjeçarit të tretë të përdoren metoda më të përparuara për shfrytëzimin më të mirë të puseve, mbajtjen e presionit të shtresave për rritjen e nxjerrjes së naftës.

Brenda vitit 1961 të përfundojë kolona për zgjerimin e aftësisë së përpunimit në uzinën e Cërrikut dhe brenda vitit 1962 të përfundojë riformingu. Të kryhet rindërtimi i uzinës së përpunimit të naftës në Qytetin Stalin.

Me qëllim që të shfrytëzohet gazi i naftës, të ndërtohet një fabrikë për pastrimin e gazit. Të merren masat për grumbullimin e gazit shoqëruar të naftës dhe të arrihet që gjer në vitin 1965 të shfrytëzohet 75 për qind e burimeve të gazit nga vendburimet e sotme dhe 40 për qind nga vendburimi i ri i naftës.

5) Prodhimi i industrisë së qymyrgurit në fund të pesëvjeçarit të tretë të rritet 62 për qind më shumë se në vitin 1960. Brenda vitit 1961 të vihet në shfrytëzim miniera e qymyrgurit e Alarupit, si dhe fabrika e briketit e qymyrgurit në Tiranë. Të sigurohet mekanizimi i mëtejshëm i nxjerrjes së qymyrgurit, duke përdorur

sharrat prerëse, duke mekanizuar transportin e brendshëm dhe të jashtëm, si dhe punimet minerale.

Brenda pesëvjeçarit të ndërtohet dhe të përgatitet për shfrytëzim miniera e qymyrgurit në Mëzez të Tiranës.

6) Prodhimi i industrisë së kromit në vitin 1965 të jetë rreth 20 për qind më shumë se në vitin 1960. Të futen në shfrytëzim, brenda pesëvjeçarit të tretë, dy fabrika për pasurimin e kromit dhe të përgatitet për shfrytëzim uzina e ferro-kromit. Të merren masat e nevojshme për shfrytëzimin sa më të plotë të rezervave të mineralit të kromit dhe të rritet mekanizimi i punimeve për nxjerrjen e tij.

7) Prodhimi i industrisë së bakrit në vitin 1965 të rritet 186 për qind më shumë kundrejt vitit 1960. Të fillojnë punimet e ndërtimit për vënjen në shfrytëzim të një vendburimi të ri të mineralit të bakrit. Të mekanizohen punimet për nxjerrjen dhe transportimin e këtij minerali.

8) Prodhimi i industrisë së hekur-nikelit në vitin 1965 të rritet 89 për qind më shumë se në vitin 1960. Për të siguruar këto ritme të shpejta për nxjerrjen e mineralit të hekur-nikelit, të merren të gjitha masat për mekanizimin e mëtejshëm të nxjerrjes dhe të transportit të tij.

9) Për ngritjen e industrisë kimike, brenda pesëvjeçarit të tretë të ndërtohen dhe të vihen në provë për shfrytëzim uzina e plehërave azotike në Fier me aftësi prej 112 mijë tonësh në vit, si dhe uzina kimike dhe e bakrit e kombinatit kimiko-metalurgjik në Laç për prodhimin e bakrit blister, të 70 mijë tonëve acid sulfurik, të 170 mijë tonëve superfosfat të granular dhe të 2 mijë tonëve gurrkali.

10) Industria elektrike të sigurojë nevojat e ekonomisë me energji elektrike, duke krijuar edhe rezervën e domosdoshme. Fuqia e vendosur e centraleve elektrike të Ministrisë së Industrisë, të Ministrisë së Minierave dhe të Gjeologjisë dhe të Drejtorisë së ekonomisë komunale të arrijë në vitin 1965 në 211 për qind në krahasim me vitin 1960, ndërsa prodhimi industrial i kësaj dege të jetë 68 për qind më shumë se në vitin 1960. Hidrocentrali i Shkopetit, me aftësi prej 24 mijë kw, të vihet në shfrytëzim brenda vitit 1962. Në vitet 1963-1964 të vihen në shfrytëzim hidrocentralet e Bisticës me fuqi të vendosur prej 27 mijë kw. dhe në vitin 1965 pjesa e parë e centralit termik të Fierit.

Të vazhdohet ndërtimi i sistemit kryesor të shpërndarjes së energjisë elektrike, duke shtuar, gjatë pesëvjeçarit të tretë, gjatësinë e linjave elektrike të tensionit të lartë prej 22 deri 110 kilovolt me më tepër se 300 km të tjera. Përveç lidhjeve që janë sot, me sistemin e energjisë elektrike, gjatë pesëvjeçarit të tretë, të lidhen edhe Memaliaj, Gjirokastra, Laçi, Lezha, Shkodra etj.

Gjatë pesëvjeçarit të tretë të bëhen studime për projektimin e hidrocentraleve mbi lumin Drin.

Të vazhdojë puna për elektrifikimin e ndërmarrjeve bujqësore shtetërore dhe të SMT-ve. Kooperativat bujqësore dhe fshatarësia në përgjithësi të ndihmohen nga ana e shtetit për zgjerimin e elektrifikimit të fshatit.

Që të sigurohet furnizimi i pandërprerë me energji elektrike dhe të ulet kostua e saj, të merren masat për përmirësimin e mëtejshëm të shërbimit në centralet elektrike, të ngarkesës së tyre dhe të rrjetit të shpërndarjes në qytete e qendra pune.

Ministria e Industrisë të organizojë ngritjen e një reparti për ndreqjen e pajisjeve të ndryshme elektrike, në mënyrë që nga fundi i pesëvjeçarit të plotësohen nevojat për të gjithë vendin.

11) Prodhimi i industrisë mekanike dhe të përpunimit të metaleve në vitin 1965 të rritet 83 për qind më shumë se në vitin 1960. Vëmendja më e madhe t'i kushtohet prodhimit të pjesëve të këmbimit, sidomos për të siguruar nevojat e industrisë, dhe veçanërisht të industrisë së naftës, të transportit automobilistik, të traktorëve dhe të maqinerive të ndërtimit. Në vitin 1965 të sigurohen jo më pak se 50 për qind e nevojave të përgjithshme të ekonomisë popullore për pjesë këmbimi. Gjatë pesëvjeçarit të tretë të përfundojë zgjerimi i Uzinës mekanike në Qytetin Stalin, zgjerimi dhe specializimi i Uzinës «Enver» për prodhimin e pjesëve të këmbimit për automjete me aftësi prodhimi prej rreth 200 milion lekësh në vit, së bashku me repartin e shkrirjes së çelikut, Fabrika e gozhdëve dhe e bulonave në Durrës, uzina e re për prodhimin e pjesëve të këmbimit për traktorë me aftësi prodhimi prej 250 milion lekësh në vit, të bëhet zgjerimi dhe rindërtimi i Uzinës «Dinamo» për prodhimin e pjesëve të këmbimit dhe të riparimit të maqinave të ndryshme industriale; të shtohet në Uzinën «Partizani» reparti për prodhimin e materialeve të imta ndërtimi, të sobave dhe të enëve të zmaltuara; të përfundojë zgjerimi i ofiçinës automobilistike në Tiranë, duke rritur aftësinë e prodhimit nga 450 në 1.000 riparime të përgjithshme; të vihet në shfrytëzim ofiçina hekurudhore për lokomotiva dhe vagona.

Të përmirësohet rrënjësisht cilësia e prodhimit dhe e riparimeve në industrinë mekanike, sidomos cilësia e prodhimit të pjesëve të këmbimit. Kujdes i posaçëm t'i kushtohet regjenerimit të pjesëve të konsumuara të këmbimit. Të zhvillohet më tej prodhimi i maqinave të thjeshta për bujqësinë dhe për degët e tjera, të merren masa që ndërmarrjet dhe repartet e industrisë mekanike të sigurojnë plotësisht riparimin e të gjitha maqinerive të ekonomisë popullore, duke shkurtuar sa më shumë kohën e riparimit. Për këtë qëllim gjatë pesëvjeçarit të bëhet përqëndrimi i riparimeve të përgjithshme të automjeteve «Skoda» në ofiçinën

e Ministrisë së Komunikacionit, riparimi i përgjithshëm i ekskavatorëve në ofiçinën e Ministrisë së Ndërtimit në Durrës, të zgjerohet dhe të specializohet ofiçina e Ministrisë së Ndërtimit në Tiranë për riparimin e automjeteve të këtij sektori. Ofiçina e Ministrisë së Minierave dhe të Gjeologjisë në Tiranë dhe ajo e Kombinatit të naftës të zgjerohen për riparimin e maqinerive, të pajisjeve dhe të automjeteve të sektorëve të tyre; të ndërtohet një ofiçinë e re për riparimet e përgjithshme të kamionave «Zil» dhe «Gaz» të republikës si dhe një ofiçinë për riparimet e përgjithshme dhe të mesme të autoveturave dhe «Gaz-eve» të lehta.

12) Prodhimi i industrisë së materialeve të ndërtimit të rritet gjatë pesëvjeçarit të tretë 79 për qind. Të futet në shfrytëzim pjesa e parë e fabrikës së çimentos me aftësi të përgjithshme prodhimi prej 400 mijë tonësh në vit. Të prodhohen llojet e çimentos të markave të larta, të përmirësohet cilësia e prodhimit.

Të rritet prodhimi i tullave dhe i tjegullave në masën që të sigurohen të gjitha nevojat e vendit. Të bëhet kthesë rrënjësore në industrinë e prodhimit të materialeve të ndërtimit, për të siguruar të gjitha ndërtimet me materialet e nevojshme, në veçanti tulla me bira, tjegulla marslieze, qyngje gres etj.

13) Prodhimi i industrisë së drurit në vitin 1965 të rritet 36 për qind më shumë se në vitin 1960. Gjatë pesëvjeçarit të tretë të sigurohet forcimi i mëtejshëm organizativ dhe administrativ i ndërmarrjeve të reja për shfrytëzimin e pyjeve. Të sigurohet një shfrytëzim i plotë i fabrikave të përpunimit të drurit në të gjitha stinat e vitit. Të merren masat për një shfrytëzim sa më të mirë të pyjeve. Për këtë gjatë pesëvjeçarit të tretë të ndërtohen rreth 400 km. rrugë pyjore. Ripërtëritja e pyjeve, përmirësimi dhe mirëmbajtja e tyre janë nga detyrat më të rëndësishme të pesëvjeçarit. Prerja mbi rritjen natyrore nga 91 për qind që është sot në vitin 1965 të zbresë në rreth 20 për qind. Të organizohet përdorimi i mbeturinave të lëndës së drurit për prodhime të ndryshme industriale dhe për lëndë djegëse.

Të merren masa për mekanizimin e mëtejshëm të punës në sharrat, veçanërisht në prerjen dhe në pregatitjen e lëndës, në ngarkim-shkarkimin dhe në transportimin e brendshëm.

Prodhimi i mobiljeve dhe i orendive në vitin 1965 të rritet 47 për qind më shumë se në vitin 1960 dhe të merren masat e nevojshme për të siguruar përmirësimin rrënjësor të cilësisë, pakësimin e peshës së tyre dhe shtimin e llojeve të ndryshme, sidomos atyre të përkulura dhe për fshatin.

Gjatë pesëvjeçarit të ndërtohen dhe të vihen në shfrytëzim dy kombinate druri: njëri në Milot për prodhimin e lëndës së sharruar, të lëndës së stazhionuar, rimesos, pllakave nga mbeturinat e drurit, parketit dhe pjesëve për ndërtim, ambalazh etj. dhe tjetri në Shkodër për prodhimin e lëndës së sharruar, lëndës

së stazhionuar, pllakave nga mbeturinat e drurit, parketit dhe pjesëve për ndërtim dhe ambalazhim. Brenda vitit 1961 të përfundojë ndërtimi i fabrikës së mobiljeve të përkulura dhe gjatë pesëvjeçarit reparti për pllaka nga mbeturinat e drurit në Kombinatin e drurit në Elbasan.

14) Prodhimi i industrisë së qelqit dhe të qeramikës në vitin 1965 të jetë 112 për qind më shumë se në vitin 1960. Për këtë qëllim të zgjerohet Fabrika e porcelanit në Tiranë dhe pranë saj të ngrihet një repart për prodhime hidrosanitare. Brenda vitit 1965 të ndërtohet një fabrikë qelqi e xhami. Të merren të gjitha masat për të siguruar në këtë degë përmirësimin rrënjësor të cilësisë dhe zgjerimin e llojeve të prodhimeve, duke ua përshtatur kërkesave të konsumit.

15) Prodhimet e industrisë së lehtë në vitin 1965 të jenë 62 për qind më shumë se në vitin 1960. Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së prodhimit dhe shtimi i llojeve të quhen detyra kryesore të pesëvjeçarit të tretë për industrinë e lehtë.

Të përmirësohet shumë cilësia e llojeve të reja të pëlhurëve të pambukta të lehta, si puplin, tafta, satin, maja, të shtohen vizatimet dhe përpunimet e ngjyrave për basmat, të zgjerohen dhe të përmirësohen llojet dhe cilësia e stofave të leshta për pallto, të stofave të krehjes së lartë etj.

Brenda pesëvjeçarit të tretë të ndërtohet dhe të vihet pjesërisht në shfrytëzim një kombinat i ri i tekstileve të pambukta, i cili të përfundojë plotësisht në pesëvjeçarin e katërt.

Në vitin 1963 të përfundojë zgjerimi i fabrikës së pëlhurëve të leshta në Tiranë, duke rritur aftësinë prodhuese nga 1,1 milion në 2,3 milion metra.

Të zhvillohet më tej industria e rrobave të gatshme. Në vitin 1965 rrobat e gatshme të pambukta në seri të jenë 69 për qind më shumë se në vitin 1960 dhe rrobat e gatshme të leshta në seri 54 për qind më shumë.

Prodhimi i trikotazhit në vitin 1965 të jetë 93 për qind më shumë se në vitin 1960 dhe ai i çorapeve 139 për qind më shumë. Në vitin 1963 të përfundojë fabrika për tjerren e fillit pranë trikotazhit në Korçë me repartin e ngjyritjes me aftësi prodhimil prej 900 ton fijesh në vit, duke bërë njëkohësisht edhe zgjerimin e Fabrikës së trikotazhit për të ngritur aftësinë prodhuese në 3 milion copë trikotazhe dhe 3 milion palë çorape në vit. Përmirësimi rrënjësor i cilësisë dhe shtimi i llojeve të prodhimit të jenë detyrat kryesore në prodhimin e rrobave të gatshme dhe të trikotazhit.

Gjatë pesëvjeçarit të tretë të bëhet zgjerimi i Fabrikës së këpucëve në Tiranë dhe të ndërtohen tri reparte këpucësh pranë fabrikave të lëkurëve në Korçë, Shkodër e Gjirokastër. Të përfundojë zgjerimi i Fabrikës së gomës në Durrës.

16) Prodhimi i industrisë ushqimore në vitin 1965 të jetë 43 për qind më shumë se në vitin 1960. Përmirësimi rrënjësor i cilësisë, zbatimi i përpiktë i rregullave të higjienës, zgjerimi i llojeve dhe përvetësimi i proceseve të reja teknologjike të prodhimit të quhen si detyrat më të rëndësishme në industrinë ushqimore.

Prodhimet e makaronave, të bukës dhe të miellrave të shtohen si lloje dhe të përmirësohet vazhdimisht cilësia e tyre. Gjatë pesëvjeçarit të tretë të ndërtohen fabrikat e bukës në Tiranë, Korçë, Durrës, Shkodër, si dhe fabrikat e miellit në Elbasan, Vlorë e Gjirokastër, si dhe të përmirësohet gjendja e pajisjeve teknologjike në fabrikat ekzistuese.

Zhvillim të madh të marrë industria e përpunimit të rrushit. Prodhimi i përgjithshëm i verërave në vitin 1965 të jetë 231 për qind më shumë se në vitin 1960. Për këtë gjatë viteve të para të pesëvjeçarit të tretë të vihen në shfrytëzim fabrikat e përpunimit të rrushit që janë në ndërtim e sipër dhe të ndërtohet një fabrikë e re. Të përvetësohet sa më shpejt teknologjia e fabrikave të përpunimit të rrushit për të prodhuar verëra me cilësi të mirë.

Për të përmirësuar cilësinë e vajit të ullirit dhe të yndyrnave industriale, gjatë pesëvjeçarit të tretë të vihen në shfrytëzim tri fabrika vaj ulliri në Tiranë, Cakran e Dhërmi me aftësi përpunimi prej 20 tonësh ullinj në 24 orë secila, si dhe fabrika e ekstraksionit dhe e rafinimit të vajrave në Fier. Kujdes i veçantë të tregohet për rritjen e rrezes së nxjerrjes së vajit, për grumbullimin, ruajtjen dhe industrializimin e ullirit dhe në veçanti për të përmirësuar cilësinë e prodhimit të vajrave dhe të sapunit, sidomos të sapunit të tualetit.

Në vitin 1965 zënja e peshkut të jetë 92 për qind dhe prodhimi i konservave të peshkut 184 për qind më shumë se në vitin 1960. Të merren të gjitha masat për një shfrytëzim më të mirë të flotës së sotme të peshkimit dhe të pajiset ajo me mjete të reja. Të bëhen studime dhe kërkime për përcaktimin e zonave të peshkimit, për gjetjen e zonave të reja, për zbulimin e sasive gjithmonë e më të mëdha të sardeles dhe për rritjen artificiale të peshkut.

Vemendje e veçantë t'i kushtohet përpunimit të disa prodhimeve të rëndësishme që kanë të bëjnë me nevojat e përditshme të popullatës. Të shtohen prodhimet e përpunuara, si konserva natyrore dhe marinada perimesh, konserva mishi e peshku, ullinj të kripur, salcë domatesh, lloje të ndryshme marmalate dhe reçeli etj.

T'i kushtohet kujdes i veçantë industrializimit dhe përpunimit të qumështit. Brenda pesëvjeçarit të vihen në shfrytëzim 4 fabrika për përpunimin e qumështit dhe një fabrikë për prodhimin e qumështit pluhur. Të bëhet një punë më e madhe për orga-

nizimin më të mirë të baxhove dhe punishteve, si dhe për grumbullimin e sasive më të mëdha të qumështit.

Të përmirësohet rrënjësisht cilësia e duhanit, duke filluar që nga prodhimi e deri në manipulimin dhe fermentimin e tij. Brenda pesëvjeçarit të tretë të bëhet zgjerimi i uzinave të fermentimit të duhanit në Durrës dhe Gjirokastrë. Të merren gjithashtu të gjitha masat për përmirësimin rrënjësor të cilësisë së cigareve dhe për prodhimin e sa më shumë llojeve të ndryshme.

Të merren masat për përpunimin e të gjitha mbeturinave të industrisë ushqimore dhe për përdorimin e tyre për ushqimin e kafshëve.

17) Kooperativat e artizanatit në vitin 1965 të rrisin prodhimin e përgjithshëm industrial 69 për qind më shumë se në vitin 1960 dhe ndërmarrjet e industrisë lokale 23 për qind më shumë. Rritja e mëtejshme e prodhimit në industrinë lokale dhe në artizanat të mbështetet kryesisht në lëndën e parë dhe në materialet që gjenden në vend dhe në shfrytëzimin e mbeturinave të industrisë kombëtare.

Kooperativat e konsumit të zgjerojnë prodhimin duke përpunuar prodhimet bujqësore dhe blegtorale, veçanërisht në zonat e thella të vendit, duke rritur në vitin 1965 prodhimin 67 për qind më shumë se në vitin 1960.

Ndërmarrjet e industrisë lokale dhe organizatat kooperativiste të quajnë detyrë të tyre kryesore plotësimin më të mirë të nevojave të popullsisë me mallra të konsumit të gjerë, sidomos të nevojave të fshatit, të shtojnë sa më shumë llojet e mallrave dhe të përmirësojnë vazhdimisht cilësinë e tyre.

Kooperativat e artizanatit të zgjerojnë dhe të përmirësojnë punën e shërbimeve dhe riparimeve, për t'ju përgjigjur siç duhet kërkesave dhe nevojave të popullit. Gjithashtu të merren masat për rritjen e prodhimit të artikuljeve artistikë me motive kombëtare, për eksport dhe për nevojat e vendit, sidomos të qilimeve, të xunkthit, të shqopës etj.

II. — ZHVILLIMI I BUJQËSISË

1) Gjatë pesëvjeçarit të tretë detyrë kryesore e bujqësisë është shtimi i prodhimit të drithit. Krahas kësaj, të shtohen edhe prodhimet e tjera bujqësore e blegtorale në atë masë që të sigurohet një furnizim i kënaqshëm i popullit, të plotësohen më mirë nevojat e industrisë me lëndë të parë dhe të shtohet eksportimi i tyre.

Këto detyra të arrihen përmes zgjerimit të vazhdueshëm dhe shfrytëzimit të plotë të sipërfaqes së tokës nën kulturë, rritjes së rendimenteve, rritjes së numrit dhe të prodhimtarisë së blegto-

risë, duke u mbështetur në forcimin e mëtejshëm ekonomik dhe organizativ të kooperativave bujqësore dhe të ndërmarrjeve bujqësore shtetërore dhe duke shtuar bazën materialo-teknike.

Volumi i përgjithshëm i prodhimit bujqësor e blegtoral në vitin 1965 do të jetë 72 për qind më shumë se në vitin 1960 (të dhënat e vitit 1960 për prodhimin bujqësor e blegtoral janë paraprake). Pësha specifike e prodhimit të përgjithshëm bujqësor kundrejt volumit të përgjithshëm të prodhimit industrial dhe bujqësor në vitin 1965 të jetë 46 për qind.

Prodhimet kryesore bujqësore e blegtorale në vitin 1965 të arrijnë si më poshtë:

Në përqindje:

viti 1960 = 100

Drithërat e bukës	195
Orizi	155
Pambuku çeltik	165
Duhani	212
Panxhari i sheqerit	175
Elbi distik	137
Perimet	213
Patatet	200
Fasulet	169
Drithërat për tagji	141
Mishi	134
Qumështi	158
Frutat	208
Rrushit	172
Ullinjat	281
Agrumet	229

2) Detyrë kryesore për kooperativat bujqësore të jetë forcimi organizativ dhe ekonomik i tyre. Organet e Partisë dhe të shtetit të punojnë me këmbëngulje për forcimin e ndërgjegjes socialiste të fshatarit për organizimin më të mirë të punës, për administrimin me rentabilitet të ekonomisë, për shpërblimin e drejtë të punës, për plotësimin e kooperativave me kuadro të aftë, për ngritjen e agroteknikës në një nivel më të lartë.

Që të krijohen kushte më të favorshme për rritjen e prodhimit dhe për përmirësimin e drejtimit të ekonomisë bujqësore, të vazhdohet atje ku janë pjekur kushtet puna për bashkimin e kooperativave të vogla në kooperativa më të mëdha. Bashkimet të bëhen të matura dhe të studjuara mirë.

Madhësia mesatare e tyre në zonat krejt fushore të jetë rreth 500 ha tokë nën kulturë, ndërsa në zonat kodrinore —

fushore rreth 300 ha. Në zonat malore të bashkohen vetëm fshatrat shumë të vogla dhe kur nuk janë larg njëri-tjetrit.

Për kooperativat bujqësore të zonave malore është e domosdoshme të merren masa të veçanta nga organet e Partisë dhe të pushtetit për përmirësimin e gjendjes së tyre ekonomike, duke i vënë rëndësi zhvillimit të blegtorisë, frutikulturës etj.

Të rritet pjesëmarrja e anëtarëve në punët e përbashkëta të kooperativës, si kusht i domosdoshëm për forcimin ekonomik dhe për shtimin e të ardhurave të kooperativës. Të luftohet kudo për plotësimin e minimumit të ditëve të punës nga çdo anëtar. Të përhapet gjerësisht lëvizja e përparuar për të bërë jo më pak se 300 ditë-punë në vit.

Kujdes i madh të tregohet sidomos për rritjen e pjesëmarrjes së grave në punët e kooperativës dhe të lehtësohen ato nga punët e shtëpisë, duke hapur kopshte e çerdhe fëmijësh, furra buke të përbashkëta etj. Të vazhdojë për kooperativat bujqësore ndihma nga ana e shtetit me kredi agrare, kryesisht për nevojat e rritjes së prodhimit, me materiale ndërtimi, maqineri, vegla e pajisje të nevojshme për punimet bujqësore, materiale për elektrifikimin etj.

3) Në vitin 1965 sipërfaqet nën kulturë të arrijnë 515 mijë ha ose 13 për qind më shumë se në vitin 1960, duke hapur gjatë pesëvjeçarit 63 mijë ha toka të reja. Në sektorin shtetëror të bujqësisë sipërfaqja nën kulturë të rritet jo më pak se 24 për qind.

Problemi i hapjes së tokave të reja të jetë edhe në pesëvjeçarin e tretë një nga detyrat më kryesore për organet e Partisë dhe të pushtetit. Për të zgjeruar sa më shumë sipërfaqet e mbjella, të mobilizohet e gjithë fshatarësia, duke përdorur për këtë qëllim mjetet e mekanizuara, pendët dhe krahët e punës, si dhe të gjitha mjetet e tjera që gjenden në kooperativat bujqësore.

Të vendoset një regjim i fortë në administrimin dhe përdorimin e fondit të tokës, duke mos lejuar përdorimin e tokës — arë ose të çdo toke të përshtatshme për arë, për qëllime të tjera.

4) Rritja e rendimenteve të bimëve bujqësore të jetë për këtë pesëvjeçar dhe për të ardhmen një nga detyrat më kryesore për shtimin e prodhimit bujqësor. Rendimenti mesatar i kulturave bujqësore për pesëvjeçarin e tretë të jetë si vijon: për grurin 12,4 kv. për ha, për misrin 13,5 kv. për ha, për misrin hamullor 7,5 kv. për ha, për tagjirat 9,6 kv. për ha, për pambukun 10,9 kv. për ha, për duhanin 7,8 kv. për ha, për panxharin e sheqerit 221,5 kv. për ha, për perimet 135,1 kv. për ha. Në vitin 1965 rendimentet e kulturave bujqësore të jenë si vijon: gruri 13,6 kv. për ha, misri 14,6 kv. për ha, misri hamullor 8 kv. për ha, tagjiti 10 kv. për ha, pambuku 12,5 kv. për ha, duhani 8 kv. për ha, panxhari i sheqerit 244 kv., për ha, perimet 145 kv. për ha. Në sektorin shtetëror të bujqësisë të merren këto rendimente mesatare pesëvjeçare për ha: për grurin 17,2, për misrin 17,2, për tagjirat 14,5, për pambu-

kun 13,5 për panxharin e sheqerit 310, për perimet 193 dhe për patatet 126 kv. për ha. Në vitin 1965 në sektorin shtetëror të arrihen këto rendimente: gruri 18,5 kv. për ha, misri 18,5 kv. për ha, tagjirat 15 kv. për ha, pambuku 14 kv. për ha, panxhari i sheqerit 310 kv. për ha, perimet 200 kv. për ha dhe patatet 130 kv. për ha.

Të tregohet kujdes i vazhdueshëm për përmirësimin e mëtejshëm të strukturës së sipërfaqeve të mbjella dhe të vendoset një renditje e drejtë e kulturave. Të përmirësohet rrënjësisht sistemi i punimit të tokës, duke zbatuar gjerësisht punimet e thella jo më pak se 30 cm. dhe këto plugime të bëhen kryesisht që në vjeshtë; atje ku është e nevojshme, për kulturat e vjeshtës toka të punohet me lehe të ngritura. Të mbahet kurdoherë parasysh, sidomos në fushat kryesore të vendit tonë, se klima me shira të shumta në stinët e mbjelljeve është pengesa më e madhe për bujqësinë tonë dhe, si rrjedhim, kullimi i shpejtë i çdo ngastre toke është çelësi për t'ja arritur qëllimit që të kryejmë mbjellje të shpejta dhe, pas mbjelljeve, që bimët të zhvillohen në kushtin e tokave të terura. Të punohet, pra, me këmbëngulje për zbatimin e teknikës së kullimit të ngastrës. Stina e gjatë e verës pa reshje kërkon gjithashtu punë këmbëngulëse të durueshme e të vazhdueshme për përmirësimin e teknikës së ujitjes, për shfrytëzimin e plotë të aftësisë ujitore dhe për shtimin e gjithanshëm të sipërfaqes nën ujë. Të përhapen gjerësisht metodat e përparuara dhe më ekonomike të vaditjes për çdo kulturë.

Pesëvjeçari i tretë në bujqësi duhet të karakterizohet nga përpjekje të gjithanshme, që mbjelljet, shërbimet, plugimet etj. të kryhen brenda afateve më të shkurtëra dhe më të mira. Lufta kundër sëmundjeve dhe dëmtuesve të bimëve dhe të pemëve si dhe kundër barërave të këqia të quhet si një detyrë e rëndësishme. Të organizohet kudo përhapja e gjerë e eksperiencës së përparuar të ndërmarrjeve bujqësore shtetërore, të kooperativave bujqësore dhe të brigadave të dalluara. Punonjësit e bujqësisë të përvetësojnë gjithashtu eksperiencën dhe metodat e përparuara të vendeve të tjera.

5) Gjatë pesëvjeçarit të tretë të përfundojnë bonifikimet e fushave të Myzeqesë, të Vurgut, të Thumanës, të Fier-Roskovecit, të Maliqit, të Kënetës së Durrësit, të Karavastasë, të Lezhë-Matit si dhe të fillojnë punimet për bonifikimin e Hoxharës. Të bëhet ujitja e fushës së Devollit dhe të Korçës, e tokave të Hekal-Gjonçit (Fier) dhe e fushave të Dumresë (Elbasan); të bëhet kanali ujitës Bistricë-Vagalat (Sarandë), kanali i Qillnës së Poshtme (Peshkopi) dhe kanali i Spilles (Durrës). Të ndërtohen rezervuarë, kanale ujitëse, si dhe qendra pompimi në Shkodër, Krujë, Vlorë, Durrës, Fier, Përmet, Berat, Lushnjë, Burrel, Tiranë, Ersekë, Pogradec, Gramsh, Kukës, Tepelenë etj.

Nga përfundimi i bonifikimeve gjatë pesëvjeçarit të tretë të

përfitohen rreth 16 mijë ha toka të reja, nga të cilat të vihen nën kulturë 10 mijë ha dhe aftësia ujitëse në fund të vitit 1965 të arrijë në 200 mijë ha, nga 135 mijë ha. që është në vitin 1960, ose 48 për qind më shumë.

Organet e Partisë dhe të pushtetit në rrethe t'i japin një rëndësi të posaçme ndërtimit të veprave vaditëse me karakter lokal, duke vënë në lëvizje kooperativat bujqësore që të shfrytëzojnë plotësisht mundësitë e brendshme, në mënyrë që, në fund të pesëvjeçarit, aftësia ujitëse në veprat lokale të rritet edhe 34 mijë ha. Për këtë të ndërtohen kanale me rrjedhje të lirë, rezervuarë, hauze, çikrikë, puse, motopompa etj. Shtimi i aftësive ujitëse përmes ndërtimeve lokale të bëhet kryesisht me iniciativën dhe me punën e vetë fshatarëve.

6) Prodhimi dhe përdorimi në masë të gjerë i farërave të zgjedhura të jetë një nga detyrat kryesore për rritjen e rendimentit të bimëve të arave. Kooperativat dhe ndërmarrjet bujqësore të krijojnë ngastrat e farërave, të cilat të furnizohen çdo vit me farë të zgjedhur nga shteti, dhe të bëjnë shumëzimin e saj për të përballuar nevojat vetiake. Organet shtetërore dhe të Partisë të tregojnë kujdes të vazhdueshëm për prodhimin, zgjedhjen, ruajtjen dhe dizinfektimin e farërave. Deri në vitin 1965 jo më pak se 80 për qind e sipërfaqes me grurë të mbillet me farëra të zgjedhura. Ekonomitë bujqësore në përgjithësi dhe në mënyrë të veçantë Instituti i kërkimeve shkencore bujqësore t'i kushtojnë kujdes të posaçëm studimit të llojeve të reja të farërave me rendiment të lartë, të përshtatshme për kushtet tokësore dhe klimaterike të vendit tonë.

7) Të tregohet kujdes i posaçëm për rritjen e prodhimit të bimëve industriale, dhe sidomos për përmirësimin e cilësisë së tyre.

Për mbjelljen e pambukut të caktohen tokat më të mira, të kulluara dhe të pastra nga grami. Pambuku të përqëndrohet në radhë të parë në rrethet e Lushnjës, të Fierit, të Durrësit dhe të Beratit, për të cilat kjo kulturë të jetë bima kryesore.

Sipërfaqja e mbjellë me duhan të rritet 32 për qind, duke e përhapur këtë kulturë edhe në zona të reja. Për përmirësimin rrënjësor të cilësisë së duhanit të tregohet më shumë kujdes për kultivimin, manipulimin dhe përpunimin e tij. Të merren masa për ta organizuar kudo më mirë prodhimin e fidanave. Në kooperativat bujqësore të ngrihen angarët dhe depot e nevojshme për duhanin.

8) Të organizohet në shkallë të gjerë grumbullimi dhe përdorimi i plehërave organike, që gjenden me shumicë në çdo vend. Çdo kooperativë të grumbullojë më shumë kujdes jo vetëm plehun nga bagëtitë kolektive, por edhe nga të gjitha burimet e tjera. Çështja e ruajtjes, e grumbullimit dhe e përdorimit të gjerë të

të gjitha plehërave organike lokale të kapet mirë në duar dhe të bëhet problem i madh i të gjitha organizatave të Partisë.

Të tregohet më shumë kujdes për përdorimin sa më të mirë të plehërave kimike dhe të mos lejohet në asnjë mënyrë dëmtimi i tyre.

9) Gjatë pesëvjeçarit të tretë të mbillen 3,7 milion rrënjë ullinj, 8,5 milion pemë frutore, 1 milion rrënjë agrume, 7,7 milion rrënjë pjergulla dhe 6.640 ha vreshta. Në krahasim me vitin 1960, në fund të pesëvjeçarit numri i rrënjëve në prodhim të rritet: për ullinj të 8 për qind, për pemët frutore 71 për qind, për agrumet 193 për qind, për pjergullat 59 për qind dhe për vreshtat 289 për qind më shumë. Në vitin 1965 prodhimi i frutave gjithsejt të jetë 108 për qind më shumë se në vitin 1960, i ullinjve 181 për qind, i agrumeve 129 për qind dhe i rrushit 72 për qind.

Mbjellja e pemëve dhe e vreshtave të bëhet në bloqe tokash të pjerrëta që nuk përdoren për mbjelljen e drithërave të bukës, dhe në raste të veçanta në toka të rrafshta. Ministria e Bujqësisë të studjojë mundësinë e mbjelljes së kulturave drurore dhe të hardhive në rreshta të largëta me qëllim që sipërfaqja të shfrytëzohet njëkohësisht edhe për kulturat e arave. Të organizohet prodhimi i fidaneve antifilokserike në vend dhe të merren të gjitha masat e nevojshme për të siguruar prodhimin e fidaneve në numrin e nevojshëm.

Të punohet me shumë kujdes për mbjelljen e pemëve frutore me fidane të shëndosha, ose, kur nuk ka mundësi, me copa të rrënjëzuara, duke zbatuar një agroteknikë të lartë për mënjanimin e humbjeve. Të organizohet më mirë kryerja e shërbiemeve kulturore në të gjitha bloqet e mbjella me pemë frutore, ullinj, agrume, vreshta e pjergulla.

Me qëllim që të përcaktohen më mirë llojet e pemëve dhe të rrushit në përputhje me kushtet klimaterike, me nevojat e industrisë, të eksportit dhe të konsumit të gjerë për këto prodhime, Ministria e Bujqësisë të bëjë studimin përkatës për zhvillimin e tyre në të ardhshmen dhe t'ja paraqesë qeverisë brenda vitit 1962.

10) Me qëllim që të sigurohet shfrytëzimi më i mirë i kohës së përshtatshme për mbjellje dhe të bëhet rajonizimi vertikal për mbjelljen e bimëve të ndryshme, Ministria e Bujqësisë ta përfundojë studimin e këtij problemi brenda vitit 1962.

11) *Zhvillimi i blegtorisë* — Në pesëvjeçarin e tretë të rritet numri i krerëve të të gjitha llojeve të gjësë së gjallë, si dhe prodhimentaria e saj, për të plotësuar më mirë nevojat e popullit dhe të industrisë me mish, qumësht, lesh etj.

Kundrejt vitit 1960, në vitin 1965 numri i lopëve të rritet 23 për qind, i deleve 20 për qind, i dhive pëlla 19 për qind, i dosave 33 për qind, i shpendëve 90 për qind dhe i bletëve 55 për

qind. Rendimenti mesatar për lopë të arrijë 1.100 kg. qumësht për të gjithë republikën dhe për ndërmarrjet bujqësore shtetërore 3000 kg.

Rëndësi e posaçme t'i kushtohet shtimit të numrit të do-save, për të rritur edhe më shumë prodhimin e mishit të derrit dhe të yndyrnave. Në fund të pesëvjeçarit numri i tyre të arrijë në 38,5 mijë krerë.

Për të realizuar me sukses detyrat e planit të blegtorisë, duhet të përqëndrohen përpjekjet në dy drejtime kryesore: në sigurimin e bazës ushqimore të blegtorisë dhe në përmirësimin e racës e në zbatimin e masave sanitaro-veterinare. Sigurimi i bazës ushqimore për blegtorinë kërkon përgatitjen e sa më shumë silazhi, mbjelljen e sa më shumë hasëlleve dhe bimëve të tjera foragjere, përmirësimin e kullotave, sigurimin e më shumë koncentreve, përdorimin racional të ushqimit të bagëtisë. Ndërzimi artificial të bëhet metoda kryesore për përmirësimin e racës së dhenve dhe të lopëve, ndërsa zbatimi i masave sanitaro-veterinare duhet të çojë në uljen e dështimeve dhe në mbrojtjen e bagëtisë nga sëmundjet e ndryshme, sidomos nga tuberkulozi dhe bruceloza.

Në vitin 1965 të mbillen 21 mijë ha me barëra shumëvjeçare, 13 mijë ha me foragjere të drejtpërdrejta dhe 80 mijë ha me kultura të dyta dhe shoqëruese. Silazhimi i ushqimeve të njoma të përdoret gjerësisht nga ekonomitë bujqësore shtetërore dhe kooperativiste.

Komitetet ekzekutive të rretheve, këshillat popullore të fshatrave dhe kooperativat bujqësore të bëjnë një punë të vazhdueshme për pastrimin dhe përmirësimin e kullotave, shtimin e kapacitetit të tyre.

Të tregohet kujdes më i madh për ushqimin dhe mbarështrimin e blegtorisë. Të merren masa për ngritjen e pjellshmërisë dhe luftën kundër sëmundjeve dhe parazitëve, që shkaktojnë dëme të mëdha në ekonominë blegtorale. Të përmirësohet me hapa më të mëdha shërbimi zooveterinar, të merren masa rrënjësore për kufizimin dhe zhdukjen e brucelozës dhe të tuberkulozit në kafshët. Të përdoret vënja në majmëri e blegtorisë nga kooperativat bujqësore para se të dorëzohen.

Të punohet vazhdimisht për përmirësimin e racës së lopëve me anë të kryqëzimit natyror dhe artificial, duke e quajtur këtë të domosdoshëm për ngritjen e prodhimeve blegtorale. Të vazhdohet kryqëzimi i dhenve që kanë lesh të ashpër me racat «ci-gaja» dhe «merinos».

Për shtimin e prodhimit të mishit, krahas me kafshët e trasha dhe të imta, një rëndësi e madhe t'i jepet shumëzimit dhe rritjes së shpendëve, veçanërisht atyre të ujit, të cilat janë të qëndrueshme ndaj sëmundjeve dhe bëhen gati për t'u therur

brenda një kohe më të shkurtër. Pulat e detit, të cilat japin prodhim të lartë mishi, të përhapen më tepër sidomos në kooperativat bujqësore që ndodhen në zonën bregdetare. T'i jepet rëndësi krijimit të fermave të vogla pranë ndërmarrjeve bujqësore shtetërore dhe kooperativave bujqësore për rritjen dhe zhvillimin e lepujve të butë dhe të shpendëve. Në fund të vitit 1965 të arrihet që në pjesën më të madhe të kooperativave të ketë ferma të tilla. Të merren masa të veçanta për të luftuar sëmundjet e shpendëve dhe të tregohet kujdes për strehimin e mirë të tyre.

Prodhimi i vezëve në vitin 1965 të arrijë në 81 për qind më shumë se në vitin 1960. Prodhimi i mjaltit në vitin 1965 të jetë 148 për qind më shumë se në vitin 1960.

Të bëhet një punë më e mirë për përhapjen e njohurive për rritjen e bletëve, të luftohen sëmundjet dhe të sigurohen përgjithësisht zgjoje moderne.

Kooperativat bujqësore, organizatat e Partisë, të rinisë dhe të gruas të kujdesen më shumë për rritjen e krimbit të mëndafshit. Të shtohet në shkallë të gjerë mbjellja e manave, sidomos në Shkodër, Krujë, Tiranë, Kavajë, Elbasan, Lushnjë etj., me qëllim që të sigurohet baza e nevojshme për një shtim të shpejtë të krimbit të mëndafshit.

12) Në sektorin shtetëror të bujqësisë të merren masat për përmirësimin e drejtimit dhe forcimin e tij nga ana organizative dhe ekonomike, që të luajë si duhet rolin e tij pararojë në prodhimin bujqësor, të sigurojë rritjen e vazhdueshme të rendimenteve të bimëve bujqësore dhe të blegtorisë. Të rritet rentabiliteti i tij, duke zbatuar një agroteknikë të përparuar, të luftohet për uljen e koston dhe shtimin e prodhimeve për çdo 100 ha tokë.

Në vitin 1965 sektori shtetëror i bujqësisë të japë jo më pak se 12 për qind të prodhimit të përgjithshëm bujqësor të vendit dhe t'i dorëzojë shtetit më shumë se në vitin 1960: drithëra buke 210 për qind, pambuk 179 për qind, panxhar sheqeri 140 për qind, perime 70 për qind, patate 134 për qind, ullinj 125 për qind, qumësht 137 për qind, mish 122 për qind etj.

13) Të zgjerohet në një shkallë më të lartë mekanizimi i punimeve bujqësore, me qëllim që punimet kryesore të mbjelljeve të kryhen në një kohë sa më të shkurtër dhe në kushte më të mira.

Volumi i punimeve që do të kryhen me mjete të mekanizuara nga SMT-të dhe ndërmarrjet bujqësore shtetërore në vitin 1965 të jetë 93 për qind më shumë se në vitin 1960. Për këtë parku i traktorëve (të kthyer në 15 kuaj fuqi) të rritet 118 për qind më shumë se në vitin 1960. Gjithashtu të shtohet edhe numri i kombajnave, maqinave dhe agregatëve të tjerë bujqësorë në përshtatje me numrin e përgjithshëm të traktorëve.

Të përmirësohet rrënjësisht cilësia e punës së mekanikës bujqësore, duke zbatuar rregullat agroteknike në sistemin e punimit të tokës dhe të shërbimeve kulturale. Në zonat fushore të zbatohen metodat më të përparuara që kanë dhënë përfundime të mira në mbjelljen e grurit, të misrit, të pambukut, të pataveve etj.

Të forcohen në mënyrë të gjithanshme stacionet e maqinave dhe të traktorëve, sidomos nga ana e organizimit dhe e drejtimit, të shfrytëzohen drejt dhe plotësisht aftësitë e maqinave bujqësore, duke ngritur aftësitë tekniko-profesionale të kuadrove. Të përhapet gjerësisht eksperiencia shumë e dobishme e traktoristëve të përparuar për rritjen e rendimentit të punës, për zgjatjen e jetës së traktorëve dhe të maqinave të tjera bujqësore dhe për kursimin e karburanteve.

Të organizohet shfrytëzimi i traktorëve gjatë gjithë vitit, duke punuar edhe në dimër, sidomos për hapjen e tokave të reja.

14) Në vitin 1965, në krahasim me vitin 1960, grumbullimi i përgjithshëm i prodhimeve bujqësore dhe blegtorale të rritet si vijon: drithërat e bukës 156 për qind, orizi çeltik 139 për qind, patatet 145 për qind, perimet 72 për qind, mishi 75 për qind dhe qumështi 96 për qind. T'i kushtohet kujdes blerjes së valanidhit, shqemës, kamomilit etj., që kanë rëndësi të madhe për industrinë dhe eksportin.

15) Të sigurohet shfrytëzimi me kursim dhe me vend i lëndës së drurit dhe i asaj për djegje.

Gjatë pesëvjeçarit të pyllëzohen jo më pak se 20 mijë ha, nga të cilët 50 për qind me punën e vetë fshatarësisë. Rëndësi e veçantë t'i jepet përmirësimit të pyjeve në shkallë të gjerë. Të bëhet një punë e madhe edukative nga ana e organizatave të Partisë dhe e atyre të masave për të bindur çdo nënshtetas që të mbjellë sa më shumë drunj dhe pemë. Të merren masa të plota për të vendosur një disiplinë të fortë shtetërore në ruajtjen dhe shfrytëzimin e pyjeve.

Për ngritjen e rendimentit të pyjeve të bëhen punime përmirësimi dhe të kryhen prerje kulturale në një sipërfaqe prej jo më pak se 40 mijë ha, nga të cilët 15 mijë ha me forcat e vetë fshatarësisë.

Për të pakësuar grryerjen e tokave, gjatë pesëvjeçarit të tretë të ndërtohen jo më pak se 200 mijë m³ prita dhe vepra të tjera përforcimi, nga të cilat 100 mijë m³ nga vetë fshatarësia.

Të merren masa për të mbrojtur pyjet nga kullotja e çrregullt. Për të ripërtëritur pyjet e dëmtuara, çdo vit të ndalohet kullotja në jo më pak se 30 mijë ha pyje të dëmtuara, deri sa këto të rimëkëmben.

III. — ZHVILLIMI I TRANSPORTIT DHE I NDËRLIDHJES

1) Volumi i përgjithshëm i transportit automobilistik të mallrave në vitin 1965 të arrijë në 474 milion ton/km. ose në 44 për qind më shumë se në vitin 1960, nga i cili Ministria e Komunikacionit 294 milion ton/km, ose 41 për qind më shumë se në vitin 1960. Volumi i transportit të udhëtarëve në vitin 1965 të rritet 28 për qind më shumë se në vitin 1960.

2) Detyrat kryesore për transportin automobilistik të jenë zgjatja e jetës së automjeteve me anë të mirëmbajtjes dhe të riparimeve me cilësi të lartë, shkurtimi i kohës së riparimeve dhe zgjerimi i përdorimit të rimorkiove.

3) Të mekanizohet edhe më tej ngarkim-shkarkimi i transportit automobilistik, sidomos në vendet ku ka ngarkesa të rënda, të shumta dhe të vazhdueshme, siç janë lënda e drurit, lënda dje-gëse, mineralet, prodhimet bujqësore, si panxhar sheqeri, pambuku, duhani etj. Institucionet qendrore, dhe kryesisht Ministria e Industrisë dhe Ministria e Minierave dhe e Gjeologjisë, të marrin masa të posaçme për organizimin e vendeve dhe të pikave të ngarkim shkarkimit dhe për mekanizimin e tij. Në të gjitha vendet e ngarkim-shkarkimit, ku ka lëvizje mallrash të vazhdueshme dhe me shumicë, të sigurohen kushte pune për transportin edhe gjatë natës.

4) Për zgjerimin e rrjetit të rrugëve automobilistike dhe për përmirësimin e tij, gjatë pesëvjeçarit të tretë të hapen rreth 400 km. rrugë pyjore, të rregullohen dhe të asfaltohen rreth 300 km. rrugë dhe të organizohet më mirë mirëmbajtja e të gjithë rrjetit rrugor. Gjithashtu komitetet ekzekutive të rretheve dhe institucionet e ndryshme të marrin masa për rregullimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve me karakter lokal dhe atyre në fermat, stabilimentet dhe qendrat e punës.

5) Ministria dhe institucionet qendrore të marrin të gjitha masat për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin më të mirë të automjeteve, duke ngritur gatishmërinë teknike në masë të tillë që të rrisin koeficientin e përdorimit të automjeteve në vitin 1965 si vijon: për Ministrinë e Komunikacionit 65 për qind, dhe të Ndërtimit, të Minierave dhe të Gjeologjisë, të Industrisë, të Bujqësisë, të Tregëtisë dhe për organet e grumbullimit 65 për qind.

6) Të përkrahen iniciativat e mira të shoferëve të pararojës dhe të ushtrohet kontroll i vazhdueshëm në vendosjen e një regjimi të fortë kursimi në përdorimin e karburanteve, të gomave dhe të pjesëve të këmbimit në të gjithë transportin automobilistik të republikës.

7) Volumi i përgjithshëm i transportit detar në vitin 1965 të jetë 124 për qind më shumë se në vitin 1960, nga i cili transpor-

ti detar i brendshëm 42 për qind dhe transporti detar i jashtëm 130 për qind më shumë.

Koeficienti i përdorimit të mjeteve të transportit detar të brendshëm të rritet në vitin 1965, kundrejt vitit 1960, jo më pak se 89 për qind dhe i mjeteve të transportit detar të jashtëm 31 për qind.

Të merren masa për organizimin e mirë të punës së ngarkim-shkarkimit të mjeteve dhe të arrihet shkurtimi sa më shumë i qëndrimit të mjeteve në portet.

Transportit detar të jashtëm t'i shtohen edhe dy vapore të rinj me nga 5 mijë ton secili, duke arritur kështu tonazhi i përgjithshëm në fund të pesëvjeçarit 18.500 ton.

8) Të merren masa të posaçme për fuqizimin e kantierit detar, me qëllim që ky të përballojë dhe të përmirësojë cilësinë e riparimeve të mjeteve të transportit dhe të peshkimit. Të luftohet më shumë për shkurtimin e kohës së riparimit të mjeteve.

9) Brenda vitit 1963 të përfundojë rindërtimi dhe zgjerimi i pjesës së parë të portit të Durrësit, duke e pajisur atë me mekanizma të rënda për ngarkim-shkarkim dhe duke e sistemuar në mënyrë që koha e ngarkim-shkarkimeve të vaporeve dhe të mjeteve të tjera detare të shkurtohet sa më shumë, si dhe të përpuhohet në të njëjtën kohë 16 vapore dhe mjete të tjera detare.

10) Volumi i përgjithshëm i transportit hekurudhor të arrijë 111,8 milion ton/km, në vitin 1965, ose 105 për qind më shumë se në vitin 1960. Gjithashtu të rritet transporti hekurudhor i udhëtarëve 7 për qind më shumë. Për këtë në vitin 1963 të vihen në shfrytëzim hekurudha Vorë-Milot, të shtohet parku i vagonave të mallrave, të udhëtarëve dhe të lokomotivave, të përmirësohet përdorimi i trenave dhe të shkurtohet koha e qarkullimit të vagonave. Të rritet gatishmëria teknike dhe koeficienti i përdorimit për vagonët e udhëtarëve në jo më pak se 24 për qind dhe për vagonat e mallrave xhiro-vagoni të ulet jo më pak se 26 për qind.

Të organizohet transporti i shpejtë dhe me cilësi të mirë i mallrave, të mos lejohen grumbullime të shumta nëpër fushat dhe magazinat e stacioneve. Të vendoset një disiplinë e shëndoshë në zbatimin e rregullave teknike të qarkullimit. Të sigurohen mjetet dhe pajisjet e nevojshme për sinjalizimin dhe qarkullimin. Të vendoset një disiplinë dhe rregull i fortë në shërbimin e trenave të udhëtarëve, të mbahet pastërti në vagonat dhe të plotësohen sa më mirë kërkesat e popullit. Të merren të gjitha masat e duhura për të plotësuar hekurudhën me kuadro të aftë për shfrytëzimin më të mirë të trenave.

11) Të sigurohet zhvillimi i mëtejshëm i mjeteve të ndërlydhjes. Të përfundojë ndërtimi i radiostacionit të ri në Shijak dhe shtëpia e radios në Tiranë. Të zgjerohet rrjeti telefonik urban me

73 km. kablllo dhe rrjeti interurban duke ndërtuar 1500 km. linjë telefonike. Të përmirësohet rrënjësisht shërbimi postar telegrafik e telefonik, duke e pajisur këtë me mjete moderne.

IV. — RITJA E INVESTIMEVE DHE E NDËRTIMEVE.

1) Për plotësimin e detyrave të caktuara për zhvillimin e prodhimeve industriale e bujqësore, për zhvillimin e transportit, për shtimin e sipërfaqes së banesave, për arësimin, kulturën dhe shëndetësinë të ndërtohen mbi 400 vepra të ndryshme. Për këtë volumi i përgjithshëm i investimeve në pesëvjeçarin e tretë të jetë 69,5 miliard lekë, ose 51 për qind më shumë se në pesëvjeçarin e dytë, nga i cili për ndërtimet 35,7 miliard lekë (me çmimet e vitit 1961), ose 60 për qind më shumë se në pesëvjeçarin e dytë. Nga volumi i përgjithshëm i investimeve 81,9 për qind të jenë për degët prodhuese dhe 18,1 për qind për ato joprodhuese. Ndërtimet 72,1 për qind të kryhen për degët prodhuese dhe 27,9 për qind për ato joprodhuese. Nga volumi i përgjithshëm i ndërtimeve të kryhen për industrinë 39,4 për qind, për bujqësinë 11,3 për qind, për komunikacionin 15,5 për qind, për sektorët socialo-kulturalë 26,1 për qind (për arësimin, kulturën, shëndetësinë etj.).

2) T'u kushtohet kujdes i posaçëm studimeve të nevojshme paraprake tekniko-shkencore të veprave që do të ndërtohen, me qëllim që të përcaktohet drejt domosdoshmëria dhe leverdia e investimeve.

Ngritja e nivelit të studimeve të projektimit përbën një nga detyrat kyçe në lëmin e ndërtimeve. Studimet në lëmin e ndërtimeve dhe të materialeve të ndërtimit të drejtohen kryesisht në tipizimin e projekteve, në parafabrikimin e pjesëve prej beton-armeje të zakonshme dhe të paratensionuar, në kërkimin e materialeve të ndërtimit, sidomos të gurit, argjileve, rërave me përmbajtje kuarci për prodhimin e tullave silikat etj., si dhe në mekanizimin e punimeve të ndërtimit.

Të përmirësohet më tej puna e projektimit dhe të synohet që të sigurohen me kohë veprat me projekte dhe preventiva me cilësi të larta. Të kalohet më me guxim në tipizimin e projekteve, si dhe në përdorimin e tyre me kriter, në përshtatje me arkitekturën, urbanistikën dhe me kushtet topografike dhe klimaterike të vendit. Të zgjerohet tipizimi, sidomos në projektimin e ndërtesave të banimit, ato kulturalo-shoqërore e bujqësore, duke rritur projektet tip, në përgjithësi, nga 25 për qind që janë sot në 50 për qind brenda vitit 1965.

3) Shkurtimi i afateve të ndërtimit dhe të bonifikimit, vënja me kohë në shfrytëzim e veprave, përmirësimi i vazhdueshëm i

cilësisë së punimeve dhe ulja e kostos të jenë për organizatat e Partisë, për organet ekonomike shtetërore, për ndërmarrjet dhe kantieret e ndërtimit, për personelin inxhiniero-teknik dhe për gjithë punonjësit e ndërtimit detyrat më të rëndësishme të pesëvjeçarit të tretë.

Të përmirësohet në mënyrë rrënjësore organizimi i punimeve të ndërtimit, të synohet që ritmi i punimeve të jetë pak a shumë i barabartë në të gjitha stinat, të ngrihet rendimenti i punës, të zbulohen dhe të vihen në shfrytëzim burimet e brendshme të ndërmarrjeve dhe të kantierëve të ndërtimit, të tregohet më shumë kujdes për sigurimin teknik në punë, të përhapen eksperienca e përparuar, të rehat e shkencës dhe të teknikës së ndërtimit.

Të tërhiqen dhe të ngarkohen më shumë kuadro inxhiniero-teknikë të ndërtimit për një punë shkencore më të gjerë në fushën e ndërtimit, në mënyrë që të përhapen zbulime shkencore më të reja në praktikën e ndërtimeve dhe në industrinë e materialeve të ndërtimit. Kuadrot e Universitetit shtetëror të Tiranës, bashkëpunëtorët shkencorë, inxhinierët, teknikët dhe specialistët e tjerë të zgjerojnë bashkëpunimin e tyre në këtë fushë dhe të mbajnë parasysh që të lidhin teorinë dhe teknikën shkencore me problemet kryesore praktike të ndërtimeve në vendin tonë.

V. — MBI RRITJEN E RENDIMENTIT TË PUNËS, ULJEN E KOSTOS DHE PËRMIRËSIMIN E CILËSISË

1) Organizatat e Partisë, organet shtetërore e të ekonomisë dhe organizatat e masave ngritjen e vazhdueshme të rendimentit të punës në të gjitha degët e ekonomisë ta quajnë faktorin vendimtar për të plotësuar detyrat për shtimin e prodhimit, për uljen e kostos dhe për përmirësimin e mëtejshëm të kushteve materiale të punonjësve.

Rritja e rendimentit të punës gjatë pesëvjeçarit të tretë të caktohet si vijon:

a) në prodhimin industrial 27 për qind, nga i cili në minierat 25 për qind, në industri 34 për qind, në artizanat 25 për qind.

b) në transportin automobilistik 15 për qind, në transportin hekurudhor 44 për qind dhe në transportin detar 75 për qind.

c) për ndërtim-montime që kryhen nga NSHN-të 29 për qind.

Plotësimi i këtyre detyrave të sigurohet me anën e përvetësimit të teknikës, ngritjes së aftësisë tekniko-profesionale të punëtorëve, mekanizimit të mëtejshëm të proceseve të prodhimit dhe të punës, organizimit më të përsosur të prodhimit, mobilizimit më të madh të burimeve të brendshme nëpërmjet shfrytëzimit më të mirë të kohës së punës.

2) Të përmirësohet rrënjësisht puna me norma. Të kalohet në zëvendësimin e normave eksperimentalo-statistikore me norma teknike, duke synuar që në fund të pesëvjeçarit normat teknike të vendosen në një masë të ndjeshme në të gjitha degët e prodhimit dhe të ndërtimit.

3) Të zbatohen me kujdes masat e parashikuara për përmirësimin e sistemit të pagave në përgjithësi dhe të shpërblimeve nxitëse në veçanti. Të mbahet mirë parasysh zbatimi i përpiktë i parimit socialist të shpërblimit të punës sipas sasisë dhe cilësisë, për ta bërë sistemin e pagave një mjet edhe më të fortë nxitës për rritjen e prodhimit dhe të rendimentit të punës, për ngritjen e aftësive teknike, për kursimin e materialeve dhe për përdorimin më mirë të teknikës. Të vendoset një disiplinë më e fortë në përdorimin me nikoqirllëk të fondit të pagave, duke forcuar kontrollin në përgjithësi, dhe sidomos kontrollin bankar.

4) Ulja e kostos së prodhimit dhe pakësimi i shpenzimeve të qarkullimit të mallrave të jetë një nga treguesit kryesorë të vlerësimit të punës së ndërmarrjeve dhe të organizatave ekonomike. Të gjithë komunistët dhe punonjësit pa parti ta kenë të qartë se ulja e vazhdueshme e kostos dhe pakësimi i shpenzimeve janë burimi i rritjes së akumulimeve shtetërore për zgjerimin e prodhimit e uljen e çmimeve dhe, si rrjedhim, për ngritjen e mirëqenjes materiale dhe kulturele të popullit.

Në fund të pesëvjeçarit të tretë, në krahasim me vitin 1960, të ulet kostoja: në Ministrinë e Minierave dhe të Gjeologjisë 13 për qind, në Ministrinë e Industrisë 15 për qind, në industrinë lokale 11,4 për qind, në kooperativat e artizanatit 18 për qind, në kooperativat e konsumit 7,2 për qind dhe në Komitetin Shtetëror të Grumbullimit 10 për qind; kostua e shërbimit të transportit të ulet mesatarisht 24 për qind, kostua e punimeve të ndërtim-montimit 10 për qind; stacionet e maqinave dhe të traktorëve të ulin koston e punimeve për një hektar unitet hamullor 16,5 për qind, ndërmarrjet bujqësore shtetërore të ulin koston e prodhimeve mesatarisht 26,5 për qind.

Shpenzimet e qarkullimit dhe të grumbullimit të ulen: në tregëtinë shtetërore 12,2 për qind, në tregëtinë e furnizimit të punëtorëve 15 për qind, në kooperativat e konsumit 14,7 për qind, në ndërmarrjet e Komitetit Shtetëror të Grumbullimeve 16 për qind.

5) Për plotësimin e këtyre detyrave të përmirësohet vazhdimisht puna për shfrytëzimin e burimeve të brendshme, që janë të shumta në ekonominë popullore, për pakësimin e normativave të harxhimit të materialeve, të lëndëve të para, të lëndëve djegëse, për përdorimin e plotë të aftësive prodhuese, për pakësimin e humbjeve gjatë transportit, për pakësimin e humbjeve dhe të

mbeturinave gjatë procesit teknologjik të prodhimit dhe për mënjanimin e shpenzimeve të tepërta joproduese.

Normativat e harxhimit të disa materialeve kryesore në vitin 1965, kundrejt vitit 1960, të pakësohen:

a) në prodhim: për hekur profil 5-8 për qind, për qymyrin koks (në prodhimet e industrisë) 27 për qind, për gizën 6 për qind, për lëkurët e trasha të papunuara 2-5 për qind, për shollën prej lëkure 5-6 për qind, për soletën 6 për qind, për letrën e sheshme të shtypit 4-5 për qind etj.

b) Në ndërtim: për hekur-betonin 4-5 për qind, për çimenton 5 për qind, për tullat 4-5 për qind, për lëndën e drurit të sharruar 20 për qind, etj.

Brenda vitit 1962 të studjohen dhe të përcaktohen normativat e konsumit të energjisë elektrike.

Në ndërtim të përdoren gjerësisht materialet e vendit dhe ato që gjenden më afër veprës që ndërtohet, siç janë guri, qerpiçi, kallami, thuprat etj. Përdorimi i këtyre materialeve të nxitet dhe të përhapet sa më shumë në ndërtimet e kooperativave bujqësore, të ndërmarrjeve bujqësore shtetërore dhe të SMT-ve.

6) Përmirësimi i cilësisë së prodhimit, të ndërtimit dhe të shërbimit në të gjitha degët e ekonomisë popullore të mbahet vazhdimisht parasysh nga të gjitha organizatat e Partisë, organet ekonomike shtetërore dhe kolektivat punonjëse. Të luftohet kundër shfaqjeve të dëmshme, siç janë rendja pas sasisë në dëm të cilësisë, plotësimi i planit si volum i përgjithshëm pa ju përmbajtur nomenklaturës së prodhimit.

Kujdes i posaçëm të tregohet për shtimin dhe zgjerimin e llojeve të reja të prodhimit, për të plotësuar më mirë nevojat dhe kërkesat e popullit.

Përmirësimi i mëtejshëm i cilësisë së punimeve të ndërtimit të jetë detyra kryesore e ndërtuesve dhe e punonjësve të industrisë së materialeve të ndërtimit. Të forcohet kontrolli për të mos lejuar punime të pa përfunduara në veprat që vihen në shfrytëzim. Të bëhet një punë e gjerë nga inxhinierët, teknikët, mjeshtrit dhe punëtorët më të mirë për njohjen e kushteve dhe të rregullave teknike dhe të standardeve.

7) Në pesëvjeçarin e tretë të ngrihet në një shkallë më të lartë drejtimi i ekonomisë, zhvillimi i mëtejshëm i emulacionit socialist, përvetësimi i teknikës së re, niveli profesional i kuadrove, përhapja e organizuar e eksperiencës së përparuar të punonjësve tanë e të vendeve të kampit socialist.

Të përkrahen fuqimisht dhe të nxitin me të gjitha mënyrat iniciativat e përparuara të punonjësve të pararojës siç janë metoda «1 + 2» për aftësimin e punëtorëve, lëvizja për plotësimin e normave nga çdo punëtor, për kursimin e materialeve, për të vënë në radhën e të përparuarve punonjësit e prapambetur, për për-

hapjen e brigadave të përziera të novatorëve, për kursimin e karburanteve dhe për rritjen e shfrytëzimit të maqinerisë etj.

Organizatat e Partisë, Bashkimet Profesionale, organizatat e rinisë dhe drejtuesit e ndërmarrjeve të tregojnë një kujdes të vazhdueshëm për edukimin e punonjësve, për ngritjen e ndërgjegjes së tyre, për zgjerimin e lëvizjes së brigadave që luftojnë për të merituar titullin «Brigadë e punës socialiste» me parullën «Të punojmë, të mësojmë dhe të jetojmë në mënyrë socialiste».

8) Organizatat e Partisë, të masave, organet shtetërore dhe ekonomike t'i kushtojnë kujdes të veçantë administrimit dhe ruajtjes së pronës shoqërore. Përveç punës së madhe edukative për të rritur ndërgjegjen e masave punonjëse, duhet të merren të gjitha masat organizativo-administrative për të vendosur disiplinë të shëndoshë në zbatimin e rregullave shtetërore për të mos i lënë shteg shpërdorimit të pasurisë së popullit.

VI. — NGRITJA E MIRËQENJES MATERIALE TË MASAVE PUNONJËSE

1) Qëllimi më i lartë i Partisë së Punës të Shqipërisë është rritja e vazhdueshme e mirëqenjes materiale të masave punonjëse, në bazë të zhvillimit të prodhimit dhe të rritjes së rendimentit të punës. Duke u nisur nga kjo, të ardhurat kombëtare në vitin 1965 të rriten 56 për qind në krahasim me vitin 1960.

2) Si rrjedhim i zgjerimit të prodhimit industrial, bujqësor, të ndërtimeve, të transportit, të tregëtisë etj., numri i punëtorëve dhe nëpunësve në vitin 1965 të jetë 26 për qind më shumë se në vitin 1960 dhe të arrijë në rreth 257.000 vetë.

3) Paga reale e punëtorëve dhe e nëpunësve gjatë pesëvjeçarit të tretë të rritet 30 për qind, nëpërmjet uljes së çmimeve dhe rritjes së pagës minimale.

Të ardhurat reale të fshatarësisë të rriten 35 për qind, në radhë të parë duke shtuar prodhimin bujqësor dhe blegtoral dhe përmes uljes së çmimeve me pakicë.

4) Në pesëvjeçarin e tretë shpenzimet shtetërore për sigurimet shoqërore të punëtorëve dhe nëpunësve — për pensionet, për shërbimin mjekësor, për ndihmën e nënave me shumë fëmijë, për kopshte dhe çerdhe, për kujdesin social, — për arësim-kulturën dhe për nevojat e tjera socialo-kulturale të rriten rreth 65 për qind më shumë se në pesëvjeçarin e dytë.

Numri i punonjësve që do të kalojnë pushimet në kampet e pushimit të jetë rreth 37 mijë dhe ai i pionierëve rreth 21 mijë vetë më shumë se në pesëvjeçarin e dytë.

Me qëllim që të përmirësohen kushtet e jetesës e të punës për punëtorët e nëntokës, brenda pesëvjeçarit të tretë të kalohet

në shkurtimin e ditës së punës nga 8 në 7 orë pa prekur pagën e tyre.

5) Qarkullimi i mallrave përmes tregëtisë socialiste në fund të pesëvjeçarit të tretë të jetë jo më pak se 38 për qind më shumë se në vitin 1960, me çmimet përkatëse të çdo viti.

Furnizimi i popullsisë me mallra industriale dhe ushqimore nëpërmjet rrjetit të tregëtisë socialiste në vitin 1965 të jetë më shumë se në vitin 1960 si vijon: bukë 18 për qind, miell 6 për qind, yndyrna 68 për qind, mish 83 për qind, peshk 124 për qind, patate 122 për qind, perime 40 për qind, qumësht 113 për qind, sheqer 126 për qind, oriz 118 për qind, sapun 44 për qind, pëlhura të pambukta 61 për qind, pëlhura të leshta 53 për qind, këpucë të ndryshme 113 për qind, çimento 117 për qind, lëndë druri e sharruar 73 për qind, tulla 163 për qind etj.

Organet e tregëtisë shtetërore dhe kooperativiste të përmirësojnë në mënyrë të dukshme shërbimin ndaj popullit në qytete, fshatra dhe në qendra pune, duke studjuar dhe duke ju përgjigjur sa më mirë kërkesave të masave punonjëse për lloje dhe cilësi mallrash, të përmirësojnë rrënjësisht reklamën dhe kulturën tregëtare.

Të zgjerohet rrjeti i mensave të ushqimit social nëpër qendrat e punës, të shtohen llojet e gjellëve me çmime të ulëta. Të çelen më shumë mensa dhe të shtohet shitja e ushqimeve të gatshme ose gjysmë të gatshme. Të vihen në shitje më shumë artikuj që lehtësojnë punën e gruas në shtëpi.

6) Volumi i eksportit në vitin 1965 të jetë 50-55 për qind më shumë se në vitin 1960. Të shtohen artikujt e rinj për eksport, të zgjerohet në një masë të ndjeshme eksporti i zarzavateve dhe i frutave të freskëta. Të rritet kujdesi i organeve prodhuese dhe të tregëtisë për të bërë kthesë rrënjësore në përmirësimin e cilësisë së mallrave të eksportit, si dhe të ambalazhimit të tyre. Organet e tregëtisë së jashtme të shtojnë përpjekjet për të siguruar tregje për mallrat e eksportit. Organet prodhuese dhe të tregëtisë së jashtme t'i kushtojnë kujdes të posaçëm shtimit të artikujve të rinj, industrialë dhe bujqësorë për eksport.

Importi të plotësojë në radhë të parë nevojat për maqineritë, pajisjet dhe lëndën e parë për ekonominë dhe për mallrat kryesore të konsumit të gjerë të popullsisë. Të vendoset një disiplinë e rreptë në importimin e mallrave, duke bërë përpjekje të vazhdueshme, me pjesëmarrjen e gjerë të punonjësve, për shkurtimin e mallrave të importit që mund të zëvendësohen me prodhime të vendit dhe duke shfrytëzuar më mirë maqineritë që ndodhen në vend. Kërkesat për materiale dhe maqineri të reja nga importi t'i nënështrohen një kontrolli të imtë mbi domosdoshmërinë e tyre.

Të gjitha organet shtetërore, organizatat ekonomike dhe ve-

çanërisht Komisioni i Planit dhe Ministria e Tregëtisë të marrin masa për të mos lejuar importimin e mallrave që nuk janë të domosdoshëm.

7) Gjatë pesëvjeçarit të tretë të sigurohet një përmirësim i gjithanshëm i shërbimit komunal, me qëllim që të përmirësohet strehimi i popullsisë së qyteteve dhe të qendrave të punës; të ndërtohen gjatë pesëvjeçarit të tretë rreth 1 milion e 360 mijë metra katrore banesa ose 75 për qind më shumë se në pesëvjeçarin e dytë.

Për zhvillimin dhe përmirësimin e kushteve të jetesës në fshat të vazhdojë gjatë pesëvjeçarit elektrifikimi me hapa më të shpejta me anën e ndërtimit të linjave elektrike përkatëse, për t'i lidhur me sistemin, ose duke ndërtuar hidrocentrale të vogla.

Drejtoria e ekonomisë komunale, Ministria e Industrisë dhe Komisioni i Planit të Shtetit gjatë pesëvjeçarit të tretë të studjojnë mundësinë e përdorimit të gazit të lëngshëm për nevojat komunale. Për këtë Ministria e Industrisë dhe Drejtoria e ekonomisë komunale të projektojnë dhe të fillojnë prodhimin e stufave të përshtatshme që do të përdoren me gaz të lëngët, si dhe të stufave për t'u përdorur me qymyrguri të briketuar.

Të tregohet një kujdes i gjithanshëm për mirëmbajtjen e banesave shtetërore dhe ruajtjen e tyre nga dëmtimet. Të bëhet një punë e madhe nga të gjitha organizatat e Partisë dhe organizatat e masave për mbajtjen e pastërtisë dhe për zbukurimin e qyteteve dhe të qendrave të banimit, për ndërtimin e parqeve dhe të lulishteve të reja dhe për mirëmbajtjen e atyre që janë, duke shtuar në këtë punë pjesëmarrjen e gjerë vullnetare të punonjësve. Të tregohet kujdes për mirëmbajtjen e rrugëve, të trotuarëve dhe të kanaleve të ujërave të zeza dhe të bardha. Gjatë pesëvjeçarit të tretë të parashikohen investime për kanalizimin e pjesshëm të qyteteve, për ndërtimin e ujësjellësve të rinj ose për zgjerimin e rrjetit të sotëm, për ndërtimin dhe zgjerimin e banjave dhe të lavanderive, për mirëmbajtjen, zgjerimin dhe sistemin e plazhave.

Gjatë pesëvjeçarit të tretë të ndërtohen ujësjellësit e Shkodrës, të Lezhës, Shëngjinit, Peshkopisë, Elbasanit, Peqinit, Kavajës, Gjirokastrës, Tepelenës, Përmetit etj. si dhe të përfundojë zgjerimi i ujësjellësit të Tiranës.

8) Të tregohet kujdes i vazhdueshëm për ruajtjen e shëndetit të popullit, duke përmirësuar në mënyrë rrënjësore pastërtinë, profilaksinë dhe propagandën shëndetësore në masat e gjera të popullit.

Të përmirësohet shërbimi mjekësor për popullsinë në spitalet, poliklinikat, maternitetet etj. T'i jepet ndihmë mjekësore më e madhe fshatit. Të tregohet kujdes i veçantë për ruajtjen e shëndetit të nënës dhe të fëmijës.

Gjatë pesëvjeçarit të tretë të zgjerohet rrjeti i institucioneve shëndetësore, duke ndërtuar 20 spitale, 5 maternitete dhe 9 qendra shëndetësore, si dhe duke zgjeruar institucionet shëndetësore të sotme. Në vitin 1965, kundrejt vitit 1960, numri i shtretërve në institucionet e mjekimit të rritet 33 për qind.

Në spitale e klinika të krijohen repartet për shërbime të specialistëve të ndryshëm, të shtohen aparaturat e reja dhe të rritet numri i mjekëve. Më 1965 të ketë 1150 mjekë, d.m.th. një mjek për çdo 1.600 banorë kundrejt një për 3.400 banorë që kemi sot.

Në çerdhet e fëmijëve numri i vendeve më 1965 të jetë 44 për qind më shumë se në vitin 1960.

Fizkultura dhe sportet të përfshijnë gjithmonë e më shumë masat më të gjera punonjëse dhe të rritet mjeshtëria sportive.

VII. — MBI ARËSIMIN, KUADRIN, PUNËN SHKENCORE DHE KULTURËN

1) Të vazhdojë zhvillimi i mëtejshëm i revolucionit kultural në vendin tonë. Të zgjerohet numri i shkollave, të përmirësohet dhe të ngrihet në një nivel më të lartë përmbajtja dhe metoda e punës në to.

Numri i nxënësve dhe i studentëve në të gjitha kategoritë e shkollave të ditës, të natës e me korrespondencë të rritet gjatë pesëvjeçarit të tretë rreth 31 për qind dhe të arrijë në vitin 1965 mbi 410.000, kundrejt 313.000 që është sot.

Të zgjerohet rrjeti i shkollave në mënyrë që në vitin 1965 në arësimin 7 ose 8-vjeçar të detyruar të përfshihen mbi 80 për qind e nxënësve që do të mbarojnë shkollën fillore. Numri i nxënësve në shkollat 7 ose 8-vjeçare të rritet rreth 60 për qind, duke arritur nga 63.300 që është sot në 101.300 në vitin 1965.

Të shtohet numri i shkollave të mesme dhe numri i nxënësve në këto shkolla gati të dyfishohet.

Numri i studentëve në shkollat e larta (pa përfshirë ata të natës e me korrespondencë) nga 4.300 të rritet në 7.000.

Gjatë pesëvjeçarit të tretë të merren masa për riorganizimin e arësimit popullor, për lidhjen e ngushtë të teorisë me praktikën, të shkollës me jetën, mbi bazën e parimit themelor të bashkimit të të mësuarit me punën prodhuese. Shkolla të sigurojë më mirë edukimin dhe përgatitjen e brezit të ri, të pajisë atë me njohuri të shëndosha teknike e shkencore, me edukatën e punës dhe me aftësi praktike për të marrë gjallërisht pjesë në ndërtimin e socializmit.

Të forcohet arësimi për të rriturit pa shpëputje nga puna dhe të çmohet si burim i rëndësishëm për ngritjen kulture e

profesionale të masave punonjëse dhe për përgatitjen e kuadrit.

Detyrë e dorës së parë të jetë ngritja e cilësisë së punës mësimore-edukative në të gjitha kategoritë e shkollave.

Të merren të gjitha masat për sigurimin dhe përgatitjen e kuadrit të ri dhe për ngritjen e aftësisë së kuadrove të sotme, në mënyrë që shkolla të kryejë plotësisht detyrat gjithnjë e më të mëdha që i shtohen.

T'i kushtohet vëmendja e duhur bazës materiale-mësimore të shkollave me anë të ngritjes dhe të pajimit të tyre me laboratorët dhe mjetet më të domosdoshme të mësimi dhe duke siguruar të gjitha sendet shkollore të nevojshme për nxënësit. Ndërmarrjet industriale e bujqësore dhe kooperativat bujqësore të marrin përsipër plotësimin e gjithë bazës materiale-mësimore të shkollave.

2) Plotësimi i detyrave të mëdha që shtohen në planin e tretë pesëvjeçar kërkon që çështja e përgatitjes dhe e ngritjes së aftësive të kuadrit të mbahet vazhdimisht parasysh nga të gjitha organizatat e Partisë, Bashkimet Profesionale dhe organet shtetërore.

Të merren të gjitha masat që deri në fund të pesëvjeçarit çështja e plotësimi të kuadrit, sidomos për degët kryesore të ekonomisë, të vihet përfundimisht në rrugën e zgjidhjes.

Të shpejtohet ritmi i përgatitjes së specialistëve të lartë e të mesëm, me qëllim që të përmirësohet rrënjësisht përpjesëtimi midis tyre dhe punëtorëve në të gjitha degët e ekonomisë. Në vitin 1965 numri i kuadrove të lartë të arrijë në 9.700 vetë, ose 129 për qind më shumë se në vitin 1960, dhe numri i kuadrove me shkollë të mesme në 25.700 vetë, ose 117 për qind më shumë se në vitin 1960.

Organizata e Partisë dhe e rinisë dhe organet shtetërore të kujdesen vazhdimisht për plotësimin e numrit të nxënësve dhe të studentëve për çdo shkollë. Të luftohet me këmbëngulje për plotësimin e planit të arësimit në përgjithësi, të arësimit të natës dhe me korrespondencë.

Të riorganizohet sistemi i shkollave tekniko-profesionale për të përgatitur punëtorë të aftë për industrinë, bujqësinë dhe degët e tjera të ekonomisë popullore.

Në këto shkolla të përgatiten më shumë punëtorë në përgjithësi, e sidomos për mjeshtëritë më të rëndësishme, si për muratorë, karpentierë, tornitorë, mekanikë, etj. Të përgatiten punëtorë të kualifikuar me më shumë se dy mjeshtëri, si për murator — karpentier — suvaxhi, mekanik — kovaç — hekurthyes, traktorist — buldezerist etj.

Gjatë pesëvjeçarit të përgatiten mbi 57 mijë punëtorë të kualifikuar, nga të cilët 4.000 për minierat dhe gjeologjinë, mbi 13.000 për industrinë, mbi 9.000 për ndërtimin, mbi 13.000 për

bujqësinë, mbi 6.000 për artizanatin e kooperuar etj. Në të njëjtën kohë të ngrihen aftësitë e jo më pak se 115.000 punëtorëve specialistë, nga të cilët 13.500 për minierat dhe gjeologjinë, 23.000 për industrinë, 13.000 për ndërtimin, 12.000 për bujqësinë, 11.500 për artizanatin e kooperuar etj.

Të punohet me perspektivë nga çdo rreth për të plotësuar vetë nevojat e kuadrit dhe të punëtorëve të kualifikuar.

Të përmirësohet në mënyrë rrënjësore cilësia e punës në shkollat dhe në kurset e ndryshme të përgatitjes dhe të aftësimin të punëtorëve dhe të plotësohen ato me planet dhe programet mësimore të nevojshme.

Për forcimin organizativ dhe ekonomik të kooperativave bujqësore, gjatë pesëvjeçarit të tretë kuadrot që do të mbarojnë institutet dhe teknikumat bujqësore t'u jepen rretheve për t'u dërguar kryesisht në kooperativat bujqësore.

Për plotësimin e nevojave të kooperativave me kuadro të mesëm e të ulët, të merren masa për organizimin e kurseve të posaçme pranë NBSH-ve.

3) Të zgjerohet dhe të forcohet puna shkencore, sidomos në fushën e shkencave të natyrës, kryesisht me qëllim studimi e shfrytëzimi sa më të gjerë të burimeve natyrore të vendit, në fushën e shkencave teknike, veçanërisht për problemet e ndërtimit dhe të elektrifikimit, të shkencave ekonomike e shoqërore, duke zhvilluar më tej studimin e ekonomisë konkrete të vendit, studimin e historisë së Shqipërisë dhe të letërsisë shqipe.

Kujdes i posaçëm t'u kushtohet ruajtjes e mirëmbajtjes së monumenteve të kulturës dhe gërmimeve arkeologjike, sidomos në fushën e kulturës ilire dhe të kulturës së lashtë shqiptare.

Të zhvillohen më tej studimet në fushën e gjuhësisë, të drejtësisë, të bujqësisë dhe të mjekësisë.

Puna shkencore të lidhet ngushtë me prodhimin dhe praktikën e ndërtimit socialist të vendit, sidomos në fushën e minierave, të industrisë, të bujqësisë e të ndërtimit, dhe të bëhen përpjekje për t'i siguruar asaj baza studimesh dhe specialistë për detyrat që i shtrohen.

4) Të zgjerohet e të përmirësohet më tej puna kulturele në përgjithësi e veçanërisht në fshat, dhe kjo të shërbejë për edukimin komunist të punonjësve dhe mobilizimin e tyre për ndërtimin socialist të vendit. Të parashikohet zgjerimi dhe forcimi i mëtejshëm i institucioneve dhe i veprimtarisë kulturele.

Të rritet numri i shtëpive dhe i vatrave të kulturës, sidomos në kooperativat bujqësore, të zgjerohet rrjeti i bibliotekave, i muzeve dhe i shtëpive muze. Të ndërtohet në Tiranë pallati i madh i kulturës.⁵⁴

Të rritet numri i vendeve në kinematë 11 për qind kundrejt vitit 1960. Të rritet dhe të përmirësohet prodhimi i kinostudios për të dhënë më shumë filma kronikalë e dokumentarë, si dhe filma artistikë. Të rritet numri i shfaqjeve të filmave në fshat me anë të autokinemave dhe të mjeteve të tjera.

Të forcohet dhe të përmirësohet puna në Teatrin shtetëror të operas dhe të baletit, në estradat etj. dhe të ngrihet niveli artistik i shfaqjeve.

Vëmendje e madhe t'i kushtohet zhvillimit të mëtejshëm të lëvizjes artistike të amatorëve në qytet e në fshat, duke tërhequr në to sa më shumë njerëz, të ngrihet cilësia e saj dhe të sigurohen kuadrot drejtues për gjinitë e ndryshme artistike.

T'i kushtohet kujdes i veçantë mbledhjes dhe përpunimit të folklorit tonë të pasur.

* * *

Plani i tretë pesëvjeçar shënon një etapë të re të rëndësishme për ndërtimin e socializmit në vendin tonë.

Plotësimi me sukses i detyrave që caktohen në direktivat për planin e tretë pesëvjeçar dikton nevojën për përmirësimin e mëtejshëm të metodës së drejtimit të ekonomisë dhe të stilit në punë nga organizatat e Partisë, organet shtetërore dhe ekonomike. Të bëhen të gjitha përpjekjet për të ngritur nivelin e punës drejtuese në përshtatje me detyrat e kohës. Kjo kërkon që të luftohet me këmbëngulje për t'i dhënë fund metodës së drejtimit «në përgjithësi» të problemeve ekonomike dhe të kalohet në drejtimin e vazhdueshëm konkret të tyre, në mënyrë që të sigurohet plotësimi i detyrave të planit, jo vetëm në sasi, por, medoemos, edhe në treguesit cilësorë të tij. Drejtimi konkret i ekonomisë duhet të sigurojë përmirësimin rrënjësor të cilësisë, shtimin dhe zgjerimin e llojeve të prodhimit, uljen e kostos, rritjen e rendimentit të punës dhe në përgjithësi përdorimin me një regjim të fortë kursimi të vlerave materiale dhe monetare. Drejtimi konkret i ekonomisë kërkon mobilizimin e gjithë punonjësve, njohjen e tyre me detyrat e planit dhe një luftë të vazhdueshme për plotësimin e këtyre detyrave nga secili.

Shfrytëzimi sa më i mirë i të gjitha burimeve të brendshme që gjenden në gjirin e degëve të ndryshme të ekonomisë popullore, në mënyrë të veçantë përvetësimi i teknikës nga të gjithë punonjësit, të vlerësohen si kushte nga më të rëndësishmit për plotësimin e detyrave të planit.

Kongresi IV i Partisë së Punës të Shqipërisë shpreh bindjen se klasa heroike punëtore, fshatarësia punonjëse, inteligjencia

popullore, gjithë masat punonjëse të vendit, duke u njohur me detyrat e pesëvjeçarit të tretë dhe perspektivat e mëdha që i hapen vendit tonë në rrugën e zhvillimit të mëtejshëm të ekonomisë dhe të kulturës, nën udhëheqjen e Partisë, do t'i përvishen punës për të vënë në jetë këto direktiva, që janë një program madhështor për ndërtimin e socializmit në vendin tonë.

**Botohet sipas librit
Kongresi IV i PPSH
Tiranë, 1961**

SHËNIME

1. — Agresioni anglo-franko-izraelit kundër Egjiptit u krye më 29-30 tetor 1956. Ky akt përbënte një hallkë tjetër të sulmit të përgjithshëm të imperializmit kundër popujve dhe forcave lirishtetërore. (f. 11).

2. — Kundërrevolucioni në Hungari shpërtheu më 23 tetor dhe vazhdoi deri më 4 nëntor 1956. (f. 11).

3. — Është fjala për programin e politikës së jashtme agresive të qeverisë së SHBA në Lindjen e Afërme e të Mesme, i shpallur zyrtarisht më 9 mars 1957, pas nënshkrimit nga presidenti Ajzenhauer të rezolucionit të përbashkët të të dy dhomave të Kongresit. Rezolucioni i jep të drejtë presidentit të përdorë forcat e armatosura të SHBA në Lindjen e Afërme dhe të Mesme kundër çdo vendi që ndodhet gjoja «nën kontrollin e komunizmit ndërkombëtar».

Kjo doktrinë përfaqëson në vetëvete politikën kolonialiste e imperialiste dhe drejtohet kryesisht kundër lëvizjes nacional-çlirimtare të popujve. (f. 13).

4. — Bloku ushtarak i Atlantikut Verior. Shih PPSH Dokumenta kryesore, vëllimi II, f. 549, shënimi 12. (f. 15).

5. — Është fjala për revoltën kundërrevolucionare të organizuar nga imperializmi ndërkombëtar dhe revizionistët në Poznan të Polonisë në qershor 1956 për të përmbysur rendin socialist e për të rivendosur kapitalizmin në Poloni. (f. 20).

6. — Plenumi VIII i PPBP zhvilloi punimet në tetor 1956. (f. 20).

7. — Kongresi VIII i PKI zhvilloi punimet në Romë prej 8 deri 14 dhjetor. Ky kongres revizionoi parimet programatike e taktike të partisë dhe bëri në statutin e partisë ndryshime të tilla që i hapën rrugën degjenerimit të saj. (f. 23).

8. — V. I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 5. (f. 25).

9. — Artikulli i Zhenminzhibaos, «Përsëri mbi eksperiencën historike të diktaturës së proletariatit», Shih «Zëri i Popullit», dt. 30 dhjetor 1956. (f. 26).

10. — V. I. Lenin. Veprat, vëll. 21, f. 233. (f. 29).

11. — Konferenca e Tiranës u mbajt në prill 1956. Në këtë konferencë elementët armiq, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre që mundën të zgjidheshin delegatë, u hodhën në sulm kundër vijës dhe udhëheqjes marksiste-leniniste të Partisë. Ata shtruan platformën e tyre antimarksiste, që synonte rishikimin e vijës politike të Partisë në frymën e Kongresit XX të PKBS. E gjithë kjo

punë armiqësore ishte kurditur nga forcat revizioniste dhe drejtohej nga klika e Titos nëpërmjet legatës jugosllave në Tiranë.

Elementët antiparti, duke shpërdoruar demokracinë e brendshme të Partisë, krijuan një gjendje të nderë në konferencë. Komiteti Qendror e vlerësoi gjendjen tepër serioze dhe dërgoi në konferencë shokun Enver Hoxha, i cili demaskoi qëllimet e revizionistëve dhe parashtoi qëndrimin e vendosur të PPSH për ruajtjen e pastërtisë së politikës dhe praktikës së saj revolucionare. Delegatët e konferencës mbështetën plotësisht këtë qëndrim të Partisë dhe dënuan orvatjet e armiqve për ta larguar atë nga vija e saj marksiste-leniniste. Komploti revizionist dështoi. (f. 31).

12. — V. I. Lenin. Veprat, vëll. 32, f. 283-284. (f. 36).
13. — K. Marks — F. Engels. Veprat, vëll. 13, pjesa I, f. 67. (f. 36).
14. — Shih V. I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 34. (f. 37).
15. — V. I. Lenin. Veprat, vëll. 25, f. 54. (f. 37).
16. — Shih K. Marks — F. Engels. Vepra të zgjedhura, vëll. II, f. 23. (f. 38).
17. — V. I. Lenin. Veprat, vëll. 32, f. 553. (f. 39).
18. — V. I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 8, 33 (f. 39).
19. — V. I. Lenin. Veprat, vëll. 29, f. 430. (f. 39).
20. — K. Marks — F. Engels. Veprat, vëll. 15, f. 137. (f. 39).
21. — Eliksiri i qëmotit — pije fantastike që sipas alkimistëve gjoja zgjat jetën dhe ruan rininë e përjetshme. (f. 40).
22. — V. I. Lenin. Veprat, vëll. 29, f. 432. (f. 42).
23. — Provokacioni i Berlinit u krye më 17 qershor 1953 nga imperializmi për të vënë në rrezik fitoret e socializmit dhe çështjen e paqes. (f. 42).
24. — Është fjala për plenumin VIII të KQ të PKSH që u mbajt në shkurt të vitit 1948. Plenumi u pregatit nga grupi i Koçi Xoxes dhe udhëheqësit revizionistë jugosllavë me qëllim që të mposhtnin PKSH dhe të krijonin truallin për kolonizimin e Shqipërisë. (f. 44).
25. — Në kohën kur forcat e armatosura greke shkelën kufitë e Shqipërisë (2 gusht 1949) klika titiste ndërmori një lëvizje kërcënuese trupash në kufitë veriorë të Shqipërisë, në rrethin e Strugës e të Ohrit dhe mori përsipër armatosjen e elementëve reaksionarë shqiptarë që ishin pregatitur të delnin në mal për të organizuar një «kryengritje». Veprimtaria e tyre dështoi. (f. 45).
26. — Është fjala për bisedimet midis delegacionit qeveritar të BRSS dhe Qeverisë Jugosllave që u zhvilluan në Beograd prej 27 majit deri me 2 qershor 1955. Rezultat i këtyre bisedimeve qe Deklarata e Beogradit, e cila shërbeu për rehabilitimin e klikës titiste, duke hedhur poshtë vendimet e Byrosë Informativë e vlerësimet e gjithë partive komuniste e punëtore lidhur me tradhëtinë e kësaj klike. (f. 45).
27. — V. I. Lenin. Veprat, vëll. 19, f. 37. (f. 52).
28. — Është fjala për kryengritjen kundërrevolucionare të organizuar nga revizionizmi dhe imperializmi ndërkombëtar për të përmbysur diktaturën e proletariatit dhe rendin socialist në Hungari. (f. 81).

29. — Është fjala për vendimin e Plenumit të KQ të PPSH datë 27 prill 1955 «Mbi punën ideologjike të Partisë dhe masat për përmirësimin e saj». Shih PPSH Dokumenta kryesore, vëll. II, f. 347. (f. 81).

30. — Me vendime të veçanta të KQ të PPSH planet e prodhimit të industrisë së naftës janë reduktuar për shkak të parashikimeve të shpejtuara që ishin bërë më parë. Në sajë të punës vetmohuese dhe ndërgjegjes së lartë të punëtorëve, teknikëve dhe inxhinierëve të naftës në vitin 1960 prodhimi i industrisë së naftës arriti 417 për qind në krahasim me vitin 1955. (f. 156).

31. — Shih Direktivat e Kongresit III të Partisë së Punës të Shqipërisë, «Vendimet, rezolucioni dhe direktivat mbi planin e dytë pesëvjeçar» (Vendosur nga Kongresi III i PPSH). Tiranë 1956, f. 71. (f. 164).

32. — Në vitin 1965 problemet e sistemit të pagave, të kategorizimeve dhe të normimit të punës u hiqen Bashkimeve Profesionale dhe i kalojnë plotësisht drejtorisë përkatëse në Komisionin e Planit të Shtetit. (f. 173).

33. — Në vitin 1958 Bashkimeve Profesionale përveç sigurimeve shoqërore u kaluan për administrim nga Ministria e Financave edhe pensionet. Në vitin 1965 sigurimet shoqërore dhe pensionet ju hoqën Bashkimeve Profesionale dhe ju kaluan drejtorive përkatëse në Ministrinë e Financave. (f. 177).

34. — Këshilli Ekonomik i Ndihmës Reciproke zhvilloi punimet prej 20 deri më 23 maj 1958 në Moskë. Mbledhja e përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore të vendeve pjesëmarrëse të KENR-it diskutoi probleme të zhvillimit të mëtejshëm të marrëdhënjeve ekonomike midis vendeve socialiste në bazë të zbatimit rigoroz të ndarjes socialiste ndërkombëtare të punës, të specializimit e të kooperimit racional të prodhimit. (f. 185).

35. — Kongresi VII i LKJ që u mbajt prej 22-26 prill 1958 në Lublanë aprovoi një program fund e krye antimarksist e revizionist, që shërbeu si platforma ideologjike e revizionizmit ndërkombëtar, duke u drejtuar kundër marksizëm-leninizmit e forcave revolucionare në botë dhe kundër dokumentave historike të Moskës të vitit 1957. (f. 185).

36. — V. I. Lenin. Veprat, vëll. 18, f. 653. (f. 188).

37. Plani Marshall. Shih PPSH Dokumenta kryesore, vëll. II, f. 547, shënimi 4 (f. 192).

38. — Enver Hoxha. «Fjala në konferencën e 6-të të organizatës së Partisë të qytetit të Tiranës», 15 mars 1959. (f. 314).

39. — V. I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 333. (f. 322).

40. — F. Engels. «Anti Dyring», f. 320. (f. 322).

41. V. I. Lenin. Veprat, vëll. 2, f. 549. (f. 322).

42. — Enver Hoxha. Raport i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë në Kongresin III të Partisë. Tiranë, 1956, f. 133. (f. 360).

43. — V. I. Lenin. Veprat, vëll. 5, f. 453. (f. 379).

44. — Shih Rezolucionin e Kongresit III të Partisë së Punës të Shqipërisë. «Vendimet, rezolucioni dhe direktivat mbi planin e dytë pesëvjeçar» (Vendosur nga Kongresi III i PPSH). Tiranë, 1956, f. 22. (f. 382).

45. — V. I. Lenin. Veprat, vëll. 33, f. 276, (f. 389).

46. — Shih, V. I. Lenin. Veprat, vëll. 32, f. 100. (f. 394).

47. — Në dhjetor të vitit 1959, kryetari i qeverisë sovjetike N. Hrushov, i cili ishte për zgjidhjen e problemeve të rëndësishme ndërkombëtare vetëm nëpërmjet bisedimeve me krerët e imperializmit, siguroi, nëpërmjet kanaleve diplomatike, thirrjen e një konference të nivelit të lartë me pjesëmarrjen e kryetarëve të BRSS, SHBA, Anglisë dhe Francës. Kjo konferencë do të mbahej në maj të vitit 1960 por nuk mundi të zhvillonte punimet për shkak të sabotimit nga ana e imperialistëve amerikanë dhe të qëndrimit të lëkundshëm prej aventurieri të N. Hrushovit. (f. 419).

48. — Me anën e këtij propozimi dhe të notave që qeveria sovjetike u dërgoi më 25 maj 1959 qeverive të Shqipërisë, Bullgarisë, Rumanisë, Jugosllavisë, Turqisë, Greqisë, Italisë, Francës, Anglisë dhe SHBA kërkohet që të krijohej në Ballkan dhe në rajonin e Adriatikut një zonë pa armë bërthamore dhe pa raketa. (f. 424).

49. — Deklaratë e Mbledhjes së përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore të vendeve socialiste. f. 24. Tiranë 1958, (f. 428).

50. — Më 2 qershor 1960 KQ i PKBS me anën e një letre propozonte që në fund të muajit qershor të bëhej një mbledhje e përfaqësuesve të Partive Komuniste e punëtore të kampit socialist «për këmbimin e mendimeve mbi çështjet e gjendjes së sotme ndërkombëtare dhe për përcaktimin e vijës sonë të mëtejshme të përbashkët». Ndërsa më 7 qershor 1960 KQ i PKBS me një letër tjetër shprehte mendimin që mbledhja të mos mbahej në qershor, kurse data e mbledhjes të caktohej në një takim paraprak që do të bënin përfaqësuesit e Partive Komuniste e Punëtore të vendeve socialiste në Bukuresht, gjatë kohës që do të zhvillonte punimet Kongresi III i Partisë Punëtore Rumune. (f. 429).

51. — Në Plenumin II të KQ të PPSH që u mbajt në nëntor të vitit 1944 në Berat, i dërguari i KQ të PKJ organizoi në prapaskenë një komplot kundër PK të Shqipërisë me pjesëmarrjen e elementëve antiparti Sejfulla Malëshova, Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo. Qëllimi kryesor i këtij komploti ishte përmbysja e udhëheqjes së partisë me shokun Enver Hoxha në krye dhe zëvendësimi i saj me një udhëheqje të re jugosllave. (f. 445).

52. — Është fjala për demaskimin nga një forum me përfaqësi të gjërë të partive komuniste e punëtore, siç është Mbledhja e Moskës e 81 Partive, por revizionistët jugosllavë janë kritikuar ashpër e demaskuar si agjenturë e imperializmit e tradhëtarë të marksizëm-leninizmit edhe në rezolutat e Byrosë Informative të qershorit 1948. (f. 496).

53. — Në pranverë të vitit 1961 qeveria revizioniste sovjetike, me qëllim që të gjunjëzohet e nënshtrojë PPSH e popullin shqiptar, në mënyrë të njëanshme, duke shkelur marrëveshjet e nënshkuara më parë, preu të gjitha ndihmat e kreditë që detyrohej t'i jepte RPSH për planin e tretë pesëvjeçar 1961-1965. Në vitin 1962 u prenë kreditë edhe nga qeveritë e disa vendeve të demokracisë popullore, që ndiqnin kursin dhe shembullin e qeverisë sovjetike. (f. 500).

54. — Më 29 maj të vitit 1960 filluan punimet për ndërtimin e Pallatit të Kulturës, por në janar të vitit 1961 pala sovjetike i ndërpreu krejtësisht

furnizimet për ndërtimin e këtij pallati si në projekte ashtu edhe në materiale, ndërsa në prill ajo tërhoqi edhe të gjithë specialistët që punonin për ndërtimin e tij. Kjo ishte një masë tjetër presioni kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe popullit shqiptar.

Më 5 maj 1961, qeveria e RPSH mori vendim për financimin e ndërtimit të pallatit dhe përgatitjen e projekteve përkatëse nga organizatat tona të projektimit.

Duke ndërtuar me forcat e veta Pallatin e madh të Kulturës populli ynë i dha një goditje të fortë klikës revizioniste hrushoviane. (f. 576).

TREGUESI I LËNDËS

Parathënje	5
------------------	---

— 1957 —

1. Plenumi III i KQ të PPSH. Tiranë, 13-16 shkurt 1957.	9
Nga raporti i mbajtur nga Sekretari i Parë i KQ të PPSH shoku Enver Hoxha «Mbi gjendjen ndërkombëtare dhe detyrat e Partisë».	9
Vendim i Plenumit të KQ të PPSH «Mbi aprovimin e raportit të Byrosë Politike të KQ të PPSH të paraqitur nga shoku Enver Hoxha»	53
2. Plenumi VI i KQ të PPSH. Tiranë, 10-12 korrik 1957.	54
Nga raporti i Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi gjendjen e kuadrit në RPSH dhe detyrat për të ardhshmen».	54
Nga vendimi i Plenumit të KQ të PPSH «Mbi masat për zhvillimin e mëtejshëm të tregëtisë shtetërore e kooperativiste».	101
3. Vendim i Këshillit të Ministrave të Republikës Popullore të Shqipërisë dhe i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë «Mbi heqjen e plotë të sistemit të triskëtimit, zbritjen e çmimeve të tregut komercial për artikujt ushqimorë, zbritjen e çmimeve unike të artikujve industrialë e ushqimorë, ngritjen e pagave të punëtorëve dhe nëpunësve, rritjen e pensioneve, bursave të studentëve, ndihmën për fëmijët e prindërve në marrëdhënje pune, rritjen e çmimeve të grumbullimeve të detyrueshme, si dhe mbi rregullimin e çmimeve të tepricave të prodhimeve bujqësore në bazë të çmimeve unike të shitjes me pakicë», 19 gusht 1957.	123

	Faqe
4. Plenumi VII i KQ të PPSH. Tiranë, 2 dhjetor 1957.	133
Nga rezoluta e Plenumit të KQ të PPSH «Mbi mbledhjen e përfaqësuesve të partive komuniste e punëtorë të vendeve socialiste dhe mbledhjen e përfaqësuesve të partive komuniste e punëtorë që muarën pjesë në festimin e 40-vjetorit të Revolucionit socialist të Tetorit, si dhe mbi veprimtarinë e delegacionit të Partisë e të qeverisë sonë në Moskë»	
	133
— 1958 —	
5. Plenumi VIII i KQ të PPSH. Tiranë, 3-5 shkurt 1958	136
Vendim i Plenumit të KQ të PPSH «Mbi rezultatet e arritura në realizimin e planit të shtetit dhe të buxhetit për vitin 1957 dhe detyrat e planit dhe të buxhetit për vitin 1958» ..	
	136
Vendim i Plenumit të KQ të PPSH «Mbi shtesat në planin e dytë pesëvjeçar për zhvillimin ekonomik e kultural të Republikës Popullore të Shqipërisë»	
	151
6. Plenumi IX i KQ të PPSH. Tiranë, 1-2 prill 1958.	166
Vendim i Plenumit të KQ të PPSH «Mbi masat për përmirësimin e mëtejshëm të punës në Bashkimet Profesionale të Shqipërisë»	
	166
7. Plenumi X i KQ të PPSH. Tiranë, 20 qershor 1958.	185
Raport i mbajtur nga Sekretari i Parë i KQ të PPSH shoku Enver Hoxha «Mbi pikëpamjet antimarksiste e antisocialiste të grupit Tito që u shprehën edhe një herë në Kongresin VII të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë e programin e saj dhe mbi luftën pa kompromis që duhet bërë për demaskimin e shkatërrimin politik e teorik të revizionizmit modern» ..	
	186
Vendim i Plenumit të KQ të PPSH Mbi aprovimin e raportit të paraqitur nga Sekretari i Parë i KQ të PPSH shoku Enver Hoxha.	
	199
8. Vendim i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë «Mbi përmirësimin e punës së shkollave», 31 korrik 1958 ..	200
9. Plenumi XI i KQ të PPSH. Tiranë, 3-4 nëntor 1958.	217
Vendim i Plenumit të KQ të PPSH «Mbi pjesëmarrjen në punë fizike të kadrove drejtues dhe nëpunësve të aparateve të Partisë, të shtetit dhe të organizatave të masave»	
	217

	Faqe
10. Plenumi XII i KQ të PPSH. Tiranë, 26-27 dhjetor 1958.	221
Vendim i Plenumit të KQ të PPSH «Mbi rezultatet e arritura në realizimin e planit dhe të buxhetit të shtetit për vitin 1958 dhe detyrat e planit dhe të buxhetit për vitin 1959» ..	
	221
— 1959 —	
11. Vendim i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë «Mbi traditat patriotike-revolucionare të popullit tonë dhe masat për njohjen dhe zhvillimin e tyre të mëtejshëm». 7 korrik 1959 ..	245
12. Plenumi XIV i KQ të PPSH. Tiranë, 2-3 nëntor 1959.	252
Vendim i Plenumit të KQ të PPSH «Mbi masat që duhen marrë për zhvillimin e ekonomisë pyjore, shfrytëzimin racional dhe ekonomizimin e lëndës së drurit»	
	252
Vendim i Plenumit të KQ të PPSH «Mbi shtimin e sipërfaqes së tokave të ujitshme dhe mbi teknikën e ujitjes» ..	
	268
13. Plenumi XV i KQ të PPSH. Tiranë, 22-23 dhjetor 1959.	279
Vendim i Plenumit të KQ të PPSH «Mbi rezultatet e arritura në realizimin e planit dhe të buxhetit gjatë katër vjetëve të pesëvjeçarit të dytë dhe detyrat e planit dhe të buxhetit për vitin 1960» ..	
	279
— 1960 —	
14. Plenumi XVI i KQ të PPSH. Tiranë, 25-26 maj 1960.	299
Vendim i Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë «Mbi zhvillimin e mëtejshëm të ndërtimeve» ..	
	299
Vendim i Plenumit të KQ të PPSH «Mbi thirrjen e Kongresit IV të zakonshëm të Partisë së Punës të Shqipërisë» ..	
	319
15. Teza të Komitetit Qendror të PPSH dhe të Këshillit të Ministrave të RPSH «Për lidhjen e ngushtë të shkollës me jetën dhe zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të arësimit popullor». 14 qershor 1960	321
16. Plenumi XVII i KQ të PPSH. Tiranë, 11-12 korrik 1960. Komunikatë.	338
17. Letër e KQ të PPSH drejtuar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik lidhur me incidentin e kryer në Ambasadën e RP të Shqipërisë në Poloni. 21 korrik 1960	340

	Faqe
18. Letër e KQ të PPSH drejtuar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik lidhur me ndërhyrjen e hapët në punët e brendshme të PPSH dhe të shtetit shqiptar nga disa funksionarë të Ambasadës së BS në Tiranë, 6 gusht 1960.	344
19. Letër e KQ të PPSH drejtuar gjithë organizatave bazë të Partisë mbi zhvillimin e Mbledhjes së Bukureshtit të qershorit 1960 dhe mbi mosmarrëveshjet që kishin lindur midis Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste të Kinës, 9 gusht 1960	348
20. Letër e KQ të PPSH drejtuar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik lidhur me propozimin e bërë nga KQ i PKBS për organizimin e një takimi të përfaqësuesve të PKBS dhe të PPSH para mbledhjes së nëntorit të vitit 1960 të partive komuniste dhe punëtore në Moskë. 29 gusht 1960	353
21. Plenumi XVIII i KQ të PPSH. Tiranë, 5-8 shtator 1960.	356
Raport i Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi disa çështje të punës organizative të partisë».	357
Vendim i Plenumit të KQ të PPSH «Mbi disa çështje të punës organizative të Partisë».	409
22. Plenumi XIX i KQ të PPSH. Tiranë, 7-8 tetor 1960.	410
Vendim i Plenumit të KQ të PPSH «Mbi riorganizimin e shkollës dhe zhvillimin e mëtejshëm të sistemit arësorim». .	411
23. Plenumi XX i KQ të PPSH. Tiranë, 1 nëntor 1960.	
Komunikatë.	413
24. Fjala e mbajtur nga shoku Enver Hoxha në emër të KQ të PPSH në Mbledhjen e 81 partive komuniste dhe punëtore në Moskë. 16 nëntor 1960.	414
25. Letër e KQ të PPSH drejtuar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik lidhur me rifillimin e bashkëbisedimeve midis përfaqësuesve të PKBS dhe PPSH. 21 nëntor 1960. . .	463
26. Plenumi XXI i KQ të PPSH. Tiranë, 19-20 dhjetor 1960.	466
Nga rezoluta e Plenumit të KQ të PPSH mbi Mbledhjen e përfaqësuesve të 81 partive komuniste e punëtore në Moskë në nëntor 1960.	466
27. Letër e KQ të PPSH drejtuar gjithë organizatave bazë të Partisë mbi zhvillimin e Mbledhjes së Moskës të vitit 1960 të 81 partive komuniste e punëtore dhe mbi qëndrimin e PPSH në luftën kundër revizionizmit modern, 31 dhjetor 1960.	468

	Faqe
— 1961 —	
28. Letër e KQ të PPSH drejtuar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, me anën e së cilës kritikohen përpjekjet e udhëheqjes sovjetike për të sabotuar marrëveshjet ekonomike midis RP të Shqipërisë dhe BRSS për periudhën 1961-1965. 14 janar 1961.	505
29. Letër e KQ të PPSH drejtuar Komitetit Qendror të Partisë Socialiste të Bashkuar Gjermane, me anën e së cilës protestohet për akuzat e ngritura në fjalimin e sekretarit të parë të KQ të PS të Bashkuar Gjermane Valter Ulbriht kundër Partisë së Punës të Shqipërisë. 14 janar 1951.	510
30. Plenumi XXII i KQ të PPSH. Tiranë, 6 shkurt 1961.	
Komunikatë.	613
31. Kongresi IV i Partisë së Punës të Shqipërisë. Tiranë 13-20 shkurt 1961.	514

Vendime të Kongresit IV të PPSH:

— për aprovimin e raportit «Mbi veprimtarinë e KQ të PPSH».	515
— për aprovimin e raportit të Komisionit Qendror të Revizionimit të PPSH	515
— për raportin «Mbi direktivat e planit të tretë pesëvjeçar të zhvillimit ekonomik e kultural të Republikës Popullore të Shqipërisë».	516
— «Mbi disa ndryshime në Statutin e Partisë së Punës të Shqipërisë».	516
Rezolucion i Kongresit IV të PPSH për raportin «Mbi veprimtarinë e Komitetit Qendror të PPSH».	517
Direktivat e Kongresit IV të PPSH «Mbi planin e tretë pesëvjeçar të zhvillimit ekonomik e kultural të Republikës Popullore të Shqipërisë gjatë vjetëve 1961-1965».	538